



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar auditimi i ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës
dhe Energjisë si dhe në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI

**AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË
NË LICENCIMIN DHE MONITORIMIN E SUBJEKTEVE ME
VEPRIMTARI NË FUSHËN MINERARE**

Tetor 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-8
	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimet	3-6
	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	6-8
II.	HYRJA	8-13
	Titulli	9
	Marrësi	9
	Objekti dhe qëllimi i auditimit	9
	Identifikimi i çështjes	10
	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjekteve të audituara:	10
	Përgjegjësitë e audituesve	10
	Kriteret e vlerësimit	11
	Standardet e auditimit	12
	Metodat e auditimit	12
	Dokumentimi i auditimit	13
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13-149
1	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektet në auditim	13-15
2	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:	15-149
2.1	<i>Auditim mbi zbatimin e procedurës së licencimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare.</i>	15-53
2.2	<i>Auditim mbi zbatimin e procedurave dhe rezultatet e monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare, si dhe të shoqërive minerare publike.</i>	53-120
2.3	<i>Auditim mbi përdorimin e fondit pyjor dhe kullësor publik nga subjektet e licencuara në fushën e minierave dhe procedurat e ndjekura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në përdorimin e territorit për këtë qëllim.</i>	120-130
2.4	<i>Çështje të tjera të dala gjatë auditimit.</i>	130-149
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	149-170

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore me kriteret e vlerësimit përfshirë rregullat, rregullore dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në, ushtrimin e aktivitetit përkatës duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me periudhën e aktivitetit 2018-2022.

- Veprimtaria dhe shkalla e zbatimit të kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës së Energjisë në procedurat e licencimit të subjekteve me veprimtari në fushën minerare.

- Shkallën e zbatimit të përgjegjësisë dhe funksioneve nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në monitorimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare.

- Përdorimi i fondit pyjor dhe kullor publik nga subjektet e licencuara në fushën e minierave dhe procedurat e ndjekura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në përdorimin e territorit për këtë qëllim.

I.2. Përmbledhje e gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore nga auditimi.

Nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Ref.	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p><i>Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)</i> nuk janë respektuar rregullat dhe procedurat e licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare, shpalljen e zonave dhe zhvillimin e procedurave konkurruese operatorëve ekonomikë, procedurat e shqyrtimit të ankesave nga njësia e ankimimit, ushtrimin e përgjegjesive ligjore mbi revokimet dhe pezullimet e lejeve minerare të shfrytëzimit, heqjen nga fondi pyjor e kullor të sipërfaqeve të dhëna në shfrytëzim për subjektet private të licensuara në këtë sektor; mos respektim i kushteve dhe administrimin e dokumentacionit që duhet të plotësojnë aplikuesit për një leje minerare, për vlerësimin e përbushjes së kushteve të përcaktuara në aktet ligjore. <i>MIE si ministria e linjës administrative</i>, nuk ka siguruar koordinimin dhe bashkërendimin e roleve dhe funksioneve me strukturat përgjegjëse respektive në ministritë e linjës, me qëllim ushtrimin nga ana e këtij institucioni të gjitha kompetencave dhe mekanizmave ligjor për zgjidhjen e të gjitha çështjeve me institucionet e varësisë (AKBN) si dhe me ministritë e linjës (MTM), për të shmangur procedurat e ri aplikimit për pajisje me leje minerare. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për rastet e moskryerjes së inspektimeve dhe mbikëqyrjeve nga AKBN sipas ligjit, nuk ka marrë masat për nxjerrjen e përgjegjesive apo rishikimin e kapaciteteve njerëzore dhe fondeve në dispozicion të kësaj strukture, etj.</p>		E lartë	<p>Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të merren masat për zbatimin e procedurës së licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare duke respektuar kushtet e detajuara dhe dokumentet shoqëruese për vlerësimin e përbushjes së kushteve që duhet të plotësojnë aplikuesit për një leje minerare dhe procedura e trajtimit të kërkesave me afatet, të përcaktuara me aktet ligjore.</p> <p>- MIE si organ i drejtimit politik i cili ushtron detyrat dhe funksionet e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, nëpërmjet Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minierave, midis të tjerave të sigurojë mbajtjen e kontakteve edhe me strukturat paralele në ministritë e linjës, duke i dhënë MIE të gjitha kompetencat dhe mekanizmat ligjor për zgjidhjen e të gjitha çështjeve me institucionet e varësisë (AKBN) si dhe me ministritë e linjës (MTM), për të shmangur procedurat e ri aplikimit për pajisje me leje minerare.</p> <p>- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të marrë masat për revokimin e licensave të mësipërme me parregullsi dhe shkelje të rënda ligjore, nënligjore dhe rregullative në zbatimin e kriterëve për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare.</p>

2	<p>Nga ana e MIE dhe AKBN nuk kanë ndërmarrë iniciativa për përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe hartimin e akteve nënligjore, me qëllim përcaktimin e procedurave administrative dhe afatet ligjore për çështje të parregulluara deri në mbajtjen e raportit të auditimit, të tilla si <i>procedurat (gjurma e auditimit) dhe afatet e vlefshmërisë së pezullimit të përkohshëm, si për rastin e pezullimit mbi bazën e kërkesës së vetë subjektit dhe të ndëshkimit nga strukturat përgjegjëse</i>, kjo, në funksion të disiplinimit dhe standardizimit përfundimisht të proceseve dhe procedurave të sektorit mineral. Mangësi në zbatimin e plotë të rregullave për zhvillimin e veprimtarive minerare e postminerare; nuk janë ndjekur detyrimet e zotëruesit pas revokimit të lejes për të vjelë dëmshpërblimin përkatës për dëmet shkaktuar shtetit nga shkeljet e zotëruesit të lejes minerare; mungesë e përditësimit dhe azhurnimit të regjistrimit mineral duke përfshirë të gjitha të dhënat për regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje, respektimin e projektit dhe kryerjen e operacioneve minerare, vlerësimin e investimeve të raportuara nga zotëruesit e lejeve minerare, mos sigurim i punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë, sipas rregullave të sigurimit, etj.</p>		E lartë	<p>Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative të vlerësojë dhe shqyrtojë provat e sjella nga subjekti për shfuqizimin e masave administrative të marra ndaj zotërueseve të lejeve minerare nëse janë të mjaftueshme për të marrë vendim shfuqizimi ose lënien në fuqi të aktit administrativ, me argumentimin e zbatimit të drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankuesi ka pretenduar shkelje.</p> <p style="text-align: right;"><i>Në vijimësi</i></p>
3	<p>Nga ana e AKBN, në cilësinë e strukturës përgjegjëse të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nuk është përmbushur detyrimi ligjor i kryerjes së inspektimeve së paku dy herë në vit, i të gjitha subjekteve-zotërues të lejes minerare të shfrytëzimit; nuk ka miratim të programit vjetor për ushtrimin e kontrolleve në çdo veprimtari minerare; raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit të këtyre subjekteve nuk japin informacion të plotë e të rakorduar mbi numrin e të punësuarve, sigurimin e jetës së punonjësve, realizimin e prodhimit, treguesit teknologjikë, realizimin e investimeve, realizimin e shitjeve brenda dhe jashtë vendit, të ardhurat e realizuara nga shitjet brenda vendit dhe eksportet, rentën minerare; neglizhencë dhe mosveprime për marrjen e masave në përputhje me ligjin mineral për mosshlyerjen në afat të garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit apo realizimit të investimit; dobësi në kryerjen e procedurave të monitorimit postminerar të objekteve minerare, etj. Nuk është hartuar dhe miratuar një udhëzues i detajuar (në plotësim të kuadrit ligjor dhe rregullator bazë), lidhur mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e</p>		E lartë	<p>AKBN, Strukturat Përgjegjëse në plotësim të kuadrit ligjor dhe rregullator të miratuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të hartojnë dhe miratojnë një udhëzues të detajuar, ku të pasqyrohen të dhënat mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen. - të kryejnë inspektimin çdo 6 muaj të të gjitha subjekteve minerare dhe të miratojnë planet vjetore të punës të subjekteve-zotërues të lejes minerare; - të miratojnë programe periodike ose të posaçëm, për të ushtruar kontrolle në çdo veprimtari minerare; duke hartuar raporte për mbikëqyrjen e monitorimin e këtyre subjekteve për çdo 6-mujor; ku të shprehen për numrin e punëtoreve, realizimin e prodhimit, treguesit teknologjikë, realizimin e investimeve, realizimi i shitjeve brenda dhe jashtë vendit, të ardhurat e realizuara nga shitjet brenda vendit dhe eksportet, realizimi i rentës minerare; etj. - Të marrin masat për të përputhur treguesit e paraqitur në raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit me treguesit e raportuar në sistemin

	<p>të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen. me qëllim lehtësimin e veprimtarinë monitoruese dhe inspektuese të strukturave përgjegjëse, si dhe aspekte të tjera të aktivitetit të AKBN përsa i përket shqyrtimit dhe miratimit të planeve vjetore, aplikimin e sanksioneve dhe masave ndëshkimore për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit teknik dhe financiar, si dhe mos kryerjen e raportimin e monitorimeve në përputhje me kriteret e aprovuara; zbatimin e komponentëve të strategjisë minerare, etj.</p>			<p>REVZONE dhe treguesit e planit vjetor të miratuar të veprimtarisë minerare të dërguara on line nga subjektet AKBN.</p> <p>- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për rastet e moskryerjes së inspektimeve dhe mbikëqyrjeve nga AKBN sipas ligjit të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive apo rishikimin e kapaciteteve njerëzore dhe fondeve në dispozicion të kësaj strukture.</p> <p style="text-align: right;"><i>Në vijimësi</i></p>
4	<p>Nga ana e AKSEM nuk rezulton ti jenë nënshtruar kontrollit teknik të Autoritetit të gjithë minierat dhe karrierat në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi etj.</p>		E lartë	<p>AKSEM të marrë masat për kryerjen e plotë dhe në mënyrë të vazhdueshme të inspektimeve në veprimtaritë minerare dhe ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave energjetike për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në minierat nëntokësore dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve.</p>
5	<p>Shoqëritë anonime në likuidim e sipër në sektorin minerar</p> <p>Bashkimi i shoqërive që veprojnë në sektorin minerar ka rezultuar, krahas të tjerave, me mungesë pothuajse totale, jo vetëm të dokumentacionit ekonomik - financiar, por dhe atij teknik, (si, harta topografike, planimetri të minierave, koordinata të vendndodhjes së punimeve minerare, etj.), si për objektet ndërtimore sipërfaqësore dhe për punimet minerare të 34 minierave në juridiksionin e Shoqërisë "A.", duke krijuar probleme të vazhdueshme në administrimin e aseteve të Shoqërisë, por dhe në përcaktimin e saktë të zonave minerare të rrezikshme në territoret e juridiksionit të kësaj shoqërie. Nuk ka bilance ekonomike të sakta të ish-minierave, për periudhën që ato kanë funksionuar si subjekte më vete; llogaritë inventariale të tyre kanë qenë të paargumentuara, rezultojnë 613 pasuri të miratuara për privatizim ndër vite, për të cilat procesi i vlerësimit nuk ka vijuar për arsye të ndryshme etj.</p>		E lartë	<p>MIE dhe "A." sha të marrin masat për rivlerësimin e aktiveve afatgjata pasuri sipërfaqësore që administrohen nga "A." sha në likuidim e sipër, të cilat janë kontabilizuar sipas të dhënave që i përkasin periudhës 1970 e në vijim, për përputhjen e gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me dokumentacionin financiar me qëllim pasqyrimin e vërtetë të vlerave të këtyre pasurive.</p> <p>- Nga MIE të përshpejtohet procesi ligjor i likuidimit të këtyre shoqërive, deri në shkrirjen dhe çregjistrimin përfundimtar të këtyre shoqërive duke evituar shpenzimet e konsiderueshme që i ngarkohen buxhetit të shtetit për kostot e stafit administrativ të minierave, shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe shpenzimet për kontraktimin e ekspertëve kontabël me status "Sha në likuidim e sipër" pasi këto shoqëri nuk kryejnë asnjë aktivitet prodhues por vetëm monitorimin e minierave dhe aseteve. Gjithashtu nga MIE, të studiohet dhe gjykohet mundësia e bashkimit me anë të përthithjes së të këtyre tre sha-ve që operojnë në sektorin e industrisë minerare, në një shoqëri më vete, e cila duhet të realizojë procedurat e likuidimit të shoqërisë dhe të përjashtohet nga skema e financimit buxhetor.</p> <p>- Nga MIE të merren masat për koordinimin dhe bashkërendimin me shoqëritë në likuidim e sipër, për rastet</p>

				kur këto pasuri, galeri dhe zona minerare, jepen për shfrytëzim sipas lejeve të shfrytëzimit, për zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit, që janë pjesë e këtyre shoqërive në likuidim e sipër.
--	--	--	--	---

1.3 Konkluzioni i përgjithshëm i Auditimit.

Auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin e sistemit të licensimit, shfrytëzimit dhe mbikëqyrjes e monitorimit të veprimtarisë minerare, në strukturat përgjegjëse Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare të Burimeve Natyrore, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, si dhe në disa shoqëri tregtare që veprojnë në këtë sektor për periudhën 2018-2022, e vlerëson këtë sistem pjesërisht funksional dhe pjesërisht efikas, pasi:

- ka rezultuar se, këto institucione shtetërore janë të ekspozuara ndaj risqeve ligjore, ekonomike, financiare, mjedisore, etj., si dhe mangësive domethënëse të ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësive të tyre zyrtare, me ndikim të mundshëm në shfrytëzimin e zonave minerare, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre pasurive publike dhe kryerjen e këtyre veprimtarive me interes publik;
- gjetjet e auditimit dëshmojnë për një sërë dobësish, parregullsish e shkeljesh të karakterit, tekniko-ekonomik, financiar e administrativ, kundrejt kërkesave të ligjit minerar dhe legjislacionit mbështetës, të dalë në zbatim të tij;
- këto mangësi dhe parregullsi, mund të konsiderohen dhe klasifikohen si devijime nga kriteret, probleme thelbësore dhe sistematike, të cilat janë të përsëritura nga viti në vit.

Më hollësisht, këto dobësi e anomali janë identifikuar si më poshtë vijon:

Mbi veprimtarinë e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM):

AKSEM për periudhën e audituar nuk ka inspektuar të gjitha subjektet e planifikuara, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera” pika 5/a, si dhe në raportet vjetore të aktivitetit nuk janë paraqitur arsyet për mosrealizimin e këtyre inspektimeve.

Gjithashtu, nga analiza statistikore e treguesve të inspektimit të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe atyre të paraqitur nga AKSEM në Raportet Vjetore të Veprimtarisë ka mospërputhje të theksuara lidhur me punëmarrësit e aksidentuar dhe të aksidentuar me vdekje në miniera (Paraqitur më pak në Raportim nga AKSEM).

- Shoqëritë anonime në likuidim e sipër në sektorin minerar (“A.” SHA, “A.” SHA dhe “A.” SHA),

Bashkimi i shoqërive që veprojnë në sektorin minerar ka rezultuar, krahas të tjerave, me mungesë pothuajse totale, jo vetëm të dokumentacionit ekonomik - financiar, por dhe atij teknik, (si, harta topografike, planimetri të minierave, koordinata të vendndodhjes së punimeve minerare, etj.), si për objektet ndërtimore sipërfaqësore dhe për punimet minerare të 34 minierave në juridiksionin e Shoqërisë “A.”, duke krijuar probleme të vazhdueshme në administrimin e asetëve të Shoqërisë, por dhe në përcaktimin e saktë të zonave minerare të rrezikshme në territoret e juridiksionit të kësaj shoqërie. Nuk ka bilance ekonomike të sakta të ish-minierave, për periudhën që ato kanë funksionuar si subjekte më vete; llogaritë inventariale të tyre kanë qenë të paargumentuara, rezultojnë 613 pasuri të miratuara për privatizim ndër vite, për të cilat procesi i vlerësimit nuk ka vijuar për arsye të ndryshme, etj.

- Nga ana e AKBN, në cilësinë e strukturës përgjegjëse të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nuk është përmbushur detyrimi ligjor i kryerjes së inspektimeve së paku dy herë në vit, i të gjitha subjekteve-zotërues të lejes minerare të shfrytëzimit; nuk ka miratim të

programit vjetor për ushtrimin e kontrolleve në çdo veprimtari minerare; raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit të këtyre subjekteve nuk japin informacion të plotë e të rakorduar *mbi numrin e të punësuarve, sigurimin e jetës së punonjësve, realizimin e prodhimit, treguesit teknologjikë, realizimin e investimeve, realizimin e shitjeve brenda dhe jashtë vendit, të ardhurat e realizuara nga shitjet brenda vendit dhe eksportet, rentën minerare; neglizhencë dhe mosveprime për marrjen e masave në përputhje me ligjin mineral për mosshlyerjen në afat të garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit apo realizimit të investimit; dobësi në kryerjen e procedurave të monitorimit postminerar të objekteve minerare, etj.* Nuk është hartuar dhe miratuar një udhëzues i detajuar (në plotësim të kuadrit ligjor dhe rregullator bazë), lidhur mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen. me qëllim lehtësimin e veprimtarinë monitoruese dhe inspektuese të strukturave përgjegjëse, si dhe aspekte të tjera të aktivitetit të AKBN përsa i përket *shqyrtimit dhe miratimit të planeve vjetore, aplikimin e sanksioneve dhe masave ndëshkimore për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit teknik dhe financiar, si dhe mos kryerjen e raportimit e monitorimeve në përputhje me kriteret e aprovuara; zbatimin e komponentëve të strategjisë minerare, etj.*

- ***Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)*** nuk janë respektuar rregullat dhe procedurat e licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare, shpalljen e zonave dhe zhvillimin e procedurave konkurruese operatorëve ekonomikë, procedurat e shqyrtimit të ankesave nga njësia e ankimimit, ushtrimin e përgjegjesive ligjore mbi revokimet dhe pezullimet e lejeve minerare të shfrytëzimit, heqjen nga fondi pyjor e kullësor të sipërfaqeve të dhëna në shfrytëzim për subjektet private të licensuara në këtë sektor; mos respektim i kushteve dhe administrimin e dokumentacionit që duhet të plotësojnë aplikuesit për një leje minerare, për vlerësimin e përmbushjes së kushteve të përcaktuara në aktet ligjore. *MIE si ministria e linjës administrative, nuk ka siguruar koordinimin dhe bashkërendimin e roleve dhe funksioneve me strukturat përgjegjëse respektive në ministritë e linjës, me qëllim ushtrimin nga ana e këtij institucioni të gjitha kompetencave dhe mekanizmave ligjor për zgjidhjen e të gjitha çështjeve me institucionet e varësisë (AKBN) si dhe me ministritë e linjës (MTM), për të shmangur procedurat e ri aplikimit për pajisje me leje minerare. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për rastet e moskryerjes së inspektimeve dhe mbikëqyrjeve nga AKBN sipas ligjit, nuk ka marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive apo rishikimin e kapaciteteve njerëzore dhe fondeve në dispozicion të kësaj strukture, etj.*

- ***Nga ana e MIE dhe AKBN*** nuk kanë ndërmarrë iniciativa për përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe hartimin e akteve nënligjore, me qëllim përcaktimin e procedurave administrative dhe afatet ligjore për çështje të parregulluara deri në mbajtjen e raportit të auditimit, të tilla si *procedurat (gjurma e auditimit) dhe afatet e vlefshmërisë së pezullimit të përkohshëm, si për rastin e pezullimit mbi bazën e kërkesës së vetë subjektit dhe të ndëshkimit nga strukturat përgjegjëse, kjo, në funksion të disiplinimit dhe standardizimit përfundimisht të proceseve dhe procedurave të sektorit mineral. Mangësi në zbatimin e plotë të rregullave për zhvillimin e veprimtarive minerare e postminerare; nuk janë ndjekur detyrimet e zotëruesit pas revokimit të lejes për të vjelë dëmshpërblimin përkatës për dëmet shkaktuar shtetit nga shkeljet e zotëruesit të lejes minerare; mungesë e përditësimit dhe azhurnimit të regjistrit mineral duke përfshirë të gjitha të dhënat për regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje, respektimin e projektit dhe kryerjen e operacioneve minerare, vlerësimin e investimeve të raportuara nga zotëruesit e lejeve minerare, mos sigurim i punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë, sipas rregullave të sigurimit, etj*

- **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjekteve të audituara:**

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësi të caktuara në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së tyre në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative përkatëse.

Struktura drejtuese e njësi publike duhet të jenë të përgjegjshëm dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se e kryejnë veprimtarinë e tyre në pajtim me kriteret ligjore e normative.

Koncepti i përputhshmërisë (pajtuashmërisë) merr një rëndësi të veçantë në kushtet kur kërkesa për performancë në sektorin publik është gjithnjë në rritje, dhe marrja e sigurisë referuar përputhshmërisë me ligjet dhe rregullat, konsiderohet si një dimension jetik i përgjegjshmërisë dhe transparencës në qeverisje.

- Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Është përgjegjësi e audituesve të KLSH për të shprehur konkluzionin mbi çështjet e trajtuara në këtë auditim përputhshmërie: dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në respektimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodit të etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e konkluzioneve.

Audituesit e KLSH kanë planifikuar dhe kryer auditimin me qëllim që të vlerësohet nëse veprimtaria, aktiviteti, informacioni etj., në të gjitha aspektet janë në pajtuashmëri me kërkesat ligjore, nënligjore e rregullatore dhe janë kryer në pajtim me kompetencat e personave përgjegjës.

Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit e KLSH marrin evidencë të besueshme, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e dala lidhur me organizimin, veprimtarinë, programin dhe funksionet e subjekteve nën auditim.

Gjithashtu, audituesit e KLSH kanë përzgjedhur dhe përdorur metoda të përshtatshme për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave që plotësojnë kriteret e përcaktuara për këtë auditim, si dhe janë siguruar se teknikat e përdorura janë të mjaftueshme e të arsyeshme për të evidentuar parregullsitë në veprimtarinë e Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin dhe Komisionit Shtetëror të rindërtimit. Në zgjedhjen e metodave dhe procedurave, është marrë në konsideratë veçoria e subjekteve që auditohen, si dhe cilësia e evidencave dhe dëshmi.

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit deri në këtë fazë, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se Raporti i Auditimit dhe konkluzionet e auditimit janë të përshtatshme.

Nëpërmjet këtij auditimi përputhshmërie, KLSH luan një rol të rëndësishëm për të garantuar nëse parimet e transparencës, përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë, aplikohen dhe përmbushen nga ana e institucioneve publike.

Ky auditim përputhshmërie promovon përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr.983/1 prot., datë 31.10.2022, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 01.11.2022 deri me datë 31.05.2023, në subjektet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore për periudhën e aktivitetit 2018-2022, “Mbi përputhshmërinë në licencimin dhe monitorimin e subjekteve me veprimtari në fushën minerare”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Gj. P., Përgjegjës grupi,
2. B. Z., anëtarë,
3. Q. C., anëtarë,
4. E. C., anëtare,
5. B. H., anëtare,
6. A. M., anëtare.

Duhet theksuar se në këtë auditim janë përfshirë Njësi të Vetëqeverisjes Vendore sipas rastit, shoqëritë në likuidim: "A." SHA, "A." SHA, "A." SHA, si dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, krahas disa të dhënave të ndryshme nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

1. Titulli

Raport auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore në licencimin dhe monitorimin e subjekteve me veprimtari në fushën minerare për periudhën e aktivitetit 2018 -2022.

Raporti i auditimit është i strukturuar në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë të hyrjes janë trajtuar çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj. Në vijim është përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektet e audituara dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit. Në kreun e tretë jepet konkluzioni i përgjithshëm, bazuar në rezultatet e auditimit. Gjetjet dhe rekomandimet të strukturuar sipas llojit të tyre janë vendosur në kreun e katërt. Raporti ka kreun e pestë anekse dhe mbyllet me kreun VI-Lista e dokumenteve të auditimit.

2. Marrësi:

Marrësit e Raportit të Auditimit janë Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

3. Objektivat dhe qëllimi:

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse aktiviteti i zhvilluar për periudhën objekt auditimi përputhet me kriteret përkatëse të kuadrit ligjor, nënligjor e rregullator përkatës.

Objektivi i Auditimit është arritja e një konkluzioni nëse aktiviteti i zhvilluar për licencimin dhe monitorimin e subjekteve me veprimtari në fushën minerare është në përputhje ose jo me dispozitat ligjore, nënligjore dhe rregullatore përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimeve nga standardet e pranuarra i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë dhe kuadrit rregullator, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjekteve të audituara.

Gjithashtu, nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm nëse aktivitetet janë zhvilluar sipas një procesi të rregullt duke respektuar kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të ndërmerren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.
- Qeverisjen e mire, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:

1. Nëpërmjet konkluzioneve të arritura, dhënia e një sigurie të arsyeshme mbi veprimtarinë dhe shkallën e zbatimit të kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës së Energjisë në procedurat licencimit të subjekteve me veprimtari në fushën minerare.
2. Vlerësim mbi shkallën e zbatimit të përgjegjësisë dhe funksioneve nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në monitorimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare.
3. Analiza mbi përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor publik nga subjektet e licencuara në fushën e minierave dhe procedurat e ndjekura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në përdorimin e territorit për këtë qëllim.
4. Arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së Ministrisë së Infrastrukturës së Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore në veprimtarinë minerare.

4. Identifikimi i çështjes:

Raporti mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Infrastrukturës së Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore në licencimin dhe monitorimin e subjekteve me veprimtari në fushën minerare për periudhën e aktivitetit 2018-2022 ka identifikuar sipas kriterëve të specifikë të auditimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e tre fushave në vijim:

- Auditim mbi zbatimin e procedurës së licencimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare.
- Auditim mbi zbatimin e procedurave dhe rezultatet e monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare, si dhe të shoqërive minerare publike.
- Auditim mbi përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor publik nga subjektet e licencuara në fushën e minierave dhe procedurat e ndjekura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në përdorimin e territorit për këtë qëllim.

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjekteve të audituara:

Strukturat dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë janë përfaqësues shtetëror për mineralet në trajtë natyrore, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në sipërfaqen nënujore, shtratit dhe nënshtratit të hapësirës detare shqiptare, përtej detit territorial, të përcaktuar sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, i përkasin shtetit dhe janë prona publike.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision, midis të tjerave dhe hartimin e zbatimit e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare.

Agjencia Kombëtare të Burimeve Natyrore, në cilësinë e strukturës përgjegjëse në sektorin minerar ka për detyrë, midis të tjerave pranimin, regjistrimin dhe publikimin në website të datës e të orës së kërkesës për aktverifikimin e lejes për zonat e hapura; shqyrtimin e plotësimit të kushteve të dhënies së lejes së shfrytëzimit dhe dokumenteve vërtetuese për kërkesat për zonat e hapura dhe fituesit e procedurës së konkurrimit publik; mbikëqyrjen për respektimin nga titullari i lejes i kushteve të lejes dhe normave të detyrueshme për legjislacionin në fuqi; raportimin për kontrollin e zbatimit të ligjit minerar; mbështetjen e ministrit për përgatitjen e politikave dhe programeve; monitorimin minerar dhe post minerar të minierave të mbyllura në regjim konservimi; hartimin dhe paraqitjen ministrit çdo 3 muaj të një raporti mbi realizmin e prodhimit, të investimeve, produkteve të shitura etj; hartimin dhe paraqitjen në ministri çdo 6 muaj të një raporti për çdo veprimtari minerare shfrytëzimi etj.

6. Përgjegjësitë e audituesve:

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i zhvilluar, të dhënat, raportet dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, i cili shprehet nëpërmjet konkluzioneve të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

(INTOSAI), si dhe kodin e etikës, me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për arritjen e konkluzioneve.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i zhvilluar përputhet, në të gjitha aspektet, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, udhëzime, sqarime, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të veprohet etj.;

- Njëherësh dhe aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, vendimet, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik); si dhe

- Promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese, si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre devijuese të evidentuara.

7. Kriteret e vlerësimit:

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*.

- Ligji Nr. 10304, datë 15.7.2010 *“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.

- VKM Nr. 942, datë 17.11.2010, *“Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”*.

- VKM Nr. 232, datë 23.03.2011 *“Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë”*.

- VKM Nr. 248, datë 2.05.2012 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 347, datë 29.04.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të veprimit 3 vjeçar për miratimin e strategjisë minerare”*.

- VKM Nr. 320, datë 21.4.2011 *“Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”*.

- VKM Nr. 436, datë 16.06.2011 *“Për disa ndryshime në vendimin Nr. 538, datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta të ndryshuar”*.

- VKM Nr. 440, datë 16.06.2011 *“Për miratimin e formës, të kushteve të rikthimit dhe të mënyrës së llogaritjes së garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe për realizimin e investimit ”*.

- VKM Nr. 441, datë 16.06.2011 *“Për përcaktimin e kushteve të certifikimit e të licencimit, të dokumenteve shoqëruese, të afateve të vlefshmërisë dhe të procedurave të shqyrtimit të kërkesave, për licencimin e veprimtarisë studimore-projektuese në veprimtaritë minerare”*.

- VKM Nr. 442, datë 16.06.2011 *“Për miratimin e kushteve, të dokumenteve shoqëruese, të afateve të vlefshmërisë dhe të procedurave të shqyrtimit të kërkesave, për autorizimin e tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara”*.

- VKM Nr. 479, datë 29.06.2011 *“Për miratimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Shqipërisë”*.

- VKM Nr. 347, datë 29.04.2011 *“Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”*.

- VKM Nr. 741, date 09.09.2015 *“Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare”*.

- VKM Nr. 969, datë 02.12.2015 “Për miratimin e rregullores “për kërkesat minimale për mbrojtjen e sigurisë e të shëndetit të punëmarrësve në industrinë minerare nxjerrëse, sipërfaqësore dhe nëntokësore”.
- VKM Nr. 820, datë 21.11.2020 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, të kushteve, të kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata në veprimtarinë studimore projektuese në fushën minerare”.
- Urdhër Nr. 306, datë 13.04.2011, “Për procedurat dhe formën e hartimit të planit vjetor minerar”.
- Urdhër Nr. 308, datë 13.04.2011, “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet”.
- Urdhër Nr. 310, datë 13.04.2011, “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karriere për grupin e mineraleve ndërtimore”.
- Urdhër Nr. 312, datë 13.04.2011, “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së informacioneve të detyrueshme që përgatiten nga zotëruesit e lejeve”.
- Urdhër Nr. 382, datë 20.05.2011, “Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare”.
- Urdhër Nr. 384, datë 20.05.2011, “Për miratimin e procedurave të regjistrimit dhe dokumentacionit që regjistrohet në kadastrën minerare dhe në regjistrin minerar, si dhe forma dhe procedura e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare”.
- Urdhër Nr. 477, datë 27.06.2011, “Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurës së hartimit të aktit të miratimit dhe aktit të refuzimit për aplikimet e lejeve minerare”.
- Urdhër Nr. 615, datë 02.09.2011, “Për përcaktimin e njësisë së hartimit të dokumentacionit për përcaktimin e procedurave konkurruese, të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe kriterëve të kualifikimit dhe vlerësimit të ofertave për të drejtën e aplikimit për një leje minerare në zonat konkurruese”.
- Udhëzim Nr. 10, datë 26.01.2015, “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara”.

8. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit.

Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, si dhe mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 – 165);
- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400- Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000- Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- ISSAI 1530 (ISA 530)- Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”;
- si dhe në praktikat më të mira të fushës.

9. Metodat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Nisur nga veçoritë e subjekteve të audituara, pasi si për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ashtu edhe për Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, veprimtaria në licencimin dhe monitorimin e subjekteve në fushën minerare është një pjesë (segment) i aktivitetit në tërësi të tyre, në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit;

c. *Verifikimi në sistemin elektronik* - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

10. Dokumentimi i auditimit

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minerave dhe të Industrisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Drejtorisë së Minerave në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore; të të dhënave nga disa Njësi të Vetëqeverisjes Vendore, të tre shoqërive publike minerare në likuidim si dhe të dhënave nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, krahas disa të dhënave të ndryshme nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushëveprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to.

Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet dhe më pas shqyrtimin e observacioneve të subjektit për Projekt Raportin (*Dërguar me shkresën nr. 983/12, datë 05.07.2023*) të sjella nga AKBN me shkresën nr. 983/13, datë 24.07.2023 dhe MIE me shkresën nr. 983/15, datë 04.08.2023, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTET NËN AUDITIM

A. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është krijuar me VKM nr. 504, datë 13.9.2017, dhe gjatë periudhës së auditimit 2018-2022 fusha e përgjegjësisë ka ndryshuar, duke ruajtur si mision hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit e shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë.¹

¹ <https://www.infrastruktura.gov.al/misioni-2/>

Në organigramën e MIE, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, bën pjesë dhe Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minerave dhe të Industrisë me 16 punonjës gjithsej në organikë, në përbërje të të cilit janë tre sektorë: i programeve të zhvillimit në fushën e burimeve minerare, në fushën e industrisë dhe Sektori i Mjedisit dhe Sigurisë në Punë në Miniera dhe Industri. Duhet theksuar se që nga viti 2020, konstatohen vakanca në pozicionet e punës kryesisht në Sektorin e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Burimeve Minerare.

Sipas Rregullores për organizmin dhe funksionimin e brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, miratuar me Urdhrin e ministrit nr.469, datë 30.12.2021, për Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minerave dhe të Industrisë janë përcaktuar një sërë detyrash që kanë të bëjnë me hartimin e programeve të zhvillimit në fushën e minerave në zbatim të strategjive sektoriale, miradministrimi i pronës publike dhe pasurive natyrore në interes të zhvillimit të vendit, krijimin e një databaze të përditësuar për veprimtarinë industriale, vlerësimin dhe analizën e tendencave të kohës për gjendjen e mjedisit, mbajtjen e kontakteve me strukturat e drejtorive brenda ministrisë së linjës, me institucionet e varësisë kësaj ministrie dhe me strukturat paralele në ministritë e linjës etj.

B. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është krijuar me VKM nr.547, datë 09.08.2006 dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj, zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e post-shfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik.

Fusha e veprimtarisë së AKBN konsiston në: propozimin, konsultimin, dhe bashkëpunimin me strukturat përkatëse të Qeverisë për hartimin e politikave të saj dhe strategjive në fushën e minerave, hidrokarbureve dhe energjisë; zbatimin e politikave të Qeverisë në këto fusha, sigurimin brenda fushës së veprimtarisë së vet të oponencës qeveritare, përgatitjen e dokumentacionit dhe praktikave të nevojshme për dhënien e lejeve, të licencave, autorizimeve, në përputhje me ligjin, mbikëqyrjen e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike, realizimin e monitorimit të zonave të shfrytëzuara, të rrezikut minerar dhe të mbylljes së veprimtarisë minerare etj.

Struktura organizative e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore është e përbërë nga 9 drejtori brenda të cilave ndodhen sektorë të ndryshëm.

Nga ana organizative Drejtoria Minerare në AKBN përbëhet nga 6 sektorë (32 punonjës gjithsej) si më poshtë:

- Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve të Ndërtimit, Qymyreve dhe Bitumeve (1 shef sektori dhe 6 specialistë);
- Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore (1 shef sektori dhe 6 specialistë);
- Sektori i Procedurave Statistike, Garancive Financiare, Koordinimit dhe GIS (1 shef sektori dhe 5 specialistë);
- Sektori i Monitorimit Postminerar (1 shef sektori dhe 3 specialistë);
- Sektori i Akt Verifikimit dhe Trajtimit të Ankesave (1 shef sektori dhe 2 specialistë);
- Sektori i Labororit Minerar dhe Pasurimit (1 shef sektori dhe 3 specialistë)

Detyrat për secilin pozicion pune janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të saj, ndërsa në Statut-Rregulloren e funksionimit të AKBN pasqyrohen kompetencat dhe objekti i veprimtarisë së strukturave organizative të saj. Kështu, në objektin e veprimtarisë së Drejtorisë Minerare përfshihen: konsultimi, propozimi dhe bashkëpunimi me strukturat përkatëse të Qeverisë, për hartimin e politikave të saj në fushën minerare; zbatimi i politikave të Qeverisë në fushën minerare; mbikëqyrja e veprimtarisë minerare e postminerare dhe raportimi për gjendjen aktuale; administrimi, ekskluzivisht, i të gjithë të dhënat parësore, që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare; azhurnimin periodik me sektorin e projekteve minerare dhe industriale në ministri të lejeve të reja të dhëna nga ministria; ecuria e lejeve në mënyrë kronologjike; përditësimin e të dhënave të subjekteve minerare që lidhen me statusin e tyre etj.

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

2.1 Auditim mbi zbatimin e procedurës së licencimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë rezulton se në periudhën 2018-2022 është miratuar dhënia e 91 lejeve minerare në total, të ndara sipas viteve si më poshtë.

Tabela nr. 1 Lejet e miratuara sipas llojit dhe sipas viteve 2018-2022

Nr.	Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
1.	Leje kërkim -zbulimi	3	4	3	3	3	16
2.	Leje shfrytëzimi	17	15	12	22	9	75
	Gjithsej	20	19	15	25	12	91

Burimi: Të dhëna të MIE të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në referencë dhe në zbatim të neneve 29, pikat 1 e 11, 30 e 56, pika 1, të ligjit nr.10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar, ka dalë VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”, i cili bën të mundur shoqërisë së shpallur fituese për dhënien e të drejtës së aplikimit për Leje Minerare shfrytëzimi/kërkimi në një zonë minerare të caktuar aplikimin në QKB për pajisje me leje minerare shfrytëzimi/kërkimi.

• Mbi zbatimin e kërkesave ligjore për afatin e Akt Miratimit ose Refuzimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjeve të aplikimit për pajisje lejeve minerare për periudhën 2018-2022 është konstatuar se, nga ana e MIE nuk është respektuar afati maksimal prej 240 ditë (120+120) për nxjerrjen e aktit të miratimit ose të refuzimit të lejes së shfrytëzimit, kërkim-zbulim-shfrytëzimit dhe garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare. Afatet e mësipërme përcaktohen në pikën 10, germa B.3 të VKM nr. 942, datë 17.11.2010 për 120 ditë dhe pika 5 germa “c” të VKM nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” ku përcaktohet se shtyrja shtesë nuk mund të jetë më e gjatë se vetë afati përkatës i marrjes së vendimit, pra 120 ditë, gjithsej 240 ditë nga aplikimi në QKL i subjektit për leje minerare.

Bazuar në sa më sipër, konstatohet se në 49 dosje ose 54 % të lejeve gjithsej të miratuara në periudhën 2018-2022 janë jashtë afatit 240 ditë. Me nxjerrjen e aktit të miratimit të lejeve jashtë afatit përkatës, MIE ka vepruar në kundërshtim me pikën 10, germa B.3 të VKM nr. 942, datë 17.11.2010 për rastet e miratimit të lejeve të mëposhtme: nr. 18... “B.” SHPK, 18. “D.” SHPK, 18. “H. SHPK”, 18. “A.” SHPK, 18. “T.” SHPK, 18... “F. P. K. B” SHPK, 18. “S. M” SHPK, 18. “N. Sh. P. F” SHPK, 18... “D.” SHPK, 18. “K. S” SHPK, 18. “A.” SHPK, 18“T. A. T. M” sha, 18. “T. A. T. M” SHA, 18. “V.” SHPK, 18. “M.” SHPK, 18. “B. C” SHPK, 18. “E. C. E. M. I” SHPK, 18. “.” SHPK, 18. “I.” SHPK, 18. “A.”, 18. “T” SHPK, 18. “K.” SHPK, 18.. “V. D. I. E” SHPK, 18. “C. G. I” SHPK, 18. “K. CH. M” SHPK, 18. “A. S” SHPK, 18. “P.”, 18. “P. G”, 18.“V.” SHPK, 18. “A.”, 18. “K. D” SHPK, 18. “L. T” sha, 19. “R. G”, 19. “M. Gj” SHPK, 19. “F.” SHPK, 19. “M. V” SHPK, 19. “P. M” SHPK, 19. “D. E” SHPK, 19. “A.” SHPK, 19. “2. G” SHPK, 19. “A. S” SHPK, 19.“E. M” SHPK, 19. “C.”, 19. “K. K” SHPK, 19. “K.” SHPK, 19. “E.” SHPK, 19. “K. I” SHPK, 19. “A. G” SHPK, 19. “N.” SHPK.

• Mbi procedurat e ndjekura nga zotëruesit e lejeve minerare dhe MIE për Riaplikimet.

Gjatë shqyrtimit të dosjeve të aplikimit për miratim leje, grupi i auditimit të KLSH ka konstatuar se në periudhën 2018-2022 u është dhënë e drejta për riaplikim 19 subjekteve nga 91 gjithsej (20.9%), për të cilët është dalë më parë me akt refuzimi, për mosplotësim

dokumentacioni brenda afatit, kryesisht për mungesën e pajisjes me leje mjedisore brenda afatit 240 ditë. MIE, në kushtet e kërkesës së subjekteve për mundësinë e dhënies së të drejtës për të riaplikuar pranë QKB, për të përfunduar procedurën e pajisjes me leje minerare shfrytëzimi për zonën konkurruese minerare, pas pajisjes jashtë afatit (pas aktit të refuzimit) me leje mjedisore, i ka kërkuar QKB të pranojë aplikimin e shoqërisë, për të përfunduar procedurën e pajisjes me leje minerare shfrytëzimi për zonën konkurruese minerare të shpallur fitues.

Një veprim i tillë i Ministrisë të MIE është në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010 *“Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”*, pasi nuk janë respektuar kushtet e detajuara dhe dokumentet shoqëruese për vlerësimin e përmbushjes së këtyre kushteve që duhet të plotësojnë aplikuesit për një leje minerare dhe procedura e trajtimit të kërkesave me afatet, të përcaktuara në pikën 10 të këtij Vendimi.

Në zbatim të pikës 11 të VKM mësipërme: *“Kërkuesi njoftohet për miratimin ose jo të kërkesës nëpërmjet publikimit në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave”*, gjë që nuk krijon mundësi riaplikimi subjekt të cilit i refuzohet, nuk i miratohet pajisja me leje minerare shfrytëzimi.

Në zbatim të VKM nr. 111, datë 2.3.2022 *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”* i ndryshuar, MIE e ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe në sektorin e minierave dhe gjeologjisë.

Gjithashtu, në zbatim të Rregullores për organizmin dhe funksionimin e brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, miratuar me Urdhrin e ministrit nr.469, datë 30.12.2021, neni 5, MIE është organ i drejtimit politik dhe ushtron detyrat dhe funksionet e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minierave ka për detyrë, midis të tjerave, mbajtjen e kontakteve me strukturat e drejtorive brenda ministrisë së linjës, me institucionet e varësisë së kësaj ministrie dhe me strukturat paralele në ministritë e linjës.

Bazuar në sa më sipër, MIE i ka të gjitha kompetencat dhe mekanizmat ligjor për zgjidhjen e të gjitha çështjeve me institucionet e varësisë (AKBN) si dhe me ministritë e linjës (MTM), për të shmangur procedurat e jashtëligjshme të ri aplikimit për pajisje me leje minerare.

Duhet theksuar, se një veprim i tillë i ri aplikimeve heq kuptimin e afateve procedurale, bën të pavlefshëm në kohë kontratat e ndryshme etj., duke nxjerrë jashtë funksionit VKM për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese dhe për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura.

Riaplikimet e lejuara nga ana e MIE janë për lejet si më poshtë: nr. 18. “E. M. N” SHPK, 18. “T.” SHPK, 18. “S. M” SHPK, 18. “E. C. E. M. I” SHPK, 18. “A. L” SHPK, 18..“B. C” SHPK. 18. “S.” SHPK. 1. “A.”, 18. “R. E” SHPK, 18. “P. S”, 18... “M. H”, 19. “M.” SHPK, 19... “M. Gj”, 19. “Xh. SHPK”, 19. “M. V” SHPK, 19. “K.” SHPK, 19. “K. I” SHPK, 19. “A. G”, 19. “Xh. M. A”.

• ***Mbi zbatimin e përcaktimeve ligjore mbi Kontratat me Drejtuesin Teknik të punimeve minerare.***

Gjatë shqyrtimit të dosjeve për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, janë konstatuar gjithsej 33 raste (36% e numrit total të dosjeve) të cilat, në dokumentacionin e dorëzuar nga subjektet, kontratës me Drejtuesin Teknik i ka përfunduar afati i vlefshmërisë në datën e nxjerrjes së Akt Miratimit. Duhet theksuar se këtu përfshihen 6 raste të zotëruesve të lejeve minerare që kanë kryer riaplikim. Bazuar në sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010 *“Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”*, pika 10, germa A.1/c dhe germa B.1/c në të cilën përcaktohet se dokumentacioni i plotë përmban: *“Kontrata me drejtuesin teknik të*

punimeve, të noterizuar, i cili duhet të jetë inxhinier i fushës së veprimtarive minerare të shfrytëzimit sipas emërtimeve të universiteteve, vërtetuar me diplomën përkatëse”.

Kjo mangësi është konstatuar në dosjet në vijim: nr. 18. “P. O. Q” SHPK, 18. “D.” SHPK, 18. “H.” SHPK, 18. “A.” SHPK, 1. “T.” SHPK, 18. “S. M” SHPK, 18. “N. Sh. P. F”, 18... “D.” SHPK, 18. “K. S”, 18. “T. A. T. M” SHPK, 18. “A.” SHPK, 18. “T A. T. M” SHPK, 18. “B. P”, 18. “T. A. T. M” Sha, 18. “T. A. T. M” Sha, 18. “V.” SHPK, 18. “B. C” SHPK, 18. “R.” SHPK, 18. “K.” SHPK, 18. “C. G. I” SHPK, 18. “K. CH. M” SHPK, 18. “A. S” SHPK, 18. “A. L” SHPK, 18. “V.” SHPK, 18.. “A”, 18... “P. S” SHPK, 19... “A. G” SHPK, 19. “P. M” SHPK, 19. “A. S” SHPK, 19. “C.”, 19. “E.” SHPK, 19. “K. I” SHPK, 19. “A. G”.

- ***Në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore mbi depozitimin e Burimeve Financiare të domosdoshme.***

Gjatë shqyrtimit të dosjeve për lejet minerare të periudhës 2018-2022, janë konstatuar 10 subjekte të cilët nuk e kanë plotësuar 20% e vlerës totale të investimit, konkretisht: leja nr. 18. “K. I” SHPK, 18. “.” SHPK, 18. “S. M” SHPK, 18. “D.” SHPK, 18. “V. SHPK”, 19. “M.” SHPK, 1.. “A.” SHPK, 19. “E. M” SHPK, 19. “K. K” SHPK, 19. “A. SHPK”.

Bazuar në sa më sipër, rezulton se është në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”, pika 10, germa A.1/ç/i dhe germa B.1/ç/i në të cilën përcaktohet se dokumentacioni i plotë duhet të përmbajë: “Burimet financiare të nevojshme për realizimin e investimeve të programuara për të zhvilluar veprimtarinë minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit dhe vërtetime për ekzistencën e tyre...” dhe nënpika “i”, përcakton se: “Një deklaratë nga banka që të konfirmojë se personi juridik ka çelur numrin e llogarisë, ku duhet të ketë të depozituara të paktën 20% të vlerës së investimit, të parashikuar në programin e investimeve që ka paraqitur”.

Veç sa më sipër, konstatohet se ka një diferencë kohore të konsiderueshme midis datës në dokumentacionin bankar të paraqitur nga subjekti dhe datës së aplikimit në QKB që lëviz nga 4 deri në 12 muaj. Vonesa të tilla në humbjen e vlefshmërisë së dokumentacionit financiar kanë pasoja në sigurinë dhe garancinë e realizimit të investimit të parashikuar në projektin përkatës, dhe në fund të fundit me vetë zhvillimin e sektorit minerar. Vonesat e konstatuar konkretisht në dosjet nr. 18. “P. O. Q” SHPK (12 muaj), 18. “D.” SHPK (rreth 6 muaj), 18. “V. M” SHPK (2 muaj), 18. “T.” SHPK (8 muaj), 18. “S. M” SHPK (rreth 5 muaj), 18. “I.” SHPK (4 muaj), 18. “K. CH. M” SHPK (rreth 7 muaj), 18. “A. S” SHPK (4 muaj), 18. “A. L” SHPK (11 muaj), 18. “B. C” SHPK (12 muaj), 18. “A.” (rreth 9 muaj), 19... “M. V” SHPK (rreth 20 muaj (1.6 vjet)), 19. “.” SHPK (4 muaj), 19. “2. G” SHPK (6 muaj), 19. “A. S” SHPK (4 muaj), 19. “E. M” SHPK (rreth 5 muaj), 19. “K. K” SHPK (6 muaj), 19. – “V. H” SHPK (4 muaj), 19. dhe 19. “N. F. C” (5 muaj), 19. “T. O” SHPK (4 muaj). Gjithashtu janë të shumta dhe subjektet, burimet financiare të të cilëve janë me distance 1-3 muaj nga aplikimi në QKB.

- ***Mospërputhje e emërtesës së mineralit në objektin e kërkuar nga minerali për të cilin është kryer procedura.***

Gjatë shqyrtimit të dosjes minerare nr. 18... “B. A” SHPK, konstatohet se, në Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN nr. 6..., datë 27.08.2018 “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit me numër aplikimi në QKB LC ...”, datë 02.08.2018, të subjektit “B. A” SHPK, për zonën minerare nr.34..., ish leja 11... në objektin “K.”, qarku Vlorë, ardhur në MIE me nr. 11218 datë 30.08.2018, citohet se në verifikimin e kryer në terren nga specialistët përkatës, është konkluduar se minerali në objektin e kërkuar nuk është gur gëlqeror por gëlqeror i mermerizuar. Në fakt procedura konkurruese për zonën minerare nr.34... është zhvilluar për mineralin gur gëlqeror dhe njoftimi i fituesit me nr. 10... prot, datë 19.07.2018 është për mineralin gur gëlqeror.

Bazuar në sa më sipër, konstatohet se lloji i mineralit në objektin e kërkuar ndryshon nga lloji i mineralit për të cilin është kryer procedura e konkurrimit, me pasoja komplekse në vijim për

monitorimin dhe mbikëqyrjen e pagesës së rentës minerare nga ana e zotëruesit të lejes minerare.

Nga auditimi i zbatimit të procedurës së licencimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare ka rezultuar gjetja dhe situatat si më poshtë:

Titulli i gjetjes:	Nga auditimi i zbatimit të procedurës së licencimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare ka rezultuar se nga ana e MIE nuk është respektuar VKM nr. 942, datë 17.11.2010 <i>“Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”</i> .
Situata:	<p>- Nga ana e MIE nuk është respektuar afati maksimal prej 240 ditë (120+120) për nxjerrjen e aktit të miratimit ose të refuzimit të lejes së shfrytëzimit, kërkim-zbulim-shfrytëzimit në 49 raste ose 54 % të lejeve gjithsej (91) të miratuara në periudhën 2018-2022, pasi janë jashtë afatit të mësipërm. Në këtë mënyrë MIE ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010 <i>“Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”</i>, pika 10, germa B.3.</p> <p>- Në periudhën 2018-2022 është konstatuar se iu është dhënë e drejta për riaplikim 19 subjekteve (20.9 % e numrit gjithsej), për të cilët është dalë më parë me akt refuzimi, për mosplotësim dokumentacioni brenda afatit, kryesisht për mungesën e pajisjes me leje mjedisore. Një veprim i tillë i MIE është në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010 <i>“Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”</i>, pasi nuk janë respektuar kushtet e detajuara dhe dokumentet shoqëruese për vlerësimin e përmbushjes së këtyre kushteve që duhet të plotësojnë aplikuesit për një leje minerare dhe procedura e trajtimit të kërkesave me afatet, të përcaktuara në pikën 10 të këtij Vendimi. Gjithashtu, në zbatim të pikës 11 të VKM së mësipërme: <i>“Kërkuesi njoftohet për miratimin ose jo të kërkesës nëpërmjet publikimit në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave”</i>, gjë që nuk krijon mundësi riaplikimi subjekt të cilit i refuzohet, nuk i miratohet pajisja me leje minerare shfrytëzimi.</p> <p>Në zbatim të Rregullores për organizmin dhe funksionimin e brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, miratuar me Urdhrin e ministrit nr.469, datë 30.12.2021, neni 5, e përcakton MIE si organ i drejtimit politik i cili ushtron detyrat dhe funksionet e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndërsa Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minerave ka për detyrë, midis të tjerave, mbajtjen e kontakteve edhe me strukturat paralele në ministritë e linjës, duke i dhënë MIE të gjitha kompetencat dhe mekanizmat ligjor për zgjidhjen e të gjitha çështjeve me institucionet e varësisë (AKBN) si dhe me ministritë e linjës (MTM), për të shmangur procedurat e jashtëligjshme të ri aplikimit për pajisje me leje minerare.</p> <p>- Gjatë shqyrtimit të dosjeve për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, janë konstatuar gjithsej 33 raste (36% e numrit total të dosjeve) të cilat, në dokumentacionin e dorëzuar nga subjektet, kontrata me Drejtuesin Teknik nuk është e vlefshme në datën e nxjerrjes së Akt Miratimit, veprime të MIE në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010, pika 10, germa A.1/c dhe germa B.1/c.</p>

	<p>- Janë konstatuar 10 subjekte aplikuese për miratim leje minerare të cilët nuk e kanë plotësuar depozitimin e burimeve financiare për 20% e vlerës totale të investimit, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”, pika 10, germa A.1/ç/i dhe germa B.1/ç/i.</p> <p>Veç sa më sipër, konstatohet se ka vonesa në humbjen e vlefshmërisë së dokumentacionit financiar në një diferencë kohore të konsiderueshme midis datës në dokumentacionin bankar të paraqitur nga subjekti dhe datës së aplikimit në QKB që lëviz nga 4 deri në 12 muaj, me pasoja në sigurinë dhe garancinë e realizimit të investimit të parashikuar në projektin përkatës, dhe në fund të fundit me vetë zhvillimin e sektorit minerar.</p> <p>- Në rastin e shqyrtimit të dosjes minerare nr. 18... “B. A.” SHPK, është konstatuar mospërputhje e emërtesës së mineralit në objektin e kërkuar nga minerali për të cilin është kryer procedura, e cilësuar kjo nga Këshilli Teknik i AKBN, me pasoja komplekse në vijim për monitorimin dhe mbikëqyrjen e pagesës së rentës minerare nga ana e zotëruesit të lejes minerare.</p>
Kriteri:	VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”, pika 10, 11, germa B.3. germa A.1/c dhe germa B.1/c.
Ndikimi:	Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nuk është i mbështetur në bazën ligjore zbatimit i procedurës së licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare.
Shkaku	Mos zbatimi i procedurës së licencimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>- Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të merren masat për zbatimin e procedurës së licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare duke respektuar kushtet e detajuara dhe dokumentet shoqëruese për vlerësimin e përmbushjes së kushteve që duhet të plotësojnë aplikuesit për një leje minerare dhe procedura e trajtimit të kërkesave me afatet, të përcaktuara me aktet ligjore.</p> <p>- MIE si organ i drejtimit politik i cili ushtron detyrat dhe funksionet e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, nëpërmjet Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minerave, midis të tjerave të sigurojë mbajtjen e kontakteve edhe me strukturat paralele në ministritë e linjës, duke i dhënë MIE të gjitha kompetencat dhe mekanizmat ligjor për zgjidhjen e të gjitha çështjeve me institucionet e varësisë (AKBN) si dhe me ministritë e linjës (MTM), për të shmangur procedurat e ri aplikimit për pajisje me leje minerare.</p> <p>- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të marrë masat për revokimin e licensave të mësipërme me parregullsi dhe shkelje të rënda ligjore, nënligjore dhe rregullative në zbatimin e kriterëve për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare.</p>

Pretendimi i subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar MIE me shkresën nr. 983/15, datë 04.08.2023 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt Raportin, janë sjellë observacionet të cilat shkurtimisht po i paraqesim në raport konkretisht:

- Shoqëritë që kanë shprehur interesin si dhe kanë rezultuar fitues të një konkurimi publik për pajisje me leje minerare aplikojnë pranë QKB për plotësimin e dokumentacionit për leje minerare dhe MIE referuar po kësaj VKM duhet të miratojë ose refuzoj aplikimin 120+120 për lejet minerare të shfrytëzimit. Në konstatimin tuaj rezultoi se 54% e lejeve të miratuara në periudhën objekt auditimi janë miratuar jashtë afateve 240 ditë dhe në kundërshtim me pikën 10, B. 3. MIE në këto raste nuk ka vepruar në kundërshtim me këtë pikë të VKM pasi një subjekt vepron në kundërshtim me një normë ligjore kur norma është ndaluese/urdhëruese gjë e cila nuk është për paragrafin e parë të kësaj pike norma është ndaluese në paragrafin e 2 të saj ku shprehet se MIE duhet të

refuzoj aplikimet e shoqërive pranë QKB në rast se shoqëritë nuk pajisen me leje mjedisore përkatëse brenda këtij afati. Në të gjitha rastet që ju përmendni në akt konstatim shoqëritë kanë qenë të pajisura me leje mjedisore përkatëse brenda afatit të aplikimit të përcaktuar në VKM dhe për këtë arsye refuzimi i këtyre aplikimeve do ishte në kundërshtim me VKM, vonesat në publikimin e Akt-Miratimeve lidhen thjesht vetëm me vonesa kohën e pandemisë por që nuk kanë cenuar ligjshmërinë e aktit dhe as të drejtat e subjekteve për kryerjen e veprimtarive minerare.

- Në rastet e dhënies e të drejtës për riaplikim shoqërive referuar VKM 320 datë 21.04.2011, dhënia e të drejtës për të plotësuar dokumentacionin për një leje minerare në zonat e përcaktuara minerare në planin mineral si zona konkurruese u jepet subjekteve fituese të konkurrimit publik dhe referuar pikës 7.1 të po kësaj VKM përgjegjës për këtë procedurë është Autoriteti kontraktues (MIE) i përfaqësuar nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare dhe në çdo rast edhe e drejta për të riaplikuar i është dhënë po këtyre subjekteve që janë shpallur fitues në një procedurë konkurruese nga ministri i cili është i ngarkuar nga VKM si person përgjegjës për ta verifikuar këtë fakt, në këto kushte kjo praktik nuk është në kundërshtim me asnjë normë ligjore dhe ministri është plotësisht në përmbushje të kompetencave të tij ligjore pra është e pa mbështetur pretendimi se në mbështetje të VKM 111, datë 02.03.2023 “Për përcaktimin e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë” siç edhe theksuam më lartë këtë të drejtë ministrit ja nje VKM 320 datë 21.04.2011.

- Lidhur me konstatimin në lidhje me kontratat e drejtuesit teknik ju sqarojmë se në momentin që shoqëritë aplikojnë këto kontrata janë të vlefshme dhe brenda afateve dhe pas këtij momenti shoqëritë nuk mund të kryejnë plotësime apo shtesa për dokumentacionin e paraqitur. Gjithashtu referuar ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 149 pika 2, kontratat me afat të caktuar kur kjo kontratë zgjatet në heshtje tej afatit të caktuar ajo quhet si kontratë me afat të pacaktuar.

- Nga shqyrtimi i dosjes Akt-Miratimit nr. 18... I shoqërisë “B. A”, ndryshimi i llojit të mineralit pasi janë kryer të gjitha procedurat e lartpërmendura duhet fillimisht të mbështetet në një studim të detajuar gjeologjik të shtresave të mineralit në këtë zonë dhe nuk mund të mbështetet vetëm në një akt verifikim sipërfaqësor të zonës.

- Nga 10 (dhjete) subjektet e siper cituara, ku, 9 prej tyre janë shpallur fitues me procedure konkurruese bazuar ne kriteret e VKM Nr.320, dat 21.04.2011, “Për miratimin e procedurave e te kriterave te konkurimit dhe te afateve te shqyrtimit te kërkesave për marrjen e lejeve minerare ne zonat konkurruese” dhe kur janë shpallur fitues e kane vërtetuar kriterin financiar se kane mjete monetare për te filluar investimet, prandaj dhe janë shpallur fitues, pasi kriteri financiar ka qene kriter skualifikues.

- Lidhur me konstatimin se ka një diference kohore te konsiderueshme midis datës ne dokumentacionin bankar te paraqitur nga subjekti dhe datës se aplikimit ne QKB, ky afat nuk është kriter vlerësues. Për subjektet me procedure konkurruese si afat i lëshimit te vërtetimit te bankës, është ai i përcaktuar ne VKM Nr.320, datë 21.04.2011, te dokumenteve standarte ku theksohet se, vërtetimi duhet te jete lëshuar jo me pare se 30 dite nga dita e hapjes se ofertës.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar MIE për Projekt Raportin e auditimit, dërguar me shkresën nr. 983/15, datë 04.08.2023 edhe pse të përsëritura pa sjellë argumente të reja, grupi i auditimit gjykon se:

- Nga ana e MIE nuk është respektuar afati maksimal prej 240 ditë (120+120) për nxjerrjen e aktit të miratimit ose të refuzimit të lejes së shfrytëzimit, kërkim-zbulim-shfrytëzimit në 49 raste ose 54 % të lejeve gjithsej (91) të miratuara në periudhën 2018-2022, pasi janë jashtë afatit të mësipërm.

- Në periudhën 2018-2022 është konstatuar se iu është dhënë e drejta për riaplikim 19 subjekteve (20.9 % e numrit gjithsej), për të cilët është dalë më parë me akt refuzimi, për mosplotësim dokumentacioni brenda afatit, kryesisht për mungesën e pajisjes me leje mjedisore.

- Gjatë shqyrtimit të dosjeve për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, janë konstatuar gjithsej 33 raste (36% e numrit total të dosjeve) të cilat, në dokumentacionin e dorëzuar nga subjektet, kontrata me Drejtuesin Teknik nuk është e vlefshme në datën e nxjerrjes së Akt Miratimit, veprime të MIE në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010, pika 10, germa A.1/c dhe germa B.1/c.

- Janë konstatuar 10 subjekte aplikuese për miratim leje minerare të cilët nuk e kanë plotësuar depozitimin e burimeve financiare për 20% e vlerës totale të investimit, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”, pika 10, germa A.1/ç/i dhe germa B.1/ç/i.

Në rastin e shqyrtimit të dosjes minerare nr. 18... “B. A” SHPK, është konstatuar mospërputhje e emërtesës së mineralit në objektin e kërkuar nga minerali për të cilin është kryer procedura.

Gjykojmë se nga Njësia e Zbatimit të Projektit Koncesionar nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart argumentet e sjella, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

1.1 Për zbatimin e procedurës dhe të kriterave të konkurrimit për marrjen e lejes minerare në zonën konkurruese nr.27..., për objektin B., Selenicë, Qarku Vlorë

Sipas Urdhrit të Ministrit të MIE nr.161, datë 25.08.2022 “Për fillimin e procedurave të konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën kombëtare të

Biznesit për zonat minerare konkurruese nr.31..., nr.25..., nr.27..., nr.42...dhe nr. 42...” është dërguar për botim në APP ftesa për ofertë.

Në Buletinin e Njoftimeve Publike nr.122, datë 06.09.2022, në procedurën konkurruese për leje minerare është botuar dhe ftesa për ofertë për pesë zona minerare, me afat të fundit për dorëzimin e ofertave në MIE në datën 05.10.2022, ora 10.00.

Grupi i auditimit të KLSH zgjodhi në mënyrë rastësore procedurën e zhvilluar nga MIE për zonën minerare konkurruese nr.27....

Sipas Aneks I të ftesës për ofertë, zona minerare nr.27... që përket planit mineral i vitit 2022, është në objektin B..., Selenicë qarku Vlorë, për llojin e mineralit “Ranor, silicor, masiv”, me rezerva 950 000 m³, leje shfrytëzimi me sipërfaqe të zonës 0.240 km², me kriter minimal të sipërfaqes prej 0.02 km², të prodhimit 1 000 m³ dhe vlerë minimale të investimit për prodhimin minimal prej 200 mijë euro.

Sipas Procesverbalit të datës 05.10.2022 të KVO me përbërje: 1. E. A., kryetar; 2. M. H., ; 3. E. I., ; 4. S. M., 5. T. A., ; 6. E. G.; 7. M. C., anëtarë, më datën 05.10.2022, ora 10.00 kanë paraqitur ofertë dy subjekte: “S. Q” SHPK dhe “B. S” SHPK, dhe në vijim është përshkruar dokumentacioni që përmbajnë zarfet përkatëse të subjekteve. Ky Procesverbal rezulton se nuk është i firmosur nga anëtarja T. A.

Sipas Procesverbalit të KVO nr.2, datë 10.10.2022 nga shqyrtimi i dokumentacionit është konstatuar se subjekti “S. Q” SHPK nuk ka sjellë dokument që vërteton se subjekti nuk është në proces falimentimi; dokument që ka plotësuar detyrimet fiskale; dokument që ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore të lëshuar nga administrata tatimore, në kundërshtim me kërkesat e pikave 1/a, 2/a dhe 2/b të Dokumenteve Standarde të Procedurës Konkurruese (DSPK).

Nga shqyrtimi dokumentacionit financiar, kjo shoqëri ka konfirmuar gjendjen e llogarisë me 5,000,000 lekë, për vlerën e investimit 250,000,000 lekë, në një kohë që sipas përcaktimit në DSPK është përcaktuar që duhet të jetë 20% e vlerës së investimit të parashikuar, që korrespondon me vlerën 50,000,000 lekë. Në këtë rast oferta skualifikohet, pasi nuk vërteton se ka të depozituar në një bankë të paktën 20% të vlerës së investimit të parashikuar për t’u realizuar në objektin e publikuar për konkurrim.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko profesional, KVO ka konkluduar se subjekti “S. Q” SHPK, nuk ka vërtetime mbi përvojën në fushën minerare apo referenca për përmbushje të suksesshme të punimeve minerare të ngjashme, si dhe i mungon licenca profesionale e drejtuesit teknik dhe kontrata përkatëse, në kundërshtim me kërkesat e pikave 1 dhe 4 të DSPK, duke e bërë këtë ofertë të pavlefshme. Kontrata e punës e sjellë me R. T., është konsideruar e pavlefshme, pasi nuk është e kategorisë B8- Certifikatë si Drejtues teknik për veprimtarinë minerare të shfrytëzimit të minierave.

Bazuar në sa më sipër, KVO ka arritur në konkluzionin se subjekti “S. Q” SHPK nuk plotëson kriteret ligjore, ekonomiko-financiare dhe tekniko-profesionale për kualifikim.

Për subjektin “B. S” SHPK, KVO ka konkluduar se i plotëson kriteret ligjore, ekonomiko-financiare dhe tekniko-profesionale për kualifikim.

Lidhur me dokumentacionin financiar është cilësuar se ka sjellë vërtetim nga B. në vlerën 3,466,000 lekë, 41,904,700 lekë dhe 150,047 euro, duke plotësuar kriterin ekonomik të përcaktuar në DSPK.

Duhet cilësuar se në mbyllje të këtij Procesverbali, është cilësuar se KVO vendosi: “1. Të skualifikojë ofertën e paraqitur nga shoqëria “B. S” SHPK.” dhe 2. Të kualifikojë ofertën e paraqitur nga shoqëria “K.-S.” SHPK.” e nënshkruar dhe firmosur nga të gjithë anëtarët e KVO.“

KVO me Vendimin e datës 10.10.2022 ka skualifikuar subjektin “S. Q.” SHPK dhe ka kualifikuar “B. S.” SHPK.

Me shkresën e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave E. A., nr.7683 prot., datë 11.10.2022 është njoftuar për skualifikim subjekti “S. Q” SHPK, duke cilësuar dhe arsyet e

skualifikimit. Më pas, ky subjekt me shkresën në MIE nr.8074 prot., datë 24.10.2022 kërkon informacion se ku dhe kur do të bëhet njoftimi mbi ofertuesin fitues, shpallja e tij, me qëllim ushtrimin e të drejtës së ankimimit, përgjigje e dhënë me shkresën nr.8074/1 prot, datë 15.11.2022, pra pas miratimit të Raportit të KVO nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Kryetari i KVO E. A., ka përgatitur Raportin mbi vlerësimin e ofertave për dhënien e së drejtës për aplikim për leje minerare pranë institucionit të QKB për zonën nr.27... që përket planit mineral i vitit 2022, në objektin B., Selenicë qarku Vlorë, për llojin e mineralit “Ranor, silicor, masiv”, veprimtaria shfrytëzim, i cili është miratuar nga Ministri i MIE me nr. 7684/1 prot., datë 08.11.2022. Në përfundim të këtij Raporti, i ka propozuar Ministrin të MIE, skualifikimin e shoqërisë “S. Q.” SHPK dhe kualifikimin e “B. S.” SHPK me prodhim që mendohet të realizohet 26 250 m³ në vit dhe po kaq edhe përpunim, me vlerë investimi 173,300,000 lekë, vlerë të produkteve minerare 13,130 milion lekë dhe vlerë rentabiliteti ekonomik IRR=59 %.

MIE, me shkresën nr.7684/2 prot., datë 08.11.2022 i ka dhënë shoqërisë “B. S” SHPK të drejtën të aplikojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t’u pajisur me leje minerare shfrytëzimi në zonën konkurruese nr.27... në objektin e quajtur B., sipas përcaktimeve të VKM nr.942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”.

Nga auditimi rezulton se, shoqëria “B. S.” SHPK, sipas ekstraktit historik në QKB është themeluar më datë 18.05.2022 dhe regjistruar më datë 14.06.2022, në adresën: V., Lagja “P.”, Rruga “Ç”, pallati “R.”, kati ..., nr....; pra më pak se 3 muaj nga shpallja në buletinin e njoftimeve publike të zonës minerare nr.27... të B., Vlorë.

Shoqëria zotëron vetëm kapitalin themeltar prej 100,000 lekë, në një kohë që vlera totale e investimit minimal për sipërfaqen 0.02 km² është 200,000 euro dhe që subjekti është shpallur fitues për të gjithë sipërfaqen 0.24 km².

Nga shqyrtimi i dokumenteve në dosjen e kësaj procedure, konstatohet se Sigurimi i ofertës në vlerë 3,466,000 lekë është bërë nga “B. S” SHPK më datë 29.09.2022 në B., dega Lushnjë, me nr.975 prot., me afat vlefshmërie 150 ditë nga momenti i dorëzimit të ofertave, por në çdo rast, jo më vonë se data 05.03.2023, e nënshkruar nga Drejtuese e degës E. H., dhe Drejtuese operacionesh A. P.

Veç këtij dokumenti, në dosje ndodhet “Konfirmimi i gjendjes së llogarisë/depozitës bankare”, i B.-Dega Lushnjë, me nr.982 prot., që mban vendin dhe datën “Tiranë, më 03.10.2022”, i cili vërteton se subjekti “B. S” SHPK është klient i B.-Dega Lushnjë dhe se nga verifikimi në sistemin kompjuterik në datë 03.10.2022 rezultojnë balancat e mëposhtme të llogarisë/ve dhe depozitës/ve të klientit të sipërcituar:

Lloji i llogarisë/depozitës	Nr. i llogarisë/depozitës	Monedha	Gjendja e llogarisë	Gjendja e disponueshme
Llogari rrjedhëse	40.....	ALL	3,466,000.00	3,466,000.00
Llogari rrjedhëse	40.....	ALL	41,904,700.00	41,904,700.00
Llogari rrjedhëse	40.....	EUR	150,047.50	150,047.50

Nga sa më sipër konstatohet se vlera e Sigurimit të ofertës prej 3,466,000 lekë nuk është në llogari depozitë por, llogari rrjedhëse; konfirmimi i gjendjes së llogarisë është lëshuar nga B...-Dega Lushnjë, por vendi i përket Tiranë; subjekti “B. S” SHPK i ka llogaritë në B.-Dega Lushnjë, ndërsa selinë në Vlorë.

Nga shqyrtimi i Aneksit IV-A, Formulari i ofertës tekniko-financiare për leje minerare shfrytëzimi, KVO ka vlerësuar subjekti e shpallur fitues “B. S.” SHPK me pikët maksimale (15) Aftësitë tekniko profesionale të subjektit, edhe pse ofertuesi nuk ka eksperiencë në veprimtarinë minerare dhe për rrjedhojë nuk ka efektiviteti në veprimtari të mëparshme minerare, në përbërje të stafit mungon fuqia punëtore e nevojshme; drejtuesi teknik nuk ka eksperiencë në fushën minerare, edhe me mbështetjen teknike nuk ofrohen kapacitetet e e mjaftueshme të mekanikës për veprimtarinë minerare etj.

Po kështu dhe për Aftësitë ekonomiko-financiare të subjektit është vlerësuar me pikët maksimale (20) ku në dosjen e aplikimit i mungojnë dokumentet që provojnë burimet e financimit të shoqërive që e mbështesin financiarisht subjektin e shpallur fitues.

Njëlloj dhe për Vlerën e investimit që parashikohet për t'u kryer në objektin/zonën minerare vlerësuar me pikët maksimale (20), megjithëse ofertuesi i skualifikuar ka paraqitur investim rreth 40 % më të lartë.

Bazuar në sa më lart, konstatohet se KVO nuk ka vlerësuar drejt me pikë plotësimin e kriterëve nga subjekti shpallur fitues "B. S." SHPK, siç kërkohet në Aneksin IV-A Formulari i ofertës tekniko-financiare për leje minerare, të përcaktuar në DSPK.

Në kriteret specifike të kualifikimit, lidhur me kërkesat **për kapacitetet ekonomike dhe financiare** është përcaktuar se: *"Ofertuesit duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme ekonomike dhe financiare të kualifikimit të përcaktuara në këto Dokumente Standarde të Procedurës Konkurruese.*

1. Kopje të pasqyrave financiare të dy viteve të fundit, të certifikuar nga Administrata Tatimore;

- Vërtetim të xhiros vjetore të dy viteve të fundit të lëshuara nga Administrata Tatimore;

Kriteret që duhet të plotësohen me pasqyrat financiare janë:

i. xhirot vjetore kumulative të dy viteve të fundit të jetë të paktën sa vlera e përgjithshme e investimit (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi; dhe

ii. kapitali i vet (totali i aktivitet minus totalin e detyrimeve) i vitit të fundit ushtrimor të jetë të paktën sa 20% e vlerës së përgjithshme të investimit (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi; Në rast se xhirot vjetore kumulative të dy viteve të fundit ushtrimor nuk janë sa vlera e përgjithshme e investimit (pa TVSH), por janë të paktën 60% deri në 100%, atëherë shoqëria kualifikohet për këtë kriter financiar me kushtin që kapitali i vet (totali i aktivitet minus totalin e detyrimeve) i vitit të fundit ushtrimor të jetë të paktën sa 30% e vlerës së përgjithshme të investimit (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi.

2. Vërtetim nga Banka që konfirmon se personi juridik ka të depozituara numrin e llogarisë të paktën 20 % të vlerës së investimit të parashikuar për t'u realizuar në objektin e hedhur për konkurrim të publikuar. Vërtetimi duhet të jete lëshuar jo më parë se 30 dite nga dita e hapjes së ofertës.

Ne rastet kur ofertuesi ka paraqitur një dokument noterial me një investitor, i cili garanton mbështetje financiare për realizimin e programit të investimit, ky dokument duhet të shoqërohet me dokumentet që provojnë burimet financiare të këtij të fundit, si të parashikuara në pikat 1 dhe 2, më sipër.

Shënim: Mosplotësimi i kriterëve të parashikuar në pikën 1 nuk përbën kusht skualifikimi por është i rëndësishëm për vlerësimin e kriterëve ekonomiko - financiarë. Kriteri i parashikuar në pikën 2 është kusht i domosdoshëm dhe mosplotësimi i tij përbën kusht skualifikimi.

Për rastin e shoqërive që mund të kenë fituar një ose disa procedura konkurrimi, ato duhet të vërtetojnë se, përveç burimeve financiare të deklaruara për projektet e mëparshme, disponojnë burime të tjera financiare të mjaftueshme sipas kriterëve të mësipërme për realizimin e projektit të kësaj procedure konkurruese.

Oferta do të quhet e pavlefshme dhe ofertuesi skualifikohet në rastet kur:

1. Nuk vërteton se ka të depozituara në një banke të paktën 20 % të vlerës së investimit të parashikuar për t'u realizuar në objektin e publikuar për konkurrim.

2. Investitori, me të cilin është lidhur kontrata e bashkëpunimit për mbështetje financiare nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në këto Dokumente Standarde të Procedurës Konkurruese;"

Megjithëse shoqëria "B. S" deri në momentin e aplikimit nuk ka fare aktivitet ekonomik dhe financiar ka paraqitur konfirmimin e gjendjes së llogarisë nga B... me nr.982 prot., datë 03.10.2022 për subjektin "B. S." me NIPT M2..... që ka pranë B.-Dega Lushnje në llogari rrjedhëse 3,466,000 lekë, 41,904,700 lekë dhe 150,047.5 euro, vlera këto që i përkasin sigurimit të ofertës dhe kërkesës 20% të vlerës së investimit.

Meqenëse shoqëria “B. S.” nuk ka aktivitet në fushën e shfrytëzimit mineral ka paraqitur dy kontrata noteriale me shoqëri të cilët garantojnë mbështetjen financiare për këtë shoqëri:

- Kontrata të tjera (kontratë bashkëpunimi), me nr. repertori 18..., nr. koleksioni nr.10..., datë 27.09.2022 midis “B. S.” e përfaqësuar nga administratori A. Xh., dhe shoqërisë “G. C.” e përfaqësuar nga administratori P. B për mbështetjen teknike dhe financiare, pasi palët kanë shprehur interesin për të bashkuar forcat, mjetet, kompetencat dhe për të ndarë përgjegjësitë për arritjen e objektivave të kësaj kontrate. Në nenin 2 është përcaktuar objekti i kësaj kontrate bashkëpunimi i shoqërive “B. S” dhe shoqërisë “G. C” për të marrë mbështetje teknike dhe financiare nga shoqëria “G. C”.

- Kontrata të tjera (kontratë bashkëpunimi), me nr. repertori 18..., nr. koleksioni nr.10... datë 01.10.2022 midis “B. S” e përfaqësuar nga administratori A. Xh., dhe shoqërisë “P. M. G” e përfaqësuar nga administratori A. Xh., për mbështetjen teknike dhe financiare, pasi palët kanë shprehur interesin për të bashkuar forcat, mjetet, kompetencat dhe për të ndarë përgjegjësitë për arritjen e objektivave të kësaj kontrate. Në nenin 2 është përcaktuar objekti i kësaj kontrate bashkëpunimi i shoqërive “B. S” dhe shoqërisë “P. M. G” për të marrë mbështetje teknike dhe financiare nga shoqëria “P. M. G”.

Nga sa më lart, konstatohet se administratori A. Xh., ka nënshkruar kontratë me vetveten, në cilësinë e përfaqësuesit të subjekteve palë në marrëveshje.

Në dosjen e aplikimit të kësaj procedure konkurruese, mungojnë dokumentet që provojnë burimet financiare të shoqërive “G. C” dhe “P. M. G”, të cilat janë mbështetësit financiar të shoqërisë “B. S”: mungojnë kopjet e pasqyrave financiare të dy viteve të fundit, të certifikuara nga Administrata Tatimore, si dhe mungojnë vërtetimet nga Banka që konfirmon se personi juridik me të cilët është lidhur kontrata e bashkëpunimit për mbështetje financiare ka të depozituara numrin e llogarisë të paktën 20 % të vlerës së investimit të parashikuar për t’u realizuar në objektin e hedhur për konkurrimin e publikuar. Në referencë pikës 2 të kriterëve specifike të kualifikimit të kreut- “Pjesëmarrja dhe kualifikimi”, të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, plotësimi i kërkesave për kapacitetet ekonomike dhe financiare, oferta e shoqërisë “B. S” duhej të konsiderohej e pavlefshme dhe ky ofertues të skualifikohej, pasi shoqëritë me të cilën është lidhur kontrata e bashkëpunimit për mbështetje financiare, nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këto Dokumente Standarde të Procedurës Konkurruese.

Në kriteret specifike të kualifikimit, lidhur me kërkesat për **kapacitetet tekniko-profesionale** në pikën 2 është përcaktuar: *“Subjekti të vërtetohet se ka përvojë në fushën minerare, të vërtetuar nga referenca për përmbushje të suksesshme të punimeve minerare të ngjashme, të lëshuara nga një ent publik, ose privat, që tregon vlerën kohën dhe natyrën e punimeve të ekzekutuara, dhe/ose çfarëdolloj dokumenti tjetër që parashikon legjislacioni në fuqi dhe që mund ta vërtetohet një gjë të tillë.*

Në rast se subjekti nuk ka përvojë në fushën minerare atëherë ai duhet të paraqesë një dokument noterial (marrëveshje bashkëpunimi) ne te cilin shprehet vullneti për mbështetje teknike nga një subjekt me përvojë në fushën minerare. Subjekti mbështetës duhet të vërtetohet eksperiencën e tij në fushën minerare me dokumentacionin e parashikuar në paragrafin e mësipërm.”

Meqenëse shoqëria “B. S” nuk ka aktivitet dhe përvojë fare në fushën e shfrytëzimit mineral ka paraqitur tre kontrata noteriale me investitor të cilët shprehet vullneti për mbështetje teknike për këtë shoqëri:

- Kontrata të tjera (kontratë bashkëpunimi) dy kopje, me nr. repertori 17..., nr. koleksioni nr.97..., datë 15.09.2022, midis “B. S” e përfaqësuar nga administratori A. Xh., dhe shoqërisë “B.” SHPK e përfaqësuar nga administratori G. D., për mbështetjen teknike, pasi palët kanë shprehur interesin për të bashkuar forcat, mjetet, kompetencat dhe për të ndarë përgjegjësitë për arritjen e objektivave të kësaj kontrate. Në nenin 2 është përcaktuar objekti i kësaj kontrate bashkëpunimi i shoqërive “B. S” dhe shoqërisë “B.” SHPK për të marrë mbështetje teknike nga shoqëria “B.”.

- Kontrata të tjera (kontratë bashkëpunimi), me nr. repertori 17..., nr. koleksioni nr.98..., datë 20.09.2022 midis "B..." SHPK e përfaqësuar nga administratori G. D., dhe shoqërisë "G. C SHPK" e përfaqësuar nga administratori P. B., për mbështetjen me makineri dhe pajisje të shoqërisë "B." SHPK. Në nenin 2 është përcaktuar objekti i kësaj kontratë bashkëpunimi i shoqërive "B." SHPK dhe shoqërisë "G. C" SHPK për të marrë mbështetje teknike nga shoqëria mëmë "G."

Nga sa më sipër konstatohet se shoqëria "B." SHPK nuk ka kapacitetet e nevojshme dhe të mjaftueshme për mbështetje teknike, pasi vetë asaj do t'i vihen në dispozicion nga shoqëria mëmë "G. C" SHPK.

- Kontrata të tjera (kontratë bashkëpunimi), me nr. repertori 17..., nr. koleksioni nr.98..., datë 20.09.2022 midis "B. S" dhe shoqërisë "P. M. G" për mbështetjen teknike, pasi palët kanë shprehur interesin për të bashkuar forcat, mjetet, kompetencat dhe për të ndarë përgjegjësitë për arritjen e objektivave të kësaj kontrate. Në nenin 2 është përcaktuar objekti i kësaj kontrate bashkëpunimi i shoqërive "B. S" dhe shoqërisë "P. M. G" për të marrë mbështetje me makineri pajisje nga shoqëria "P. M. G".

Veç sa më lart, duhet mbajtur në konsideratë se subjektet e mësipërme, me forcat, mjetet, kompetencat duhet të plotësojnë detyrimet e tyre të marra përsipër në lejet e tyre në zotërim.

Në përmbushje të pikës 5 të kriterëve specifike të kualifikimit, kërkesat për kapacitetet tekniko-profesionale, lidhur me dëshmi mbi fuqinë mesatare punëtore të ofertuesit dhe stafit drejtues, subjekti i shpallur fitues "B. S." ka paraqitur kontratë bashkëpunimi me kohë të pjesshme me juristin A. C.; me kontabilisten P. H.; kontratë pune me E. S., për Drejtues teknik nga data 21.09.2022, me leje profesionale nr.682/1, datë 18.05.2020, pa asnjë eksperiencë në fushën minerare: topograf terreni në HEC Fan, në "T. E." dhe në një subjekt tjetër privat.

Gjithashtu, në listë pagesat e sigurimeve shoqërore figuron 1 kontribues në muajt qershor dhe gusht, si dhe në muajin shtator janë 6 punonjës: 2 administrator, 2 shoferë nga i cili 1 kamioni; 1 menaxher guroreje dhe 1 drejtues ekskavatori.

Në këtë mënyrë subjekti i shpallur fitues "B. S.", nuk dëshmon se ka fuqinë punëtore të nevojshme dhe të domosdoshme për të realizuar nxjerrjen dhe përpunimin e 26 250 m³ ranor silicor në vit me 1 shofer kamioni dhe 1 drejtues ekskavatori, pasi në Lejen minerare nr.96..., date 14.07.2016 për të prodhuar gur gëlqeror 24 000 m³ në vit, MIE ka përcaktuar fuqinë punëtore 8 punonjës. Nga sa më sipër, në zbatim të pikës 5 të kriterëve specifike të kualifikimit, për mosplotësim të kërkesave për kapacitetet tekniko-profesionale, oferta duhej të konsiderohej e pavlefshme dhe ofertuesi "B. S" duhej të skualifikohej.

Në plotësim të pikës 6 të kriterëve specifike të kualifikimit, kërkesat për kapacitetet tekniko-profesionale, për listën e mjeteve, të shoqëruar me dokumentet që vërtetojnë të drejtat reale që subjekti gëzon ndaj mjetit (pronësi, qira, përdorim apo çdo lloj tjetër posedimi), shoqëria "B. S" ka paraqitur listën e mjeteve dhe dokumentet shoqëruese që zotërojnë subjektet "B." SHPK, "G. C" SHPK dhe "P. M. G".

Meqenëse, kompania "G. C" ka marrëveshje noteriale me subjektin "B." SHPK, nga ana e KVO nuk duhej të merret në konsideratë, pasi nuk është palë direkte me subjektin aplikues "B. S". Megjithatë, në listën e mjeteve në pronësi të "B." SHPK janë paraqitur 1 fadromë; 2 ekskavatorë nga të cilët njëri me zinxhir; 1 gërmues vetëlëvizës, si dhe 1 linjë prodhim inertesh, ndërsa nga shoqëria "P. M. G" janë listuar 20 makineri mermeri (sharrë, frezë, torno, lucidues, robot shkarkim mermeri etj.) dhe një vinç lëvizës, të pamjaftueshme për realizimin e nxjerrjes së mineralit jometalor.

Mbi të gjitha, këto lista të mjeteve nuk kanë dokument që të vërtetojnë të drejtat reale që subjekti "B. S" gëzon ndaj mjetit: pronësi, qira, përdorim apo lloj tjetër posedimi, dhe në këto kushte kjo ofertë duhet të quhej e pavlefshme dhe ofertuesi të skualifikohej, për mos plotësim të kapaciteteve tekniko-profesionale.

Për germën "c" lidhur me pagesën energjisë janë paraqitur dy vërtetime debie: me nr.921 prot., datë 21.09.2022, bazuar në deklaratimet e deklaruesit A. Xh., që për kontratën FI..... në pritje për t'i kaluar përdorues "B. S", nuk ka detyrime për muajin gusht 2022; me nr.952 prot.,

datë 03.10.2022, bazuar në deklaratimet e deklaruesit A. Xh., që për kontratën FI..... përdorues është “B. S”, nuk ka detyrime deri më datë 03.10.2022, gjë që tregon se subjekti nuk ka kontratë për pagesë të energjisë elektrike.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka zbatuar përcaktimet e germës “b” të pikës 7.20 të VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese” i ndryshuar, për të deklaruar të pavlefshme ofertën e subjektit “B. S”, pasi nuk ka plotësuar dy nga tre kërkesat e ftesës për procedurë konkurruese: kriterin profesional dhe ekonomiko-financiar.

Procedura konkurruese për zonën minerare nr.27... në objektin B., Selenicë qarku Vlorë, për llojin e mineralit “Ranor, silicor, masiv”, duhej të konsiderohej e pasuksesshme, pasi asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përmbush kërkesat për procedurë konkurruese, në zbatim të pikës 7.21, germa “a” të VKM nr.320, datë 21.04.2011 i ndryshuar.

Në dosjen e aplikimit të subjektit “B. S” ndodhet dhe një Referencë për aktivitetin minerar të shoqërisë mbështetëse teknike “B.” SHPK lëshuar nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN, A. B., me nr. 3779/1 prot., datë 20.09.2022, që cilëson se subjekti ka qenë i rregullt në veprimtarinë minerare, sjelljen e informacioneve, sigurimin e punonjësve nga aksidentet në punë, kryerjen e veprimtarisë sipas rregullave, kryerjen e pagesave të garancisë etj.

Sipas raporteve të monitorimit, në maj 2022, subjekti “B.” SHPK për lejen minerare 96..., datë 14.07.2016, nga 12 punonjës gjithsej vetëm 5 janë me sigurim jete, si dhe është lënë detyrë që të bëhet rehabilitimi i mjedisit në sipërfaqet ku ka mbaruar shfrytëzimi, gjë që tregon se subjekti nuk ka kryer rehabilitimin progresiv të mjedisit, si dhe nuk ka të gjithë punonjësit me sigurim jete.

Për lejen minerare nr.18..., datë 29.08.2016 të po këtij subjekti nga 13 punonjës vetëm 3 janë të siguar dhe nuk është kryer rehabilitimi i mjedisit në sipërfaqet ku ka mbaruar shfrytëzimi. Për sa i përket numrit të punonjësve e njëjta situatë ka qenë dhe në vitin 2021 për te dyja lejet, si dhe në RevZone, nuk ka të dhëna të raportuara për lejen minerare nr.18...,

Nga auditimi i zbatimit të procedurës së konkurrimit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën kombëtare të Biznesit për zonën minerare konkurruese nr.27... për objektin B..., Selenicë, Qarku Vlorë ka rezultuar gjetja dhe situatat si më poshtë:

Titulli gjetjes:	i Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar shpallur fitues në mënyrë të padrejtë subjektin “B. S” për procedurën dhe kriteret e konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën kombëtare të Biznesit për zonën minerare konkurruese nr.27... për objektin B., Selenicë, Qarku Vlorë.
Situata:	Nga dokumentacioni dhe informacioni i mësipërm i vënë në dispozicion, konstatohet se: - Sipas dokumentacionit financiar në dosjen e aplikimit konstatohet se, vlera e Sigurimit të ofertës prej 3,466,000 lekë është në llogari rrjedhëse dhe jo në llogari depozitë; konfirmimi i gjendjes së llogarisë është lëshuar nga B.-Dega Lushnjë, por vendi i cilësuar në shkresë i përket Tiranës; subjekti “B. S” SHPK i ka llogaritë në B.-Dega Lushnjë, ndërsa selinë në Vlorë. - Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar me pikët maksimale plotësimin e kriterëve nga subjekti shpallur fitues “B. S” SHPK, për Aftësitë tekniko profesionale në kushtet kur ky ofertues nuk ka eksperiencë në veprimtarinë minerare, në përbërje të stafit mungon fuqia punëtore e nevojshme; drejtuesi teknik nuk ka eksperiencë në fushën minerare etj.; për Aftësitë ekonomiko-financiare të subjektit kur në dosjen

e aplikimit i mungojnë dokumentet që provojnë burimet e financimit të shoqërive që e mbështesin financiarisht; etj., në kundërshtim me përcaktimet në Aneksin IV-A “Formulari i ofertës tekniko-financiare për leje minerare”, të DSPK.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar shpallur fitues në mënyrë të padrejtë subjektin “B. S” për procedurën dhe kriteret e konkurrencimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën kombëtare të Biznesit për zonën minerare konkurruese nr.27... për objektin B., Selenicë, Qarku Vlorë, pasi:

- Dy kontratat noteriale me shoqëritë të cilët garantojnë mbështetjen financiare të subjektit të shpallur fitues nuk janë shoqëruar me dokumente që provojnë burimet financiare të shoqërive “G. C.” dhe “P. M. G”, pasi mungojnë kopjet e pasqyrave financiare të dy viteve të fundit të certifikuar nga Administrata Tatimore, si dhe mungojnë vërtetimet nga Banka që konfirmojnë se personi juridik ka të depozituara në numrin e llogarisë të paktën 20 % të vlerës së investimit të parashikuar për t’u realizuar në objektin e hedhur për konkurrencimin e publikuar. Sa më sipër janë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2 të Kriterëve specifike të kualifikimit të kreut- Pjesëmarrja dhe kualifikimi, të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. Mbi këtë bazë, oferta e shoqërisë “B. S” duhej të quhej e pavlefshme dhe ky ofertues të skualifikohej, pasi investitorët me të cilin është lidhur kontrata e bashkëpunimit për mbështetje financiare, nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara Dokumentet Standarde të Procedurës Konkurruese.

- Në mungesë të përvojës në fushën e shfrytëzimit minerar subjekti i shpallur fitues ka paraqitur tre kontrata noteriale me investitor të cilët shprehet vullneti për mbështetje teknike për këtë shoqëri, nga e cila Kontrata e bashkëpunimit me nr. repertori 17..., nr. koleksioni nr.98..., datë 20.09.2022 është midis “B.” SHPK dhe shoqërisë “G. C SHPK” për mbështetjen me makineri dhe pajisje të shoqërisë “B.” SHPK, dhe jo për mbështetje të subjektit të shpallur fitues “B. S”. Në kontratat e mësipërme, krahas mangësive në numrin dhe llojin e makinerive dhe që duhet të shërbejnë fillimisht për plotësimin e detyrimeve të veta të investimit dhe prodhimit, listat e mjeteve nuk kanë dokument që të vërtetojnë të drejtat reale që subjekti “B. S” gëzon ndaj mjetit: pronësi, qira, përdorim apo lloj tjetër posedimi, dhe në këto kushte kjo ofertë duhet të quhej e pavlefshme dhe ofertuesi të skualifikohej, për mos plotësim të kapaciteteve tekniko-profesionale, pika 7 e Kriterëve Specifike të Kualifikimit, të Kreut – Pjesëmarrja dhe Kualifikimi të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

- Subjekti i shpallur fitues “B. S” nuk dëshmon se ka fuqinë punëtore të nevojshme, pasi ka paraqitur kontratë bashkëpunimi me kohë të pjesshme me 1 jurist; me 1 kontabilist; kontratë pune me Drejtuesin teknik pa eksperiencë në fushën minerare, si dhe në listë pagesat e sigurimeve shoqërore figuron 1 kontribues në muajt qershor dhe gusht, si dhe në muajin shtator janë 6 punonjës: 2 administrator, 2 shoferë nga i cili 1 kamioni; 1 menaxher guroreje dhe 1 drejtues ekskavatori, të pamjaftueshme për të realizuar nxjerrjen dhe përpunimin e 26 250 m³ ranor silicor në vit, pasi për krahasim, në Lejen minerare nr.96..., datë 14.07.2016 për të prodhuar gur gëlqeror 24 000 m³ në vit, MIE ka përcaktuar fuqinë punëtore 8 punonjës. Nga sa më sipër, në zbatim të pikës 5 të Kriterëve Specifike të Kualifikimit, të Kreut –Pjesëmarrja dhe Kualifikimi të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. kërkesat për kapacitetet tekniko-profesionale, oferta duhej të quhej e pavlefshme dhe ofertuesi “B. S” duhej të skualifikohej.

	Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka zbatuar përcaktimet e germës “b” të pikës 7.20 të VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese” i ndryshuar, për të deklaruar të pavlefshme ofertën e subjektit “B. S”, pasi nuk ka plotësuar dy nga tre kërkesat e ftesës për procedurë konkurruese: kriterin profesional dhe ekonomik-financiar. Si përfundim, procedura konkurruese për zonën minerare nr.27... në objektin B., Selenicë qarku Vlorë, për llojin e mineralit “Ranor, silicor, masiv”, duhej të konsiderohej e pasuksesshme, pasi asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përmbush kërkesat për procedurë konkurruese, në zbatim të pikës 7.21, germa “a” të VKM nr.320, datë 21.04.2011 i ndryshuar.
Kriteri:	VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese” i ndryshuar dhe Kriteret Specifike të Kualifikimit, kërkesat për kapacitetet tekniko-profesionale.
Ndikimi:	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar shpallur fitues në mënyrë të padrejtë subjektin “B. S” për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën kombëtare të Biznesit për zonën minerare konkurruese nr.27... për objektin B., Selenicë, Qarku Vlorë.
Shkaku	Procedura konkurruese për zonën minerare nr.27... në objektin B., Selenicë qarku Vlorë, për llojin e mineralit “Ranor, silicor, masiv”, duhej të konsiderohej e pasuksesshme, pasi asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përmbush kërkesat për procedurë konkurruese, në zbatim të pikës 7.21, germa “a” të VKM nr.320, datë 21.04.2011 i ndryshuar.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	MIE dhe Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masat për të kualifikuar shpallur fitues subjekte të cilët në përputhje me procedurën konkurruese plotësojnë kriteret e konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën kombëtare të Biznesit për zonat minerare konkurruese.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave E. A., Kryetar; M. H., , anëtar; E. I., , anëtar; S. M., anëtar; T. A., , anëtar, E. G., anëtar; M. C., anëtar.

Pretendimi i subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar MIE me shkresën nr. 983/15, datë 04.08.2023 ka bërë komente dhe shpjegime për Projekt Raportin, janë sjellë observacionet të cilat shkurtimisht po i paraqesim në raport konkretisht:

- Formulari i sigurimit te ofertës nr. 975 prot. date 29.10.2022, depozituar ne procedurën konkurruese nga shoqëria “B. S” shpk është paraqitur sipas formatit te përcaktuar në DSPK, Aneksi II, duke përmbushur te gjitha kriteret dhe kushtet e përcaktuara ne Aneksin II, te DSPK. Ne formularin e sigurimit te ofertës nr. 975 prot. date 29.10.2022 është përcaktuar se përfituesi është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe ne vërtetimin e lëshuar nga Banka përcaktohet se: “Vërtetojmë se shoqëria “B. S” shpk ka depozituar pranë “B.” sha Dega Lushnje një vlere prej 3 466 000 leke, si kusht për sigurimin e ofertës”.

- Për plotësimin e pikës 1), te kriterëve tekniko profesionale, shoqëria “B. S” shpk, duke qene se është shoqëri e re dhe pa eksperiencë ne fushën minerare, ka lidhur kontrate bashkëpunimi me nr. 17... rep, nr. 97... kol date 15.09. 29022, me shoqërinë “B.” shpk, e cila është një shoqëri me eksperiencë ne fushën minerare. Për te vërtetuar eksperiencën ne fushën minerare, shoqëria “B.” sh.p.k ka paraqitur shkrese nga AKBN nr. 3779 prot date 20.09.2022 me lende “Reference për aktivitetit minerar”, Miratimin e programit vjetor te punës për periudhën 05.09.2020 – 05.09.2021, me nr. 3021/1 prot date 04.11.2020, si dhe Miratimin e programit vjetor te punës për periudhën 05.09.2021 – 05.09.2022, me nr. 2903/1 prot date 15.11.2021.

- Ne lidhje me drejtuesin teknik ju sqarojmë se, ne DSPK, Kriteret Specifike të Kualifikimit, Kërkesat për Kapacitetet tekniko profesional, pika 5), Licenca Profesionale e drejtuesit teknik dhe kontratën me drejtuesin teknik. Për plotësimin e kësaj kërkesë shoqëria ka paraqitur kontratën e punës me nr. 46... rep. Nr. 18... kol date 21.09.2022, e lidhur ndërmjet shoqërisë “B. S” shpk dhe E. S., me objekt kontratë “Marrja ne pune e te punësuarit

si Drejtues teknik, me profesion Inxhinier Markshajder, pajisur me Leje Profesionale nr. 682/1 date 18.05.2020. Ne DSPK nuk përcaktohet se Drejtuesi teknik duhet te ketë eksperience ne pune.

- Ne rastet kur ofertuesi ka paraqitur një dokument noterial me një investitor, i cili garanton mbështetje financiare për realizimin e programit të investimit, ky dokument duhet të shoqërohet me dokumentet që provojnë burimet financiare të këtij të fundit, si te parashikuara në pikat 1 dhe 2, me sipër.

Shënim: *Mosplotësimi i kriterëve te parashikuar ne piken 1) nuk përbena kusht skualifikimi por është i rëndësishëm për vlerësimin e kriterëve ekonomiko – financiare. Kriteri i parashikuar në piken 2 është kusht i domosdoshëm dhe mosplotësimi i tij përbën kusht skualifikimi.*

Mbi kapacitetet tekniko – profesionale. ”, sqarojmë se:

- Ne DSPK, është kërkuar lista e mjeteve e shoqëruar me dokumentet që vërtetojnë të drejtat reale që subjekti gëzon ndaj mjetit (pronësi, qera, përdorim apo çdo lloj tjetër posedimi). Për plotësimin e kriterit te mësipërm, shoqëria “B. S” sh.p.k ka paraqitur kontrate bashkëpunimi me shoqërinë “G. C” sh.p.k me nr. 18... rep. Nr. 10... kol. date 27.09.2022., Gjithashtu shoqëria “B. S” sh.p.k ka lidhur kontrate bashkëpunimi me shoqërinë “B.” sh.p.k me nr. 17... rep, nr. 97... kol date 15.09.2022, si dhe dokumentacion për mjetet qe shoqëria “B...” sh.p.k zotëron. Gjithashtu shoqëria “B. S.” sh.p.k ka lidhur dhe një kontrate bashkëpunimi me shoqërinë “P. M. G” sh.p.k me nr. 18... rep, nr. 10...kol date 01.10.2022.

- Për plotësimin e pikës 1), te kriterëve tekniko profesionale, shoqëria “B. S” shpk ka lidhur kontrate bashkëpunimi me nr. 17... rep, nr. 97... kol date 15.09. 29022, me shoqërinë “B.” shpk, e cila është një shoqëri me eksperiencë ne fushën minerare. Për te vërtetuar eksperiencën ne fushën minerare, shoqëria “B.” sh.p.k ka paraqitur shkresë nga AKBN nr. 3779 prot date 20.09.2022 me lende “Reference per aktivitetet minerare” si dhe Miratimin e programit vjetor te punës për periudhën 05.09.2020 – 05.09.2021, me nr. 3021/1 prot date 04.11.2020. Mospërputhja e referencës se lëshuar nga AKBN ne shkresën nr. 3779/1 prot date 20.09.2022, me situatën aktuale apo me raportet vjetore nuk është përgjegjësi e KOV-s por përgjegjësi e AKBN.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar MIE për Projekt Raportin e Auditimit dërguar me shkresën nr. 983/15, datë 04.08.2023 grupi i auditimit gjykon se:

- Sipas dokumentacionit financiar në dosjen e aplikimit konstatohet se, vlera e Sigurimit të ofertës prej 3,466,000 lekë është në llogari rrjedhëse dhe jo në llogari depozitë;

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar me pikët maksimale plotësimin e kriterëve nga subjekti shpallur fitues “B. S” SHPK, për Aftësitë tekniko profesionale në kushtet kur ky ofertues nuk ka eksperiencë në veprimtarinë minerare, në përbërje të stafit mungon fuqia punëtore e nevojshme; drejtuesi teknik nuk ka eksperiencë në fushën minerare etj.;

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar shpallur fitues në mënyrë të padrejtë subjektin “B. S” për procedurën dhe kriteret e konkurrimit për dhënie e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën kombëtare të Biznesit për zonën minerare konkurruese nr.27... për objektin B., Selenicë, Qarku Vlorë.

Si përfundim, procedura konkurruese për zonën minerare nr.27... në objektin B., Selenicë qarku Vlorë, për llojin e mineralit “Ranor, silicor, masiv”, duhej të konsiderohej e pasuksesshme, pasi asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përmbush kërkesat për procedurë konkurruese, në zbatim të pikës 7.21, germa “a” të VKM nr.320, datë 21.04.2011 i ndryshuar.

Gjykojmë se nga Komisionit i Vlerësimit të Ofertave (KVO) nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet dhe gjetjet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart argumentet e sjella, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

1.2 Për zbatimin e kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullativ në procedurat e shqyrtimit të masave të pezullimit dhe të revokimit të lejeve minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Grupi i auditimit të KLSH, bazuar në të dhënat e kërkuara dhe të vëna në dispozicion nga AKBN, konstaton se në periudhën 2018 - 2022 janë propozuar për pezullim nga ana e saj dhe me kërkesë të subjekteve gjithsej 124 leje, me numrin më të lartë 43 në vitin 2020 (e lidhur në një farë mënyre dhe me pandeminë COVID 19) dhe më të ulët 4 në vitin 2018.

a. Për vendim-marrjet e MIE mbi miratimin e pezullimeve të përkohshme të lejeve minerare

Sipas të dhënave të AKBN, në periudhën 2018 - 2022, MIE ka dhënë 92 miratime për pezullim të përkohshëm të lejeve minerare me kërkesën e subjektit, nga të cilat 63 në periudhën 2018 -21.07.2021 dhe 29 pezullime nga kjo datë deri në fund të vitit 2022.

Në zbatim të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 9/2013, datë 14.02.2013 dhe me ligjin nr. 134/2014 datë 10.09.2014, ministri i MIE është në ushtrim të kompetencave të veta për miratimin e

pezullimeve, në referencë të pikës 3 të nenit 18: *“Pas miratimit nga ministri të ndalimit, pezullimit, uljes së prodhimit sipas shkronjave “d”, “dh”, “e” të pikës 1 të këtij neni, zotëruesit i kthehet garancia vjetore për realizimin e investimit”*.

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 me ligjin nr. 65/2021 datë 20.5.2021, (botuar në Fletoren Zyrtare nr.107, datë 15.07.2021), duke filluar nga data 21.07.2021 është shfuqizuar pika e mësipërme 3 e nenit 18, midis të tjerave edhe për miratimin nga ministri të pezullimit, uljes së prodhimit etj.

Në referencë të nenit 18, pika 1 dhe 2 dhe të nenit 25 të ligjit mineral të mësipërm, është struktura përgjegjëse ajo së cilës i paraqitet informacioni mbi realizimin e prodhimit, raporti financiar, shqyrtimin e planit vjetor etj., dhe për pasojë edhe për të dhënë informacione dhe shpjegime, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit apo ta pezullojë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar.

Për më tepër, në se zotëruesi i lejes minerare do të kërkonte miratimin e pezullimit të përkohshëm ose ndërprerjen e prodhimit në MIE, në rast të mos miratimit të kërkesës, subjektit nuk i jepet mundësia/e drejta e ankimit tek ky institucion. Kjo pasi, në rastet e ndëshkimit me pezullim, në zbatim të nenit 46 të ligjit mineral, pika 5, subjekti, ndaj të cilit merret masa e pezullimit, ka të drejtën e ankimit pranë ministrit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit të strukturës përgjegjëse.

Sipas VKM nr. 232, datë 23.02.2011 *“Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin mineral të Republikës së Shqipërisë”*, pika 1, strukturat përgjegjëse për dhënien e lejeve minerare, mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarive minerare në zbatim të ligjit nr. 10304, janë AKBN, SHGJSH, AKSEM, Drejtoria përkatëse në METE që trajton problemet minerare si dhe QKL. Duhet theksuar se, megjithëse në strukturat përgjegjëse përfshihet dhe Drejtoria përkatëse në MIE, është në të drejtën e saj që të kërkojë nga AKBN që të kryejnë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave ligjore, afateve procedurale dhe informacione, por vetë nuk ka detyra të inspektimit.

Bazuar në sa më sipër, nga shqyrtimi i pezullimeve të lejeve minerare pas datës 21.07.2021 deri në fund të vitit 2022 (pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të ligjit mineral me ligjin nr. 65/2021 datë 20.5.2021), rezultojnë 29 miratime të pezullimeve të përkohshme (3 të vitit 2021 dhe 26 të vitit 2022) për të cilat është marrë vendim nga MIE, në tejkallim të përcaktimeve ligjore trajtuar më lart, pasi MIE ka marrë atributet e strukturës përgjegjëse, në këtë rast AKBN.

Veç kësaj, sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga AKBN për kërkesat e 19 subjekteve të cilat janë pa afat të periudhës së pezullimit, rezulton se miratimi për pezullim nga ana e MIE është dhënë me shumë vonesë, mesatarisht 1.5 muaj pas kërkesës së bërë nga subjekti, megjithëse nuk ka ndonjë akt administrativ që të rregullojnë procedurën e pezullimit me kërkesë të subjektit dhe kohëzgjatjen e ndërprerjes së prodhimit apo pezullimit të përkohshëm.

Sipas të dhënave të regjistrit të lejeve minerare, konstatohet se një numër subjektesh kanë vijuar pezullimin për periudha disa vjeçare, si p.sh: leja minerare nr.98..., datë 12.12.2006 “D. O” ka marrë miratimin e pezullimit të përkohshëm nga MIE që nga data 08.11.2016 dhe gjatë periudhës 2018-2022 vazhdon me të njëjtin status; leja minerare nr.11..., datë 12.12.2007 “J.” ka marrë miratimin e pezullimit të përkohshëm nga MIE që nga data 06.10.2016 dhe gjatë periudhës 2018-2022 vazhdon me të njëjtin status; leja minerare nr.10..., datë 06.04.2007 “O. A” ka marrë miratimin e pezullimit të përkohshëm nga MIE që nga data 10.09.2015 dhe gjatë periudhës 2018-2022 vazhdon me të njëjtin status; leja minerare nr.12..., datë 30.07.2008 “Sh.” ka marrë miratimin e pezullimit të përkohshëm nga MIE që nga data 02.09.2016 dhe gjatë periudhës 2018-2022 vazhdon me të njëjtin status etj.

b. Për çështjet e zbatimit të procedurës për revokimin e lejeve minerare.

Sipas të dhënave të MIE mbi propozimet për revokim të dërguara nga strukturat përgjegjëse dhe të kërkesave të vetë subjekteve minerare rezulton si më poshtë.

Tabela nr. 2 Statusi i propozimeve për revokim 2018-2022

Nr.	Emërtimi	Gjithsej	Numër					Pa të dhëna
			2018	2019	2020	2021	2022	
	Gjithsej	185	72	47	10	12	38	6
1	Revokuar	146	66	45	6	7	22	
2	Ndërprerje e procedurës	27	2	1	4		14	6
3	Procedurë ankimi	5				4	1	
4	Shtyrje afati	3	2	1				
5	Të tjera	4	2			1	1	

Burimi: Të dhëna të MIE të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Lidhur me masën e revokimit, nga të dhënat e websitet zyrtar të MIE (<https://www.infrastruktura.gov.al/lejet-minerare-ne-proces-revokimi/>) konstatohet se propozimet e dërguara për revokim nga strukturat përgjegjëse (AKBN, AKSEM dhe SHGJSH) dhe njoftimi i subjekteve për fillimin e procedurave të revokimit janë sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela nr. 3 Propozimet dhe dërgimi i njoftimit për fillimin e procedurave 2018-2022

Nr.	Emërtimi	Dërgimi i njoftimeve					Gjithsej
		2018	2019	2020	2021	2022	
1	Propozimet deri në 2017	38	2				40
2	Propozimet 2018	34	1				35
3	Propozimet 2019		44				44
4	Propozimet 2020			10	6		16
5	Propozimet 2021				19	3	22
6	Propozimet 2022					28	28
	Gjithsej	72	47	10	25	31	185

Burimi: Të dhëna nga website i MIE, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se në periudhën 2018-2022 nga ana e MIE janë dërguar zotëruesve të lejeve minerare 185 njoftime për fillimin e procedurave të revokimit, nga të cilat 2 të propozuara nga AKSEM, 1 nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), 173 nga AKBN dhe 9 të tjera me kërkesën e vetë subjekteve. Duhet theksuar se janë 40 propozime të periudhës deri në vitin 2017, njoftimet për fillimin e procedurës së revokimit janë dërguar nga MIE në vitin 2018 dhe 2019, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 48, pika 1, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Propozimet për revokim kanë për shkak kryesisht për mospagim në afat të garancisë financiare për rehabilitim progresiv të mjedisit rreth 51 %, për mos fillim të aktivitetit minerar brenda afatit dhe/ose ndërprerja e aktivitetit për më shumë se 1 vit rreth 20 %, por nuk mungojnë dhe rastet për shkaqe të mos ushtrimit të aktivitetit sipas projektit teknik etj.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, **janë konstatuar 11 raste kur MIE nuk ka vijuar më tej procedurën e revokimit pas propozimeve të dërguara nga struktura përgjegjëse AKBN, kryesisht për vitin 2017 dhe 2018**, duke detyruar këtë të fundit të ri propozojë revokimin për herë të dytë apo dhe të tretë, si më poshtë.

Tabela nr. 4 Lejet e propozuara për revokim dy herë dhe më shumë nga AKBN 2018-2022

Nr.	Emërtimi	Datat e propozimit nga AKBN	Shënime:
1	Leja Nr.17..., datë 30.05.2014	09.01.2018; 18.04.2018	Revokuar 19.12.2018
2	Leja Nr.14..., datë 14.07.2010	09.01.2018; 16.04.2018	Revokuar 19.12.2018
3	Leja Nr.12..., datë 13.10.2008	30.01.2018; 16.04.2018	Revokuar 19.12.2018
4	Leja Nr.15..., datë 13.09.2010	13.09.2016; 01.08.2017	Revokuar 24.07.2018
5	Leja Nr. 17..., datë 08.10.2014	21.07.2016; 01.08.2017	Revokuar 24.07.2018
6	Leja Nr. 16..., datë 12.08.2013	15.06.2016; 01.08.2017	Revokuar 24.07.2018
7	Leja Nr. 11..., datë 06.12.2007	23.05.2017; 17.10.2017	Revokuar 19.07.2018
8	Leja Nr. 13..., datë 27.08.2013	05.01.2016; 07.07.2016; 10.11.2016; 25.07.2017	Revokuar 08.06.2018

9	Leja Nr.12... datë 18.12.2008	10.01.2016; 01.08.2017; 11.10.2017	Revokuar 28.05.2018
10	Leja nr.15..., datë 08.11.2012	15.05.2017; 01.08.2017	Ndërprerje procedurash 18.06.2018
11	Leja nr.18..., datë 23.10.2017	03.06.2021 (në objekt nuk punohet për më shumë se 1 vit); 26.01.2022 (pagesa e garancisë)	Ndërprerje procedurash

Burimi: Të dhëna të MIE dhe AKBN, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga shqyrtimi i regjistrit të lejeve, konstatohet se leja nr.12..., datë 13.10.2008 e cila është revokuar më datë 19.12.2018, ka qenë aktive deri në vitin 2020, duke shfaqur parregullsi në regjistrin e lejeve për kategorinë e lejeve aktive.

Krahas sa më sipër, **konstatohet se MIE ju ka dërguar zotëruesve të lejeve minerare njoftimin për fillimin e procedurave të revokimit për periudhën 2018-2022 mesatarisht 4 muaj pas marrjes së propozimit nga struktura përgjegjëse, periudhë e cila ka ardhur duke u zvogëluar në mesatarisht rreth 25 ditë në vitin 2022, por përsëri me vonesa.** Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme të MIE janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 48, pika 1, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili përcakton: “*Procedura e revokimit të lejes fillon, si rregull, me raportin e propozimit të strukturës përgjegjëse ose me kërkesë të zotëruesit të saj, kur ky i fundit ka plotësuar të gjitha detyrimet e saj.*”

Sipas të dhënave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion nga MIE lidhur me propozimet e AKBN për fillimin e procedurave të revokimit, konstatohen gjithsej 19 leje minerare: 7 në 2018; 7 në 2021 dhe 5 në 2022, **për të cilat megjithëse është dërguar propozimi për revokim nga ana e AKBN, si dhe nga ana e ministrit të MIE është bërë njoftimi i subjektit për fillimin e procedurave të revokimit, nga ana e këtij të fundit nuk është dalë me vendim përkatës,** në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 të nenit 48 të ligjit minerar: “*Ministri vendos revokimin e lejes minerare 30 ditë kalendarike pas kalimit të afateve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni. Në rast se brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e dytë, të pikës 2, zotëruesi i lejes minerare paraqet argumente dhe prova të mjaftueshme që provojnë mungesën e shkaqeve, për të cilat është iniciuar revokimi, ministri vendos pushimin e procedurës së revokimit.*”

Tabela nr. 5 Lejet e propozuara nga AKBN për revokim për të cilat nuk ka vendim-marrje nga MIE 2018-2022 dhe arsyetimi i grupit të auditimit të KLSH.

Nr.	Numri dhe data e lejes	Propozimi nga AKBN	Njoftimi nga MIE	Arsyetimi i MIE	Komente të grupit të auditimit të KLSH
1	Nr.16..., datë 06.03.2013	26.01.2022	22.02.2022	Ka shlyer detyrimin garancisë financiare për vitin 2020-2021, për te cilin ka filluar procedura e revokimit.	
2	Nr.18..., datë 21.06.2016	26.01.2022	16.02.2022	Ka shlyer detyrimet e garancisë financiare për vitet 2020-2021, për te cilin ka filluar procedura e revokimit.	
3	Nr.16..., datë 07.02.2014	15.12.2021	16.02.2022	Ankim me shkresën nr.384/1, prot., MIE, datë 18.01.2021.	Ankimi është para datës së njoftimit për fillim procedure
4	Nr.11..., datë 03.03.2008	12.12.2021	10.01.2022	Procedura e revokimit është në vazhdim.	
5	Nr.80..., datë 28.03.2005	07.12.2021	10.01.2022	Ka shlyer detyrimin garancisë financiare për vitin 2021, për te cilin ka filluar procedura e revokimit.	
6	Nr.18..., datë 23.10.2017	03.06.2021	20.09.2021	Përgatitur Akti për revokim leje.	
7	Nr. 16..., datë 06.09.2016	08.03.2021	15.11.2021	Ankim me shkresën nr.3521 prot., datë 28.04.2022, bashkëlidhur shkresa.	Nuk është punuar në objekt që nga momenti i marrjes së lejes

8	Nr.80..., datë 04.10.2004	01.11.2021	18.11.2021	Në objekt kanë përfunduar rezervat e nxjerrshme, Leja është në përfundim të afatit të vlefshmërisë, subjekti është në procedurë për mbylljen përfundimtare të objektit.	Nuk punohet për më shumë se 1 vit.
9	Nr. 16..., datë 07.02.2014	10.12.2020	12.01.2021	Ankimi me shkresën nr.384/1, prot., MIE, datë 18.01.2021.	Nuk është filluar punë brenda 180 ditëve, si dhe ka dështuar në realizmin 90% të vlerës së investimit.
10	Nr. 16..., datë 07.02.2014	10.12.2020	12.01.2021	Ankim me shkresën nr.384/1, prot., MIE, datë 18.01.2021.	Nuk është filluar punë brenda 180 ditëve, si dhe ka dështuar në realizmin 90% të vlerës së investimit.
11	Nr. 15..., datë 22.02.2012	10.12.2020	12.01.2021	Ankim me shkresën nr.384/1, prot., MIE, datë 18.01.2021	nuk zhvillon aktivitet minerar për më shumë se 1 vit.
12	Nr. 64..., datë 27.08.2001	10.12.2020	12.01.2021	Ankim me shkresën nr.384/1, prot., MIE, datë 18.01.2021	nuk zhvillon aktivitet minerar për më shumë se 1 vit.
13	Nr.18..., datë 07.12.2016	11.12.2018	19.12.2018	Ka mbaruar afati 3 vjeçar i vlefshmërisë se lejes. Në njoftimin për fillim procedurash i është vene kusht qe te shlyeje detyrimet për mjedisin për sipërfaqen e shfrytëzuar, e cila është me e madhe se ajo për te cilën ka kryer garancinë e rehabilitimit dhe me pas do procedohet me revokimin e lejes minerare.	
14	Nr. 17..., datë 10.02.2015	02.08.2017	27.03.2018	Sipas AKBN, ka pasaktësi në përlogaritjen e vlerës së investimit, pasi prevalon VKM 741 datë 09.09.2015, ndërkohë që leja është marrë kur në fuqi ka qenë VKM 440 datë 16.06.2011.	Në shkresë është cilësuar i ligjshëm veprimi i AKBN për propozimin.
15	Nr. 61..., datë 02.04.2001	01.08.2017	16.07.2018	Akt –miratimi shtyrje, nr. 61..., datë 26.11.2020.	Eshtë më shumë se dy vjet më pas.
16	Nr.71..., datë 20.08.2003	01.08.2017	16.07.2018	Me urdhrin e ministrit Nr.185, date 30.04.2021 , ka ndryshuar vlera e garancisë financiare te mjedisit, dhe subjekti ka shlyer te gjitha detyrimet.	Propozimi për mos pagesë të garancisë së rehabilitimit 2016-2017, paguar në maj-qershor 2021. Kërkesa e subjektit e datës 28.02.2018, protokolluar në MIE më datë 01.03.2019.
17	Nr. 14..., datë 25.10.2010	01.08.2017	19.03.2018	Akt Miratimi shtyrje Nr.14..., datë 08.11.2019.	Nuk është paguar garancia financiare e mjedisit 2012, 2013, 2014 dhe 2015.
18	Nr. 17..., datë 29.05.2014	01.08.2017 21.01.2022	16.03.2018 22.02.2022	Ka shlyer detyrimin, për garancinë e rehabilitimit për vitin 2017-2018.	Nuk ka filluar aktivitetin minerar që nga data e marrjes së lejes.
19	Nr.77..., datë 03.02.2014	02.05.2017	31.01.2018	Akt Miratimi shtyrje nr.77..., datë 3.12.2014.	Nuk ka paguar garancinë e rehabilitimit 2016 dhe 2017.

Burimi: Të dhëna të MIE të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Duhet theksuar dhe mbajtur në konsideratë se mos fillimi i procedurave të revokimit dhe/ose fillimi me vonesë i tyre nga data e propozimit të strukturës përgjegjëse, dhe mungesa e finalizimit me vendim-marrje ndikojnë negativisht në veprimtarinë monitoruese të strukturave përgjegjëse dhe në tërësi në mbikëqyrjen e sektorit minerar.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga MIE dhe AKBN rezulton se MIE ka 23 raste që e ka ndërprerë procedurën e revokimit.

Tabela nr. 6 Lejet për të cilat është pushuar procedura e revokimit nga Ministri i MIE.

Nr	Emërtimi	Data e propozimit nga AKBN të revokimit	Data e njoftimit nga MIE të procedurës së revokimit	Data e kërkesës së subjekti për anulimin e procedurës	Data e ndërprerjes së procedurës së revokimit
1	Leja nr.59..., datë 26.01.2012	23.12.2014	09.07.2015	30.07.2015	09.11.2015
2	Leja nr.59..., datë 26.12.2000	10.04.2015	03.11.2015	15.01.2016	10.03.2016
3	Leja nr.17..., datë 06.06.2014	02.05.2017	15.01.2018		28.05.2018
4	Leja nr.14..., datë 11.09.2009	01.08.2017	16.03.2018	27.04.2018	07.06.2018
5	Leja nr.14..., datë 04.06.2010	01.08.2017	31.01.2018	06.02.2018	08.06.2018
6	Leja nr.15..., datë 08.11.2012	01.08.2017	24.11.2018	21.12.2017	18.06.2018
7	Leja nr.72..., datë 23.05.2014	09.11.2017	5615; 19.06.18	16.12.2017	18.06.2018
8	Leja nr.17..., datë 29.05.2014	01.08.2017	16.03.2018	04.04.2018	26.07.2018
9	Leja nr.61..., datë 02.04.2001	01.08.2017	16.03.2018	04.04.2018	09.08.2018
10	Leja nr.10..., datë 03.07.2007	31.01.2022	22.02.2022	09.03.2022	22.04.2022
11	Leja nr.17..., datë 21.05.2015	10.04.2019	05.07.2019	Pag.19.04.19	18.09.2019
12	Leja nr.86..., datë 02.06.2005	13.02.2020	18.05.2020	15.06.2020	07.07.2020
13	Leja nr.18..., datë 12.11.2015	13.09.2017	13.02.2020	18.05.2020	27.07.2020
14	Leja nr.18..., datë 13.09.2017	13.02.2020	18.05.2020	10.06.2020	27.07.2020
15	Leja nr.17..., datë 12.11.2015	13.02.2020	18.05.2020	Nuk ka	07.07.2020
16	Leja nr.17..., datë 21.05.2015	25.01.2022	22.02.2022	22.02.2022	11.04.2022
17	Leja nr.17..., datë 12.11.2015	22.02.2021	20.12.2021	30.12.2021	12.04.2022
18	Leja nr.17..., datë 21.05.2015	25.01.2022	22.02.2022	22.02.2022	12.04.2022
19	Leja nr.15..., datë 03.07.2007	25.01.2022	16.02.2022	Pag.14.04.22	22.04.2022
20	Leja nr.14..., datë 24.08.2009	22.02.2021	10.11.2021	Pag.08.03.22	11.05.2022
21	Leja nr.14..., datë 03.07.2007	31.01.2022	22.02.2022	Pag.29.04.22	11.05.2022
22	Leja nr.15..., datë 24.12.2010	27.04.2022	14.07.2022	12.07.2022	18.10.2022
23	Leja nr.11..., datë 03.03.2008	12.01.2022	16.02.2022	Shkr. nr.794/2	22.04.2022

Burimi: Të dhëna të AKBN dhe MIE, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Sipas të dhënave të mësipërme, konstatohet se MIE nuk ka vepruar në afat pas propozimit të AKBN për njoftimin e fillimit të procedurës së revokimit dhe lejes për marrjen e vendimit, pasi janë 15 raste kur vendim-marrja për pushimin e procedurave të revokimit është jashtë afateve të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 48 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, duke vënë në vështirësi veprimtarinë monitoruese të AKBN gjatë kësaj periudhe. E njëjta gjë vërehet dhe në vitin 2022, ku sipas të dhënave rezulton se 29 % vendimeve (për revokim apo për pushim procedure) janë marrë jashtë afateve ligjore të mësipërme.

Përgjithësisht, ndërprerjen e procedurës së revokimit, MIE e ka arsyetuar me kryerjen e pagesave të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit nga ana e zotëruesve të lejeve minerare gjatë ose pas periudhës pasi është marrë njoftimi për fillimin e procedurës së revokimit, duke i konsideruar faturat përkatëse prova të mjaftueshme për mungesën e shkaqeve, për të cilat është iniciuar revokimi, pa mbajtur në konsideratë që shkaku i fillimit të procedurës së revokimit është mospagesa në afat e garancisë së rehabilitimit, e pasqyruar kjo në propozimin e strukturës përgjegjëse.

Në shkresat dërguar subjekteve për ndërprerjen e procedurës së revokimit, MIE ka cilësuar të ligjshëm propozimin e AKBN për revokimin e lejes, dhe nga ana e tjetër konsideron të ligjshëm edhe pagesat e këtyre garancive nga ana e subjekteve pas njoftimit për fillimin e procedurave, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e germës “ç” të pikës 1 të nenit 47 të

ligjit minerar, i cili përcakton se mungesa e paraqitjes nga zotëruesi i lejes minerare të dokumentit të garancisë financiare të zbatimit të planit të rehabilitimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e çdo viti në vazhdim, përbën shkak ligjor për revokimin e lejes.

Veç kësaj, **Ministri i MIE ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 të nenit 48 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, i cili përcakton: “Në rast se brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e dytë, të pikës 2, zotëruesi i lejes minerare paraqet argumente dhe prova të mjaftueshme që provojnë mungesën e shkaqeve, për të cilat është iniciuar revokimi, ministri vendos pushimin e procedurës së revokimit”.** Kjo pasi, nisja e procedurës së revokimit të lejes në rastin mos pagesës së garancisë së rehabilitimit të mjedisit ka të bëjë me afatin shlyerjes së detyrimit, dhe mandatet e pagesës nuk janë rivendosje në afat dhe mungesë të shkaqeve për të iniciuar revokimin.

Krahas sa më sipër, zbatimi i sanksionit të revokimit të lejes nuk e liron zotëruesin nga detyrimet e këtij ligji, si dhe është detyrë e ministrit që të ndjek pa kufizim çdo të drejtë ligjore dhe të ndërmarrë çdo veprim ligjor, për të vjelë dëmshpërblimin përkatës për dëmet shkaktuar shtetit nga shkeljet e zotëruesit të lejes minerare, sipas pikë 2 dhe 3 të nenit 49 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar: “2. Zbatimi i sanksioneve administrative të pezullimit apo revokimit të lejes nuk e liron zotëruesin nga detyrimet e këtij ligji dhe nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar, sipas legjislacionit në fuqi. 3. Kur revokohet leja minerare, sipas parashikimeve të këtij ligji, ministri ndjek pa kufizim çdo të drejtë ligjore dhe ndërmerr çdo veprim ligjor, për të vjelë dëmshpërblimin përkatës për dëmet shkaktuar shtetit nga shkeljet e zotëruesit të lejes minerare”. Mbi këtë bazë, rezulton se zbatimi i detyrimeve të ligjit minerar jashtë afateve, nuk përbën shkak për ndërprerjen e procedurës së revokimit.

c. Anulimi i revokimeve

Nga regjistri i lejeve për vitet e periudhës 2018 - 2022 janë konstatuar raste që anulimi i revokimit të lejes është bërë me shpresë dhe/ose me urdhër nga ministri i MIE, kopje të dokumenteve të tilla të gjetura dhe në dosjet e planeve të sjella për miratim nga subjektet që i përkasin periudhës para vitit 2018.

Tabela nr. 7 Lejet për të cilat është hequr revokimi nga Ministri i MIE

Nr.	Emërtimi	Data e revokimit	Data e kërkesës	Data e anulimit të revokimit	
1	Leja nr.12..., datë 02.07.2008	21.05.2014	Nuk ka	Anulim revokimi	17.12.2014
2	Leja nr.14..., datë 24.08.2009	21.05.2014	24.09.2014	Anulim revokimi	31.12.2014
3	Leja nr.71..., datë 20.08.2003	04.08.2014	Nuk ka	Urdhër nr.221	23.09.2015
4	Leja nr.13..., datë 23.07.2009	23.11.2011	Nuk ka	Urdhër nr.122	04.04.2016
5	Leja nr.15..., datë 09.11.2010	22.09.2015	Nuk ka	Urdhër nr.238	22.07.2016
6	Leja nr.10..., datë 03.08.2007	22.09.2015	Nuk ka	Riaktivizim leje	28.12.2016
7	Leja nr.11..., datë 08.01.2008	22.09.2015	25.10.2016	Anulim leje	31.07.2017
8	Leja nr.10..., datë 13.06.2007	24.07.2017	28.08.2018	Urdhër nr.796	08.11.2018
9	Leja nr.16..., datë 03.04.2013	19.12.2018	14.11.2018	Njoftim anulimi	15.01.2019
10	Leja nr.16..., datë 07.08.2013	30.04.2018	15.07.2019	Anulim vendimi	16.12.2019
11	Leja nr.64..., datë 07.09.2001	07.07.2020	Nuk ka	Anulim vendimi	30.03.2021
12	Leja nr.15..., datë 06.01.2012	19.12.2018	24.03.2021	Shfuqizim akti	08.04.2021
13	Leja nr.15..., datë 29.10.2010	07.07.2020	Nuk ka	Anulim procedure	22.06.2021

Burimi: Të dhëna të AKBN dhe MIE të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në referencë dhe në zbatim të nenit 48- Procedura e revokimit të lejes, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pika 5 përcakton se: “Revokimi në të gjitha rastet vendoset nga ministri, në bazë të raportit të strukturës përgjegjëse”. Pika 6 e nenit të mësipërm përcakton se: “Kundër vendimit të ministrit bëhet ankim në gjykatën administrative, sipas legjislacionit në fuqi”, duke mos lënë hapësirë veprimeve të mëtejshme të anulimit/shfuqizimit/riaktivizimit të lejes së revokuar.

Bazuar në sa më sipër, anulimi/shfuqizimi/riaktivizimi i lejes së revokuar nga ana e Ministrit të MIE është në kundërshtim me pikën 6 të nenit 48 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i

ndryshuar, dhe në tejkalim të kompetencave ligjore të fushës minerare, marrje e kompetencave të gjykatës administrative, krahas pasojave që sjell në problemet e monitorimit, miratimit të planeve vjetore dhe informacioneve periodike gjatë periudhës së revokimit, e cila rezulton të jetë nga 6 muaj në 5 vjet.

Veç sa më sipër, pas revokimit të lejes, në zbatim të nenit 49 të ligjit minerar, zotëruesi i lejes detyrohet të zbatojë planin e rehabilitimit dhe ministri ndjek pa kufizim çdo të drejtë ligjore dhe ndërmerr çdo veprim ligjor, për të vjelë dëmshpërblimin përkatës për dëmet shkaktuar shtetit nga shkeljet e zotëruesit të lejes minerare, çka do të thotë se pagesa e detyrimeve në një afat të mëvonshëm pas përcaktimeve ligjore, nuk përbën shkak për heqjen e revokimit.

Duhet theksuar se, në referencë të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015, "Kompetenca administrative" është tërësia e kompetencave lëndore dhe kompetencave territoriale të organit të administratës publike, siç është parashikuar në ligj dhe aktet nënligjore (pika 5 e nenit 3 të ligjit të mësipërm), dhe Ministri i MIE ka shkelur parimin e ligjshmërisë, pasi nuk e ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, brenda kufijve të kompetencave të tij dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. Ministri i MIE, për rastet e anulimit/ shfuqizimit/ riaktivizimit të lejes së revokuar nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative, për të verifikuar në fillimin e procedurës administrative nëse organi publik ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.

Ministri i MIE me vendim-marrje të tilla, duke i konsideruar si ankime administrative kërkesat e subjekteve për heqjen e revokimit, ka tejkaluar kompetencën e organeve publike të përcaktuara me ligjin minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, edhe pse zëvendësimi i kompetencave nuk është i parashikuar në këtë ligj.

Trajtimi i anulimit/ shfuqizimit/ riaktivizimit të lejes së revokuar si ankim kundër aktit-administrativ, është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 136 -Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi publik kompetent, pika 1 e ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili përcakton se: "*Ankimi ndaj një akti administrativ shqyrtohet, në radhë të parë, nga vetë organi publik kompetent, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj*". Bazuar në sa më sipër, procedura administrative e ndjekur nga Ministria për anulimin e revokimeve të lejeve është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 48- Procedura e revokimit të lejes, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, pikat 5 dhe 6, të cilat përcaktojnë: "*Revokimi në të gjitha rastet vendoset nga ministri, në bazë të raportit të strukturës përgjegjëse. Kundër vendimit të ministrit bëhet ankim në gjykatën administrative, sipas legjislacionit në fuqi.*"

d. Raste të mos zbatimit të procedurës për revokimin e lejeve minerare

✓ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë qëllim, sipas shkresës nr.10039/7, datë 15.01.2019 "Njoftim mbi anulimin e vendimit të revokimit për lejen minerare nr.16..., datë 03.04.2013 të shoqërisë "S." SHPK", cilësohet se: Shoqëria "S." SHPK me shkresën nr.564 prot., datë 13.11.2018 (prot. MIE nr. 6433/2, datë 14.11.2018) i është drejtuar MIE, AKBN dhe AKSEM duke argumentuar se: "*Shoqëria "S." SHPK ka paguar rregullisht nga viti 2013 e deri më 2015 vlerën e garancisë së mjedisit së rehabilitimit mjedisor për lejen e shfrytëzimit në fjalë, e cila në vlerë vjetore 1,170,000 lekë/vit (3,510,000 lekë në tre vite) ndonëse për këtë leje nuk ka ushtruar aktivitet minerar. Sipërfaqja e shfrytëzuar në këtë zonë është shumë herë më e vogël (0.6 Ha) në krahasim me sipërfaqen totale (162.7 ha) të kërkuar për shfrytëzim. Si pasojë vlera e paguar nga ana jonë për garancinë e rehabilitimit mjedisor në vite rezulton të jetë shumë më e madhe*".

Bazuar në deklaratimet e vetë subjektit që "*...për këtë leje nuk ka ushtruar aktivitet minerar*", në referencë të nenit 47, pika 1, germa "b/ii" të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, zotëruesi i lejes minerare ka pasur mbi 180 ditë kalendarike që nuk ka ushtruar veprimtarinë minerare në afatin e përcaktuar nga hyrja në fuqi e lejes, dhe vetëm ky shkak do të shërbente për revokimin e lejes dhe jo për heqjen e revokimit.

✓ Nga shqyrtimi i Raporteve të monitorimit të AKBN 2018-2022, rezulton se për katër leje të subjektit B... SHA: lejet me nr.15..., datë 22.02.2012; nr. 16..., datë 07.12.2014; nr. 16..., datë 07.02.2014 dhe nr.16..., datë 07.02.2014, megjithëse nuk ka fare prodhim në periudhën 2014-2021, pra nuk është zhvilluar aktivitetet minerar pas marrjes së lejes, AKBN vetëm në vitin 2020, pra pas 6 vitesh i ka propozuar MIE revokimin e tyre, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 47, pika 1, germa “c”, i cili përcakton afatin 180 ditë mos fillim të veprimtarisë minerare, shkak për revokimin e lejes.

Veç kësaj, edhe pas propozimeve të AKBN për revokim leje: - leja minerare nr. 64..., datë 27.08.2001, bazuar në nenin 47, pika 1, germa “c”, me shkresë nr. 4493, datë 09.12.2020;

- leja minerare nr. 15..., date 22.02.2012, bazuar në nenin 47, pika 1, germa “c”, me shkresë nr. 4491, datë 09.12.2020;

- leja minerare nr. 16..., date 07.02.202014, bazuar në nenin 47, pika 1, germa “ii” dhe “f”, me shkresë nr. 4490, datë 09.12.2020;

- leja minerare nr. 16..., date 07.02.2014, bazuar në nenin 47, pika 1, germa “ii” dhe “f”, me shkresë nr. 4492, datë 09.12.2020;

- leja minerare e shfrytëzimit nr. 16..., datë 07.02.2014, me shkresë nr. 4482 datë 14.12.2021, MIE, sipas raportit të monitorimit të AKBN të 6 mujorit të parë të vitit 2022, (lejet e mësipërme janë aktive në regjistrin e lejeve 2018-2022) nuk ka asnjë komunikim lidhur me statusin e këtyre propozimeve, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 47- Procedura e revokimit të lejes, pikat 1, 2, 3 dhe 5 të këtij neni, si dhe duke ndikuar negativisht dhe veprimtarinë monitoruese dhe inspektuese e strukturës përgjegjëse AKBN.

✓ Zotëruesi i lejes minerare nr.11..., datë 03.03.2008, “H.” SHPK, ka marrë njoftim nga MIE për fillimin e procedurave të revokimit të lejes më datë 16.02.2022, në bazë të propozimit të AKBN të datës 12.01.2022, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me miratimin e planit vjetor 2021-2022, si dhe ka ndërprerë aktivitetin minerar për më shumë se 1 vit, pa njoftuar strukturat përgjegjëse dhe vazhdon të jetë aktive në regjistrin e lejeve.

✓ Për lejen nr.16..., datë 30.07.2013, “I. M. I” SHA, rezultojnë dy njoftime për fillimin e procedurave të revokimit: e argumentuar për revokim për mos fillim pune në objekt të verifikuar më datë 27.02.2014 (shkelje e afatit 180 ditë); njoftim me datë 15.03.2017, pasi nuk janë përmbushur detyrimet e përcaktuara në marrëveshjen e koncesionit për realizimin e investimeve dhe prodhimit për objektin “M. K. K”, ndërkohë që nga zotëruesi i lejes minerare nuk ka paraqitur sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit për asnjërën nga njoftimet, referuar përcaktimeve në paragrafin e dytë të pikës 2 të nenit 48. Subjekti në regjistrin e lejeve të periudhës 2018 - 2022 figuron aktiv, dhe sipas të dhënave të sistemit RevZone ka zhvilluar aktivitetet me plane vjetore të miratuara. Mungesa e finalizimit të procedurës së propozuar të revokimit nga ana e Ministrisë të MIE është në kundërshtim me pikën 3, të nenit 48 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, i cili përcakton: “*Ministri vendos revokimin e lejes minerare 30 ditë kalendarike pas kalimit të afateve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni*”.

✓ Lidhur me Lejen nr.16..., datë 06.09.2016, “V. I” SHPK, konstatohet se është njoftuar nga MIE për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare më datë 15.11.2021, në bazë të propozimit të strukturës përgjegjëse AKBN të datës 08.03.2021, pra pas më shumë se 8 muajve, pasi nga ana e zotëruesit të lejes minerare të shfrytëzimit (ZLMSH) nuk është punuar që nga momenti i marrjes së lejes deri në datën e propozimit, pra prej më shumë se 5 vitesh, duke vënë në diskutim veprimtarinë monitoruese të kryer nga kjo e fundit. Kjo pasi, shkak ligjor për propozimin për revokim është mungesa e zhvillimit të aktivitetit në periudhën prej 180 ditë kalendarike nga fillimi i lejes, që do të thotë që në muajin mars të vitit 2017.

✓ Lidhur me lejen nr.17..., datë 12.11.2015 të zotëruesit “G.” SHPK, rezulton se me shkresën nr.1675/1 prot., datë 18.05.2020 nga MIE është njoftuar zotëruesi i lejes për fillimin e procedurave të revokimit, në bazë të propozimit të AKBN nr.1675 prot., datë 13.02.2020 pasi nuk ka paguar garancinë financiare, duke e njoftuar për marrjen e vendimit 30 ditë pas këtij njoftimi.

Me shkresën nr.1675/2 prot, datë 07.07.2020 nga MIE njoftohet shoqëria, AKBN dhe AKSEM se Ministri i MIE ka ndërprerë procedurat e revokimit të lejes, pasi rezulton se shoqëria “G.” SHPK ka kryer pagesat për katër vitet në shumën 208,368 lekë.

Me shkresën e MIE nr.5352/1 prot., datë 09.09.2020 njoftohet zotëruesi i lejes minerare nr.17..., datë 12.11.2015, shoqëria “G.” SHPK për fillimin e procedurës së revokimit, në bazë të propozimit të AKBN nr. 5352, datë 15.07.2020, pasi nuk është filluar aktiviteti minerar edhe pse ka 55 muaj që është dhënë kjo leje me datë efektive 12.11.2015.

MIE, me shkresën nr.5352/2 prot., datë 27.10.2020 ka njoftuar shoqërinë, QKB, AKBN dhe AKSEM se Ministri i MIE ka revokuar këtë leje.

Në regjistrin e lejeve, leja me nr.17..., datë 12.11.2015 figuron aktive vetëm në vitin 2018, si dhe në sistemin RevZone subjekti nuk ka hedhur të dhëna lidhur me aktivitetin.

✓ Për lejen nr.92..., datë 09.03.2017, zotëruar nga subjekti “L. T.” SHPK, propozimi nga ana e AKBN është bërë me shkresën nr. 8138 prot., datë 09.10.2018, për arsye se nuk është zhvilluar aktiviteti minerar në zonën për të cilën është dhënë kjo leje. Në këtë mënyrë AKBN ka vepruar me mbi 1 vit vonësë, pasi në referencë të nenit 47, pika 1/b, germa ii, leja revokohet nëse zotëruesi i lejes minerare nuk fillon veprimtarinë minerare në afatin 180 ditë kalendarike nga hyrja në fuqi e lejes.

✓ Për revokimin e lejes minerare nr.70..., datë 08.07.2003 të subjektit “K.” SHPK, propozimi nga ana e AKBN me shkresën nr. 8141 prot., datë 09.10.2018 për arsye se nuk është paguar garancia financiare e rehabilitimit të mjedisit për vitet 2011 – 2013, sipas përcaktimeve të nenit 31 të ligjit të mësipërm, është bërë me të paktën 5 vite me vonësë.

✓ Për revokimin e lejes minerare nr.66..., datë 19.03.2012 të “M.” SHPK dhe nr.89..., datë 08.08.2005 të subjektit “B.” SHPK propozimi nga ana e AKBN me shkresën nr. 8130 prot., dhe nr.8139 prot., datë 09.10.2018 për arsye se janë përfunduar rezervat e mineralit. Në këtë rast AKBN nuk ka vepruar në përputhje të plotë me kërkesat e germës “b” të pikës 2 të nenit 47 të ligjit të mësipërm, pasi kur janë mbaruar rezervat gjeologjike duhet që zotëruesi të kërkojë revokimin e lejes dhe jo struktura përgjegjëse, në këtë rast AKBN.

e. Për trajtimin e procedurave të revokimit të lejeve në zona të cilësuar “Peizazh i mbrojtur” dhe për sipërfaqen e zgjeruar park kombëtar “Mali Tomorrit”.

e.1- Për peizazhin e mbrojtur Krastë-Verjon

Pas VKM nr. 468 date 26.07.2018 “Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë-Verjon “Peizazh i mbrojtur”, MIE dhe MTM kanë hartuar Urdhrit e Përbashkët nr. 322 datë 13.09.2018 për “Ngritjen e grupit të punës për kontrollin mbi zbatimin e kërkesave të Lejeve të Mjedisit dhe të Lejeve Minerare nga subjektet e shfrytëzimit minerar (guroret), që preken nga zbatimi i VKM nr. 468 date 26.07.2018 “Për shpalljen e Peisazhit Natyror të Mbrojtur Krastë – Verjon”.

Gjithashtu, në zbatim dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 31, datë 30.01.2019, “Për ngritjen e Task-Forcës për evidentimin e zbatimit të kërkesave dhe standardeve ligjore nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e shfrytëzimit minerar brenda territorit të ekosistemit Krastë-Verjon “Peisazh i Mbrojtur”, është vijuar me verifikimin në vend për evidentimin dhe gjendjen e lejeve minerare që ushtrojnë aktivitetet në këtë zonë.

Nga ana e AKBN, megjithëse ka qenë pjesë e task-forcës për evidentimin e zbatimit të kërkesave dhe standardeve ligjore nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e shfrytëzimit minerar brenda territorit të zonës së shpallur peizazh i mbrojtur natyror Krastë - Verjon, Krujë, nisur nga VKM nr.468, datë 26.07.2018 “Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë - Verjon, peizazh i mbrojtur”, Urdhrit të Kryeministrit nr.31, datë 30.01.2019 për ngritjen e kësaj task-force, me shkresa të veçanta të Drejtorit Ekzekutiv të AKBNA. B., të datës 01.03.2019 është propozuar revokimi i lejeve minerare si më poshtë.

Tabela nr. 8 Lejet për të cilat është propozuar nga AKBN dhe janë revokuar nga MIE

Nr.	Emërtimi	Data e akt-konstatimit	Data e propozimit	Data e njoftimit	Data e revokimit
-----	----------	------------------------	-------------------	------------------	------------------

1	Leje nr.13..., datë 17.03.2009	28.02.2019	01.03.2019	04.03.2019	29.05.2019
2	Leje nr.13..., datë 11.05.2009	28.02.2019	01.03.2019	04.03.2019	29.05.2019
3	Leje nr.13..., datë 11.05.2009	28.02.2019	01.03.2019	04.03.2019	29.05.2019
4	Leje nr.59..., datë 01.01.2011	28.02.2019	01.03.2019	04.03.2019	29.05.2019
5	Leje nr.16..., datë 31.01.2013	28.02.2019	01.03.2019	04.03.2019	29.05.2019
6	Leje nr.87..., datë 27.05.2015	28.02.2019	01.03.2019	04.03.2019	29.05.2019
7	Leje nr.69..., datë 18.09.2015	28.02.2019	01.03.2019	04.03.2019	29.05.2019
8	Leje nr.17..., datë 03.11.2015	28.02.2019	01.03.2019	04.03.2019	29.05.2019
9	Leje nr.90..., datë 05.11.2015	28.02.2019	01.03.2019	04.03.2019	29.05.2019
10	Leje nr.89..., datë 12.02.2016	28.02.2019	01.03.2019	04.03.2019	29.05.2019
11	Leje nr.93..., datë 12.02.2016	28.02.2019	01.03.2019	04.03.2019	29.05.2019
12	Leje nr.97..., datë 15.07.2016	28.02.2019	01.03.2019	04.03.2019	29.05.2019

Burimi: Të dhëna të AKBN dhe MIE të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Referuar raportit të AKBN “Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare nga subjektet private” 2018, të përgatitur nga Drejtoria Minerare, Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve të Ndërtimit, Qymyrit dhe Bitumit, janë cilësuar 21 leje minerare të shfrytëzimit që bien në zonë të mbrojtur (faqe 17), ndërsa në Raportin e 6-mujorit të parë të vitit 2019 janë cilësuar se, në zonën e shpallur Peizazh i Mbrojtur “Krastë – Verjon” ushtrojnë aktivitetet minerar aktualisht 12 subjekte të licencuara (faqe 224-253). Kjo gjë tregon se, struktura përgjegjëse AKBN ka mangësi të njohjes së terrenit dhe për pasojë dhe të monitorimeve me mangësi, duke lënë hapësira për veprime subjektive ndaj zotëruesve të lejeve të kësaj zone.

AKBN në arsyetim të shkeljes së kryer nga zotëruesit e lejeve minerare të kësaj zone, ka përcaktuar nenin 47, pika 1, shkronja “dh”, që ka të bëjë me “vazhdimin e përdorimit të praktikave të dëmshme të shfrytëzimit të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, ose vazhdimin e drejtimit të operacioneve të punës në kundërshtim me projektin e miratuar nga ana e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit minerar”, tregon se një situatë e tillë ka ardhur në vijimësi dhe struktura përgjegjëse AKBN nuk ka vepruar në kohë nëpërmjet monitorimit/inspektimeve, por pas 3-10 viteve aktivitet shfrytëzimi, duke e bërë formale procedurën monitoruese dhe inspektuese të saj.

Megjithëse lejet e mësipërme janë dhënë në periudhën 2009 - 2016, në Raportin e monitorimit të 6-mujorit të parë të vitit 2019 “Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare nga subjektet private” të përgatitur nga AKBN, është cilësuar si shkak revokimi për secilin prej tyre se: “Subjekti nuk ka zbatuar projektin e hapjes së objektit minerar për radhën e shfrytëzimit nga lart-poshtë sipas projektit të miratuar në Këshillin Teknik pranë AKBN-së dhe si rrjedhojë nuk ka respektuar ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 47, Pika 1, shkronja “dh”, gjë që tregon se AKBN ka përdorur si shkak revokimi mos zbatimin e projektit të hapjes së objektit minerar, pasi ka kaluar një periudhë 3-10 viteve aktivitet shfrytëzimi, duke e bërë formale procedurën monitoruese dhe inspektuese të saj.

e.2 Për sipërfaqen e zgjeruar park kombëtar “Mali Tomorrit”.

Me VKM nr.467, datë 26.07.2018 “Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar “Mali Tomorrit”, sipërfaqja është zgjeruar me 1383.758 ha, shoqëruar me hartën e zgjerimit dhe koordinatat e 409 pikave x dhe y.

Me shkresën nr. 6161/1 prot., datë 21.10.2019 AKBN ka dërguar informacion MIE “... mbi materialin e përgatitur nga grupi i punës mbi gjendjen e lejeve minerare në zonën e Novaj (Parku Kombëtar Mali i Tomorrit)” në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 378, datë 07.10.2019, përcaktuar sipas VKM nr. 611, datë 11.09.2019 “Për zgjerimin e sipërfaqes së Parkut kombëtar Mali i Tomorrit” ku ndër të tjera ka informuar dhe propozuar revokimin e lejeve minerare të shfrytëzimit si më poshtë:

1. Për Subjektin “K.” NIPT: K1....., PN-04..... me aktivitet “Shfrytëzim i gurit gëlqeror pllakor” me vendodhje, Objekti N... Fshati Fush Peshtan, Berat me leje minerare nr. 70... gjatë kontrollit në objekt është evidentuar se:

1. Gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar subjekti nuk ka respektuar projektin fillestar në lidhje me radhën e shfrytëzimit (parametrat teknike të shkallëve).

5. Në zonën minerare nuk janë kryer investime për rehabilitimin e mjedisit.

2. Për "A." NIPT: K3, PN-57..... me aktivitet "Shfrytëzim i gurit gëlqeror pllakor" me vendodhje, Objekti N... Lagja Uznovë, Berat me leje minerare nr. 76... gjatë kontrollit në objekt është evidentuar se:

1. Gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar subjekti nuk ka respektuar projektin fillestar në lidhje me radhën e shfrytëzimit (parametrat teknike të shkallëve).

5. Në zonën minerare nuk janë kryer investime për rehabilitimin e mjedisit.

3. Për Subjektin "G." me NIPT: K4....., me PN-27..... me aktivitet "Shfrytëzim i gurit gëlqeror pllakor" me vendodhje, Objekti N...Fshati Mëlovë, Otlak, Berat, me leje minerare nr. 80... gjatë kontrollit në objekt është evidentuar se :

1. Gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar subjekti nuk ka respektuar projektin fillestar në lidhje me radhën e shfrytëzimit (parametrat teknike të shkallëve).

5. Në zonën minerare nuk janë kryer investime për rehabilitimin e mjedisit.

4. Për Subjektin "Q." me NIPT: K6....., PN-59..... me aktivitet "Shfrytëzim i gurit gëlqeror pllakor" me vendodhje, Objekti N...Bogovë, Skrapar, Berat me leje minerare nr. 10... gjatë kontrollit në objekt është evidentuar se :

1. Gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar subjekti nuk ka kryer shfrytëzimin sipas projektit teknik të miratuar.

5. Në zonën minerare nuk janë kryer investime për rehabilitimin e mjedisit.

5. Për Subjektin "P. N" NIPT: K53, PN-34..... me aktivitet "Shfrytëzim i gurit gëlqeror pllakor" me vendodhje, Objekti N...Fshati Dushnik, Otlak, Berat me leje minerare nr. 10... gjatë kontrollit në objekt është evidentuar se :

1. Gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar subjekti nuk ka respektuar projektin teknik për rradhën e shfrytëzimit.

5. Në zonën minerare nuk janë kryer investime për rehabilitimin e mjedisit.

6. Për Subjektin "L. B." me NIPT: K92, PN-04..... me aktivitet "Shfrytëzim i gurit gëlqeror pllakor" me vendodhje, Objekti N. Fshati Vodicë, Vërtop, Berat me leje minerare nr. 15... gjatë kontrollit në objekt është evidentuar se :

1. Gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar subjekti nuk ka respektuar projektin teknik të miratuar (parametrat teknike).

5. Në zonën minerare nuk janë kryer investime për rehabilitimin e mjedisit.

7. Për Subjektin "E." me NIPT: K63, PN-04..... me aktivitet "Shfrytëzim i gurit gëlqeror pllakor" me vendodhje, Objekti N. Uznovë, Berat me leje minerare nr. 18... gjatë kontrollit në objekt është evidentuar se :

1. Gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar subjekti nuk ka respektuar projektin teknik të miratuar në lidhje me radhën e shfrytëzimit të mineralit

5. Në zonën minerare nuk janë kryer investime për rehabilitimin e mjedisit.

8. Për Subjektin "Xh." NIPT: K82, PN-92..... me aktivitet "Shfrytëzim i gurit gëlqeror pllakor" me vendodhje, Objekti N...Uznovë, Berat me leje minerare nr. 13... gjatë kontrollit në objekt është evidentuar se :

1. Në zonën minerare nuk janë kryer investime për rehabilitimin e mjedisit.

9. Për Subjektin "I. " NIPT: K88....., PN-34..... me aktivitet "Shfrytëzim i gurit gëlqeror pllakor" me vendodhje, Objekti N., Fshati Dushnik, Otlak Berat, me leje minerare nr. 14... gjatë kontrollit në objekt është evidentuar se:

5. Në zonën minerare nuk janë kryer investime për rehabilitimin e mjedisit.

- Sa konstatohet në informacionin e AKBN drejtuar MIE ku ndër të tjera ka informuar dhe propozuar revokimin e lejeve minerare të shfrytëzimit me argumentet se 1. Gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar subjektet nuk ka respektuar projektin teknik të miratuar në lidhje me radhën e shfrytëzimit të mineralit dhe 5. Në zonën minerare nuk janë kryer investime për rehabilitimin e mjedisit, por në asnjë rast nuk evidentohet fakti që Ministri i Turizmit dhe Mjedisit B. K., ka urdhëruar pezullimin dhe revokimin e lejeve mjedisore të disa operatorëve të mësipërm që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Qarkun e Beratit, dërguar me shkresën nr. 1658,

datë 23.05.2018 “Vënie në dijeni” (protokolluar me nr. 5137 prot., datë 25.05.2018) ku Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm të Mjedisit ka vënë në dijeni Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore se me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit B. K., ka urdhëruar pezullimin dhe revokimin e lejeve mjedisore të disa operatorëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Qarkun e Beratit.

- Gjithashtu, konstatohet se, në raportet e monitorimit të vitit 2018 – 2019 për subjektet e mësipërme gjatë kontrollit në objektet, (ndryshe nga shkresa nr. 6161/1, datë 21.10.2019), AKBN nuk ka evidentuar se “Gjatë ushtrimit të aktivitetit minerar subjekti nuk ka respektuar projektin teknik të miratuar (parametrat teknike) dhe se në zonën minerare nuk janë kryer investime për rehabilitimin e mjedisit.

- Nga auditimi i procesit të monitorimit të aktivitetit të Subjekteve me lejet minerare të revokuara rezulton se për këto subjekte për periudhën 2020, 2021, 2022 nuk ka raporte monitorimi për investimet e kryera për rehabilitimin e mjedisit, në një kohë kur një nga arsyet e revokimit të lejeve minerare është konstatimi se në zonat minerare nuk janë kryer investime për rehabilitimin e mjedisit.

Sa më lart, në kundërshtim me Ligji nr. 10304, date 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” nenin 37, “Detyrimi i rehabilitimit të zonës së lejes minerare”, pika 5. “Në rastin kur zotëruesi i lejes minerare, që përfshin shfrytëzimin, braktis zonën e lejes minerare apo nuk përfundon zbatimin e plotë të planit të rehabilitimit, rehabilitimi kryhet nga subjekte të specializuara, të përzgjedhura nga struktura përgjegjëse, sipas procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shpenzimet përballohen me fondet e garancisë financiare”.

Veprimet e mësipërme bien ndesh me kërkesat e neneve 6, 7, 8 dhe 9 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010, të ndryshuar, pasi vendimmarrja për zhvillimin e veprimtarive minerare në vend mbështetet në kuadrin strategjik të zhvillimit minerar që përbëhet nga:

- a) strategjia minerare;
- b) programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare;
- c) plani vjetor minerar.

Strategjia minerare është dokumenti themelor, që përcakton politikat, përparësitë e zhvillimit, programet e veprimit dhe të administrimit të burimeve minerare për një periudhë 15-vjeçare, në përputhje me objektivat e strategjisë kombëtare të zhvillimit, si dhe programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare është dokumenti afatmesëm i planifikimit minerar, që hartohet në bazë të strategjisë minerare dhe është i vlefshëm për një periudhë 3-vjeçare.

Gjithashtu, kriteret e përcaktimit të zonave minerare kanë karakter teknik, mjedisor, ekonomik e financiar dhe për zonat konkurruese mbështeten në kapacitetin e njohur të rezervave minerare, interesin për llojin e mineralit, leverdinë ekonomike të prodhimit të produkteve të gatshme, vlerën e investimit të kërkuar, objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe planifikimin e territorit.

Duhet theksuar se, zonat përkatëse të lejeve të mësipërme, janë shpallur për konkurrim, janë miratuar subjektet fituese dhe miratuar lejet në zbatim të VKM nr.347, datë 29.04.2011, “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare” i cili përcakton drejtimit e zhvillimit të sektorit minerar për periudhën 3 (tre) vjeçare, të përcaktuara me koordinata në aneksin 1 bashkëlidhur këtij vendimi: zona, prefektura, minerali, sipërfaqja, pika x dhe y; ndryshimet për vitet e tjera deri në vitin 2016; Urdhrit përkatës të Ministrit të MIE “Për miratimin e planit vjetor minerar”, si dhe lejen e mjedisit nga Ministria e Mjedisit. Nga sa më sipër, VKM nr.467, datë 26.07.2018 “Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar “Mali Tomorrit” dhe VKM nr.468, datë 26.07.2018 “Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë - Verjon, peizazh i mbrojtur” shpërfill dhe nuk merr në konsideratë VKM nr.479, datë 26.09.2011 “Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë” 2010-2025; VKM nr.347, datë 29.04.2011, “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare” të ndryshuar; Urdhrat e Ministrit të MIE, si dhe lejet mjedisore të Ministrit të Mjedisit.

Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për problematikën e pezullimeve të përkohshme të lejeve minerare ka rezultuar gjetja dhe situatat si më poshtë:

<p>Titulli gjetjes:</p>	<p>i Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për problematikën e pezullimeve të përkohshme me kërkesë të subjektit, si dhe nga komunikimet me zyrtarë të subjekteve nën auditim konstatohet se, mungon një akt administrativ nënligjor për të përcaktuar procedurën dhe afatet e pezullimit të përkohshëm, për rastin e kërkesës së vetë subjektit dhe të ndëshkimit nga strukturat përgjegjëse, në funksion të disiplinimit dhe zhvillimit të sektorit minerar gjë që ka sjellë për pasojë që pezullimet e përkohshme për subjekte të veçanta të zgjasin edhe 5-6 vite, duke bërë të pavlefshme zhvillimin e procedurës së konkurrimit të zonës minerare.</p>
<p>Situata:</p>	<p>- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për çështjen e pezullimeve të përkohshme me kërkesë të subjektit, si dhe nga komunikimet me zyrtarë të subjekteve nën auditim konstatohet se, mungon një akt administrativ nënligjor për të përcaktuar procedurën dhe afatet e pezullimit të përkohshëm, për rastin e kërkesës së vetë subjektit dhe të ndëshkimit nga strukturat përgjegjëse, në funksion të disiplinimit dhe zhvillimit të sektorit minerar. Mungesa e një akti të tillë ka sjellë për pasojë që pezullimet e përkohshme për subjekte të veçanta të zgjasin edhe 5-6 vite, duke bërë të pavlefshme zhvillimin e procedurës së konkurrimit të zonës minerare.</p> <p>- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se, me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 me ligjin nr. 65/2021 datë 20.5.2021, (botuar në Fletoren Zyrtare nr.107, datë 15.07.2021), i cili i ka hequr MIE kompetencën e miratimit të pezullimeve të përkohshme, duke filluar nga data 21.07.2021 deri në fund të vitit 2022, Ministri i MIE ka miratuar 29 të pezullime të përkohshme (3 të vitit 2021 dhe 26 të vitit 2022), në kundërshtim me nenit 18, pika 1 dhe 2 dhe të nenit 25 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pasi MIE ka marrë atributet e strukturës përgjegjëse, në këtë rast AKBN.</p> <p>- Nga të dhënat për periudhën 2018-2022 konstatohet se, nga 185 raport - propozimet e AKBN për fillimin e procedurave të revokimit, nga ana e MIE i janë dërguar subjekteve njoftimet për fillimin e procedurës, ku 40 propozime i përkasin periudhës deri në vitin 2017, si dhe konstatohet se veprimet e MIE janë ndërmarrë mesatarisht për një periudhë prej 4 muaj pas marrjes së propozimit nga struktura përgjegjëse. Ndonëse kjo periudhë ka ardhur duke u zvogëluar në mesatarisht rreth 25 ditë në vitin 2022, përsëri me vonesa në kundërshtim me përcaktimet e nenit 48, pika 1, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili përcakton: “Procedura e revokimit të lejes fillon, si rregull, me raportin e propozimit të strukturës përgjegjëse ose me kërkesë të zotëruesit të saj, kur ky i fundit ka plotësuar të gjitha detyrimet e saj.”</p> <p>- Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, janë konstatuar 11 raste kur MIE nuk ka vijuar më tej procedurën e revokimit, pas propozimeve për revokim të strukturës përgjegjëse AKBN, kryesisht për vitin 2017 dhe 2018, duke detyruar këtë të fundit të ri propozojë revokimin për herë të dytë apo dhe të tretë.</p> <p>- Sipas të dhënave të MIE lidhur me propozimet e AKBN për fillimin e procedurave të revokimit, konstatohen gjithsej 19 leje minerare për të cilat megjithëse është dërguar propozimi dhe është bërë njoftimi i subjektit për</p>

fillimin e procedurave të revokimit, nga ana e ministrit të MIE, nuk është dalë me vendim përkatës.

- Konstatohet se 29 % vendimeve gjithsej të marra nga MIE në vitin 2022, janë marrë jashtë afateve të përcaktuar në pikën 3 të nenit 48 të ligjit minerar: *“Ministri vendos revokimin e lejes minerare 30 ditë kalendarike pas kalimit të afateve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni. Në rast se brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e dytë, të pikës 2, zotëruesi i lejes minerare paraqet argumente dhe prova të mjaftueshme që provojnë mungesën e shkaqeve, për të cilat është iniciuar revokimi, ministri vendos pushimin e procedurës së revokimit”* Gjithashtu, tejkalimi i afateve ligjore të vendim-marrjes së MIE, konstatohet dhe në 15 raste të pushimit të procedurave të revokimit nga 23 gjithsej.
- Konstatohet se MIE ka ndërprerë procedurën e revokimit të lejeve, për rastet kur propozimi nga AKBN ka qenë për mos-pagesë në afat të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit nga ana e zotëruesve të lejeve minerare, dhe këto pagesa janë kryer pas njoftimit për fillimin e procedurës së revokimit. Ndërprerja e procedurës së revokimit nga ana e MIE në rastin e pagesave të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit nga ana e zotëruesve të lejeve minerare, në një kohë që, MIE ka cilësuar të ligjshëm propozimin e AKBN për revokimin e lejes, nga ana e tjetër konsideron të ligjshëm edhe pagesat e këtyre garancive nga ana e subjekteve pas njoftimit për fillimin e procedurave. Nisja e procedurës së revokimit të lejes në rastin mos pagesës së garancisë së rehabilitimit të mjedisit ka të bëjë me afatin shlyerjes së detyrimit, dhe mandatet e pagesës nuk janë rivendosje në afat dhe mungesë të shkaqeve për të iniciuar revokimin. Në këtë rast, MIE ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 të nenit 48 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, i cili përcakton: *“Në rast se brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e dytë, të pikës 2, zotëruesi i lejes minerare paraqet argumente dhe prova të mjaftueshme që provojnë mungesën e shkaqeve, për të cilat është iniciuar revokimi, ministri vendos pushimin e procedurës së revokimit”*.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AKBN dhe MIE janë konstatuar 13 raste që revokimi i lejes është bërë me shkresë dhe/ose me urdhër nga ministri i MIE, nga të cilat 7 raste u përkasin periudhave para vitit 2018. Anulimi/shfuqizimi/riaktivizimi i lejes së revokuar nga ana e Ministrit të MIE është në kundërshtim me pikën 6 të nenit 48 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar: *“Kundër vendimit të ministrit bëhet ankimi në gjykatën administrative, sipas legjislacionit në fuqi”*, duke mos lënë hapësirë veprimeve të mëtejshme të anulimit/shfuqizimit/riaktivizimit të lejes së revokuar. Pra, në tejkalim të kompetencave ligjore të fushës minerare, pasi ka marrë kompetencat të gjykatës administrative. Gjithashtu, trajtimi nga MIE si ankimi i aktit administrativ, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative, pasi nuk ka verifikuar në fillimin e procedurës administrative nëse organi publik ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi, si dhe të nenit 136 -Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi publik kompetent, pika 1, i cili përcakton se: *“Ankimi ndaj një akti administrativ shqyrtohet, në radhë të parë, nga vetë organi publik kompetent, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj”*.
- Veprimet e mëtejshme të AKBN dhe MIE, në bashkëpunim dhe MTM, pas daljes së VKM nr. 468 date 26.07.2018 *“Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë-Verjon “Peizazh i mbrojtur”* dhe VKM nr.467, datë 26.07.2018 *“Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar “Mali*

	<p><i>Tomorrit</i>”, për revokimin e 29 lejeve mjedisore, shpërfill dhe nuk merr në konsideratë kërkesat e neneve 6, 7, 8 dhe 9 të ligjit mineralar nr. 10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar, pasi vendimmarrja për zhvillimin e veprimtarive minerare në vend mbështetet në kuadrin strategjik të zhvillimit mineralar.</p> <p>Gjithashtu, është shpërfillur dhe nuk është marrë në konsideratë VKM nr.479, datë 26.09.2011 “<i>Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë</i>” 2010-2025; VKM nr.347, datë 29.04.2011, “<i>Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare</i>” i cili përcakton drejtimit e zhvillimit të sektorit mineralar për periudhën 3 (tre) vjeçare, të përcaktuara me koordinata në aneksin 1 bashkëlidhur këtij vendimi: zona, prefektura, minerali, sipërfaqja, pika x dhe y; Urdhrit përkatës të Ministrit të MIE “<i>Për miratimin e planit vjetor mineralar</i>”, si dhe lejet e mjedisit të dhëna nga Ministria e Mjedisit, duke rrezikuar me pasoja financiare për buxhetin e shtetit.</p> <p>- Veprimet dhe mosveprimet e MIE në lidhje me zbatimin e procedurave dhe të afateve të pezullimit dhe revokimit të lejeve minerare, kanë vënë në vështirësi veprimtarinë monitoruese dhe inspektuese të strukturave përgjegjëse, veçanërisht të AKBN gjatë kësaj periudhe, në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e planeve vjetore, ndëshkimin për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit teknik dhe financiar, si dhe kryerjen e raportimit e monitorimeve.</p>
Kriteri:	<p>Ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “<i>Për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë</i>” i ndryshuar, VKM nr. 468 date 26.07.2018 “<i>Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë-Verjon “Peizazh i mbrojtur”</i>” dhe VKM nr.467, datë 26.07.2018 “<i>Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar “Mali Tomorrit”</i>”, VKM nr. 468 date 26.07.2018 “<i>Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë-Verjon “Peizazh i mbrojtur”</i>”, VKM nr.467, datë 26.07.2018 “<i>Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar “Mali Tomorrit”</i>”, VKM nr.479, datë 26.09.2011 “<i>Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë</i>” 2010-2025; VKM nr.347, datë 29.04.2011, “<i>Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare</i>”.</p>
Ndikimi:	<p>Veprimet dhe mosveprimet e MIE në lidhje me zbatimin e procedurave dhe të afateve të pezullimit dhe revokimit të lejeve minerare, kanë vënë në vështirësi veprimtarinë monitoruese dhe inspektuese të strukturave përgjegjëse, veçanërisht të AKBN gjatë kësaj periudhe, në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e planeve vjetore, ndëshkimin për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit teknik dhe financiar, si dhe kryerjen e raportimit e monitorimeve.</p>
Shkaku	<p>Mungon një akt administrativ nënligjor për të përcaktuar procedurën dhe afatet e pezullimit të përkohshëm, për rastin e kërkesës së vetë subjektit dhe të ndëshkimit nga strukturat përgjegjëse, në funksion të disiplinimit dhe zhvillimit të sektorit mineralar me pasojë pezullimet e përkohshme për subjekte të veçanta të zgjasin edhe 5-6 vite.</p>
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>MIE, AKBN të marrë iniciativat për hartimin e akteve administrative nënligjore për të përcaktuar procedurën dhe afatet e pezullimit të përkohshëm, për rastin e kërkesës së vetë subjektit dhe të ndëshkimit nga strukturat përgjegjëse, në funksion të disiplinimit dhe zhvillimit të sektorit mineralar, me qëllim lehtësimin e veprimtarinë monitoruese dhe inspektuese të strukturave përgjegjëse, veçanërisht të AKBN në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e planeve vjetore, ndëshkimin për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit teknik dhe financiar, si dhe kryerjen e raportimit e monitorimeve.</p>

Pretendimi i subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar MIE me shkresën nr. 983/15, datë 04.08.2023 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt Raportin, janë sjellë observacionet të cilat shkurtimisht po i paraqesim në raport konkretisht:

- Pezullimi i përkohshëm i lejeve minerare parashikuar nga neni 18 i ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 është e drejtë e shoqërive që ushtrojnë veprimtarinë minerare të cilat për arsye objektive kanë të pa mundur vijimin e veprimtarisë.....çdo pezullim është marrë vendim në konsultim edhe me AKBN, gjithashtu Ministri është organi administrativ që miraton parametrat e prodhimit dhe shfrytëzimit.

- Referuar nenit 113 të ligjit 44/2015 kodi i procedurave administrative, pika 1 e tij: *Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.* Pra Ministri në kuptim të pikës së mësipërme është plotësisht kompetent në shqyrtimin dhe anulimin/shfuqizimin aktit të revokimit të nxjerrë prej saj dhe gjithashtu nuk përjashtohet edhe rruga gjyqësore. Gjithashtu neni 115 dhe 116 parashikon se anulimi dhe shfuqizimi mund të kryhet edhe kur akti është i ligjshëm. Në përfundim anulimi dhe shfuqizimi i aktit është plotësisht i ligjshëm të kryhet nga Ministri i cili është edhe organi i cili e ka nxjerrë aktin edhe kur ky akt është i ligjshëm dhe se ankimi në rrugë gjyqësore nuk e përjashton vendimmarrjen mbështetur në normat e kodit të procedurave administrative.

- Me VKM 468 datë 26.07.2018 “Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë-Verjon peisazh i mbrojtur” si dhe VKM nr. 467 datë 26.07.2018 “Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar Mali Tomorrit” ishte e nevojshme një monitorim më rigoroz i kushteve të ushtrimit të veprimtarisë minerare si dhe të respektimit të kushteve të reja mjedisore që kishin zonat e lart përmendura, për këtë arsye janë ngritur edhe grupet e punës për monitorimin e këtyre sipërfaqeve. Në përputhje me konkluzionet e grupeve të punës dhe propozimeve përkatëse të ardhura nga struktura përgjegjëse AKBN, në respektim të pikës 1 të nenit 48 të ligjit 10304 datë 15.07.2010, MIE ka filluar procedurat e revokimit dhe ka vendosur revokimin për çdo leje minerare në këto zona. Gjithashtu nga MTM për këto zona paraprakisht janë revokuar edhe lejet mjedisore përkatëse e cila gjithashtu mbështetur në nenin 47 pika h është gjithashtu shkak për revokim.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me observacionet e bëra nga subjekti i audituar MIE për Projekt Raportin e auditimit, dërguar me shkresën nr. 983/15, datë 04.08.2023 edhe pse të përsëritura pa sjellë argumente të reja, grupi i auditimit gjykon se:

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për çështjen e pezullimeve të përkohshme me kërkesë të subjektit, si dhe nga komunikimet me zyrtarë të subjekteve nën auditim konstatohet se, mungon një akt administrativ nënligjor për të përcaktuar procedurën dhe afatet e pezullimit të përkohshëm.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se, Ministri i MIE ka miratuar 29 të pezullime të përkohshme (3 të vitit 2021 dhe 26 të vitit 2022), në kundërshtim me nenin 18, pika 1 dhe 2 dhe të nenit 25 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pasi MIE ka marrë atributet e strukturës përgjegjëse, në këtë rast AKBN.

- Nga auditimi janë konstatuar 13 raste që revokimi i lejes është bërë me shkresë dhe/ose me urdhër nga ministri i MIE, nga të cilat 7 raste u përkasin periudhave para vitit 2018. Anulimi/shfuqizimi/riaktivizimi i lejes së revokuar nga ana e Ministrisë të MIE është në kundërshtim me pikën 6 të nenit 48 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar: “Kundër vendimit të ministrit bëhet ankimi në gjykatën administrative, sipas legjislacionit në fuqi”, duke mos lënë hapësirë veprimeve të mëtejshme të anulimit/shfuqizimit/riaktivizimit të lejes së revokuar. Pra, në tejkallim të kompetencave ligjore të fushës minerare, pasi ka marrë kompetencat të gjykatës administrative. Gjithashtu, trajtimi nga MIE si ankimi i aktit administrativ, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative, pasi nuk ka verifikuar në fillimin e procedurës administrative nëse organi publik ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi, si dhe të nenit 136 -Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi publik kompetent, pika 1, i cili përcakton se: “Ankimi ndaj një akti administrativ shqyrtohet, në radhë të parë, nga vetë organi publik kompetent, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj”.

- Veprimet e mëtejshme të AKBN dhe MIE, në bashkëpunim dhe MTM, pas daljes së VKM nr. 468 date 26.07.2018 “Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë-Verjon “Peisazh i mbrojtur” dhe VKM nr.467, datë 26.07.2018 “Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar “Mali Tomorrit”, për revokimin e 29 lejeve mjedisore, shpërfill dhe nuk merr në konsideratë kërkesat e neneve 6, 7, 8 dhe 9 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar, pasi vendimmarrja për zhvillimin e veprimtarive minerare në vend mbështetet në kuadrin strategjik të zhvillimit minerar.

- Gjithashtu, është shpërfillur dhe nuk është marrë në konsideratë VKM nr.479, datë 26.09.2011 “Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë” 2010-2025; VKM nr.347, datë 29.04.2011, “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare” i cili përcakton drejtimit e zhvillimit të sektorit minerar për periudhën 3 (tre) vjeçare.

- Veprimet dhe mosveprimet e MIE në lidhje me zbatimin e procedurave dhe të afateve të pezullimit dhe revokimit të lejeve minerare, kanë vënë në vëshitësi veprimtarinë monitoruese dhe inspektuese të strukturave përgjegjëse, veçanërisht të AKBN.

Gjykojmë se nga MIE nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart argumentet e sjella, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

1.3 Mbi përputhshmërinë ligjore të veprimtarisë së Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Në referencë të paragrafit të fundit të pikës 5 të nenit 45 dhe të paragrafit të fundit të pikës 5 të nenit 46 të Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ngrihet Njësia e ankimit e cila funksionon sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

Mbi këtë bazë, Ministri i Energjisë dhe Industrisë ka nxjerrë Udhëzimin nr. 10, datë 26.01.2015 të “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara”.

Në referencë dhe në zbatim të pikës 6 të Udhëzimit të mësipërm, Njësia e Vlerësimit të ankimeve përbëhet nga 7 anëtarë, me përbërje si më poshtë:

- Sekretari i Përgjithshëm, Kryetar,
- Dy përfaqësues nga Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit Minerar,
- Një përfaqësues nga Drejtoria Juridike,
- Një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore,
- Një përfaqësues nga Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave,
- Një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.

Gjatë periudhës objekt auditimi 2018-2022, Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative është ngritur sipas Urdhrave të Ministrisë të MIE si më poshtë.

Tabela nr. 9 Përbërja e Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve për periudhën 2018-2022

Pozicioni	Nr.37, datë 18.02.2015	Nr.85, datë 11.10.2017	Nr.342, datë 05.04.2018	Nr.652, datë 26.09.2018	Nr.422, datë 07.11.2019
Kryetar		G. K.			K. N.
Anëtar	M. H.				
Anëtar	F. M.				
Anëtar			F. H.	E. I.	
Anëtar			E. G.		
Anëtar	S. Sh.			Z. H.	
Anëtar	J. B.				

Burimi: Të dhëna nga MIE, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të masave Administrative janë marrë vendimet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr.10 Të dhëna mbi aktivitetin e Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve 2018-2022

Viti	Numri gjithsej i vendimeve të shqyrtuara	Vendimet “Lënie në fuqi “	Vendimet “Shfuqizim“	Vendimet “Mospranim ankimi”	Zbatim rekomandimi KLSH
2018	61	6	2	5	48
2020	3	-	1	2	-
2022	19	13	2	5	-
Gjithsej	83	19	5	12	48

Burimi: Të dhëna nga MIE, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion, konstatohet se nga vendimet e mësipërme janë ankimuar në Gjykatën Administrative me objekt të padisë “Shfuqizim të Vendimit të NJAMA” gjithsej 13 vendime të Njesisë e Vlerësimit të Ankimeve të masave Administrative: 12 në vitin 2018 ose 19.6% dhe 1 në vitin 2022 ose 5.3 %.

Konstatohet se për 1 rast padia është rrëzuar, në 3 raste është pranuar në shkallën e parë dhe çështja ndodhet në apel dhe për 9 rastet e tjera çështja është në gjykim.

Për vitin 2018, Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative ka marrë 61 vendime, ku 48 vendime janë në zbatim të rekomandimeve të Raportit të auditimit të KLSH nr. 1548/73 prot., datë 15.09.2017; 6 vendime lënie në fuqi të masës administrative të vendosur nga AKBN; 2 vendime janë shfuqizim i masës administrative, si dhe 5 vendime janë mospranim i ankesës pasi nga ana formale nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015, pika 11, për mosrespektim të afateve ligjore për ankim, mungesë të aktit administrativ etj.

Në mbledhjen e datës 28.09.2018, Njësia ka marrë 48 vendime për lënie në fuqi të masës administrative në zbatim të rekomandimit të KLSH (Raporti 1548/73 prot., datë 15.09.2017), duke shfuqizuar vendimet për heqjen e gjobave, në arsyetim të rekomandimit të KLSH për mungesë përputhjeje me bazën ligjore.

Konstatohet se, në mbledhjen e datës 27.07.2018 janë shqyrtuar ankesa dhe janë marrë 13 vendime në një mbledhje të vetme jashtë afatit 30 ditor, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 15 të Udhëzimit nr.10, datë 26.01.2015 ku citohet: *“Njësia e vlerësimit të ankimeve të masave administrative vlerëson dhe shqyrton provat e njofton vendimin e marrë brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit.”* Për sa më sipër mban përgjegjësi Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të kësaj periudhe.

Nga shqyrtimi i procedurave të vendim-marrjes së këtij viti, është konstatuar:

1. Vendimi me nr.6458/1 prot., datë 12.07.2018 për shfuqizimin e masës administrative me nr.3110 prot., datë 20.03.201 ndaj subjektit “T.” SHPK.

Shoqëria “T.” SHPK ka marrë njoftim nga AKBN me datë 20.03.2018 për masën administrative gjobë 100,000 lekë “Mos dërgim informacioni për tremujorin e IV të vitit 2017” deri më datë 14.01.2018.

Në datë 16.04.2018 shoqëria ka bërë një ankesë për të kundërshtuar këtë vendim me lëndën *“Kërkesë për anulim mase administrative”*, drejtuar MIE me nr. 6458 prot., datë 19.04.2018, e cila përmban një kopje të formularit të deklarimit të të dhënave të aktiviteti të kryer gjatë tre mujori të IV të vitit 2017 nga subjekti.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit auditues konstatohet se, ankesa nuk ka të bashkëngjitur aktin administrativ, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, shkronja “ç” të Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015, pasi *“ankimi me shkrim dhe dokumentacioni që i bashkëngjitet duhet të përfshijë Aktin administrative që është objekt ankimi”*. Për sa më sipër mban përgjegjësi Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të kësaj periudhe. Në datë 03.05.2018, shoqëria ka depozituar pranë MIE ankesën me lëndë *“Plotësim dokumentacioni”* me nr.7074 prot hyrës, datë 04.05.2018, e cila përmban Aktin administrativ nr.3110/1 prot., datë 20.03.2018. Gjithashtu, në dokumente gjendet dhe dokumenti me nr.491/4 prot., datë 02.05.2018, ku AKBN konfirmon subjektin se, pas verifikimeve rezultoi se subjekti e ka bërë vetë-deklarimin për tre mujorin e IV të vitit 2017 dhe e ka dorëzuar dokumentacionin pranë AKBN. Njësia, pas shqyrtimit të ankimit ka vendosur shfuqizimin e masës administrative me justifikimin se subjekti ka dorëzuar raportin e 3-mujorit të IV pranë AKBN bazuar në kopjen e informacionit.

Nga sa më sipër konstatohet se, shqyrtimi i ankimit të mësipërm nga Njësia e Vlerësimit të Masave Administrative është në kundërshtim me pikën 12 shkronja “a”, pasi ankesa nuk ka plotësuar kushtet formale për shqyrtim, si dhe me pikën 15 të Udhëzimit Nr. 10, datë 26.01.2015 pasi, Njësia e Vlerësimit të Ankimeve nuk ka administruar dhe shqyrtuar provat dhe nuk ka njoftuar vendimin brenda 30 ditëve nda data e paraqitjes së ankimit. Për sa më sipër mban përgjegjësi Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të kësaj periudhe.

2. Vendimi nr. 376 prot., datë 27.07.2018, *“Shfuqizimin e masës administrative nr.5338 prot., datë 10.06.2014”* ndaj subjektit “V.” SHPK.

AKBN ka vendosur dy masa administrative ndaj shoqërisë “V.” SHPK:

- në datën 10.06.2014 me nr.5338 prot., për mos dorëzim të planit vjetor të punës brenda afatit 09.12.2013 dhe ka vendosur masën administrative me gjobë 250,000 lekë;

- në datën 19.02.2015 me nr.2483 prot., për mos dorëzim të planit vjetor të punës brenda afatit 22.04.2014 dhe ka vendosur masën administrative me gjobe 250,000 lekë.

Shoqëria “V. “ SHPK zotëron leje minerare shfrytëzimi me nr. 68..., datë 06.01.2003, për të cilën me datë 22.05.2013 i është miratuar zgjatja e afatit të kësaj leje.

Në datë 04.04.2018 shoqëria “V.” ka dërguar shkresën tek AKBN me lëndën “Kërkesë për heqjen e masës administrative” me anë të së cilës pretendohet se për të njëjtën shkelje janë marrë dy masat administrative të mësipërme.

Me datë 13.04.2018, AKBN ka dërguar kërkesën për ankim pranë MIE me lëndën “Vënie në dispozicion të ankimit administrative të subjektit minerar “V.” ndaj masës administrative me nr. 5338, datë 10.06.2014 të vendosur nga AKBN”, me dokumente bashkëngjitur si: shkresa e dërguar në MIE, masat administrative, pagesa e gjobës date 22.07.2015 etj.

Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative pas shqyrtimit të ankimit të AKBN ka vendosur shfuqizimin e masës administrative me njoftim nr. 5338, datë 10.06.2014. Bazuar në sa më sipër, konstatohet se Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 45, pika 5, në të cilën përcaktohet: “*Subjekti, ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtën e ankimit tek titullari i strukturës përgjegjëse*”, pra nuk mund të ankimojë struktura përgjegjëse që ka vendosur masën administrative. Në zbatim të pikës 11, germa “b” të Udhëzimit nr.10, datë 26.01.2015, Njësia e Vlerësimit të Ankimeve nuk duhet të kishte legjitimuar ankuesin, kjo edhe për faktin se dokumentacioni i ankimit duhet të përmbajë dhe nënshkrimin e ankimesit (pika 4/ë e Udhëzimit). Për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve të kësaj periudhe.

Gjatë vitit 2020 janë marrë 3 vendime nga Njësia e Vlerësimit të ankimeve të masave Administrative pranë MIE: 2 vendime janë mospranim i ankimit dhe 1 vendim shfuqizim i masës administrative, në respektim të procedurës dhe afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë të MIE nr.10, datë 26.01.2015.

Gjatë vitit 2022 janë marrë 19 vendime nga të cilat 2 vendime janë shfuqizim i masës administrative, 6 vendime janë mospranim ankesës dhe 11 vendime janë lënie në fuqi.

Konstatohet se, Njësia e Vlerësimit të Ankimeve ka shqyrtuar dy ankesa jashtë afatit 30-ditor të përcaktuar në Udhëzimin nr.10, pika 15. Konkretisht:

1. Ankimi nr. 120 prot., datë 05.07.2022 me prot. hyrës në MIE 5129/1 prot., datë 05.07.2022. Vendimi i marrë për lënie në fuqi nga Njësia i është dërguar subjektit me datë 06.10.2022 nr.5129/2 prot., pra pothuajse 30 ditë jashtë afatit të përcaktuar;

2. Ankimi me nr. 1607 prot., datë 13.08.2022, me protokoll hyrës në MIE nr.6232/1 datë 30.08.2022. Vendimi i marrë nga komisioni për këtë ankim është dërguar subjektit me datë 06.10.2022 me nr. 6232/2 prot., rreth 8 ditë në shkelje të afatit. Për sa më sipër mban përgjegjësi Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të kësaj periudhe.

Më datë 16.09.2022, Njësia Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative ka marrë Vendimin nr. 431 për shfuqizimin e 7 masave administrative të subjektit ankues “A.” SHPK. Struktura përgjegjëse AKBN ka njoftuar subjektin “A.”SHPK, zotërues të lejes minerare nr.84..., datë 18.03.2005 për marrjen e masave administrative bazuar në rekomandimet e KLSH, si rezultat i shkeljes së dispozitave të nenit 25, shkronja “b” të ligjit nr.10304 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe në bazë të nenit 45, pika 2 dhe pika 1, shkronja “ç” të këtij ligji për marrjen e masave administrative si më poshtë.

Tabela nr.11 Masat administrative të vendosura nga AKBN për subjektin “A.”SHPK

Nr .	Emërtimi	Nr. shkresës	Data	Penaliteti (lekë)
1.	Mosparaqitje Informacioni për tremujorin e II-2020	3503	12.08.2022	100,000
2.	Mosparaqitje Informacioni për tremujorin e IV-2020	3492	12.08.2022	100,000
3.	Mosparaqitje Informacioni vjetor-2020	3518	12.08.2022	150,000

4.	Mosparaqitje Informacioni për tremujorin e I-2021	3444	11.08.2022	100,000
5	Mosparaqitje Informacioni për tremujorin e II-2021	3448	11.08.2022	100,000
6.	Paraqitje me vonesë Informacioni vjetor-2021	3437	11.08.2022	150,000
7.	Mosparaqitje Informacioni për gjashtëmujorin e I-2022	3679	11.08.2022	100,000
Gjithsej				800,000

Burimi: AKBN

Struktura përgjegjëse AKBN, për rastin e informacionit vjetor 2021 nuk ka vepruar sipas kërkesave të nenit 45, pika 7 të ligjit të mësipërm për ta dënuar me dyfishin e gjobës së parashikuar dhe mund të shoqërohej me pezullimin e lejes minerare deri në plotësimin detyrimit.

Subjekti “A.” ka ankuar me shkrim në MIE me shkresat nr.6300 prot., datë 18.08.2022; nr.6300/1 prot., datë 25.08.2022; nr.6286/1 prot., datë 25.08.2022 dhe nr.6474/1 prot., datë 06.09.2022, me pretendimin se kompania ka paraqitur në formë elektronike informacionet në adresën e email-it zyrtar të AKBN (no-replay-revzone@akbn.gov.al) në afatin e caktuar, sipas tyre e vërtetuar kjo me kopjet e email-it dhe tabelën përkatëse të printuar, bashkëngjitur ankesës.

Njësia Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative, në mbledhjen e datës 16.09.2022, ka marrë Vendimin nr.431, bazuar në ankesën e subjektit i cili ka paraqitur si dokumente fizike kopje të email-eve të nisura me informacionet përkatëse, pra e ka plotësuar detyrimin ligjor të tij për të nisur informacionet në adresën e email-t të AKBN no-replay-revzone@akbn.gov.al, për shfuqizimin e masave administrative të marra ndaj tij nga AKBN dhe pranimin e ankesës së subjektit, i cili i është dërguar subjektit me shkresën e MIE nr.6300/2 prot., datë 20.09.2022.

Veprimtaria e Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative për këtë rast nuk është e plotë, pasi sipas kërkesave të pikës 14, të Udhëzimit të Ministrit nr.10, datë 26.01.2015, provat e sjella nga subjekti nuk janë të mjaftueshme për të marrë këtë vendim, dhe Njësia duhej të kërkonte prova shtesë nga struktura përgjegjëse (në këtë rast AKBN) e cila ka vendosur masën administrative.

Në referencë të Urdhrit të Ministrit nr.201, datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtja e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalorë, qymyret dhe bitumet” ka detyrimin për paraqitjen informacionit tremujor online ose nëpërmjet shërbimit postar jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas tremujorit, si dhe informacionin vjetor jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga përfundimi i vitit përkatës.

Grupi i auditimit të KLSH, kërkoi nga Drejtoria Minerare në AKBN, Sektori i Statistikës gjurmën e dërgimit të informacioneve vjetore, tremujore dhe gjashtëmujore për këtë subjekt në sistemin RevZone, nga i cili rezultoi si më poshtë.

Tabela nr.12 Rezultatet e shqyrtimit të masave administrative në sistemin e AKBN

Nr.	Emërtimi	RevZona
1	Informacioni për tremujorin e II-2020	Nuk është dërguar, pasi për këtë subjekt nga tremujori i kalon në të IV
2	Informacioni për tremujorin e IV-2020	Nuk është dërguar. Ka një rresht me status të subjektit “krijon” më 14.10.2020
3	Informacioni vjetor-2020	Është për vitin 2019, dërguar brenda afatit me datë 28.01.2020
4	Informacioni për tremujorin e I-2021	Nuk është dërguar. Ka një dokument për këtë periudhë në datën 09.02.2022
5	Informacioni për tremujorin e II-2021	Nuk është dërguar. Ka një dokument për këtë periudhë në datën 09.02.2022
6	Informacioni vjetor-2021	Nuk është dërguar në afat, pasi ka datën 09.02.2022
7	Informacioni për gjashtëmujorin e I-2022	Nuk është dërguar. Ka një dokument të paplotësuar për këtë periudhë në datën 19.08.2022

Burimi: Sistemi RevZone i AKBN

Në këtë mënyrë, Vendimi nr. nr.431, datë 16.09.2022 i Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative me përbërje: K. N. Kryetar, M. H., , F. M., E. I., , E. G., Z. H. dhe J.

B. anëtarë, për shfuqizimin e 7 masave administrative të marra ndaj zotëruesit të lejes minerare nr.84..., datë 18.03.2005 “A.” SHPK në vlerën 800,000 lekë është marrë në mungesë të shqyrtimit të plotë të provave shtesë nga struktura përgjegjëse AKBN që ka vendosur masën administrative. Në referencë të Udhëzimit të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr.10, datë 26.01.2015, pika 12, shkronja “ç”, Njësia duhet të kishte marrë vendim lënien në fuqi të aktit administrativ, me argumentimin e zbatimit të drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankuesi ka pretenduar shkelje.

Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për problematikën e konstatuar nga vlerësimi dhe shqyrtimi i Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative për shfuqizimin e masave administrative të marra ndaj zotëruesve të lejes minerare ka rezultuar gjetja dhe situatat si më poshtë:

Titulli gjetjes:	Vendimet e Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative për shfuqizimin e masave administrative të marra ndaj zotëruesve të lejeve minerare janë marrë në mungesë të shqyrtimit të provave shtesë nga struktura përgjegjëse AKBN që ka vendosur masën administrative në kundërshtim me pikën 14, të Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015, pasi provat e sjella nga subjektet nuk janë të mjaftueshme për të marrë këto vendime.
Situata:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative në mbledhjen e datës 27.07.2018 ka vlerësuar dhe shqyrtuar provat dhe ka njoftuar vendimin e marrë jashtë afatit prej 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit për 13 raste, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 15 të Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015 “<i>Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara</i>”; 2. Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative në mbledhjen e datës 12.07.2018 ka marrë në shqyrtim 1 ankesë e cila nuk ka pasur bashkëngjitur aktin administrativ, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, shkronja “ç” të Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015; 3. Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative në mbledhjen e datës 03.05.2018, në një rast ankesa e marrë në shqyrtim nuk ka pasur aktin administrativ, dhe është dalë me vendim në kundërshtim me pikën 12 shkronja “a”, pasi ankesa nuk ka plotësuar kushtet formale për shqyrtim; 4. Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative në mbledhjen e datës 03.05.2018, në një rast ankesa e marrë në shqyrtim në mënyrë të pa legjitimuar, pasi ankesën është bërë nga struktura përgjegjëse AKBN e cila ka vendosur masën administrative, duke vepruar në kundërshtim me pikën 11, germa “b” të Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015; 5. Vendimi i Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative nr.431, datë 16.09.2022 për shfuqizimin e 7 masave administrative të marra ndaj zotëruesit të lejes minerare nr.84..., datë 18.03.2005 “A.” SHPK në vlerën 800,000 lekë është marrë në mungesë të shqyrtimit të plotë të provave shtesë nga struktura përgjegjëse AKBN që ka vendosur masën administrative. Në këtë mënyrë, Njësia ka vepruar në kundërshtim me pikën 14, të Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015, pasi provat e sjella nga subjekti nuk janë të mjaftueshme për të marrë këtë vendim, dhe duhej vendimi për lënien në fuqi të aktit administrativ, me argumentimin e zbatimit të drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankuesi ka pretenduar shkelje.
Kriteri:	Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015 “ <i>Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara</i> ”;

Ndikimi:	Vendimet e Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative për shfuqizimin e masave administrative të marra ndaj zotërueseve të lejeve minerare janë në kundërshtim me pikën 14, të Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015, pasi provat e sjella nga subjekti nuk janë të mjaftueshme për të marrë këtë vendim, dhe duhej vendimi për lënien në fuqi të aktit administrativ, me argumentimin e zbatimit të drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankuesi ka pretenduar shkelje.
Shkaku	Vendimet e Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative për shfuqizimin e masave administrative të marra ndaj zotërueseve të lejeve minerare janë marrë në mungesë të shqyrtimit të provave shtesë nga struktura përgjegjëse AKBN që ka vendosur masën administrative në kundërshtim me pikën 14, të Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative të vlerësojë dhe shqyrtojë provat e sjella nga subjekti për shfuqizimin e masave administrative të marra ndaj zotërueseve të lejeve minerare nëse janë të mjaftueshme për të marrë vendim shfuqizimi ose lënien në fuqi të aktit administrativ, me argumentimin e zbatimit të drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankuesi ka pretenduar shkelje.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: K. N., në cilësinë e Kryetares së Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve, nga data 07.11.2019; G. K., në cilësinë e Kryetarit të Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve, deri më datë 06.11.2019 dhe në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve: M. H., F. M., J. B., E. G., nga data 05.04.2018, E. I., nga data 26.09.2018, Z. H., nga data 26.09.2019, S. Sh., deri më 25.09.2018, F. H., deri më 25.09.2018.

Pretendimi i subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar MIE me shkresën nr. 983/15, datë 04.08.2023 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt Raportin, janë sjellë observacionet të cilat shkurtimisht po i paraqesim në raport konkretisht:

Me konstatimin se subjekti minerar e ka plotësuar detyrimin për dërgimin e informacionit, në momentin e shqyrtimit të ankesës kopja e masës administrative ishte pjesë e praktikës së ankimit, gjendemi në kushtet kur edhe për ekonomi administrative dhe gjyqësore vendimi i dhënë përveçse është i drejtë dhe i bazuar në ligj, shmang edhe prezantimin dhe përfaqësimin e institucioneve shtetërore (AKBN dhe MIE) në organet e tjera ankimese gjyqësore, të cilat rëndojnë pozitën e këtyre institucioneve në kohë dhe me shpenzime të panevojshme gjyqësore.

- Në lidhje me konstatimin tuaj se Vendimi nr. 431, datë 16.09.2022, është marrë në mungesë të shqyrtimit të plotë të provave, ju sqarojmë si vijon:

Referuar pikës 2 dhe 3, të Urdhrit të Ministrit Nr. 201, datë 20.06.2016, “Për miratimin e formës së informacioneve tre mujore, vjetore dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejes minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore”, Subjekti “A.”shpk ka sjellë së bashku me ankesë e tij kopje të e-mail-ve dërguar revzone të AKBN-së.

- NJVAMA pasi ka marrë në shqyrtim provat e sjella nga subjekti, detyrimin e tij për të nisur online Informacionet tremujore apo vjetore, bazuar në pikën 1 dhe 2 të Urdhrit të Ministrit Nr. 201, datë 20.06.2016, “Për miratimin e formës së informacioneve tre mujore, vjetore dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejes minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore”, ka gjykuar se provat janë të mjaftueshme për të marrë një vendim, pasi subjekti ka për detyrë të vërtetojë faktin që e ka nisur e-mail dhe informacionin e kërkuar nga ana e tij dhe jo të verifikoj nëse sistemi online Rev-zonë, funksionon apo jo, apo nëse ky informacion i dërguar ka mbërritur në sistemin Rev-zonë. Verifikimi në sistemin Rev-Zonë nëse ka ardhur apo jo informacioni nuk është provë se sistemi online ka punuar apo jo.

Në këto kushte, NJVAMA ka gjykuar se kërkesa për verifikim në AKBN nuk ka qënë e nevojshme, pasi edhe në rast se AKBN do na bënte me dije se informacionet nuk janë në Rev-Zonë, ky fakt nuk vërteton se sistemi online i Rev-Zonës, ka qënë në funksional apo jo. Nga ana tjetër e vetmja provë që mund të paraqesi subjekti janë e-mail-et e tij. Sa më sipër, subjekti e ka plotësuar detyrimin e tij për dërgimin e informacionit online në AKBN.

- Praktika me nr. 6458/1 prot, datë 12.07.2018 (vendimi nr. 375) për shfuqizimin e masës administrative me nr. 3110 prot., datë 20.03.2018, ndaj subjektit “T.” shpk.

Masa administrative me nr. 3110 prot., ka datën 20.03.2018. Subjekti ka protokolluar ankesën e tij në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. Prot. 6459, në datë 19.04.2018, pra brenda afatit të ankimit.

- AKBN me shkresën nr. Prot. 591/4, datë 02.05.2018 (prot. MIE nr. 7023, datë 03.05.2018) ka informuar se “Subjekti “T.” ka bërë vet deklarimin për tremujorin e katërt të vitit 2018, duke dorëzuar dokumentacioni përkatës në protokollin e AKBN, i cili dokumentohet me Nr. prot. 591, datë 12.01.2018. Data 12.01.2018, është brenda afatit kohor për vetdeklarimet e subjekteve për tremujorin e katërt të vitit 2017” .

Gjithashtu subjekti “T.” shpk me shkresën nr. 7074 prot. MIE, datë 04.05.2018, ka sjellë shkresën e AKBN-së nr. Prot. 591/4, datë 02.05.2018, mbi konfirmimin e dorëzimit të informacionit, si dhe kopje të masës administrative.

Sa më sipër, NJVAMA kishte të drejtën t'i kërkonte edhe vetë plotësimin e dokumentacionit, po në kushtet kur vetë subjekti e ka plotësuar këtë të metë, brenda afatit të shqyrtimit nga NJVAMA, ankimi plotëson kushtet formale të tij.

- Vendimi nr. 376, datë 27.07.2018 “Shfuqizimin e masës administrative nr. 5338 prot., datë 10.06.2014, subjekti “V.” shpk. Subjekti “V.” shpk është zotëruar i lejes minerare nr. 68..., datë 22.05.2018. Ndaj këtij subjekti janë vendosur nga AKBN dy masa administrative për mosdorëzim në afat të planit vjetor të punës, për të njëjtën leje minerare dhe për të njëjtin plan vjetor pune.

- Në lidhje me masën nr. 5338 prot., datë 10.06.2014, subjekti nuk ka pasur dijeni dhe në datë 27.03.2018 është njoftuar nga zyra e përmbarimit për ngrirjen e llogarive për shkak të mospagesës së masës administrative nr. 5338 prot., datë 10.06.2014. Pra subjekti ka marrë dijeni në datë 27.03.2018 për masën administrative nr. 5338, datë 10.06.2014 dhe ka bërë ankesë pranë AKBN-së datë 04.04.2018, pra brenda afatit të ankimit. (30 ditë nga njoftimi). Ankesa e subjektit ka nënshkrimin e administratorit dhe vulën e shoqërisë, pra janë plotësuar kushtet formale të saj.

- AKBN, si strukturë përgjegjëse e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën e saj nr. 3796/1 prot., datë 13.04.2018 (nr. Prot. MIE 6253, datë 13.04.2018), jo vetëm ka përcjellë ankesën e subjektit “V.” shpk por njëkohësisht ka vënë në dijeni MIE, se janë vendosur dy masa administrative për mosdorëzim të planit vjetor 2014 – 2015. Mos pranimi nga ana e NJVAMA-së së këtij ankimi mund ta nxirrte jashtë afateve subjektin ankimes.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me observacionet e bëra nga subjekti i audituar MIE, NJVAMA për Projekt Raportin e auditimit, dërguar me shkresën nr. 983/15, datë 04.08.2023 edhe pse të përsëritura pa sjellë argumente të reja, grupi i auditimit gjykon se:

- *Vendimi i Njësisë së Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative nr.431, datë 16.09.2022 për shfuqizimin e 7 masave administrative të marra ndaj zotëruarëve të lejes minerare nr.84..., datë 18.03.2005 “A.” SHPK është marrë në mungesë të shqyrtimit të plotë të provave shtesë nga struktura përgjegjëse AKBN që ka vendosur masën administrative, pasi provat e sjella nga subjekti nuk janë të mjaftueshme për të marrë këtë vendim, dhe duhet vendimi për lënien në fuqi të aktit administrativ, me argumentimin e zbatimit të drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankuesi ka pretenduar shkelje. 22.07.2015 etj.*

- *Vendimi me nr.6458/1 prot., datë 12.07.2018 për shfuqizimin e masës administrative me nr.3110 prot., datë 20.03.201 ndaj subjektit “T.” SHPK. konstatohet se, shqyrtimi i ankimit të mësipërm nga Njësia e Vlerësimit të Masave Administrative është në kundërshtim me pikën 12 shkronja “a”, pasi ankesa nuk ka plotësuar kushtet formale për shqyrtim, si dhe me pikën 15 të Udhëzimit Nr. 10, datë 26.01.2015 pasi, Njësia e Vlerësimit të Ankimeve nuk ka administruar dhe shqyrtuar provat dhe nuk ka njoftuar vendimin brenda 30 ditëve nda data e paraqitjes së ankimit.*

- *Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative pas shqyrtimit të ankimit të AKBN ka vendosur shfuqizimin e masës administrative me njoftim nr. 5338, datë 10.06.2014 në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 45, pika 5, në të cilën përcaktohet: “Subjekti, ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtën e ankimit tek titullari i strukturës përgjegjëse”, pra nuk mund të ankimojë struktura përgjegjëse që ka vendosur masën administrative. Në zbatim të pikës 11, germa “b” të Udhëzimit nr.10, datë 26.01.2015, Njësia e Vlerësimit të Ankimeve nuk duhet të kishte legjitimuar ankuesin, kjo edhe për faktin se dokumentacioni i ankimit duhet të përmbajë dhe nënshkrimin e ankimesit (pika 4/ë e Udhëzimit).*

Gjykojmë se nga MIE, NJVAMA nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart argumentet e sjella, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

2.2 Auditim mbi zbatimin e procedurave dhe rezultatet e monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare, si dhe të shoqërive minerare publike.

- *Mbi numrin e lejeve minerare dhe inspektimin e tyre dy herë në vit sipas sektorëve (minerar dhe jominerar).*

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, në periudhën 2018 - 2022 numri i lejeve minerare dhe inspektimi i tyre sipas sektorëve (minerar dhe jominerar) është kryer sipas pasqyrës në vijim:

Tabela nr. 13: Të dhëna mbi frekuencën 6 mujore të inspektimeve të ushtruara nga AKBN

Emërtimi		2018	2019	2020	2021	2022
Metaloret	Gjithsej Leje	317	318	323	321	306
	Subjekte inspektuar 2 here	182	133	37	199	0
	Subjekte inspektuar 1 herë	71	99	179	68	213
	Subjekte që nuk janë inspektuar	64	86	107	54	93
Jometaloret	Gjithsej Leje	324	310	280	285	211
	Subjekte inspektuar 2 herë	183	81	93	195	0
	Subjekte inspektuar 1 herë	130	122	152	44	275
	Subjekte që nuk janë inspektuar	11	107	35	46	30
Gjithsej	Gjithsej Leje	641	628	603	606	517
	Subjekte inspektuar 2 herë	365	214	130	394	0
	Subjekte inspektuar 1 herë	201	221	331	112	488
	Subjekte që nuk janë inspektuar	75	193	142	100	123
	Gjithsej leje sipas regjistrimit	606	608	580	597	601

Burimi: Të dhëna te AKBN të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga sa më sipër rezulton se AKBN gjatë periudhës 2018-2022 nuk ka arritur inspektimin çdo 6 muaj të të gjitha subjekteve minerare, pasi janë inspektuar në vend dy herë 21-65 % e subjekteve, dhe midis 12-31 % e lejeve minerare nuk inspektohen. AKBN, duke mos inspektuar dhe duke inspektuar vetëm një here në vit subjektet minerare, nuk ka vepruar sipas kërkesave ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, i ndryshuar, neni 43, pika 2 për të kryer inspektime në funksion të hartimit dhe paraqitjes ministrit çdo 6 muaj të një raporti për mesatarisht 344 veprimtari minerare për periudhën 2018-2022 për të cilën ngarkohen me përgjegjësi Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve të Ndërtimit, Qymyreve dhe Bitumeve dhe Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore.

Në të gjithë raportet e hartuara nga ana e strukturës përgjegjëse AKBN, është nënvizuar fakti i moskryerjes së inspektimeve dhe mbikëqyrjeve sipas ligjit, për të cilat është informuar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe rezulton se nuk ka patur veprim nga kjo e fundit për nxjerrjen e përgjegjësive apo rishikimin e kapaciteteve njerëzore dhe fondeve në dispozicion të kësaj strukture. *Më konkretisht, kjo gjendje është referuar në raportet periodike si vijon:*

Viti 2018:

1.Metalor, volumi 1, v 2018, faqe 7.

Një sasi e konsiderueshme e lejeve minerare nuk janë inspektuar nga specialistët e sektorit për mungesë të fondeve. Kryesisht janë pa inspektuar bashkitë Fushë Arrëz (9 leje), bashkia Kukës (12 leje), bashkia Lezhë + Mirditë 4 leje, Bulqiza (T. + F. L + L. Gj) 7 leje minerare, bashkia Dibër 5 leje, Mati + Klosi, 10 leje, Tropoja 8 leje, Përrenjas + Librazhd + Pogradec 4 leje, Devolli 1 leje, Puke + Shkodër + V. Dejës 5 leje.

Totali i lejeve të pa kontrolluara për vitin 2018 është Nt = 65 leje minerare.

Mosrealizimi i kontrollit të këtyre lejeve ka ardhur për mungese të fondeve dhe karburantit. Drejtori i Drejtorisë Minerare për këtë arsye ka vënë në dijeni Drejtorinë Ekonomike ashtu edhe Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së. Prandaj edhe në raport aktiviteti minerar i subjekteve (pa inspektuara) që ushtrojnë aktivitet minerar në këto bashki do të jetë i paplotë dhe i cunguar.

2.Jo metaloret 2018, vol 1, fq 13.

Një kuadër të kontrollit të veprimtarisë minerare të subjekteve që ushtrojnë aktivitet minerar, nga Sektori nuk janë mbikëqyrur të gjitha subjektet pasi ka patur mungesë të mjeteve të transportit, ditëve të reduktuara të shërbimit nga katër ditë në tre ditë për kryerjen e të gjitha shërbimeve. Megjithëse është detyrim ligjor për të kontrolluar veprimtarinë minerare dy herë në vit, rreth 50 subjekte në 9 bashki të vendit nuk janë inspektuar nga ana e jonë për mungesë mjeteshe dhe ditëve të reduktuara. Prandaj dhe aktiviteti minerar për këto rrethe në këtë raport do të jetë i gjashtë mujorit 2018 ose vjetor 2017, ndërsa treguesit tekniko-ekonomik janë marrë nga vetë-deklarimet e informacionit vjetor të marra nga sektori i statistikës pranë Drejtorisë Minerare.

Viti 2019:

3.Vol nr.1, metaloret, faqe 7.

Një sasi e konsiderueshme e lejeve minerare nuk janë inspektuar nga specialistët e sektorit për mungesë të fondeve. Kryesisht janë pa inspektuar bashkitë Kukës (13 leje), Bulqiza (T. + F. L + L. Gj) 18 leje minerare, bashkia Dibër 5 leje, Mati + Klosi, 16 leje, Tropoja 10 leje, Hasi 11 leje, Përrenjas + Librazhd + Pogradec 12 leje, Korçë +Devolli 6 leje, Puke + Shkodër + V. Dejës 2 leje.

Totali i lejeve të pa kontrolluara për vitin 2019 është $Nt = 95$ leje minerare.

Mosrealizimi i kontrollit të këtyre lejeve ka ardhur për mungese të fondeve dhe karburantit. Drejtori i Drejtorisë Minerare për këtë arsye ka vënë në dijeni Drejtorinë Ekonomike ashtu edhe Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së. Prandaj edhe në raport aktiviteti minerar i subjekteve (pa inspektuara) që ushtrojnë aktivitet minerar në këto bashki është i paplotë dhe i cunguar.

4.Jo metalor, vol.1/2019, faqe 7-8.

Depozita për garancinë financiare për rehabilitimin e mjedisit përcaktohet në bazë të planit të miratuar të prodhimit vjetor. Këto depozita kthehen kur i licencuari rehabiliton zonën e dëmtuar në përputhje me planin. Në të kundërt, MIE mund të përvetësojë garancinë dhe të kontrakttojë rehabilitimin e mjedisit në atë zonë.

Një kuadër të kontrollit të veprimtarisë minerare të subjekteve që ushtrojnë aktivitet minerar, nga Sektori nuk janë mbikëqyrur të gjitha subjektet pasi ka patur mungesë të mjeteve të transportit për kryerjen e të gjitha shërbimeve si dhe ristrukturimit të institucionit. Megjithëse është detyrim ligjor për të kontrolluar veprimtarinë minerare dy herë në vit, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 janë kontrolluar 128 nga (277 leje që janë sipas regjistrimit minerare) subjekte në 21 bashki dhe 149 leje minerare nuk janë inspektuar nga ana e jonë për mungese fondesh dhe mjeteshe transporti. Prandaj dhe aktiviteti minerar për këto rrethe nuk është përshkruar, ndërsa treguesit tekniko-ekonomik janë marrë nga vetë-deklarimet e informacionit të gjashtëmujorit të I-re të marra nga sektori i statistikës pranë Drejtorisë Minerare.

5.Viti 2020, volum nr. 1, metaloret, faqe 6.

Kontrrolli i aktivitetit minerar për 6-mujorin e I-rë të vitit 2020 nuk është realizuar nga specialistët e AKBN-së. Shkak ka qenë situata e pandemisë së virusit "Covid 19", që u shoqërua edhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.03.2020, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", deri më 23.06.2020.

Si rezultat i vendimit të mësipërm kryerja e kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit minerar nuk është realizuar në gjithë vendin. Për këtë 6-mujor janë mbikëqyrur me sforco nga ana e Drejtorisë Minerare vetëm zona e Bulqizës, Batrës dhe Pogradecit.

Gjatë 6-mujorit të II-të të vitit 2020 në të gjithë territorin e vendit ushtrojnë aktivitet minerar 303 leje minerare shfrytëzimi, të shpërndara në 18 bashki, të cilat janë mbikëqyrur nga specialistët e Sektorit Operativ Metalor, si pjesë e Drejtorisë Minerare të AKBN-së.

Në kuadër të mbikëqyrjes për vitin 2020 është realizuar kontrolli dhe inspektimi i subjekteve minerare në të gjitha bashkitë e vendit. Nga inspektimi është bërë e qartë panorama e zhvillimit të aktivitetit për çdo subjekt në rang vendi. Numri i lejeve minerare të inspektuara në 6-mujorin e I-rë të vitit 2020 nga Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore është: Nlk = 53 leje minerare.

6.Jo metaloret, 2020, vol.1, faqe 9.

Si në të gjitha degët e ekonomisë në vend, edhe industria nxjerrëse në Republikën e Shqipërisë për vitin 2020, ka qenë e kondicionuar nga situata e "Fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë COVID-19". Megjithëse është detyrim ligjor për të kontrolluar veprimtarinë minerare dy herë në vit, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020 janë kontrolluar 74 subjekte (nga 273 leje minerare aktive sipas regjistrimit minerar) në 10 bashki dhe 194 leje minerare nuk janë inspektuar nga ana jonë për arsyen e përmendur më lart. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020 janë kontrolluar 267 subjekte (97.8 %) të Lejeve Minerare të Shfrytëzimit. Nuk janë mbikëqyrur Lejet Minerare në bashkitë Tropojë, Has dhe Kukës (6 leje minerare shfrytëzimi ose 2.2 %).

Viti 2021

7.Metaloret, vol 1, faqe 10, 2021.

Kryerja e kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit minerar është realizuar pothuajse në gjithë vendin. Përrjashtim bëjnë disa bashki dhe subjekte që aktiviteti minerar i tyre ka qenë i cunguar dhe shoqëritë kanë qenë me pezullim të aktivitetit minerar të miratuar nga MIE si dhe ndikimi i situatës së pandemisë "Covid 19". Për këtë vit janë mbikëqyrur nga ana e Drejtorisë Minerare shumica e bashkive të vendit.

8.Jo metaloret, 2021, vol.1, faqe 14.

Në kuadër të kontrollit të veprimtarisë minerare të subjekteve që ushtrojnë aktivitet minerar, nga Sektori nuk janë mbikëqyrur të gjitha subjektet. Megjithëse është detyrim ligjor për të kontrolluar veprimtarinë minerare dy herë në vit, si arsye e situatës se "Fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë COVID-19" ky kontroll nuk është ushtruar në të gjitha subjektet e licencuara. Treguesit tekniko-ekonomik janë marrë nga vet deklaratimet e informacionit vjetor të marra nga sektori i statistikës pranë Drejtorisë Minerare. Shënim: Lejet minerare në terren janë mbikëqyrur edhe nga specialistë të sektorit metalore pasi në disa rrethe si Mirdita, Fushë Arrëz, Pukë etj, ka pak leje të mineraleve Jometallore dhe shume leje të mineraleve metalore dhe shërbimi është me kosto.

Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave të kontrolleve sipas sektorëve dhe viteve me të dhënat e regjistrimit të lejeve 2018 -2022 rezulton se numri i lejeve të inspektuara është më i lartë se ai në regjistër për vitet 2018, 2019 dhe 2022, gjë që tregon se të dhënat e inspektimeve përmbajnë pasaktësi të konsiderueshme.

Sipas ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, i ndryshuar, neni 43, pika 4: "Struktura përgjegjëse ka të drejtë të kryejë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij ligji, të lërë detyra, të marrë masa administrative apo të propozojë marrjen e tyre nga ministri." Sipas Ligjit nr. 10433, date 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", neni 3. "Inspektim" është çdo formë kontrolli që organi publik kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit."

• Mbi hartimin dhe miratimin e programeve vjetore të kontrollit/inspektimit të subjekteve të pajisura me leje minerare të shfrytëzimit dhe mbajtjen e akteve të konstatimit:

Sipas Urdhrit të Ministrit të METE nr.382, date 20.05.2011 "Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare", pika 17, titullarët e strukturës përgjegjëse në fillim të çdo viti kalendarik programojnë kontrollet për subjektet minerare aktive gjatë atij viti kalendarik dhe e dërgojnë për miratim në METE, si dhe çdo kontroll realizohet vetëm me miratim të titullarit". Nga ana e AKBN (Drejtoria e Minerave) nuk është hartuar dhe më pas miratuar në MIE plani vjetor i kontrollit të subjekteve në asnjë vit gjatë periudhës objekt auditimi, duke

mos vepruar sipas kërkesave të pikës 17, të Urdhrit të Ministrit të METE nr.382, date 20.05.2011.

Nga dokumentacioni i inspektimeve të vënë në dispozicion, rezulton se nga struktura përgjegjëse (Drejtoria e Minerave në AKBN) në çdo rast është plotësuar formulari Akt-Konstatimi sipas përcaktimeve në Aneksin 1 të Urdhrit të Ministrit të METE nr.382, date 20.05.2011, që ka të bëjë me lënien e aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare, por që në fakt nuk kanë të përshkruar kundërvajtje administrative. Në disa raste iu është bashkëlidhur një format “Mbikëqyrja” e cila mban datë tjetër nga Akt-konstatimi, me tabelë për realizimin e treguesve tekniko-ekonomik dhe përshkrimi i realizimit të projektit minerar, si dhe mbi realizimin e operacioneve të punimeve minerare dhe depozitimit të mbetjeve, të plotësuara pjesërisht, kryesisht tek tabela.

Gjithashtu, nga ana formale ka raste që mungojnë nënshkrimet e përfaqësuesit të subjektit minerar: zotëruesi i lejes minerare dhe/ose Administratori dhe/ose Drejtuesi teknik.

Në një rast, në lejen minerare 1789, me date 23.10.2019 është cilësuar se zotëruesi i lejes nuk u paraqit, megjithëse një inspektim i programuar dhe nuk është marrë masë ndaj tij;

Së paku në shtatë raste, nga ana e Grupit të Mbikëqyrjes së strukturës përgjegjëse AKBN, është evidentuar fakti se, nga ana e subjektit-zotërues të lejes minerare, nuk është miratuar plani vjetor i punës, dhe nuk është proceduar në vend me vendosjen e sanksioneve administrative gjombë sipas parashikimeve të nenit 45, të ligjit për sektorin minerar. Më konkretisht, në aktin e konstatimit² është shprehur sa vijon:

A. Nga kontrolli i ushtruar nga grupi i specialistëve të AKBN-së i përbërë nga ing. gjeolog Gj. L., ing. markshajdër F. D., ing. miniere A. A., dhe ing. gjeolog S. F., në datat 25.06.2018 deri 29.06.2018, në subjektin “T.” SHPK, rezulton se:

1. Në objekt nuk punohet. 2. *Subjekti nuk ka miratuar planin vjetor të punës.* 3. Subjekti ka bërë pagesën e garancisë finaciare të rehabilitimit. 4. Prodhim për vitin 2018 nuk ka. 5. Të dhënat për zhvillimin e aktivitetit minerar janë të 6 Mujorit të parë kurse prodhimi dhe numri i punëtorëve është sipas vetë deklarimeve të subjektit.

B. Nga kontrolli i ushtruar nga grupi i specialistëve të AKBN-së i përbërë nga ing. gjeolog Gj. L., ing. markshajdër F. D., ing. miniere A. A., dhe ing. gjeolog S. F., në datat 25.06.2018 deri 29.06.2018, në subjektin: “B. K.” SHPK, rezulton se: 1. Në objekt në momentin e kontrollit nuk punohet 2. *Nuk ka miratuar planin vjetor të punës në AKBN.* 3. Subjekti ka në objekt 3 punëtor që po punojnë për mirëmbajtjen e rrugës kryesore të punimit. 4. Numri i fuqisë punëtore me sigurim nga aksidentet është 3 persona. 5. Prodhimi për vitin 2018 nuk ka. 6. Sasia e rezervave në objekt është $\Sigma Q_{gj} = 4150 \text{ ton} \times (36.0-38.0) \% \text{ Cr}_2\text{O}_3$. 6. Të dhënat për zhvillimin e aktivitetit minerar janë të 6 Mujorit të parë kurse prodhimi dhe numri i punëtorëve është sipas vetë deklarimeve të subjektit. Detyrë e lënë: 1. Me fillimin e punës në objekt, të pezullohet menjëherë lëvizja e njerëzve, mjeteve të transportit si dhe kryerja e aktivitetit minerar kryesor dhe ndihmëse në sipërfaqe dhe në nën tokë në zonat e rrezikshme të përcaktuara në VKM Nr. 726 dt.02.09.2015 dhe VKM Nr.751 dt.26.10.2016.

C. Nga kontrolli i ushtruar nga grupi i specialistëve të AKBN-së i përbërë nga ing. gjeolog Gj. L., ing. markshajdër F. D., ing. miniere A. A., dhe ing. gjeolog S. F., në datat 25.06.2018 deri 29.06.2018, në subjektin “D.” SHPK, rezulton se: 1. Në objekt nuk punohet. 2. *Subjekti nuk ka miratuar planin vjetor të punës.* 3. Ka kryer pagesat e garancisë së rehabilitimit. 4. Prodhim për vitin 2018 nuk ka. 5. Të dhënat për zhvillimin e aktivitetit minerar janë të 6 Mujorit të parë kurse prodhimi dhe numri i punëtorëve është sipas vetë deklarimeve të subjektit.

D. Nga mbikëqyrja e kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes të Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore, të AKBN-së, i përbërë nga Ing. Miniere A. A., Ing. Gjeolog V. L., dhe Ing. Markshajdër A. I., në datat 24.09.2018 deri në 27.09.2018, në subjektin “K.” SHPK, rezulton se: 1. Në objekt nuk zhvillohet aktivitet minerar 2. *Subjekti nuk ka mbrojtur programin vjetor të punës në AKBN.* 3. Rezerva gjendje në objekt janë $\Sigma Q_{gj} = 73 \text{ 000 ton} \times$

² - Raporti Vjetor 2018, Mars 2018. Nr. Ref 3031/1, faqe 100.

(30.0-34.0%) Cr2O3. *Detyrë e lënë:* a. Të bëhet azhurnimi faktik i karrierës si dhe stogjeve të sterilitetit dhe të dërgohet në AKBN.

E. Nga kontrolli i kryer nga grupi i specialistëve të sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore, të AKBN-së i përbërë nga Ing. Gjeolog Gj. L., Ing. Miniere M. C., Ing. markshajder E. M., në datat 24.09.2018 deri në 27.09.2018 në subjektin “B.” SHPK rezulton se: 1. Në objekt nuk punohet për arsye të konfliktit me lejet minerare fqinje. 2. *Subjekti nuk ka të miratuar programin vjetor të punës për vitin 2018 – 2019.*

F. Nga kontrolli i kryer nga grupi i specialistëve të sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore, të AKBN-së i përbërë nga Ing. Gjeolog Gj. L., Ing. Miniere M. C., Ing. Markshajder E. M., në datat 24.09.2018 deri në 27.09.2018 në subjektin “A.” SHPK rezulton se: *Në objekt nuk punohet. Subjekti ka paraqitur në MIE ankesën për rivlerësimin e garancisë së rehabilitimit pasi pretendimi i subjektit është se vlera e rehabilitimit është më e lartë. Për këtë problem AKBN me Prot.nr.1204/3 I është drejtuar Ministrisë me dt.26.06.2014 për vlerën e re të garancisë së rehabilitimit. Subjekti nuk ka miratuar programin vjetor të punës për vitin 2018.*

G. Subjekti “G.” SHPK: Nr. leje minerare: Nr. 17..., Dt. 12.11.2015, Bashkia: Bulqizë. Emërtimi i vendburimit: Objekti “Z. L.”, Batërr , Vendndodhja e objektit: Batër, Bulqizë. Në objekt nuk zhvillohet aktiviteti minerar. *Edhe për vitin 2018 nuk ka prodhim dhe nuk ka filluar aktiviteti minerar. Subjekti nuk ka miratuar projekt programin për vitin 2018-2019.*

- *Në disa raste, mbikëqyrjet dhe monitorimet e AKBN-së nuk janë thelluar në analiza dhe vlerësimin e informacionit të administruar.*

Kështu, p.sh, referuar Akt Konstatimit të mbajtur më datën 15 Nëntor 2018, në subjektin “M. I” SHPK, zotërues i lejes minerare nr. 10..., datë e marrjes së lejes 19.11.2008, për vendburimin Bulqizë; me vendndodhje të objektit: Galeritë Nr. 2... & Nr.5..., kuotat (Horizonti +1194,m ÷ +1280) Zona D”, Bulqizë³, thuhet se mbikëqyrja është kryer me dt 15.11.2018 dhe se subjekti ka miratuar planin vjetor të punës në AKBN me nr. prot; 6670/1, datë 03. 11. 2017. Mirëpo, mungon një informacion dhe verifikim i hollësishëm i faktit nëse subjekti ka depozituar në AKBN se paku 30 ditë para datës 3.11.2018, (që i takon 3.10.2018, dhe kjo periudhë përkon me mbi 1.5 muaj para datës së kryerjes së mbikëqyrjes në terren), të planit vjetor të punës, sa parashikuar në Urdhrin nr. 202, datë 20.6.2016 i Ministrisë të MIE.

Më konkretisht,

Nga mbikëqyrja e kryer nga specialistët e AKBN, ing. P. H.Ing. V. L., dhe Ing. E. M. , në 15 Nëntor 2018, në bashkinë Bulqizë, në objektin Galeritë Nr. 2... & Nr. 5..., kuotat (Horizonti +1194,m ÷ +1280) Zona D”, në subjektin “M. I.” SHPK, rezulton se: *Subjekti ka miratuar planin vjetor të punës në AKBN me nr. prot; 6670/1, datë 03. 11. 2017.*

Pra, grupi i mbikëqyrjes së strukturës përgjegjëse AKBN, nuk është shprehur nëse, nga zotëruesi i lejes minerare, është depozituar plani vjetor sipas parashikimeve ligjore në fuqi dhe rrjedhimisht të procedohej me vendosjen e sanksioneve administrative gjobë, për shkelje të nenit 18/ç, në masën 250 mijë lekë, sipas parashikimeve të nenit 45/ dh, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

ç) të paraqesë për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan vjetor pune, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare, për çdo vit, jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes. Ky plan duhet të përmbajë në mënyrë të specifikuar kapacitetet e prodhimit, vlerën e investimeve, vlerat e garancive të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit, të cilat miratohen nga strukturat përgjegjëse jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mosmiratimi, struktura përgjegjëse e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Nëse ajo nuk kthen përgjigje, pas tejkallimit të këtij afati, plani quhet i miratuar. Përmbajtja e planit të punës dhe dokumentet e tjera të nevojshme që e shoqërojnë duhet të jetë në

³ - Referenca; Raporti AKBN nr. 3031/1, mars 2018, metaloret, vol.1, faqe 95-96

- Në një numër Akt Konstatimesh të mbajtura (së paku në 6 raste të testuara), nga mbikëqyrja e shfrytëzimit të burimeve minerare dhe ushtrimit të veprimtarisë minerare në Bashkinë Bulqizë, është konstatuar, grupi i mbikëqyrjes, referuar materialit të publikuar, është mjaftuar vetëm me shprehjen “Subjekti ka miratuar programin vjetor të punës në AKBN”, pa identifikuar asnjë të dhënë të aktit dhe të datës së miratimit të këtij programi. Kështu, mund të përmendim:

1. Bazuar në Aktin e Konstatimit të mbajtur në datën 14.11.2018, për mbikëqyrjen e shfrytëzimit të burimeve minerare dhe të veprimtarisë minerare në Bashkinë Bulqizë, sht konstatuar se, në objektin “Galeria 6... deri në sip. Zona D”, në subjektin “K. B.” SHPK, grupi i mbikëqyrjes, referuar materialit të publikuar, është mjaftuar vetëm me shprehjen “Subjekti ka miratuar programin vjetor të punës në AKBN”, pa identifikuar asnjë të dhënë të aktit dhe të datës së miratimit të këtij programi.

2. Referuar kontrollit të kryer nga specialistët e sektorit të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional të mineraleve metalore të AKBN-së i përbërë nga Ing. Miniere P. H., Ing. Gjeolog Gj. L., Ing. Markshajder A. I., në datat 01.11.2018, në subjektin: “K.” SHPK: rezulton se: “Punohet sipas projekt programit të miratuar në AKBN”.

3. Nga kontrolli i kryer nga specialistët e sektorit të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional të mineraleve metalore të AKBN-së i përbërë nga Ing. Miniere P. H., Inxh Gjeolog Gj. L., Ing. Markshajder A. I., , në datat 01.11.2018, në subjektin “M.” SHPK rezulton se: “Punohet sipas projekt programit të miratuar në AKBN”.

4. Nga kontrolli i kryer nga specialistët e sektorit të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional të mineraleve metalore të AKBN-së i përbërë nga Ing. Miniere P. H., Inxh Gjeolog Gj. L., Ing. Markshajder A. I., , në datat 01.11.2018, në subjektin: “A. A.” SHPK, rezulton se: “Punohet sipas projekt programit të miratuar në AKBN”.

5. Nga kontrolli i kryer nga specialistët e sektorit të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional të mineraleve metalore të AKBN-së i përbërë nga Ing. Miniere P. H., Inxh Gjeolog Gj. L., Ing. Markshajder A. I., , në datat 01.11.2018, në subjektin “G.” SHPK rezulton se: “Punohet sipas projekt programit të miratuar në AKBN”.

6. Nga mbikëqyrja e kryer nga specialistët e AKBN, ing. P. H. Ing. V. L., dhe Ing. E. M. , në 13 Nëntor 2018, në Bashkinë Bulqizë, në subjektin “C. G.” SHPK, rezulton se: “Ka miratuar planin vjetor të punës në AKBN etj.”

- Nga auditimi i dosjeve të mbikëqyrjes rezulton se, nga specialistet e Drejtorisë Minerare të AKBN janë lënë disa detyra prioritare dhe urgjente, por mungon verifikimi dhe programimi i verifikimit të këtyre detyrave të konsideruara urgjente. Kështu mund të përmendim,

✓ Nga mbikëqyrja e kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore i përbërë nga; Ing. Miniere. P. H., Ing. Gjeolog S. F., Ing. M. A. I., në datat 17.09.2018 deri më datë 20.09.2018, për subjektin “I.” SHPK, nuk ka një cikël të verifikimit të zbatimit të detyrave të lëna nga procesi i monitorimit dhe mbikëqyrjes :

a. Të mbyllet dy hyrjet e furneleve të skamja e dishinterisë me katrorë druri dhe shenja dalluese.

b. Të behet urgjentisht armatimi i grykës së punimit në balle , pasi ekspozohet nga ndikimi i hapësirës.

✓ Nga mbikëqyrja e kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore i përbërë nga; Ing. Miniere. P. H., Ing. Gjeolog S. F., Ing. M. A. I., në datat 17.09.2018 deri më datë 20.09.2018, për subjektin “C.” SHPK rezulton se nuk ka një cikël të verifikimit të zbatimit të detyrave të lëna nga procesi i monitorimit dhe mbikëqyrjes:

a. Të pezullohet puna në pjesën veriore të karrierës, derisa të bëhet azhurnimi i saktë i saj.

b. Të sjellë një planimetri të punimeve të saj në AKBN-ë.

c. Të vijoj me prerjen e shkallës së karrierës, për ta sjell në parametrat e lejuara.

✓ Nga kontrolli i kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore të AKBN-së, i përbërë nga Ing.Gjeolog Gj. L., Ing.Miniere A. A, Ing. Markshajder E. M., në datën 09.10.2018 në subjektin “R. “ *SHPK* rezulton se, *nuk ka një cikël të verifikimit te zbatimit te detyrave të lëna nga procesi i monitorimit dhe mbikëqyrjes:*

Detyrë e lënë: Të rifillojë sa më shpejt puna për vazhdimin e fushorit në n/katin e IV –të si dhe vazhdimi i furneve për tu lidhur me galerinë 20.

✓ Nga kontrolli i kryer nga Specialistët e Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore të AKBN- së i përbërë nga Ing. Markshajder B. C., Ing. gjeolog Gj. L., ing miniere A. A., në datat 29.05.2018 , dhe nga mbikëqyrja e realizuar me datën 11/12/2018, në subjektin “B.”, *SHPK*, ne objektin e lejes minerare nr.44..., date 19/02/1999, rezulton: 1. Subjekti ka miratuar programin vjetor të punës, (Shtyrë afatin e vlefshmërisë me nr. 8224/3 prot MIE, datë 06.07.2018. 2. Ka kryer pagesën e garancisë së rehabilitimit. 3. *Prodhimi vjetor i miratuar, sipas detyrimit ligjor të lejes minerare:300 ton,38.4 %Detyra të lëna:* Të pezullohen menjëherë punimet minerare në karrierë derisa të rregullohen elementët teknik të shkallëve të karrierës.

- *Informacioni i pasqyruar në një akt konstatimi e mbikëqyrje të mbajtur në subjektin ku është kryer mbikëqyrja ka pasaktësi. Kështu, për ZLM “M. D” SHPK me datën 13 Dhjetor 2018, grupi i mbikëqyrjes shpreh se subjekti ka miratuar programin vjetor të punës me datë 18 Dhjetor 2018 (?), ose 5 ditë pas mbajtjes së aktit të konstatimit në subjekt.*

Konstatimet: “Nga mbikëqyrja e kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalor i përbërë nga Ing. Miniere P. H., Ing Markshajder F. D., Ing. Gjeolog S.F., në datat 04.06.2018 deri 07.06.2018, dhe nga mbikëqyrja e realizuar me datën 13/12/2018, në subjektin “M. D” *SHPK* rezulton se: a. Subjektit i ka miratuar programin vjetor te punës, nr. 6936/4 prot. AKBN, datë 18.12.2018.⁴ b. Në momentin e kontrollit, date 13.12.2018, nuk punon. c. Ka kryer pagesën e garancisë së rehabilitimit.

- *Për subjektin “L.”, SHPK informacioni që i referohet në raportin e vitit 2018 i përket muajit Qershor të vitit 2017, ku janë konstatuar mosrespektime të kushteve dhe kriterëve të lejes minerare të shfrytëzimit, pasi Subjekti nuk ka sjellë projekt programin tekniko-ekonomik për vitin 2016-2017, për këtë atij i është akorduar një mase administrative prej 250 000 lekësh, (gjobe kjo e cila është paguar nga ana e subjektit), por pa thënë se: a është miratuar projekt programi tekniko-ekonomik për vitin 2018 dhe çfarë rezultoi për vitin 2018 dhe pse nuk janë vijuar procedurat për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit.*

Konstatimet:

Nga mbikëqyrja e kryer në rrethin e Bulqizës nga grupi i punës i përbërë nga specialistët e AKBN-së; Ing. B. C., Ing. J. TH., dhe Ing. O. M., në muajin Qershor 2017, subjektit “L.” *SHPK* në rrethin e Bulqizës, rezulton se:

1. Aktiviteti minerar në objekt nuk ka filluar.

2. Për vitin 2017 nuk ka prodhim, por subjekti kishte filluar hapjen e rrugës lidhëse me objektin, por nuk është lejuar nga banoret e zonës.

3. *Subjekti nuk ka sjellë projekt programin tekniko-ekonomik për vitin 2016-2017, për këtë atij i është akorduar një mase administrative prej 250 000 lekësh, gjobe kjo e cila është paguar nga ana e subjektit.*

4. Subjekti ka sjellë informacionin e tremujorit të I-rë të vitit 2017, duke respektuar afatet kohore.

• ***Mbi problematikat e konstatuara nga shqyrtimi dhe analizimi i raporteve të monitorimit, të hartuara nga struktura përgjegjëse:***

Në raportet e monitorimit ka përsëritje të cilësimeve për të njëjtat subjekte nga viti në vit si

⁴ -Mbikëqyrja e shfrytëzimit te rezervave minerare nga subjektet private raporti vjetor, viti 2018, vëllimi 2, Metaloret, faqe 39

p.sh leja nr.64... dhe 64... për vitet 2018 dhe 2019; për lejen nr.64... megjithëse prodhimi për periudhën 2015-2019 është zero, është vijuar normalisht pas asnjë ndëshkim për subjektin. Në raportin e monitorimit të vitit 2020, cilësohet: “Për lejet e shfrytëzimit në minierat Qafë Bari, Tuç, Fushe Arrëz dhe Palucë, MIE, është shprehur për pezullim të përkohshëm për një vit në shkresën 4742/1 datë 23/07/2015, ndërsa vendburimet Karma 2 dhe Lak Roshi nuk kanë patur pezullim të përkohshëm. Nga kjo datë e në vazhdim institucioni jonë nuk ka asnjë dokument zyrtar për pezullim të përkohshëm të këtyre minierave. Për sa me sipër komisioni i miratimit të projekt/programeve vjetore nuk mori në shqyrtim dosjet e arkivuara pranë këtij institucioni. Në zbatim të nenit 47, pika ii, të Ligjit nr.10304 datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” janë propozuar për revokim. Në lejen nr. 15... ka 5 vjet që nuk bëhet asnjë aktivitet investimi, kurse në objektet e tre lejeve të tjera të “B.” sha, nuk janë investuar dhe prekur ndonjëherë nga shoqëria”, gjë që tregon se ka munguar komunikimi midis MIE dhe AKBN për çështje të ndryshme të monitorimit, duke ndikuar negativisht në veprimtarinë e strukturës përgjegjëse AKBN dhe sektorit minerar në përgjithësi.

Në raportin e monitorimit të vitit 2021 është cilësuar se “Lejes minerare i ka mbaruar afati 20 vjeçar dhe subjekti ka aplikuar për shtyrje afati”, por nuk cilësohet në se zbatuar afati i përcaktuar në pikën 1 të nenit 16: “Afati i vlefshmërisë mund të zgjatet një herë për një periudhë 10-vjeçare, me kërkesë të zotëruesit të lejes. Kërkesa për shtyrje afati duhet të paraqitet, së paku, 1 vit para mbarimit të afatit të mëparshëm të vlefshmërisë. Afati i aplikimit është prekluziv dhe, me kalimin e tij, zotëruesi i lejes minerare humbet të drejtën e aplikimit për shtyrje të afatit të lejes së shfrytëzimit”, si dhe në rast se zotëruesi i lejes së shfrytëzimit i ka plotësuar më parë detyrimet financiare, ka kryer investimet e parashikuara në programin e punës në përputhje me lejen e dhënë, paraqet një program pune shtesë, bindës për ministrin, për vazhdimin e mëtejshëm të veprimtarisë së shfrytëzimit dhe kur vazhdimi i shfrytëzimit nuk bie ndesh me projekte të tjera që kanë interes publik ose me planifikimin e shpalljes së zonave të reja të mbrojtura (pika 2 e këtij neni)

Megjithëse, për lejet e shfrytëzimit në minierat Qafë Bari, Tuç, Fushe Arrëz, Palucë që nga data 23.07.2015 deri më 18.05.2022, komisioni i miratimit të projekt/programeve vjetore në AKBN nuk ka marrë në shqyrtim dosjet e arkivuara pranë tij, dhe më pas subjekti ka mbrojtur planin vjetor të punës me shkresën nr.2300 prot. datë 18.05.2022.

Në inspektimet e kryera bëhet një përshtetësi i përgjithshëm i punës, plotësohet me të dhëna të deklarimeve të vetë subjektit, dhe pa marrë masat ndëshkuese edhe pse evidentohet mungesa e sigurimit të të gjithë punonjësve nga aksidentet në punë, ose lihet detyrë për sjelljen në parametra normal të shkallës ndërmjetëse dhe nuk ka ndëshkim me masa administrative, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e pikës 1, germa “c” të nenit 45, për mosrespektim të detyrimeve dhe/apo kushteve që janë përcaktuar në lejen minerare, të lidhura me mosrespektimin e projektit të aktivitetit minerar.

Në rastin e miratimit të planeve vjetore nuk janë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit, Ka raste kur plani vjetor është miratuar kur nënkontraktori ka pasur detyrime për taksat vendore (RT minerals për vitin 2020).

Nga të dhënat e komisionit të shqyrtimit të programeve vjetore **për vitin 2019**, ka rezultuar që subjekti “S. P” SHPK ka diferencë të pa paguara të rentës minerare për vitet 2016, 2017, 2018 dhe pagesa të kryera jo sipas ligjit për taksat kombëtare.

Megjithëse për vitin 2019, subjekti “D. V.” SHPK, Subjekti “K. T.” SHPK për vitin 2020-2021 pasi duhet të paguajë diferencën e rentës minerare (dhe ka refuzim të planit vjetor të punës me nr.1351 prot. datë 08.09.2020), nuk ka miratuar programin e punës për vitin 2018-2019, nuk është marrë masë administrative ndaj tij, sipas parashikimeve të nenit 45, pika 1, germa “dh” të ligjit minerar.

Ka raste që janë lënë detyra (për vitin 2022 subjekti “D. V” SHPK), por që nuk rezultojnë të dokumentuara në inspektimin e radhës kontrolli zbatimit të tyre.

Megjithëse nuk është kryer pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2020-2021 nga subjekti “K. T. SHPK”, nuk ka pasur propozim për revokim leje nga ana e AKBN, në zbatim të kërkesave të nenit 47, pika 1, germa “ç”.

Për vitin 2018:

a. Në raportin e 6 mujorit të parë “*Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private*”, të hartuar nga Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore (Drejtoria Minerare e AKBN) (Numri i projektit 3031/1), rezulton se nuk kanë raport për mbikëqyrjen e subjekteve gjatë këtij 6-mujori.

- “**B.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 23..., datë 05.11.2015, “**O.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 27..., datë 15.05.1996, “**A.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 44..., datë 19.02.1999, “**M.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 29..., datë 02.07.1996, “**S. B.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 49..., datë 04.08.1999, “**R.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 58..., datë 19.06.2012 kaluar subjektit “**A.**” SHPK kalim leje minerare shfrytëzimi me nr. 58...datë 13.11.2000, “**A.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 58..., datë 22.02.2012.

b. Në raportin e 6 mujorit të dytë “*Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private*”, të hartuar nga Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore (Drejtoria Minerare e AKBN) (Numri i projektit 3031/1), rezulton se nuk kanë raporte për mbikëqyrjen e subjekteve gjatë këtij 6-mujori.

“**T.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 46..., datë 02.08.1999, “**A. M.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 45..., datë 19.03.1999, “**A. K.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 47..., datë 02.08.1999, “**R.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 48..., datë 02.08.1999, “**M.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 58..., datë 06.09.2013

c. Nuk i janë nënshtruar procesit të monitorimit dhe mbikëqyrjes nga ana e Drejtorisë Minerare në AKBN.

“**XH.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 58..., datë 15.12.2000

Për vitin 2019:

a- Në raportin e 6 mujorit të parë “*Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private*”, të hartuar nga Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore (Drejtoria Minerare e AKBN) (Numri i projektit 3040, 3038), rezulton se nuk ka raporte për mbikëqyrjen e këtyre subjekteve gjatë këtij 6-mujori.

- “**B.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 23..., datë 05.11.2015, “**O.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 27..., datë 15.05.1996, “**A.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 44..., datë 19.02.1999, “**M.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 29..., datë 02.07.1996, “**T.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 46..., datë 02.08.1999, “**S. B.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 49..., datë 04.08.1999, “**.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 58..., datë 19.06.2012 kaluar subjektit “**A.**” SHPK kalim leje minerare shfrytëzimi me nr. 58...datë 13.11.2000, “**A.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 58..., datë 22.02.2012,

b- Në raportin e 6 mujorit të dytë “*Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private*”, të hartuar nga Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore (Drejtoria Minerare e AKBN) (Numri i projektit 3040, 3038), rezulton se nuk ka raporte për mbikëqyrjen e këtyre subjekteve gjatë këtij 6-mujori.

-“**A. M.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 45..., datë 19.03.1999 “**A. K.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 47..., datë 02.08.1999, “**R.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 48..., datë 02.08.1999, “**M.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 58..., datë 06.09.2013

c. Nuk i janë nënshtruar procesit të monitorimit dhe mbikëqyrjes nga ana e Drejtorisë Minerare në AKBN.

“**XH.**” SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 58..., datë 15.12.2000

Për vitin 2020

a- Në raportin vjetor “*Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private*”, të hartuar nga Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve

Metalore (Drejtoria Minerare e AKBN) (Numri i projektit 3045/1), rezulton se nuk ka raporte për monitorimin dhe mbikëqyrjen e këtyre subjekteve për vitin 2020.

- **“T.”** SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 46..., datë 02.08.1999,

- gjithashtu nga auditimi konstatohet se ka raporte monitorimi por nuk ka një akt konstatimi për mbikëqyrjen e monitorimin e kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore për vitin 2020 në subjektin **“R.”** SHPK, **“S. A”** SHPK, **“A.”** SHPK **“M.”** SHPK, **“A”** SHPK, në kundërshtim me kërkesat e nenit 43, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 *“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”*, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, *“Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare”* pika 3. *“Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare*”.

b. Nuk i janë nënshtruar procesit të monitorimit dhe mbikëqyrjes nga ana e Drejtorisë Minerare në AKBN.

- **“.”** SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 23..., datë 05.11.2015, me shënimet në raportin e monitorimit dhe mbikëqyrjen e këtij subjekti për vitin 2020:

1. *Diktuar nga situata e krijuar nga COVID - 19, në zbatim edhe të detyrimeve ligjore të përcaktuara në VKM nr.243, datë 24.03.2020 Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore”, nga institucioni i AKBN-së, verifikimi në terren i zonës së lejuar minerare nuk u mundësua të realizohet për vitin 2020.*

- **“O.”** SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 27..., datë 15.05.1996, me shënimet në raportin e monitorimit dhe mbikëqyrjen e këtij subjekti për vitin 2020:

1. *Subjektit i ka mbaruar afati 20 vjeçar i lejes minerare dhe nuk ka kërkuar shtyrje të saj.*
2. *Subjekti ka kërkuar mbyllje të aktivitetit pasi në objekt kanë mbaruar rezervat e mineralit të kromit.*
3. *Numri i punonjësve në objekt është gjithsej: $N_{pgj} = 0$ vetë.*
4. *Numri i punonjësve me sigurim jete është: $N_{ps} = 0$ vetë.*
5. *Për periudhën Janar + Dhjetor 2020 është prodhuar: $P = 0$ ton Cr_2O_3 .*

nuk ka një akt konstatimi për mbikëqyrjen e monitorimin e kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore për vitin 2020.

- **“M.”** SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 29..., datë 02.07.1996, me shënimet në raportin e monitorimit dhe mbikëqyrjen e këtij subjekti për vitin 2020:

1. *Diktuar nga situata e krijuar nga COVID – 19, në zbatim edhe të detyrimeve ligjore të përcaktuara në VKM nr. 43, datë 24.03.2020 “Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore”, nga institucioni i AKBN-së, verifikimi në terren i zonës së lejuar minerare nuk u mundësua të realizohet për vitin 2020.*

nuk ka një akt konstatimi për mbikëqyrjen e monitorimin e kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore për vitin 2020

- **“XH.”** SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 5..., datë 15.12.2000 në raport ka shënimin: subjekti ka plotësuar kërkesat dhe vërejtjet e AKBN, si dhe ka bërë mbylljen përfundimtare dhe rehabilitimin mjedisor.

Për vitin 2021

a- Në raportin vjetor volumi II *“Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private”*, të hartuar nga Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore (Drejtoria Minerare e AKBN) (Numri i projektit 3052/1, 3061), rezulton se ka raporte për monitorimin dhe mbikëqyrjen e këtyre subjekteve për vitin 2021.

- Nga auditimi konstatohet se ka raporte monitorimi por nuk ka një akt konstatimi për mbikëqyrjen e monitorimin e kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore për vitin 2021 në subjektin **“B.”** SHPK, **“O.”** SHPK, **“A.”** SHPK, **“M”** SHPK **“S. A”** SHPK, **“A.”** SHPK, **“M.”** SHPK, **“A.”** SHPK, në kundërshtim me kërkesat e nenit 43, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 *“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”*, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014,

“Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare” pika 3. “Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare”.

b. Nuk i janë nënshtruar procesit të monitorimit dhe mbikëqyrjes nga ana e Drejtorisë Minerare në AKBN.

- **“XH.”** SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 5..., datë 15.12.2000 me shënimin e AKBN: *“Objekti është në procedurat e mbylljes dhe revokimit të lejes minerare. Subjekti ka plotësuar kërkesat dhe vërejtjet e AKBN, si dhe ka bërë mbylljen përfundimtare dhe rehabilitimin mjedisor”.*

Për vitin 2022

a- Në raportin *“Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private”*, të hartuar nga Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore (Drejtoria Minerare e AKBN) (Numri i projektit 3060), rezulton se ka raporte për monitorimin dhe mbikëqyrjen e këtyre subjekteve për vitin 2022.

- Nga auditimi konstatohet se ka raporte monitorimi por nuk ka një akt konstatimi për mbikëqyrjen e monitorimin e kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore për vitin 2021 në subjektin **“B...”** SHPK, **“O...”** SHPK, **“A.”** SHPK, **“M.”** SHPK **“A. M.”** SHPK, **“S. A”** SHPK, **“A.”** SHPK, **“M.”** SHPK, **“A.”** SHPK, në kundërshtim me kërkesat e nenit 43, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 *“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”*, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, *“Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare” pika 3. “Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare”.*

b. Nuk i janë nënshtruar procesit të monitorimit dhe mbikëqyrjes nga ana e Drejtorisë Minerare në AKBN.

- **“XH.”** SHPK, me nr. leje minerare shfrytëzimi 5..., datë 15.12.2000 me shënimin e AKBN: *“Objekti është në procedurat e mbylljes dhe revokimit të lejes minerare. Subjekti ka plotësuar kërkesat dhe vërejtjet e AKBN, si dhe ka bërë mbylljen përfundimtare dhe rehabilitimin mjedisor”.*

Konkluzione;

- Nga strukturat përgjegjëse, në zbatim të detyrimit ligjor dhe autoritetit shtetëror, nuk është hartuar një program periodik ose i posaçëm, për të ushtruar kontrolle në çdo veprimtari minerare me qëllim realizimin e mbikëqyrjes e monitorimin e veprimtarive minerare dhe konstatimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatimin të lejeve minerare, sipas kërkesave të Urdhrit nr. 382, datë 20.05.2011 *“Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare”*, pika 16 *“Strukturat përgjegjëse të Sektorit Minerare, specialistët dhe inspektorët e çdo strukture, në zbatim të detyrimit ligjor dhe autoritetit shtetëror, me program të planifikuar periodik ose të posaçëm, ushtrojnë kontrolle në çdo veprimtari minerare për të realizuar mbikëqyrjen e monitorimin e veprimtarive minerare dhe konstatimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatim të lejes minerare. Pika 17 “Titullarët e strukturës përgjegjëse në fillim të çdo viti kalendarik programojnë kontrollet për subjektet minerare të pajisura me leje minerare aktive gjatë vitit kalendarik dhe e dërgojnë për miratim në METE”*

- Nuk është kryer mbikëqyrja e monitorimi i veprimtarisë minerare çdo 6 muaj por vetëm një herë në vit duke mos respektuar kërkesat e nenit 43, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 *“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”*, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, *“Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare” pika 3. “Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare”.*

- Në raportet *“Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private”*, të hartuar nga Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve

Metalore (Drejtoria Minerare e AKBN), rezulton se nuk ka raporte për mbikëqyrjen e monitorimin e këtyre subjekteve për çdo 6-mujor.

- Në konstatimet nga mbikëqyrja e grupeve të specialistëve paraqitur në raportet 6 mujore “Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private” rezulton se grupet e specialisteve nuk janë shprehur për numrin e punëtoreve, realizimin e prodhimit, treguesit teknologjikë, realizimin e investimeve, realizimi i shitjeve brenda dhe jashtë vendit, të ardhurat e realizuara nga shitjet brenda vendit dhe eksportet, realizimi i rentës minerare etj tregues sipas kërkesave të: Nenit 43, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, “Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare”, pika 3, “Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare..... dhe Urdhrit nr. 202, datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e Zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, dhe bitumet” pika 3, “Formati dhe përmbajtja e planit vjetor të punës të parashikuar për t’u realizuar gjatë veprimtarisë minerare të vitit në vazhdim, të përcaktuar në përputhje me datën efektive të dhënies së lejes nga zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, duhet të jetë në përputhje me planin e zhvillimit të veprimtarisë minerare të miratuar në lejen e tyre minerare dhe sipas formatit të përshkruar në **aneksin 3** të këtij urdhri. Ky plan duhet të dërgohet on line (portali: raport.akbn.gov.al), pranë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes, për çdo vit” dhe pika 8. “Institucioni i AKBN-së jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të çdo gjashtëmujori, duhet të dorëzojë në MIE raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve të pajisura me lejet e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, qymyret dhe bitumet,

- Gjithashtu në konstatimet nga mbikëqyrja e grupeve të specialistëve paraqitur në raportet 6 mujore “Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private” rezulton se grupet nuk janë shprehur në mënyrë specifike për treguesit e paraqitur në **Aneksi 3**, formatin nr.1 të tabelës së planit vjetor të veprimtarisë minerare i dërguar on line, (portali: raport.akbn.gov.al) (REVZONE) pranë AKBN-së ku paraqiten në mënyrë të specifikuar dhe të detajuar në tremujorë, kapacitetet e prodhimit, vlera e investimeve dhe operacionet që do të kryhen nga ana e subjektit gjatë veprimtarisë së tij minerare njëvjeçare sipas tabelës.

1. Prodhimi minerar.

- a) Prodhimi minerar në total
- b) Nënproduktet e përpunuara
- c) Punime minerare të realizuara
- d) Punime gjeologjike të realizuara
- e) Sasia e mbetjeve minerare të depozituara në sipërfaqe

2. Realizimi i investimeve dhe punimeve gjeologo minerare

- a Punime minerare
- b Punime gjeologjike
- c Makineri e pajisje

3. Vlera e produkteve minerare të shitura ne total, në të njëjtën monedhë

4. Rehabilitimi i mjedisit

5. Pagesa e taksës lokale

6. Garancia e investimeve

7. Garancia e rehabilitimit

8. Fuqia punëtore në total

9. Fuqia punëtore me sigurim jete

10. Pagesa e rentës minerare

- Nga krahasimi i treguesve të paraqitur në raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit me treguesit e raportuar në sistemin REVZONE dhe treguesit e planit të miratuar (leja 45.... leja 47....) rezulton se vlerat e paraqitura nuk janë të njëjta si: numri i punonjësve në objekt, numri

punonjësve me siguracion jete, prodhimi i planifikuar, prodhimi i raportuar, realizimi i investimeve, Sasitë e mineralit të shitur, të ardhurat e planifikuara dhe ato të realizuar, renta minerare etj.

*- Rezulton se në sistemin REVZONE janë hedhur pjesërisht (në disa raste treguesit nuk janë hedhur) treguesit e planit vjetor të veprimtarisë minerare të dërguara on line nga subjektet si: Prodhimi mineralar, Realizimi i investimeve dhe punimeve gjeologo minerare, Vlera e produkteve minerare të shitura ne total, në të njëjtën monedhë, Rehabilitimi i mjedisit, Pagesa e taksës lokale, Garancia e investimeve, Garancia e rehabilitimit, Fuqia punëtore në total, Fuqia punëtore me sigurim jete, Pagesa e rentës minerare etj. kjo në kundërshtim me kërkesat e Urdhrit nr. 201, nr. 202, datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e Zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, dhe bitumet” (Zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore) pika 3, “Formati dhe përmbajtja e planit vjetor të punës të parashikuar për t’u realizuar gjatë veprimtarisë minerare të vitit në vazhdim, të përcaktuar në përputhje me datën efektive të dhënies së lejes nga zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, duhet të jetë në përputhje me planin e zhvillimit të veprimtarisë minerare të miratuar në lejen e tyre minerare dhe sipas formatit të përshkruar në **aneksin 3 të këtij urdhri**. Ky plan duhet të dërgohet on line (portali: raport.akbn.gov.al), pranë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN),”.*

- Nga auditimi konstatohet se për periudhën audituese për subjektet e lejeve minerare nuk janë mbajtur akte konstatimi 6 muaj për mbikëqyrjen e monitorimin e kryer nga grupet e specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore duke mos respektuar kërkesat e nenit 43, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, “Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare” pika 3. “Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare

- Në disa raporte “Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private”, të hartuar nga Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore (Drejtoria Minerare e AKBN) (Numri i projektit 3060), (leja 27...) rezultojnë me shënimin se: Subjekti i ka mbaruar afati 20 vjeçar i lejes minerare dhe nuk ka kërkuar shtyrje të saj, Subjekti ka kërkuar mbyllje të aktivitetit pasi në objekt kanë mbaruar rezervat e mineralit të kromit, ose (leja 44...) Shoqëria ka pezullim të aktivitetit mineralar të miratuar nga MIE me shkresë nr. prot: 4171/3, date 05.07.2021, (leja 297) Diktuar nga situata e krijuar nga COVID – 19, në zbatim edhe të detyrimeve ligjore të përcaktuara në VKM nr. 43, datë 24.03.2020 “Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore”, nga institucioni i AKBN-së, verifikimi në terren i zonës së lejuar minerare nuk u mundësua të realizohet për vitin 2020, Leja minerare nr. 29... datë 02.07.1996, me shkresën e MIE nr. prot: 314/3, datë 18.02.2021, është me statusin e pezullimit të përkohshëm, kur në sistemin REVZONE paraqitet prodhimi i parashikuar dhe i realizuar por nuk ka një akt konstatimi për mbikëqyrjen e monitorimin e kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore në subjektet me qëllim verifikimin nëse punohet ose jo, pra nëse ka aktivitet mineralar, në kundërshtim me kërkesat e nenit 43, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, “Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare” pika 3. “Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare”.

- Nga ana e strukturës përgjegjëse janë kryer verifikimet dhe mbikëqyrjet bazuar ne detyrimet që rrjedhin nga *Kreu VII, neni 43, pika 3, të ligjit nr. 10304 “Për sistemin mineralar”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:*

Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare, i cili përmban të dhëna për:

- a. *respektimin e realizimit të projektit mineral;*
- b. *realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare;*
- c. *lëvizjen e rezervave minerare;*
- ç) *kryerjen e operacioneve minerare, në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit mineral, duke u këshilluar me njësitë qeverisjes vendore të zonës minerare;*
- d. *respektimin e standardeve të sigurisë në punë e të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse.*

dhe pikën nr. 2, germa "i", të VKM nr. 232, datë 23.03.2011 "Për miratimin e funksioneve të strukturës përgjegjëse në sektorin mineral të RSH", ku përcaktohet detyrimi i AKBN mbi hartimin dhe paraqitjen në Ministri, çdo 6 muaj të një raporti për çdo veprimtari minerare, i cili përmban të dhëna mbi: respektimin e realizimit të projekti mineral, realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare; lëvizjen e rezervave; kryerjen e operacioneve minerare në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit mineral, duke u këshilluar me autoritetet e qeverisjes vendore të zonës minerare.

Konstatim:

Nga ana e strukturës përgjegjëse mungon një udhëzues i detajuar, ku të pasqyrohen të dhënat mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e te domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen në kuadër të vlerësimeve në një subjekt, zotërues të lejeve minerare të shfrytëzimit, etj.

*Nga vlerësimet e kryera nga ana e audituesve të autorizuar të KLSH konstatohet se aktet e mbikëqyrjes trajtojnë në **mënyrë telegrafike** informacion mbi numrin e punonjësve gjithsej dhe atyre të siguruar, sasinë e prodhimit, sasinë e rezervave, informacion nëse subjekti ka miratuar programin vjetor të punës për vitin dhe nëse Subjekti ka dërguar në AKBN informacionet periodike tre mujore dhe vjetore, si dhe ka kryer pagesën e garancisë së rehabilitimit të mjedisit.*

• *Dokumentet e raporteve periodike 6-mujore të hartuar nga ana e strukturës përgjegjëse janë konceptuar si përmbledhëse informative mbi aktivitetin mineral, se sa si raporte të mbikëqyrjes të këtij sektori.*

Kështu, duke analizuar raportet zyrtare të monitorimit të hartuara nga ana e strukturës përgjegjëse të AKBN dhe të depozituara periodikisht në MIE, rezulton se janë përfshirë në sistemin e raportimit periodik përmbledhës subjekte të ndryshme, zotërues të lejeve minerare, në 30 raste, për vitin 2018, dhe për mbi 50 subjekte për vitet 2019 dhe 2020 për të cilat nuk është kryer asnjë mbikëqyrje dhe monitorim pranë këtyre subjekteve për vitin referues, dhe se informacioni i përfshirë në raportim është vetëm sipas vetë deklarimeve të subjekteve zotëruese të lejeve minerare në sistemin rezonë.

Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në raportet periodike të mbikëqyrjes, rezulton se për periudhën objekt auditimi, janë 80 (tridhjetë) raporte të vetë deklarimeve që janë përfshirjes në raportin përmbledhës 6-mujor, dërguar ministrisë përgjegjëse për industrinë dhe aktivitetin mineral.

*Raportet e hartuara nga strukturës përgjegjëse AKBN, ndonëse titullohen "mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private", në një masë dërmuese, kanë pasqyruar informacione të cilat janë marrë nga vete deklaratimet, dhe nuk janë certifikuar për saktësinë dhe besueshmërinë e tyre nëpërmjet inspektimit dhe mbikëqyrjes në terren nga specialistet e drejtorisë minerare të AKBN. *Më hollësisht,**

*Nga shqyrtimi i të dhënave të raportit **për vitin 2018:***

✓ Subjekti "V." SHPK- *Zotërues i lejes minerare Nr.48..., Data e marrjes së lejes:2.8.1999.* Bazuar në informacionin e marrë nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjorë, si dhe në vetë deklaratimet e subjektit "V." SHPK, mbi detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit rezulton se: *Në vitin 2018 nuk u ushtrua kontrolli në objektin e kromit, "1... K", L. Gj mbi gal. 2", Bulqizë.*

- ✓ Subjekti: “D.” SHPK, Nr. 94..., Dt 17.07.2006. Bazuar në informacionin e marrë nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjorë, si dhe në vetë deklaratimet e subjektit “D.” SHPK, mbi detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit rezulton se: Në vitin 2018 nuk u ushtrua kontrolli në objektin e kromit, “V. L. S”, Bulqizë.
- ✓ Subjekti “B.” SHPK - Nr. 17..., Dt. 09.06. 2014. Bazuar në informacionin e marrë nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor, si dhe në vetë deklaratimet e subjektit “B.” SHPK, mbi detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit rezulton se: Për 2018 nuk u ushtrua kontrolli në objektin e kromit “F. L”, Martanesh, Bulqizë.
- ✓ Subjekti “A.” SHPK- Nr. 17..., Dt. 19.11.2015. Bazuar në informacionin e marrë nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjorë, si dhe në vetë deklaratimet e subjektit “A.” SHPK, mbi detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit rezulton se: Në vitin 2018 nuk u ushtrua kontrolli në objektin e kromit, Objekti “M. L.”, Martanesh, Bulqizë.
- ✓ Subjekti “A.” SHPK, Nr. 45..., Dt. 19.03.1999 . Bazuar në informacionin e marrë nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjorë, si dhe në vetë deklaratimet e subjektit “A.” SHPK , mbi detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit rezulton se: Në vitin 2018 nuk u ushtrua kontrolli në objektin e kromit, “Th. S.” Bulqizë.
- ✓ Subjekti “A.” SHPK,- nr.86..., dt. 17.6.2005: Në vitin 2018 nuk u ushtrua kontrolli në objektin e kromit “Th. V.”, Tërnovë, Bulqizë.
- ✓ Subjekti “R.” SHPK, Nr. 14... Dt. 16.04.2010, Në vitin 2018 nuk u ushtrua kontrolli në objekt.
- ✓ Subjekti “F.” SHPK -Z Nr.15..., Dt. 19/ 11/ 2012, Ky subjekt nuk është kontrolluar në vitin 2018. Relacioni është i vitit 2017.
- ✓ Subjekti “S.”, SHPK , Nr. 14..., Dt.24.08.2010 . Shënime: Relacion i kontrollit të 6-Mujorit të parë 2017.
- ✓ Subjekti” “XH. G” SHPK, Nr.18..., dt.29.09.2016. Shënime: Relacion i kontrollit të 6-Mujorit të parë 2017.
- ✓ Subjekti” “G.” SHPK (Ish-“Sh...” SHPK),Nr.13..., datë 20.08.2009. Shënime: Relacion i kontrollit të 6-Mujorit të parë 2017. Ky subjekt nuk është inspektuar nga specialistët e sektorit të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional të mineraleve metalore të AKBN për vitin 2018 për mungesë fondesh.
- ✓ Subjekti “B.” SHPK, Nr. 17..., data e marrjes së lejes: 23.04.2015. Shënime: Relacion i kontrollit të 6-Mujorit të parë 2017. Konstatimet: Ky subjekt nuk është inspektuar nga specialistët e sektorit të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional të mineraleve metalore të AKBN për 6 –mujorin e parë të vitit 2018 për mungesë fondesh
- ✓ E njëjta situatë evidentohet edhe në Subjekti “C. E.”, SHPK (LM Nr. 18..., data e marrjes së lejes: 09.11.2016; Subjekti”B...” SHPK (Nr. 17..., data e marrjes së lejes: 07/ 10/ 2015); “T. A. T. M”, SHPK (Nr. 10..., data e marrjes së lejes 20.08.2007), “SH. “ SHPK (Nr.12..., data e marrjes së lejes: 30.07.2008); “O...” SHPK (Nr.22..., data e marrjes së lejes: 18.12.1995), Subjekti ”B.” SHA. (Nr. 64..., data e marrjes së lejes: 27.08.2001), “ V. D. I. E” , SHPK (Nr. 11..., data e marrjes së lejes: 13.12.2007) etj.

Për vitin 2019 mund të përmendim raportet e hartuara nga ana e AKBN, bazuar në vetë deklaratimet e subjekteve, zotëruese të lejeve minerare, si: “K.” SHPK (Nr. lejes minerare 5..., Data 07.12.2000); E. C” SHPK, (Nr. 81..., Data 04.10.2004) ;“N.” SHPK, (Nr. 10... Data e marrjes së lejes: 03.04.2013), etj.

Për vitin 2020: “F. P. K. B”, SHPK (Nr. 89...,Dt. 27.07.2005); “A”, SHPK (Nr. 95..., Dt. 06.07.2018); “M. I”, SHPK (Nr. 10... - dt 19.11.2008); “D.”, SHPK, (nr. 1143, dt. 28.01.2008); “I.” SHPK, ish- “D.”, SHPK (Nr. 11..., Dt. 01.07.2008); “I.”, SHPK , Emri i subjektit nënkontraktor “.” , SHPK (Nr. 12..., Dt. 21.07.2008); “M.”, SHPK (Nr.14..., dt.21.10.2009); “E.”, SHPK, Nënkontraktor “.” SHPK (Nr. 15...*, Dt. 13.11.2012); “A. C” SHPK (Nr. 48...,Datë 02.08.1999);“H.”, SHPK (Nr.49..., Dt. 04.08.1999); “A.” SHPK (Nr. 50..., Dt.04/ 08/ 1999); “A.”, SHPK: (Nr. 14... , Dt. 17.08.2010), etj.etj.

- Në 4 (katër) raste, ne raportet e monitorimit janë pasqyruar detyrimet e zotëruesit të lejes minerare "B." SHA (lejet nr. 16..., 16... dhe nr. 16...), për të cilat nuk janë kryer procedurat e verifikimit nëse nga ana e subjektit janë kryer pagesat për diferencën e garancisë së investimi, bazuar në Cash Flow, përkatësisht në vlerën; $\sum \text{Inv.} = 106,000 \text{ USD}$, në vlerën: 219,000 USD, 143,000 USD dhe 106,000 USD. Raportet vjetore nuk shprehen nëse është arkëtuar në llogaritë e shtetit kjo vlerë detyrimi.

Më hollësisht:

1. "B." SHA

Emri i subjekti:	"B." SHA
Nr. lejes minerare:	Nr. 16...
Data e marrjes së lejes:	Dt.07.02.2014
Bashkia:	Fushë Arrëz
Emërtimi i vendburimit:	"Q. B", Pukë
Vendndodhja e objektit:	"Q. B.", Pukë
Lloji i mineralit:	Bakër
Administrator i subjektit:	M. N. K
Nr. Tel. Ose Cel.	06...
Adresa e selisë:	F. A., P.
Sipërfaqja e objektit:	S = 0.78 km ²
Cilësia e mineralit:	Cu = (1.6÷1.8) %
Drejtues teknik:	Ing. miniere N. Gj.

Ky subjekt nuk është inspektuar nga specialistët e sektorit të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional të mineraleve metalore të AKBN për vitin 2018 për mungesë fondesh. Nga raportimet e subjektit për këtë vit rezulton se:

Numri i punonjësve gjithsej është: $N_{pgj} = 0$ vetë.

Numri i punonjësve me sigurim jete është: $N_{ps} = 0$ vetë.

Për periudhën kohore Janar Dhjetor 2018 është prodhuar : $Q_{2018} = 0$ ton

Gjendja e rezervave gjeologjike është: $\sum Q_{gj} = 338774 \text{ ton} \times 1.8 \% \text{ Cu}$

Rezervat e nxjerrshme në këtë vendburim janë 322672 ton $\times 1.47\text{Cu}$.

Subjekti ka për të paguar diferencë garancie investimi, bazuar në Cash Flow në vlerën; $\sum \text{Inv.} = 106,000 \text{ USD}$.

2. "B." SHA.

Emri i subjekti:	"B." sha:
Nr. lejës minerare:	Nr.16...
Data e marrjes së lejës:	07.02.2014
Bashkia:	Fushë Arrëz
Emërtimi i vendburimit:	"T. L", Pukë
Vendndodhja e objektit:	"T. L", Pukë
Lloji i mineralit:	Bakër

Miniera është në konservim, puna është ndërprerë.

Shoqëria ka bërë kërkesë në MIE për ndërprerje të përkohshme të punës dhe është miratuar me shkresën e MIE me Nr. 4742/1, datë 23.07.2015. Ky subjekt nuk është inspektuar nga specialistët e sektorit të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional të mineraleve metalore të AKBN për vitin 2018 për mungesë fondesh. Nga raportimet e subjektit për këtë vit rezulton se:

Numri i punonjësve gjithsej është: $N_{pgj} = 0$ vetë. Numri i punonjësve me sigurim jete është:

$N_{ps} = 0$ vetë. Për periudhën kohore Janar Dhjetor 2018 është prodhuar : $Q_{2018} = 0$ ton .Gjendja

e rezervave gjeologjike është: $\sum Q_{gj} = 680 \text{ 000 ton} \times 2.2 \% \text{ Cu}$.

Rezervat e nxjerrshme në këtë vendburim janë 500994 ton $\times 1.53\text{Cu}$.

Subjekti ka për të paguar diference garancie investimi, bazuar në Cash Flow në vlerën: 219,000 USD.

3. "B." SHA.

Emri i subjekti:	"B." SHA.	
Nr. lejes minerare:	Nr.16...	
Data e marrjes së lejes:	07.02.2014	
Bashkia:	Fushë Arrëz	
Emërtimi i vendburimit:	"P.", P.	
Vendndodhja e objektit:	"P.", P.	
Lloji i mineralit:	Bakër	
Administrator i subjektit:	M. N. K	

Miniera është në konservim puna është ndërprerë. Shoqëria ka bërë kërkesë në MEI për ndërprerje të përkohshme të punës dhe është miratuar me shkresën e MEI-it, me Nr. 4742/1, datë 23.07.2015. Subjekti ka kryer pagesën e garancisë së rehabilitimit të mjedisit. Ky subjekt nuk është inspektuar nga specialistët e sektorit të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional të mineraleve metalore të AKBN për vitin 2018 për mungesë fondesh. Nga raportimet e subjektit për këtë vit rezulton se: Numri i punonjësve gjithsej është: $N_{pgj} = 0$ vetë. Numri i punonjësve me sigurim jete është: $N_{ps} = 0$ vetë. Për periudhën kohore Janar Dhjetor 2018 është prodhuar : $Q_{2018} = 0$ ton. Gjendja e rezervave gjeologjike është: $\sum Q_{gj} = 323626$ ton x 1.35 % Cu. Rezervat e nxjerrshme në këtë vendburim janë 217076 ton x1.08Cu.

Subjekti ka për të paguar një diferencë garancie investimi, bazuar në Cash Flow në vlerën; = 143,000 USD.

4. "B." SHA.

Nr. lejes minerare:	Nr. 16...	
Data e marrjes së lejes:	07.02.2014	
Bashkia:	Fushë Arrëz	
Emërtimi i vendburimit:	"F. A", P.	
Vendndodhja e objektit:	"F. A", P.	
Lloji i mineralit:	Bakër	
Administrator i subjektit:	M. N. K	
Nr. Tel. Ose Cel.	06.....	
Adresa e selisë:	F. A., P.	
Siperfaqja e objektit:	S = 0.55km ²	
Cilësia e mineralit:	Cu = (1.6 ÷ 1.8) %	
Drejtues teknik:	Ing. Gj. A.	

Miniera është në konservim, puna është ndërprerë.

Shoqëria ka bërë kërkesë në MEI për ndërprerje të përkohshme të punës dhe është miratuar me shkresën e MEI-it me Nr. 4742/1, datë 23.07.2015. Ky subjekt nuk është inspektuar nga specialistët e sektorit të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional të mineraleve metalore të AKBN për vitin 2018 për mungesë fondesh. Nga raportimet e subjektit për këtë vit rezulton se:

Numri i punonjësve gjithsej është: $N_{pgj} = 0$ vetë. Numri i punonjësve me sigurim jete është: $N_{ps} = 0$ vetë. Për periudhën kohore Janar Dhjetor 2018 është prodhuar : $Q_{2018} = 0$ ton . Gjendja e rezervave gjeologjike është: $\sum Q_{gj} = 809289$ ton x 1.34 % Cu. Rezervat e nxjerrshme në këtë vendburim janë 571423 ton x1.06Cu. **Subjekti ka për te paguar një diferencë garancie investimi, bazuar ne Cash Flow në vlerën; = 106,000 USD.**

- ***Ka raportime të ndryshme të numrit të punonjësve në listë-pagesa (ESIG), Raportet e Monitorimit dhe atyre të raportuara nga vete subjekti në sistemin RevZone.***

Konstatohet se në sistemin e informacionit te Rev-zonës mungojnë të dhënat mbi datën e ngarkimit të informacionit në sistemin e raportimit, me qëllim për të gjykuar mbi zbatimin e afateve dhe aplikimin automatik të penaliteteve. Nga ana tjetër, nuk ka një urdhër mbi procedurat e aksesit dhe ligjërimin e përdorimit të kësaj baze të dhënash.

Nga ana e strukturës përgjegjëse mungon një udhëzues mbi procedurën dhe elementet e detyrueshëm që duhet të përfshihen në skemën e inspektimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes

në subjektet zotëruese të lejeve minerare të shfrytëzimit apo në subjektet minerare të pezulluara, të revokuara, apo atyre në proces mbyllje dhe rehabilitimi mjedisor, etj.

- *Nga shqyrtimi i të dhënave të vëna në dispozicion (të dhënat sipas vet deklarimeve që kryejnë subjektet pranë AKBN-së në sistemin RevZONË dhe ato të ardhura me protokoll nga njëra anë, dhe shifrave të raportuara në MIE, me raportet periodike e vjetore, vërejmë mospërputhje dhe pasaktësi.*

Kështu, lidhur me pasqyrimin e numrit të punonjësve të punësuar në industrinë minerare Viti 2019:

■ Nga krahasimi i të dhënave të hedhura në *sistemin rezone* në v.2019 , rezulton ë **5,162 vetë**, nga te cilat **4,530** janë me **sigurim jete**, ndërsa

■ sipas trajtimeve në faqen nr. 20 te raportit vjetor 2019, ky numër është gati dhjetëfishuar, dhe pasqyruar **44,581 vetë**, dhe **3,742 persona me sigurim jete**:

Raporti mbi mineralet metalore:

Numri i punonjësve të punësuar në sektorin minerar dhe aktivitetin që lidhet me të, për vendburimet metalore në vendin tonë janë përkatësisht:

Numri i punonjësve gjithsej;

□ *Npgj = 44,581 vetë, kurse numri i punonjësve me sigurim nga aksidentet personale në punë është; Nps = 3724 vetë.*

□ *Krahasuar me vitin 2018, numri i punonjësve për vitin 2019 është i njëjtë.*

Raporti mbi mineralet jo metalore:


Numri total i fuqisë punëtore në këtë sektor është: Np = 1,422 punonjës

Numri i punëtorëve me sigurim nga aksidentet personale në punë në këtë sektor është: Np = 805 punonjës

Të dhënat mbi rentën (REVZONE-RAPORT VJETOR AKBN):

Periudha	Nr. lejesh minerare	Treguesi rentës minerare sipas sistemit revzone (në lekë)	Treguesi rentës minerare sipas kategorive (në lekë)		
			Metalor	Jometalor	Shuma
2018	6...	957,801,499	622,265,770	335,245,317	957,511,087
2019	5...	809,399,401	456,098,103	129,404,115	585,502,218
2020	5...	659,448,213	368,785,920	290, 115, 839	658,901,759
2021	5...	670,899,198	331,614,536	330,140,053	661,754,589

Grafiku nr.1 Treguesit e rentes minerare 2018-2021



Burimi: Të dhëna të AKBN të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

- **Problematikat lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e planeve vjetore**

Në dosjet e planeve vjetore janë vërtetime të tatimeve, që nuk i përkasin periudhës në të cilën miratohet plani vjetor (në dosje ndodhet vërtetimi i tatimeve për pagesën e detyrimeve deri më datë 16.05.2017 në një kohe që duhej vërtetim i vitit 2018 për “R. C.”, në QKB rezulton me status të pezulluar më datë 07.09.2018 dhe është bere aktiv me datë 04.04.2022; siguracioni për 3 punonjës, nga të cilët 2 janë për 6 muaj; nuk ka kontrate për R. S., drejtues teknik;)

Një problem tjetër që ka dalë edhe gjatë mbikëqyrjes dhe në komisionin e mbrojtjes së programeve për subjektin “P.” SHPK, ka të bëjë me faktin se, emri i mineralit të vendosur në Akt Miratimin të lejes minerare të shfrytëzimit nga ana e Ministrit të linjës nuk është i saktë/i përputhur me llojin e mineralit që ndodhet në objekt. *Kështu*, për shembull në Lejen minerare është shënuar gurë gëlqerorë, por në terren është gëlqerorë i mermerizuar ose emërtim tjetër i papërcaktuar qartë, i cili bie ndesh me ligjin nr. 9975, datë 28.07. 2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, ku për këtë nga ana e AKBN është mbajtur korrespondencë me Tatimet dhe Doganat, ku kërkohet informacion mbi rentën e paguar dhe mënyrën se si është paguar kjo rentë minerare edhe për raste specifike.

Prodhimi i realizuar nga subjektet zotërues të lejeve në Raportet e monitorimit përputhet me atë të raportuar në sistemin RevZone, pavarësisht datës së miratimit të lejes, që nuk përkon me vitin kalendarik;

Në dosjen e miratimit të planit vjetor për vitet e periudhës 2018-2022 për subjektin F. K. C. F. SHPK, për vitin 2018, megjithëse cilësohet se ka miratuar planin e punës 2018-2019, që nuk ka të plotësuar asnjë tregues tjetër në lidhje me investimet garancinë financiare, punime gjeologjike, numrin e punonjësve etj. Në dosje ndodhet vërtetimi i Drejtorisë së tatim paguesve të mëdhenj të datës 21.03.2019, në të cilin ka detyrime tatimore gjithsej 111,296,738 lekë për TVSH, tatim fitimin, rentën minerare, tatimin në burim dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duhet theksuar se në vërtetimin e datës 04.01.2019 ka qenë mbi 243 milion lekë.

Në procesverbalin e datës 17.09.2020 cilësohet se dokumentacioni është dorëzuar brenda afatit dhe se ka mangësi nga ana ekonomike dhe ligjore, pasi mungon vërtetim i taksave nga bashkia, pagesat e rentës tabela e shitjeve, rinovim polica sigurimi etj., për plotësim brenda datës 25.09.2020, i pa firmosur nga 3 anëtarë. Në Procesverbalin e datës 25.09.2020 është cilësuar se nuk është dorëzuar Brenda afatit të parashikuar nga ligji, ka mangësi nga ana ekonomike dhe ligjore në lidhje me vërtetimin e tatimeve, diferenca të pagesës së rentës, dokumente të pa noterizuara etj, dhe nuk është firmosur nga tre anëtarë, përfshirë nënkryetarin e komisionit. Në Procesverbalin e datës 05.11.2020, cilësohet se është dorëzuar brenda afatit dhe bazuar në procesverbalin e datës 17.09.2020 dokumentacioni është në rregull, nënshkruar vetëm nga ekonomistja, juristja dhe sekretari i komisionit, dhe firma e drejtuesit teknik **jo e saktë**.

Ka një dokument të datës 08.09.2021 marreveshjes se pagesës me këste për taksat lokale me bashkinë Fushe- Kruje në shumën prej 41,730,263 lekë, për likuidim brenda datës 20.12.2021.

Për subjektin “O. A” SHPK, mbikëqyrur në 2018, duke cilësuar “*Bazuar në ligjin minerar 10.304 dt.15.07.2010, i ndryshuar, Neni 47, pika 1 germa “c” dhe “ç”, leja minerare është propozuar për revokim në MIE, për mos kryerjen e pagesave të garancive të rehabilitimit dhe investimit, më datë 06.04.2017*” dhe në vitin 2022: “1. Në objekt nuk zhvillohet aktivitet minerar dhe nuk është punuar që nga momenti i marrjes së lejes minerare. 2. Lejes minerare i ka mbaruar afati dhe subjekti nuk ka aplikuar për shtyrjen e saj. 3. Subjekti i është dërguar njoftim nga AKBN të sjellë planin e mbylljes dhe rehabilitimit të mjedisit, ndërsa në RevZone: “*Subjekti ka bere kërkesë në MEI për rikthim në afat të lejes minerare.*”

Për lejet minerare të “G...” SHPK me nr.10..., nr. 10..., nr.10..., nr. 13... dhe nr.14..., në vitin 2018 është cilësuar se, *nuk zhvillojnë aktivitet minerar në shkëlqje të ligjit 10304, datë 15.07.2010, i ndryshuar, pasi edhe për këto subjekte është kërkuar në MIE informacion për statusin e tyre me shkresë të AKBN-së nr. 9710 prot., datë 07.11.2016 dhe ende nuk ka një përgjigje, pasi subjektet janë propozuar për revokim nga ana tyre.*” Në të gjitha vitet 2018,

2019, 2020, 2021 dhe 2022 është cilësuar: “Ky subjekt i ka marrë lejet minerare me marrëveshje koncesionare për ndërtimin e fabrikës së çimentos por ende nuk ka filluar nga puna”.

Për subjektin “S. G.” SHPK, në 2018 nuk është punuar për mungesë tregu; në 2019 nuk kanë filluar asnjëherë nga puna dhe ka mbaruar afati 10 vjeçar i tyre dhe subjektet nuk kanë aplikuar për shtyrjen e lejes minerare; për vitin 2020 nuk është punuar dhe nuk është miratuar plani vjetor; për 2021 në karrierë nuk është ushtruar aktivitetet minerar, subjekti nuk ka miratuar planin vjetor të punës për vitin 2021-2022 dhe i lihet detyrë “Subjekti të sjellë relacion shpjegues në AKBN për shkaqet e ndërprerjes së punës.” dhe në 2022 nuk kanë punuar fare, meqenëse lejet minerare të shfrytëzimit janë marrë për fabrika çimentoje.

Për subjektin “Rr. U. A. Nr.... E. SHA”, në vitin 2018 është cilësuar: “Ky subjekt është në proces revokimi me shkresë MIE Nr.8112.Prot, Dt.15.12.2015”; për vitin 2019 ka refuzim të miratimit të planit; për vitin 2020 Subjekti ka pezullim të aktivitetit minerar me nr.2073/2 prot., datë 22.09.2020.; për vitet 2021 dhe 2022 cilësohet se në karrierë është punuar pak

Për subjektin “C. M.” SHPK për vitin 2018 në objekt nuk punohet, pasi është në proces revokimi nga MIE për arsye mos pagesës të garancisë së rehabilitimit me nr. 3729/1 datë 25.07.2018; në 2019 në objekt punohet; në 2020 në procesverbalin e datës 08.09.2020, cilësohet i është miratuar pezullimi i përkohshëm; njëjtoj vijohet dhe për vitin 2021 dhe 2022; Për subjektin “J.” SHPK për vitin 2018 cilësohet se në objekt nuk punohet për arsye tregu; për vitin 2019, në objekt nuk punohet. Subjekti ka Akt-pezullimi të përkohshëm nga MIE me nr. 4929/3 prot., date 06.10.2016; njëjtoj dhe për vitin 2020; në objekt nuk punohet pasi subjekti ka bërë kërkesë për në MIE për zgjerim koordinatash në veri të lejes minerare me nr. 7... prot., datë 14.11.2018 dhe nr. 1... prot., datë 07/02/2021; subjekti ka pezullim të përkohshëm të aktivitetit minerar të miratuar nga MIE me shkresën me nr.967/3 prot., datë18.03.2022.

Për subjektin “G.” SHPK në vitin 2018 në objekt nuk punohet; në 2019 dhe 2020 subjekti ka marrë nga MIE pezullim të përkohshëm të aktivitetit minerar me shkresën nr. 7473 prot., datë 31.12.2015; Në 2021 dhe 2022 në objekt punohet.

Për subjektin “O. M” SHPK, në vitin 2018 në momentin e kontrollit në objekt nuk punohej, si dhe është shpallur zonë e mbrojtur për liqenin e Pogradecit; në 2019 punohej; në 2020 bazuar në Ligjin Nr. 10304, dt.15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 4, pika 1, germa f, Leja Minerare 15..., dt. 24.12.2010 propozohet për Masë Administrative “Revokim” shkresa nr.3122 prot., datë15.07.2020; e njëjta gjë në 2021 me shkresën Nr.1659 prot., dt.22.04.2021; e njëjta gjë dhe në vitin 2022 shkresa me Nr.1929 prot., dt.27.04.2022.

- Përfitim i pjesës takuese të rentës minerare nga ana e organeve të vetëqeverisjes vendore:

Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në rastin kur ai shet produkte minerare. Në rastin e eksportit të produkteve minerare, renta paguhet në çastin e bërjes së deklaratës së eksportit. Referuar legjislacionit në fuqi, një pjesë e caktuar në % e të ardhurave nga renta minerare i kalojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën e përgjithshme të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës, sipas përcaktimeve të shtojcës, që i bashkëlidhet ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare" i ndryshuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me identifikimin e rentës minerare të evidentuar dhe raportuar nga çdo zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit (referuar sistemit zyrtar të raportimit Rev Zonë në AKBN) dhe fondeve të grumbulluara dhe të shpërndara nga Ministria e Financave në bazë të projekteve të paraqitura në përgjithësi dhe në veçanti për periudhën objekt auditimi, u kryen verifikime me zgjedhje dhe nga informacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH nga **Bashkia Bulqizë**, rezulton se:

- 1. Për periudhën 2018-2022, nga 142 zotërues të lejes minerare që ushtrorjnë aktivitetet minerar në këtë zone, rezulton se **në 65 raste, nuk është kryer asnjë pagesë e rentës minerare, dhe për pasojë nuk është përfituar nga ana e pushtetit vendor Bashkia Bulqizë, pjesa takuese e kësaj rente. Kjo situatë është e lidhur me lejet minerare me nr. 2...**

4..., 46..., 47..., 47..., 47..., 47..., 49..., 50..., 53..., 54..., 54..., 57..., 58..., 78..., 8..., 8..., 88..., 88..., 89..., 93..., 9..., 9..., 10..., 10..., 10..., 10..., 11..., 11..., etj.

• 2. U kryen testimet e kampionit me **20 subjekte** zotëruese të lejes minerare të shfrytëzimit, që sipas të dhënave që administrohen nga ana e kësaj njësie të qeverisjes vendore, janë raportuar me zero lekë taksë të rentës minerare dhe rezultoi se në **11 prej tyre**, ose në **55 %** të kampionit të analizuar nga grupi i auditimit, për të cilat Bashkia Bulqizë nuk ka përfituar rentë minerare, Nga kryqëzimi i të dhënave me ato të sistemit të raportimit RevZonë të AKBN, këto subjekte evidentohet se kanë paguar rentën minerare, gjë që tregon se organi i vetëqeverisjes vendore nuk ka përfituar pjesën përkatëse të rentë minerare, në nivelin prej 5 % të shumës së derdhur pranë organit tatimor dhe doganor, të njohur si agjentë tatimorë për rentën minerare.

Më konkretisht,

✓ Për subjektin "**T. SHPK**", zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr.4..., për periudhën objekt auditimi (2018-2022), Bashkia Bulqizë ka përfituar zero lekë rentë minerare, bazuar në rakordimet apo shkëmbimet e informacionit me organet tatimore e doganore, *kur në fakt*, sipas të dhënave në sistemin zyrtar të raportimit të AKBN (Revzonë), rezulton se renta minerare për vitin 2018 është 1,776,361 lekë, për vitin 2019 4,324,282 lekë, për vitin 2020 ,2021 dhe 2022 për 0 lekë.

✓ Për subjektin "**K. SHPK**", zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr. 4..., për periudhën objekt auditimi (2018-2022), Bashkia Bulqizë ka përfituar zero lekë rentë minerare, bazuar në rakordimet apo shkëmbimet e informacionit me organet tatimore e doganore, *kur në fakt*, sipas të dhënave në sistemin zyrtar të raportimit të AKBN (Revzonë), rezulton se renta minerare për vitin 2018 është 2,020,978 lekë, për vitin 2019 është 0 lekë, për vitin 2020 është 1,260,755 lekë, dhe në 2021 e 2022, zero lekë.

✓ Për subjektin "**B. SHPK**", zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr. 4..., për periudhën objekt auditimi (2018-2022), Bashkia Bulqizë ka përfituar zero lekë rentë minerare, bazuar në rakordimet apo shkëmbimet e informacionit me organet tatimore e doganore, *kur në fakt*, sipas të dhënave në sistemin zyrtar të raportimit të AKBN (Revzonë), rezulton se renta minerare për vitin 2018 është 1,637,225 lekë, për vitin 2019, 0 lekë, për vitin 2020 për 505,633 lekë kurse në v.2021dhe 2022, zero lekë.

✓ Për subjektin "**B. SHPK**", zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr. 4..., për periudhën objekt auditimi (2018-2022), Bashkia Bulqizë ka përfituar zero lekë rentë minerare, bazuar në rakordimet apo shkëmbimet e informacionit me organet tatimore e doganore, *kur në fakt*, sipas të dhënave në sistemin zyrtar të raportimit të AKBN (Revzonë), rezulton se renta minerare për vitin 2018 është 20,109,929 lekë.

✓ Për subjektin "**D. SHPK**", zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr. 4..., për periudhën objekt auditimi (2018-2022), Bashkia Bulqizë ka përfituar zero lekë rentë minerare, bazuar në rakordimet apo shkëmbimet e informacionit me organet tatimore e doganore, *kur në fakt*, sipas të dhënave në sistemin zyrtar të raportimit të AKBN (Revzonë), rezulton se renta minerare për vitin 2018 është 772,329 lekë, për vitin 2019: 0 lekë, për vitin 2020: 0 , v.2021: 3,908,154 lekë dhe për vitin 2022: 2,764 mijë lekë.

✓ Për subjektin "**Z. SHPK**", zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr.4..., për periudhën objekt auditimi (2018-2022), Bashkia Bulqizë ka përfituar vetëm shumën 74,983 lekë rentë minerare (vetëm për pjesën takuese të vitit 2020), bazuar në rakordimet apo shkëmbimet e informacionit me organet tatimore e doganore, *kur në fakt*, sipas të dhënave në sistemin zyrtar të raportimit të AKBN (Revzonë), rezulton se renta minerare për vitin 2018 është 911,916 lekë, për vitin 2019: 824,878 lekë, për vitin 2020: 761,000 lekë , v.2021: 393,500 lekë dhe për vitin 2022: 8,148 mijë lekë.

✓ Për subjektin "**D. SHPK**", zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr.5..., për periudhën objekt auditimi (2018-2022), Bashkia Bulqizë ka përfituar zero lekë rentë minerare, bazuar në rakordimet apo shkëmbimet e informacionit me organet tatimore e doganore, *kur në fakt*, sipas të dhënave në sistemin zyrtar të raportimit të AKBN (Revzonë), rezulton se renta minerare për vitin 2020 është 339,060 lekë.

✓ Për subjektin "**Sh. SHPK**", zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr. 5..., për periudhën objekt auditimi (2018-2022), Bashkia Bulqizë ka përfituar zero lekë rentë minerare, bazuar në rakordimet apo shkëmbimet e informacionit me organet tatimore e doganore, kur në fakt, sipas të dhënave në sistemin zyrtar të raportimit të AKBN (Revzonë), rezulton se renta minerare për vitin 2019 ka 564,404 lekë dhe për vitin 2020 451,087 lekë.

✓ Për subjektin "**3...1... SHPK**", zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr. 5..., për periudhën objekt auditimi (2018-2022), Bashkia Bulqizë ka përfituar zero lekë rentë minerare, bazuar në rakordimet apo shkëmbimet e informacionit me organet tatimore e doganore, kur në fakt, sipas të dhënave në sistemin zyrtar të raportimit të AKBN (Revzonë), rezulton se renta minerare për vitin 2018 është 1,103,436 lekë.

✓ Për subjektin "**F. P. K. B SHPK**", zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr. 8..., për periudhën objekt auditimi (2018-2022), Bashkia Bulqizë ka përfituar zero lekë rentë minerare, bazuar në rakordimet apo shkëmbimet e informacionit me organet tatimore e doganore, kur në fakt, sipas të dhënave në sistemin zyrtar të raportimit të AKBN (Revzonë), rezulton se renta minerare për vitin 2018 është 0 lekë, për vitin 2019: 324,624 lekë, për vitin 2020: 0 , për v.2021, 373,514 lekë.

✓ Për subjektin "**K. SHPK**", zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr. 10..., për periudhën objekt auditimi (2018-2022), Bashkia Bulqizë ka përfituar zero lekë rentë minerare, bazuar në rakordimet apo shkëmbimet e informacionit me organet tatimore e doganore, kur në fakt, sipas të dhënave në sistemin zyrtar të raportimit të AKBN (Revzonë), rezulton se renta minerare për vitin 2018 është 3,555,111 lekë, etj.

✓ Për subjektin "**H. Ch. SHPK**", zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr.4..., për periudhën objekt auditimi (2018-2022), Bashkia Bulqizë ka përfituar shumë prej 33,805 lekë rentë minerare për v.2023, bazuar në rakordimet apo shkëmbimet e informacionit me organet tatimore e doganore, kur në fakt, sipas të dhënave në sistemin zyrtar të raportimit të AKBN (Revzonë), rezulton se renta minerare për vitin 2018 – 2022 është zero lekë.

Konstatimet:

Nuk ka një përputhje të dhënave të rezultuar nga një proces rakordimi mujor nga ana e organeve të qeverisjes vendore me qëllim rakordimin me drejtoritë rajonale të tatimeve dhe degët e doganave për rentën minerare të mbledhur prej tyre, e cila ka sjellë si pasojë që pushtetit vendor të mos i kalohet saktësisht pjesa e rentës minerare, llogaritur si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria, pasi destinacioni i pjesës së të ardhurat nga renta minerare është të përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.

Kriteri: Pika nr. 4 e nenit 4 "*Niveli i taksave kombëtare*", të Ligjit Nr.9975, datë 28.7.2008 "*Për taksat kombëtare*" i ndryshuar:

"Taksa e rentës minerare caktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit metalor në nënproduktin minerar është në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 në masën 0% për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri në fund të vitit 2023 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2024 e në vijim së përcaktuar në shtojcën nr. 2, "Grupi i parë (I) Minalet metalike" që i bashkëlidhet këtij ligji.

Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.

Në rastin kur taksa e rentës minerare aplikohet në përqindje, kjo taksë llogaritet duke shumëzuar vlerën e shitjes së produktit (pa TVSH) me përqindjen e rentës. Kur taksa e rentës minerare aplikohet në vlerë fikse për njësi, shuma e rentës minerare llogaritet duke

shumëzuar sasi të e shitjes së produktit me vlerën e rentës minerare. Në rastin e shitjes së mineralit të grupit të parë (I), “Mineralet metalike”, për përpunim brenda vendit, nga nxjerrësi të përpunuesi, përqindja e rentës aplikohet në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 në masën 0% për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri në fund të vitit 2023 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2024 e në vijim së përcaktuar në shtojcën nr. 2, mbi vlerën (çmimin) e shitjes, e cila, për efekt të përlllogaritjes së rentës minerare, nuk mund të jetë më e vogël se çmimi i shitjes për eksport të mineralit të papërpunuar.

Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. Masa e rentës minerare, e përcaktuar në ligjin mineralar, ndryshon sipas paragrafëve të parë dhe të dytë, të pikës 4, të nenit 4, të këtij ligji. Përcaktimi i vlerës së rentës së pasurisë minerare, për të gjitha mineralet, sipas përcaktimeve të ligjit, kryhet në përputhje me përcaktimet e bëra në shtojcën nr. 2, që I bashkëlidhet këtij ligji.”

dhe pika nr. 2.5 “Taksa e rentës minerare”, të Udhëzimit Nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, të Ministrisë së Financave, që shprehimisht përcakton se:

“2.5.3. Njësitë e qeverisjes vendore ku subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit zhvillon aktivitetin mineralar, brenda datës 30 të çdo muaji, sipas formularit nr. 8 bashkëlidhur si pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, bëjnë rakordimin me drejtoritë rajonale të tatimeve dhe degët e doganave për rentën minerare të mbledhur prej tyre.

Një kopje të rakordimit, njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 5 të muajit pasardhës, e dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave.

2.5.4. Drejtoritë rajonale tatimore dhe degët doganore të cilat janë agjentë tatimorë, brenda datës 30 të çdo muaji dërgojnë informacion analitik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave, për vlerën e rentës minerare të mbledhur, subjektin tatimor dhe njësitë e qeverisjes vendore ku kryhet aktiviteti, sipas formularit nr.9 bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij.”.

- Auditimi i detyrimeve të subjekteve që u është revokuar leja minerare e shfrytëzimit nga ana e MIE:

U audituan detyrimet e prapambetura të subjekteve që kanë qenë zotërues të lejeve minerare dhe referuar të dhënave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH-së, për periudhën 2018-2022.

Konstatime:

Ekziston një nivel i lartë i detyrimeve për garanci rehabilitimi sipas lejes, të papaguara deri në datën e kryerjes së auditimit, nga 72 subjekte që kanë qenë zotërues të lejeve minerare dhe që u është revokuar leja, por që rezultojnë me detyrime të papaguara për garanci rehabilitimi gjatë kohës që këto leje kanë qenë efektive, detyrim i cili për periudhën e audituar është në vlerën prej 21,999,067 lekë.

Analizuar sipas viteve, paraqiten këto detyrime të subjekteve që u është revokuar leja minerare e shfrytëzimit, si vijon.

Tabela nr.14 Detyrime të subjekteve që u është revokuar leja minerare e shfrytëzimit

Viti	Nr. subjekteve revokuar leja minerare dhe rezultojnë me detyrime të papaguara të garancisë rehabilitimit	Vlera e detyrimeve ndaj shtetit nga ana e ZKLM që u është revokuar leja minerare (në lekë)
2018	37	13,439,931
2019	18	5,200,026
2020	2	239,677
2021	8	2,401,655
2021	7	717,778

Gjithsej	72	21,999,067
----------	----	------------

Burimi: Të dhëna të AKBN të përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Shuma prej 21,999,067 lekë është shkelje e disiplinës financiare, si të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit dhe me pasoja në sigurimin e fondeve për rehabilitimin e mjedisit, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Audituesit e KLSH konstatojnë se në raste të veçanta, ZLM kanë patur periudha të gjata kohore (deri në 3 vite) pa kryer pagesat dhe nuk janë iniciuar nga ana e strukturës përgjegjëse, veprimet sipas përcaktimeve ligjore për revokimin e lejes minerare. Madje, për ZLM, subjekti "A." SHPK me leje minerare me nr. 12..., konstatohet se nuk janë kryer pagesat e fondeve për garancinë e rehabilitimit për një periudhë 6-vjeçare (2013-2018), duke krijuar detyrime në kundërshtim me kriteret e lejes në shumën e përgjithshme prej **2,322,301 lekë**, nga e cila, 1,088,380 lekë për periudhën 2013-2014 dhe shuma 1,233,301 lekë si detyrime të periudhës 2015-2018.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i praktikave shpresore të vëna në dispozicion, del se nga ana e AKBN është hartuar raport-propozimi me Nr.2605 Prot., dt. 08.04.2019 dhe nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit është bërë me shkresën Nr.4039/2 prot., datë 18.09.2019.

Situata të tilla të mosshlyerjes për disa vite të detyrimeve nga ana e subjekteve zotërues të lejeve minerare dhe e mosveprimeve nga ana e strukturës përgjegjëse AKBN, janë edhe këto të evidentuar në vijim.

Tabela nr.15 Detyrime të papaguara të garancisë financiare të rehabilitimit

Subjekti zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit	Leja minerar e nr.	Vlera e detyrimeve të papaguara të garancisë financiare të rehabilitimit (në lekë)	Periudha kur nuk janë paguar garancitë	Vendimi i revokimit të LM nga MIE (nr & data)
A. SHPK	64...	2,287,688	2015-2017	Nr.3477/1, 08.06.2018
A. SHPK	12...	2,322,301	2013-2014, 2015-2018	Nr.4039/2, 18.09.2019
A. M	16...	1,700,000	2019-2020	Nr.2062/2, 06.01.2022
A. N. Ch SHPK	17...	1,098,531	2018	Nr.10327/2, 19.12.2018
I. E SHPK	14...	969,690	2013-2016	Nr.10266, 24.07.2018
B. K SHPK	15...	766,930	2015-2017	Nr.701/2, 19.12.2018
T. I. KSHPK	11...	722,216	2014-2017	Nr. 8346, 07.06.2018
F. SHPK	12...	431,310	2013-2017	Nr. 10252, 24.07.2018
A. R. SSHPK	16...	349,000	2016-2017	Nr.703/2, 19.12.2018

Burimi: Të dhëna të AKBN të përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar:

▪ **Neni 2, pika 34:** "Garanci financiare për rehabilitimin e mjedisit" është vlera monetare që depozitohet çdo vit, në formën e një garancie bankare në favor të shtetit, në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri, që përdoret për realizimin e planit të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

▪ **Neni 31 "Garancitë financiare për zhvillimin e veprimtarive minerare", pika 1:** Garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit përllogaritet në vlerë monetare dhe përdoret nga zotëruesi i lejes ose shteti për realizimin e planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligji. **Garancia financiare depozitohet pas marrjes së lejes minerare çdo vit, në datën efektive të marrjes së lejes dhe vlera vjetore**

përcaktohet në bazë të vlerës së përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e planit për rehabilitimin e mjedisit, të miratuar nga ministri, të viteve të jetëgjatësisë së lejes minerare dhe të sasisë së mineralit të programuar për t'u shfrytëzuar çdo vit, sipas planit vjetor të veprimtarisë minerare. Vlera totale e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe realizimin e planit të aktiviteteve për mbylljen e veprimtarisë minerare vlerësohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga ministri. Ajo përfshin garancinë financiare për mbylljen e veprimtarisë minerare, mbylljen e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit.

▪ **Neni 36 “Detyrimet e përgjithshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerar”:** “Përveç sa parashikohet në këtë ligj, për çdo tip lejeje minerare, zotëruesi i saj, gjatë periudhës së vlefshmërisë, ka edhe këto detyrime: 1. Të paraqesë në çdo vit të vlefshmërisë së lejes dhe brenda datës së vitit vazhdues, që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes, dokumentin e garancisë financiare, për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare.

▪ **Neni 49, “Detyrimet e zotëruesit pas revokimit të lejes”:** 1. Pas revokimit të lejes, sipas nenit 48 të këtij ligji, zotëruesi i lejes detyrohet të zbatojë planin e rehabilitimit. 2. Zbatimi i sanksioneve administrative të pezullimit apo revokimit të lejes nuk e liron zotëruesin nga detyrimet e këtij ligji dhe nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar, sipas legjislacionit në fuqi. 3. Kur revokohet leja minerare, sipas parashikimeve të këtij ligji, ministri ndjek pa kufizim çdo të drejtë ligjore dhe ndërmerr çdo veprim ligjor, për të vjelë dëmshpërblimin përkatës për dëmet shkaktuar shtetit nga shkëljet e zotëruesit të lejes minerare.”

- Analizë e procedurave të veçanta të ndjekur nga ana e AKBN dhe MIE mbi revokimin e Lejeve Minerare të Shfrytëzimit, të lidhura me heqjen e lejeve mjedisore.

SUBJEKTI “Q.”: Ky subjekt ka zotëruar dy leje minerare të shfrytëzimit: nr. 12..., datë 18.12.2008 dhe nr. 10..., datë 11.05.2017 për jometalorë, gëlqeror pllakor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ka rezultuar si më poshtë vijon:

I. Në lidhje me lejen minerare me nr.12..., datë 18.12.2008, subjekti ka paraqitur kërkesë për mos rinovim leje minerare, dhe për këtë është mbledhur Komisioni i Shqyrtimit të Planeve vjetore, me datën 06.12.2017, i cili ka vendosur mbajtjen e dosjes pezull për një periudhë 30 ditore, dhe ka kërkuar që subjekti të paguajë detyrimet e prapambetura të garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për periudhën tre vjeçare, (2015, 2016, 2017).

Më konkretisht:

• Subjekti “Q.”, zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit me nr. **12..., datë 18.12.2008**, i është drejtuar AKBN sipas shkresës me nr. 21, datë 16.11.2017 (prot AKBN me nr. 3172/1 datë 16.11.2017), me kërkesën për mos rinovim të lejes minerare. Një kërkesë të tillë subjekti ia ka dërguar dhe ministrisë përgjegjëse MEI-t, me shkresën nr. 19, datë 13.4.2017 (protokolluar në MEI me nr. 2280 datë 13.4.2017). Kjo ministri ka miratuar më parë, me shkresën nr. 6169/1 datë 22.09.2015, kërkesën e ZLM “Q.” për pezullimin e përkohshëm të aktivitetit.

Lidhur me trajtimin e kërkesë për mosrinovim leje minerare, është mbledhur komisioni i shqyrtimit të planeve vjetore, me datën 06.12.2017, me përbërje: Kryetar A. A., dhe anëtarë K. S., E. M., M. Rr. Sh. M., E. E., E. M. , E. ZH., dhe sekretar R. B. Nga shqyrtimi pjesës konstatuese të procesverbalit të mbajtur, Komisioni ka vërejtur se “Me shkresën nr. 6169/2 prot, datë 22.09.2015 subjekti ka miratim nga MEI për pezullim të përkohshëm të veprimtarisë minerare. **Kjo dosje do të rrijë pezull.** Subjekti, 30 ditë para fillimit të veprimtarisë minerare duhet t'i drejtohet këtij komisioni për miratimin e planit vjetor të punës, duke plotësuar dokumentacionin teknik dhe juridik. **Subjekti duhet të bëjë pagesat për garancinë e rehabilitimit për vitet 2015, 2016 dhe 2017.**”

Konstatime:

A. Nuk ka asnjë dokument të administruar në dosje dhe asnjë deklaram në sistemin rev-zonë nga ana e këtij subjekti që të konfirmojë kryerjen pagesën e garancisë së rehabilitimit deri në datën e kryerjes së auditimit.

B. Mungojnë veprimet e strukturës përgjegjëse pas revokimit të lejes minerare, për të kërkuar shlyerjen e detyrimeve financiare të garancisë së rehabilitimit, për të cilat administratori i subjektit ka nënshkruar procesverbalin e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit.

C. Në mbledhjen e Komisionit të zhvilluar me dt. 06.12.2017 ka munguar drejtuesi teknik në kundërshtim me parashikimet e Nenit 6, pika 2, të Udhëzimit nr.19, dt.23.01.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planit vjetor të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit”, të AKBN, ku përcaktohet se subjekti në çdo rast përfaqësohet nga drejtuesi teknik, ndërsa procesverbali është nënshkruar nga administratori N. Q.

D. Subjektit i është revokuar leja minerare me shkesën e MIE me nr. 9105/3 prot, datë 19.12.2019, për shkelje të nenit 47,germa ç, të ligjit minerar që cilëson se: “ç) zotëruesi i lejes minerare, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e çdo viti në vazhdim, që i korrespondon datës së hyrjes në fuqi të lejes, nuk paraqet dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të planit të rehabilitimit, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të programit minimal të punës, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të investimit”.

Procesi i revokimit është iniciuar sipas raport propozimit të AKBN me nr. 9727 prot., date 09.11.2016, fillimi i procedurave të revokimit nga ana e MIE i është njoftuar ZLM me shkesën nr.729/1 prot., date 15.01.2018 dhe revokimi i lejes minerare është bërë nga MIE me shkesën nr.4905/1 prot., datë 28.05.2018.

Sa më sipër, në lidhje me mos shlyerjen e detyrimeve të Lejes Minerare të Shfrytëzimit me nr. **12...., datë 18.12.2008**, është vepruar në kundërshtim me:

Ligjin Nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

Neni 2, pika 34. “Garanci financiare për rehabilitimin e mjedisit” është vlera monetare që depozitohet **çdo vit**, në formën e një garancie bankare në favor të shtetit, në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri, që përdoret për realizimin e planit të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 31 “Garancitë financiare për zhvillimin e veprimtarive minerare”, pika 1:

Garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit përllëgohet në vlerë monetare dhe përdoret nga zotëruesi i lejes ose shteti për realizimin e planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligji. **Garancia financiare depozitohet pas marrjes së lejes minerare çdo vit, në datën efektive të marrjes së lejes** dhe vlera vjetore përcaktohet në bazë të vlerës së përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e planit për rehabilitimin e mjedisit, të miratuar nga ministri, të viteve të jetëgjatësisë së lejes minerare dhe të sasisë së mineralit të programuar për t'u shfrytëzuar çdo vit, sipas planit vjetor të veprimtarisë minerare. Vlera totale e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe realizimin e planit të aktiviteteve për mbylljen e veprimtarisë minerare vlerësohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga ministri. Ajo përfshin garancinë financiare për mbylljen e veprimtarisë minerare, mbylljen e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit.

Neni 36 “Detyrimet e përgjithshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerare”: “Përveç sa parashikohet në këtë ligj, për çdo tip lejeje minerare, zotëruesi i saj, gjatë periudhës së vlefshmërisë, ka edhe këto detyrime: 1. Të paraqesë në çdo vit të vlefshmërisë së lejes dhe brenda datës së vitit vazhdues, që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes, dokumentin e garancisë financiare, për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare.

Neni 47 “Revokimi i lejes”, pika 1: Leja revokohet kur: ç) zotëruesi i lejes minerare, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e çdo viti në vazhdim, që i korrespondon datës së hyrjes në fuqi të lejes, nuk paraqet dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të planit të rehabilitimit, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të programit minimal të punës, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të investimit;

Pikën nr. 2 dhe 3, të Udhëzimit nr. 201 datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore e vjetore përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit në karriera për grupin e mineraleve jometalore” të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Aneksi 4 “Formati i tabelës informuese

vjetore”, ku në nr. rendor 7, kërkon të dhëna mbi parashikimin dhe realizimin e vlerës në lekë dhe në % të garancisë së rehabilitimit, si dhe tek tabelat e planit, tabela nr. 1 “Formati i tabelës së planit vjetor mineral”, rreshti me nr. 7, “Garancia e rehabilitimit” e detajuar sipas tremujoreve dhe gjithsej vjetor.:

Nenin 6, “*Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komision*”, pika 5 të Udhëzimit nr.19, dt.23.01.2018 “*Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planit vjetor të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit*”, të AKBN, ku përcaktohet se: subjekti i cili gjatë shqyrtimit të dosjes së planeve rezultojnë mangësi dhe të meta i caktohet një afat jo më shumë se 10 ditë para mbarimit të datës, që i korrespondon kthimit të përgjigjes. Dhe se subjekti duhet të paraqesë në komision sipas aftit të caktuar dokumentacionin e plotësuar ose të rregulluar., në të kundërt, “ndaj subjektit që zotëron leje minerare të shfrytëzimit në bazë të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2021, **merret vendimi për mosmiratim të planit vjetor të ushtrimit të aktivitetit**. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës”.

II. Po ky subjekt, ka zotëruar lejen minerare të shfrytëzimit me **nr. 10..., datë 11.05.2007** për jometalorë, gëlqeror pllakor.(sipas lejes minerare), rinovuar me **nr. 10..., datë 08.08.2017**.

- Subjekti zotëruar i lejes minerare, ka paraqitur kërkesën në AKBN me nr. 03, datë 10.04.2018 “Për rinovim të lejes minerare me nr. 10..., datë 11.05.2007, (për të cilën është dhënë miratim nga ana e MEI-t me akt miratimin nr. 10..., datë 08.08.2017). Bashkëlidhur janë tre polica sigurimi , pagesa e garancisë së rehabilitimit të mjedisit për v.2018, për vlerën 82,822 lekë, (mandat arkëtimi në R. B., datë 04.05.2018).
- Nga ana e Inspektorëve të Drejtorisë së Policisë Pyjore Berat është mbajtur procesverbali me nr. 0009261, datë 21.11.2017 ku nëpërmjet tij i është vendosur “pezullimi i menjëhershëm i punimeve të subjektit “ Q.” SHPK. Sa më sipër, nga ana e ZLM, si palë paditëse është paditur ISHMP dega Berat dhe ISHMPU Tiranë. Në përfundim, me **vendimin nr. 361, datë 20.3.2018, (nr. 674 akti)**, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë **është ligjëruar masa e sigurimit të padisë** si dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative procesverbal inspektimi, duke shfuqizuar dhe aktin administrativ / vendimin e ISHMP Tirane me nr. 11, dt 20.11.2017 për kundërvajtje administrative, nxjerrë mbi bazën e procesverbalit. Subjekti ka paraqitur me datën 25.7.2018, një vërtetim të lëshuar nga ana e kancelarit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë datë 24.7.2018, (protokolluar në AKBN me nr. 3883/3, dt. 25.7.2018, mbi regjistrimin pranë Gjykatës Administrative të Apelit, të padisë së subjektit “Q.” ndaj ISHMP Dega Rajonale Berat dhe ISHMPU Tiranë.
- Gjithashtu, në lidhje me urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit me **nr. 159, datë 07.05.2018** “Për shfuqizimin/ revokimin e lejes mjedisore me nr. Serie PN-5910-7-2013, që i përket shoqërisë “Q.” SHPK me NIPT K6....., nga ana e subjektit është kërkuar marrja e sigurimit të padisë si dhe shfuqizimi i këtij akti administrativ, krahas shpërblimit të dëmit të përbërë nga humbja e paguar dhe fitimi i munguar, sipas aktit të ekspertimit përkatës. Sa sipër, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, ka lëshuar vendimin “Për sigurim objekt padie”, me nr. Ska, datë 26.06.2018 dhe nr. 1313 akti datë 18.06.2018. Ky **vendim për sigurimin e padisë i është lajmëruar për ekzekutim nga shoqëria përmbartimore “ZIKE”** sipas shkresës me nr. 450/1 prot dhe 462 regj, datë 03.07.2018: Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ISHMPU, etj. Gjithashtu, me shkresën nr. 16, datë 10.07.2018 masa për sigurimin e padisë i është bërë me dijeni edhe AKBN-se (protokolluar këtu me nr. 3882/2 datë 11.07.2018).
- Mbi këtë bazë, është përgatitur një informacion sipas shkresës me nr 3882/4, datë 27.7.2018 nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore në AKBN, A. B., “Mbi vendimin nr. 361, datë 20.3.2018, vendimin nr. 06, datë 28.05.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në funksion të miratimit të programit vjetor për subjektin Q. SHPK”. DSHL është shprehur se “sipas vërtetimit të lëshuar nga GJ.A Apelit Tirane, protokolluar në AKBN me nr. 3882/3 datë 25.7.2018, çështja rezulton

të jetë në proces gjykimi në Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Bazuar në nenin 210, të ligjit 8116, dt. 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile”, **“Ankimi kundër vendimit që lejon masën e sigurimit nuk pezullon ekzekutimin e tij”**.

- Sipas shkresës së Drejtorisë Minerare nr. 3882/5, datë 06.08.2018 nënshkruar nga Zv/Drejtori Ekzekutiv I. B., është miratuar programi vjetor për subjektin “Q.” SHPK periudhën 1.8.2018-11.5.2019.
- Në lidhje me këtë çështje, AKBN i është drejtuar edhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën e protokolluar në këtë ministri me nr. 12151, datë 28.9.2018 dhe sipas përgjigjes së dërguar me nr. 12151/1, datë 16.10.2018, nënshkruar nga ana e ish-Sekretarit të Përgjithshëm G. K., thuhet se *“Subjekti “Q.” është konform çdo norme ligjore për ushtrimin e aktivitetit minerar dhe nuk mund të pengohet të kryejë çdo detyrim ligjor që lidhet me lejen minerare”*.
- Ky subjekt, me shkresën nr. 9105/1 datë 29.10.2019 “Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr. 10..., datë 08.08.2017”, nënshkruar nga zv/ministrit I. B., për arsye se nga ana e subjektit
 - *Nuk është zhvilluar aktivitet minerar në zonën për të cilën është dhënë leja minerare në përputhje me projektin teknik të miratuar për këtë objekt, si dhe*
 - *Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është revokuar leja mjedisore për këtë objekt, me urdhrin nr.159, datë 07.05.2018.*
- Njoftimi për vendimin e revokimit i është njoftuar shoqërisë “Q.” SHPK si dhe për dijeni Qendrës Kombëtare të Biznesit, AKBN dhe AKSEM me shkresën nr. 9105/4 datë 19.12.2019 “Njoftim për vendimin e revokimit të lejes nr. 10..., datë 08.08.2017”, nënshkruar nga zv/ministrit I. B., bazuar në propozimin e dërguar nga AKBN si dhe për arsye se nga ana e subjektit:
 - *Nuk është zhvilluar aktivitet minerar në zonën për të cilën është dhënë leja minerare në përputhje me projektin teknik të miratuar për këtë objekt, si dhe*
 - *Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është revokuar leja mjedisore për këtë objekt, me urdhrin nr.159, datë 07.05.2018.*
- *Për sa më sipër, nga ana e subjektit “Q.” SHPK është ngritur kërkesë padi për shfuqizimin e aktit administrativ nr. 9105/5 prot, datë 19.12.2019 të MIE si dhe zgjidhjen e pasojës për ushtrimin e aktivitetit minerar. Gjykatës Administrative e Shkallës së parë ka vendosur pranimin e kërkesë padisë me vendimin nr. 300, datë 07.04.2021. Gjithashtu ,ka vendim të ndërmjetëm për sigurimin e objektit të padisë datë 19.02.2020. Nga ana e DSHL të AKBN është bërë ankim kundër vendimit me nr. 1754/2 datë 12.05.2021 në Gjykatën Administrative të Apelit.*

Konstatime:

✓ Me datën 27.4.2018 nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit në AKBN përbërë nga M. Rr.-Kryetar, E. M., E. B., B. C., Sh. M., A. H., R. B., P. H., dhe G. T.-anëtarë dhe A. H.-sekretar, është mbajtur procesverbali për miratimin e planit, ku në faqen e parë të tij është vënë shënimi që “Për materialin gjendje të bëjë shitje”.

✓ Në mbledhjen e Komisionit të zhvilluar me dt 27.4.2018 ka munguar drejtuesi teknik, veprim në kundërshtim me parashikimet e Nenit 6, pika 2, të Udhëzimit nr.19, dt.23.01.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planit vjetor të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit”, i ndryshuar, të AKBN, ku përcaktohet se subjekti në çdo rast përfaqësohet nga drejtuesi teknik. Audituesit e autorizuar të KLSH konstatojnë se dhe për administratorin N. Q., ka një nënshkrim të një personi, tjetër, por që nuk është identifikuar se cili ka nënshkruar për administratorin.

✓ Subjektiit për periudhën 2018-2019 nuk i është miratuar plani vjetor për prodhimin dhe shfrytëzimin e mineraleve jometalor (të llojit gëlqeror pllakor), në përputhje me detyrimet e parashikuara në lejen minerare të miratuar nga ana e Ministrit, por vetëm për shitje të stokut të mineralit jometalor gjendje, ndërkohë që detyrimet për prodhim sipas pikës nr. 7, germa c, të lejes minerare të shfrytëzimit, përcaktojnë se prodhimi mineralit në vit duhet të jetë 3,600

m3/vit dhe fuqia punëtore për realizimin e projektit do të jetë 15 punonjës. Në fakt, sigurimi i jetës është kryer vetëm për 3 punonjës pranë sha "I." për përudhen 9.5.2018-8.5.2019.

✓ *Nga ana e subjektit zotërues i lejes minerare nuk janë ngarkuar në sistemin rev-zonë raportimet mbi sasinë e prodhimit, rentën, garancitë financiare të rehabilitimit etj. për vitin 2019.*

✓ *Subjektit i është revokuar Leja e Mjedisit nga ministria përgjegjëse sipas shkresës nr.159 prot., datë 07.05.2018, për të cilën ka sigurim padie, dhe*

✓ *Gjithashtu, subjektit i është revokuar Leja Minerare sipas shkresës së MIE me nr. 9105/3 prot, datë 19.12.2019, për shkelje të nenit 47, pika 1, shkronja "dh", të ligjit minerar që cilëson se: "dh) zotëruesi i lejes së shfrytëzimit minerar të grupit të mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet apo grupit të mineraleve ndërtimore vazhdon të përdorë praktika të dëmshme të shfrytëzimit të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, ose i drejton operacionet e punës në kundërshtim me projektin e miratuar", për të cilën ka vendim të ndërmjetëm për sigurim padie. Audituesit e KLSH konstatojnë se revokimi nuk ka marrë si bazë përcaktimet sipas nenit 47, pika 1, germa "h", që parashikon revokimin e lejes minerare, nëse "organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, ka revokuar lejen mjedisore". Procesi i revokimit është iniciuar sipas raport propozimit të AKBN me nr. 6364 prot., date 21.10.2019, fillimi i procedurave të revokimit nga ana e MIE i është njoftuar ZLM me shkresën nr. 9105/1 prot., datë 29.10.2019 dhe revokimi i lejes minerare është bërë nga MIE me shkresën nr. 9105/4 prot., datë 19.12.2019.*

✓ *Në kushtet që, si për revokimin e lejes mjedisore ashtu edhe për revokimin e lejes minerare, ka sigurim të objektit të padisë, referuar edhe përcaktimeve të dhëna me shkresat e MIE me nr. 12151/1, datë 16.10.2018 dhe shkresës së DSHL të AKBN me nr. 3882/4, datë 27.7.2018, si dhe vendimit të ndërmjetëm për sigurimin e objektit të padisë datë 19.02.2020, subjekti "Q..." SHPK duhet ti ishte nënshtruar procedurave të miratimit të programit vjetor si dhe monitorimit periodik e vjetor nga ana e AKBN-së në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 i ndryshuar, gjë e cila nuk ka ndodhur.*

b. Nga shqyrtimi i informacionit vjetor të pasqyruar në sistemin revzonë të strukturës përgjegjëse AKBN rezulton se nga ana e subjektit janë evidentuar në revzonë të dhënat vetëm në raportimin vjetor të vitit 2018 dhe nuk ka asnjë të dhënë për raportimin për vitin 2019, 2020 dhe 2021. Më hollësisht:

Viti 2018

Nr.	NrLejes	Nipti	Data e lejes	Nr.Raportit	Subjekti	Bashkia	Administratori	Drejtesiteknik	Minerali	GrupimMinerali	Objekti	Nr. ipunetoreve total	I punetoreve
180	10...	K6.....	11.05.2007	MN1-02831	Q...	Skrapar	N. Q.,	I. M.	GëlqeroriMermerizuar	GëlqerorBllok	N...	27	3

Realizim				Investimi				Garancia rehabilitimit lekë	Shitja				RentaMinerare	
Ton		m3		Realizim					brendavendit		eksport			
Mineral	Cilësia%	Koncentrat	Cilësia %	Mineral	Cilësia %	Leke	USD	ton	m3	ton	m3	Leke	USD	
	0	0	0	2804	0	0		82822		1516		1288	639312	

v.2019

158	10...	K6.....	11.05 .2007	MN1- 04483	Q...	Skrapar	N. Q.,	I. M.	Gëlqerori Mermeriz uar	N...		bosh e gjitha
-----	-------	---------	----------------	---------------	------	---------	--------	-------	------------------------------	------	--	------------------

**Viti
2020**

161	10...	K6.....	11.05 .2007	MN1- 03885	Q...	BashkiaSk rapar.	N. Q.,	I. M.	Gëlqerori Mermeriz uar	N...		bosh e gjitha
-----	-------	---------	----------------	---------------	------	---------------------	--------	-------	------------------------------	------	--	------------------

**Viti
2021**

158	10...	K6.....	11.05 .2007	MN1- 04483	Q...	Skrapar	N. Q.,	I. M.	Gëlqerori Mermeriz uar	N...		bosh e gjitha
-----	-------	---------	----------------	---------------	------	---------	--------	-------	------------------------------	------	--	------------------

Nga shqyrtimi në sistemin revzonë të raportimeve dhe informacioneve vjetore evidentohet se janë ngarkuar në sistem raportimet për vitin 2019,2020 dhe 2021 (periudhë kjo pas revokimit të lejes minerale të shfrytëzimit), por nuk ka asnjë të dhënë mbi sasinë e prodhimit, shitjeve, rentën, etj. Më konkretisht:

- **Për vitin 2019:** është ngarkuar në sistem raporti vjetor me nr. MN1-03423, datë 17.01.2020, vërehet se nuk ka asnjë të dhënë në raportim, asnjë tabelë të plotësuar, vetëm është vendosur shënimi “*shitje nga stoku, se plani vjetor nuk është miratuar për vitin 2019*”. Në lidhje me sa sipër, ky raportim është pranuar pa kundërshtim nga ana e AKBN, ku në fakt , për vitin 2019, për këtë subjekt është miratuar plani sipas shkresës me nr. 3882/5 datë 06.08.2018 për periudhën 11/5/2018 - 11/5/ 2019.
- **Për vitin 2020:** është ngarkuar në sistem raporti vjetor me nr. MN1-03885, datë 06.01.2021, vërehet se nuk ka asnjë të dhënë në raportim, asnjë tabelë të plotësuar, vetëm është vendosur shënimi “*revokuar leja minerare me vendimin nr. 9105/4, dt 19.12.2019. Vendimi në proces gjyqësor. AKBN nuk ka miratuar planin vjetor për vitin 2020*”.
- **Për vitin 2021:** është ngarkuar në sistem raporti vjetor me nr. MN1-044835, datë 04.01.2022, vërehet se nuk ka asnjë të dhënë në raportim, asnjë tabelë të plotësuar, vetëm është vendosur shënimi “*Nuk është miratuar programi vjetor. Revokuar leja me vendimin nr. 9105/4, dt 19.12.2019, është në proces gjyqësor*”.

c. nga shqyrtimi i informacionit të pasqyruar në regjistrin e lejeve minerare të AKBN (2018-2022) rezulton se leja me nr. 10...është me statusin “aktive” në vitin 2018 dhe në vitin 2019 me statusin “revokuar”:

regjistri lejeve
2018

181	10...	11.05.2007	Q...SHPK	K6...	Skrapar	N...	Gëlqeror pllakor	N. Q.	0.069	Shfrytë zimi
-----	-------	------------	----------	-------	---------	------	---------------------	-------	-------	-----------------

06.....		AKTIV	Poliçan, Rrethi Skrapar	(Aplikuar shtyrje afati 11.04.2017) Larguar drejtuesi teknik me shkr.s.hyrese 5378 dt.0606.2018
	e...z...@yahoo.com			

v.2019

Q...SHPK	K6.....	Skrapar	N...	Gëlqeror pllakor	N. Q.,	0.069	I. M.	Shfrytëzimi	REVOKUAR
----------	---------	---------	------	---------------------	--------	-------	-------	-------------	----------

06.....		Poliçan, Rrethi Skrapar	(Aplikuar shtyrje afati 11.04.2017) Revokmshkr. MIE nr 9105/3 protdt 19.12.2019
	e...z...@yahoo.com		

2020-2022 nuk figuron te regjistri i lejeve minerare

Nga ana tjetër, bazuar në volumin nr.2, 2019 faqe 153, “Mbikëqyrja e shfrytëzimit te rezervave minerare nga subjektet private”, raporti i 6-mujorit të parë të vitit 2019, evidentohet sasia e prodhimit për vitin 2019 prej 299.6 m³ si dhe niveli i të ardhurave dhe renta e 6-mujorit të parë 2019:

Nr Lejes	Data e lejes	Subjekti	Administratori	Minerali	Nr. i punetoreve	Nr. I punetoreve sigurim jete	Prodhi mi m ³	Investime t	Te Ardhura	Renta Minerare
70...	03.03.2013	K...SHPK	S. Q.	GelqerorPllakor	3	3	0	0	2500000	81428
76...	29.10.2014	A...	H. K.	GelqerorPllakor	0	0	0	0	0	0
80...	02.09.2015	G...	C. Q.	GelqerorPllakor	0	0	0	0	0	10802
86...	03.04.2015	"S. P"	N.D.	Gëlqeror i Mermerizuar	38	32	2064.153	3460069.6	77285487	56587
97...	21.07.2016	F...	H. Q.	Gëlqeror i Mermerizuar	3	3	42	0	550784	0
10...	11.05.2007	Q...	N. Q.	GelqerorPllakor			299.6	0	1719200	608309

d. Nga shqyrtimi i Raporteve të Monitorimit (periodik e vjetor), dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë rezulton se për periudhën objekt auditimi janë raportuar dy monitorime, si më poshtë:

- Për vitin 2018:

Burimi: AKBN, Raporti Vjetor 2018, “Mbikëqyrja e shfrytëzimit te rezervave minerare nga subjektet privat”, Volumi nr. 2, faqe 244:

Të dhëna për shoqërinë- Emri i subjekti: “Q.” SHPK - Nr. leje minerare: Nr. 10...- Data e marrjes së lejes: 08.08.2017 - Bashkia: Skrapar - Emërtimi i vendburimit: N..., Skrapar - Vendndodhja e objektit; Komuna N., Skrapar - Lloji i mineralit: Gëlqeror Pllakor - Administrator i subjektit: N. Q - Adresa e selisë: N..., Skrapar - Sipërfaqja e objektit: S = 0.069 km² - Cilësia e mineralit: CaO = 54.0 % - Drejtues teknik: I. M., - Shënim: Pamje e karrierës, Dhjetor 2018 Konstatime: Nga mbikëqyrja e kryer nga grupi i punës i përbërë nga: Ing. E. B., Ing. G. T., Ing. H. Ç., në muajin Dhjetor 2018, subjektit “Q.” SHPK rezulton se: 1. Subjekti ka pasur pezullim nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2. Për këtë çështje subjekt është në proces gjyqësor dhe ka bërë sigurimin e padisë. 3. Në momentin e kontrollit në objekt nuk punohej. 4. Subjekti gjatë vitit 2018 ka punuar pak pasi sipas subjektit përsëri ishin pezulluar nga policia për punime të shfrytëzimit minerar. 5. Subjekti ka kryer pagesat e garancisë së rehabilitimit. 6. Janë dorëzuar në afate kohore informacionet 3-mujore. 7. Është miratuar plani vjetor i punës për vitin 2018-2019 me Nr. 3882/5 Prot, datë 06.08.2018.

- **Për vitin 2019, volumi II, 2019, faqe 161**

Të dhëna për shoqërinë- Emri i subjekti: “Q.” SHPK - Nr. leje minerare: Nr. 10...- Data e marrjes së lejes: 08.08.2017 - Bashkia: Skrapar - Emërtimi i vendburimit: N..., Skrapar - Vendndodhja e objektit; Komuna N., Skrapar - Lloji i mineralit: Gëlqeror Pllakor - Administrator i subjektit: N. Q -Adresa e selisë: N..., Skrapar - Sipërfaqja e objektit: S = 0.069 km² - Cilësia e mineralit: CaO = 54.0 % - Drejtues teknik: I. M., - Shënim: Pamje e karrierës Konstatime: 1. Subjekti ka pasur pezullim nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2. Për këtë çështje subjekt është në proces gjyqësor . 3. Është miratuar plani vjetor i punës për vitin 2019-2020 vetëm për shitjen e mineralit të gjëndjes stok dhe jo për prodhim deri në zgjidhjen e problemit me Ministrinë e Turizmit. 4. Subjektit i është revokuar leja e Mjedisit Nr.159 Prot., datë 07.05.2018.

- Për vitin 2020

- Ska shënim*
- Për vitin 2021
Ska shënim
 - Për vitin 2022.
Ska shënim

LM NR. 87... DT 21.5.2015 " V. LL", URA VAJGURORE
Raportimet në sistemin elektronik "Revzonë". Viti 2018

8...	K02.....		23.06.2005	MN1-02913	V. LI	UraVajgurore	F. LL.	F. LL.	GureGëlqeror	Gur-Gelqeror (InerteNdertimi)	
Nr punonj sig jete		cilesia		prodhimi m3		cilesia		investim		G.Rehabilit	
7	3	50.53	0	0	38301	50.53	50000	135790	38301	0	1800147

Viti 2019

1 2 9	8...	K02.....	23.06.2005	MN1-03762	V. LI	URA VAJGURORE	F. LL.	F. LL.	GureGëlqeror	8	2
	0	0	0	0	0	50000	0	0			

Viti 2020

119	8...	K02.....	23.06.2005	MN1-04309	V. LI	URA - VAJGURORE	F. LL.	F. LL.			3	1	0	0
	135790	0		0	0		0	0			0	0		

Viti 2021

117	8...	K02.....	23.06.2005	MN1-04965	"V. LI." SHPK	DIMAL	F. LL.	F. LL.	Gur gëlqeror	Konizbalte	4	1
-----	------	----------	------------	-----------	---------------	-------	--------	--------	--------------	------------	---	---

Viti 2022

119	8...	K02.....	23.06.2005	MN6 - 000472	"V. LI." SHPK	F. LL.	F. LL.	Gur gëlqeror	UraVajgurore	V. LL	1	1
-----	------	----------	------------	--------------	---------------	--------	--------	--------------	--------------	-------	---	---

- *Sipas raporteve te adminsitruara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit rezulton se për ZMLM me nr. 87... date 21.05.2015 janë këto informacione mbi pezullimin e lejes mjedisore dhe ri aplikimet e subjektit për 5 herë:*

V. LL	K02.....	15.10.2018	Riaplikim dhe refuzuar ne Komision Nr 17, nr. prot 3228, date 02.04.2019	Riaplikim dhe refuzuar ne Komision Nr 32, nr.prot 5677 ,date 17.06.2019
Riaplikim dhe refuzuar ne Komision Nr 42, nr.prot 7392, date 19.08.2019		Riaplikim dhe refuzuar ne Komision Nr 42, nr.prot 7553, date 12.11.2020.		Riaplikim dhe eshte miratuar ne date 14.04.2021 per ndryshim e kushteve te lejes mjedisore me PN - 55.....

- *Bazuar në raportet e AKBN rezulton se është monitoruar ky subjekt, i cili është pa leje mjedisore për vitin 2019, dhe rezulton sa si vijon:*

(6 mujor dhe vjetore), Jometaloret, vëllimi 1, 2019, faqe 84

11. TË DHËNA PËR SHOQËRINË:

- Emri i subjekti: **“V. LL.” SHPK**
- Nr. leje minerare: **Nr. 8...**
- Data e marrjes së lejes: **21.05.2015**
- Bashkia: Ura Vajgurore
- Emërtimi i vendburimit: **“K.”**, Ura Vajgurore, Berat
- Vendndodhja e objektit **“K.”**, Ura Vajgurore, Berat
- Lloji i mineralit: Gur Gëlqeror
- Administrator i subjektit: **F. LL.**
- Adresa e selisë: **U. V.**, Berat
- Sipërfaqja e liçensuar: **S = 19.4205 ha**
- Cilësia e mineralit: **CaO=60 %**
- Drejtues teknik: **Ing. F. LL.**

Pamje e karrierës, Prill 2019

Konstatime:

- 1. Subjekti ka miratuar planin vjetor të punës.*
- 2. Për 6-mujorin e pare të vitit 2019 janë prodhuar 32,000 m3 gur gëlqeror*

Raporti “MBIKOYRJA E SHFRYTËZIMIT TE REZERVAVE MINERARE NGA SUBJEKTET PRIVATE RAPORTI I VITIT 2020,”faqe 115

të dhëna për shoqërinë:

- Emri i subjekti: **“V. LL.” SHPK**
- Nr. Leje minerare: **Nr. 8...**
- Data e marrjes së lejes: **21.05.2015**
- Bashkia: Ura Vajgurore
- Emërtimi I vendburimit: **“K.”**, Ura Vajgurore, Berat
- Vendndodhja e objektit **“K.”**, Ura Vajgurore, Berat
- Lloji I mineralit: Gur Gëlqeror
- Administrator i subjektit: **F. LL.**
- Adresa e selisë: Ura Vajgurore, Berat
- Sipërfaqja e liçensuar: **S = 19.4205 ha**
- Cilësia e mineralit: **CaO=60 %**
- Drejtues teknik: **Ing. F. LL.**

Konstatime:

Nga kontrolli kryer nga specialistët e sektorit të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional të mineraleve të ndërtimit, qymyreve dhe bitumeve, i përbërë nga Ing. M. Rr., Ing. G. T., dhe Ing. A. I., në Gusht 2020, në subjektin **“V. LL.” SHPK**, rezulton se:

- 1. Gjatë vitit 2020 nuk është ushtruar aktivitet minerar. Subjekti është ne proces gjyqësor.*
- 2. Gjendja teknike e karrierës paraqitet e mirë.*
- 3. Ka kryer pagesat për garancinë e rehabilitimit.*
- 4. Në objekt janë regjistruar 3 punonjës nga të cilët 1 me sigurim jete për aksidentet në punë.*
- 5. Për vitin 2020 në objekt është prodhuar 0 m3 e cila justifikohet pasi subjekti A. ka ndërtuar nje garbinë elektrike ne këtë leje minerare.*
- 6. Kjo leje minerare është ne proces gjyqësor.*
- 7. Gjendja e rezervave në objekt është 375,000 m3.*

Konstatime:

Për periudhën 15.10.2018 që është hequr leja mjedisore, pavarësisht aplikimeve dhe ri aplikimeve nga ana e subjektit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (me datën 02.04.2019, 17.6.2019, 19.8.2019, 12.11.2020, nuk ka miratim të lejes mjedisore. Pas riaplikimit me datën 14.4.2021 është miratuar miratimi i ndryshimit të kushteve të lejes mjedisore me nr. PN - 55..... Sa më sipër, për periudhën Tetor 2018 deri më 14.4.2021 është pa leje mjedisore dhe ka vijuar procesin e prodhimit dhe shitjes së mineralit, dhe nga ana e strukturës përgjegjëse ka miratuar programin vjetor për vitin 2019 dhe sipas raportit të monitorimit 2019 rezulton se për 6-mujorin e parë të vitit 2019 janë prodhuar 32,000 m³ gur gëlqeror.

Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për problematikën e konstatuar nga vlerësimi dhe shqyrtimi i zbatimit të procedurave dhe rezultatet e monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare, si dhe të shoqërive minerare publike rezultuan situata dhe gjetje si; AKBN gjatë periudhës 2018-2022 nuk ka arritur inspektimin çdo 6 muaj të të gjitha subjekteve minerare, nga ana e subjektit-zotërues të lejes minerare, nuk janë miratuar plani vjetor i punës sipas VKM nr. 232, datë 23.03.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturës përgjegjëse në sektorin minerar të RSH”, si më poshtë:

Titulli gjetjes:	i Nga strukturat përgjegjëse, në zbatim të detyrimit ligjor dhe autoritetit shtetëror, janë konstatuar problematika në veprimtarinë minerare me qëllim realizimin e mbikëqyrjes e monitorimin dhe konstatimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatimin të lejeve minerare.
Situata:	<p>- Nga auditimi rezulton se AKBN gjatë periudhës 2018-2022 nuk ka arritur inspektimin çdo 6 muaj të të gjitha subjekteve minerare, pasi janë inspektuar në vend dy herë 21-65 % e subjekteve, dhe midis 12-31 % e lejeve minerare nuk inspektohen. Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, i ndryshuar, neni 43, pika 2 për të kryer inspektime në funksion të hartimit dhe paraqitjes ministrit çdo 6 muaj të një raporti për mesatarisht 344 veprimtari minerare për periudhën 2018-2022 për të cilën ngarkohen me përgjegjësi Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve të Ndërtimit, Qymyreve dhe Bitumeve dhe Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore.</p> <p>Në të gjithë raportet e hartuara nga ana e strukturës përgjegjëse AKBN, është nënvizuar fakti i moskryerjes së inspektimeve dhe mbikëqyrjeve sipas ligjit, për të cilat është informuar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ku rezulton se nuk ka patur veprim nga kjo e fundit për nxjerrjen e përgjegjësive apo rishikimin e kapaciteteve njerëzore dhe fondeve në dispozicion të kësaj strukture.</p> <p>- Së paku në shtatë raste, nga ana e Grupit të Mbikëqyrjes së strukturës përgjegjëse AKBN, është evidentuar fakti se, nga ana e subjekteve-zotërues të lejes minerare, nuk janë miratuar planet vjetore të punës, dhe nuk është proceduar në vend me vendosjen e sanksioneve administrative gjombë sipas parashikimeve të nenit 45, të ligjit për sektorin minerar.</p> <p>- Në një numër Akt Konstatimesh të mbajtura (së paku në 6 raste të testuara), nga mbikëqyrja e shfrytëzimit të burimeve minerare dhe ushtrimit të veprimtarisë minerare në Bashkinë Bulqizë, është konstatuar se grupi i mbikëqyrjes, referuar materialit të publikuar, është mjaftuar vetëm me shprehjen “Subjekti ka miratuar programin vjetor të punës në AKBN”, pa identifikuar asnjë të dhënë të aktit dhe të datës së miratimit të këtij programi.</p>

- Në raportet e monitorimit ka përsëritje të cilësimeve për të njëjtat subjekte nga viti në vit dhe megjithëse prodhimi për periudhën 2015-2019 është zero, është vijuar normalisht pas asnjë ndëshkim për subjektin.

- Nga strukturat përgjegjëse, në zbatim të detyrimit ligjor dhe autoritetit shtetëror, nuk është hartuar një program periodik ose i posaçëm, për të ushtruar kontrole në çdo veprimtari minerare me qëllim realizimin e mbikëqyrjes e monitorimin e veprimtarive minerare dhe konstatimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatimin të lejeve minerare, sipas kërkesave të Urdhrit nr. 382, datë 20.05.2011 "*Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare*", pika 16 "*Strukturat përgjegjëse të Sektorit Minerare, specialistët dhe inspektorët e çdo strukture, në zbatim të detyrimit ligjor dhe autoritetit shtetëror, me program të planifikuar periodik ose të posaçëm, ushtrojnë kontrole në çdo veprimtari minerare për të realizuar mbikëqyrjen e monitorimin e veprimtarive minerare dhe konstatimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatim të lejes minerare*". Pika 17 "*Titullarët e strukturës përgjegjëse në fillim të çdo viti kalendarik programojnë kontrollet për subjektet minerare të pajisura me leje minerare aktive gjatë vitit kalendarik dhe e dërgojnë për miratim në METE*"

- Në raportet "Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private", të hartuar nga Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore (Drejtoria Minerare e AKBN), rezulton se nuk ka raporte për mbikëqyrjen e monitorimin e këtyre subjekteve për çdo 6-mujor.

- Në konstatimet nga mbikëqyrja e grupeve të specialistëve paraqitur në raportet 6 mujore "*Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private*" rezulton se grupet e specialisteve nuk janë shprehur për numrin e punëtoreve, realizimin e prodhimit, treguesit teknologjikë, realizimin e investimeve, realizimi i shitjeve brenda dhe jashtë vendit, të ardhurat e realizuara nga shitjet brenda vendit dhe eksportet, realizimi i rentës minerare etj tregues sipas kërkesave të: Nenit 43, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 "*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*", ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, "*Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare*", pika 3, "*Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare..... dhe Urdhrit nr. 202, datë 20.06.2016 "Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e Zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, dhe bitumet"* pika 3, "Formati dhe përmbajtja e planit vjetor të punës të parashikuar për t'u realizuar gjatë veprimtarisë minerare të vitit në vazhdim, të përcaktuar në përputhje me datën efektive të dhënies së lejes nga zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometallore, qymyret dhe bitumet, duhet të jetë në përputhje me planin e zhvillimit të veprimtarisë minerare të miratuar në lejen e tyre minerare dhe sipas formatit të përshkruar në aneksin 3 të këtij urdhri. Ky plan duhet të dërgohet on line (portali: raport.akbn.gov.al), pranë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes, për çdo vit" dhe pika 8. "*Institucioni i AKBN-së jo më vonë se 30 ditë pas*

përfundimit të çdo gjashtëmujori, duhet të dorëzojë në MIE raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve të pajisura me lejet e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, qymyret dhe bitumet,

- Gjithashtu në konstatimet nga mbikëqyrja e grupeve të specialistëve paraqitur në raportet 6 mujore “Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private” rezulton se grupet nuk janë shprehur në mënyrë specifike për treguesit e paraqitur në Aneksi 3, formatin nr.1 të tabelës së planit vjetor të veprimtarisë minerare i dërguar on line, (portali: raport.akbn.gov.al) (REVZONE) pranë AKBN-së ku paraqiten në mënyrë të specifikuar dhe të detajuar në tremujorë, kapacitetet e prodhimit, vlera e investimeve dhe operacionet që do të kryhen nga ana e subjektit gjatë veprimtarisë së tij minerare njëvjeçare si: *Prodhimi minerar, Realizimi i investimeve dhe punimeve gjeologo minerare, Vlera e produkteve minerare të shitura ne total, në të njëjtën monedhë, Rehabilitimi i mjedisit, Pagesa e taksës lokale, Garancia e investimeve, Garancia e rehabilitimit, Fuqia punëtore në total, Fuqia punëtore me sigurim jete, Pagesa e rentës minerare.*

- Nga krahasimi i treguesve të paraqitur në raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit me treguesit e raportuar në sistemin REVZONE dhe treguesit e planit të miratuar rezulton se vlerat e paraqitura nuk janë të njëjta si: *numri i punonjësve në objekt, numri punonjësve me sigurim jete, prodhimi i planifikuar, prodhimi i raportuar, realizimi i investimeve, Sasitë e mineralit të shitur, të ardhurat e planifikuara dhe ato të realizuar, renta minerare etj.*

- Rezulton se në sistemin REVZONE janë hedhur pjesërisht (në disa raste treguesit nuk janë hedhur) treguesit e planit vjetor të veprimtarisë minerare të dërguara on line nga subjektet si: *Prodhimi minerar, Realizimi i investimeve dhe punimeve gjeologo minerare, Vlera e produkteve minerare të shitura ne total, në të njëjtën monedhë, Rehabilitimi i mjedisit, Pagesa e taksës lokale, Garancia e investimeve, Garancia e rehabilitimit, Fuqia punëtore në total, Fuqia punëtore me sigurim jete, Pagesa e rentës minerare etj.* kjo në kundërshtim me kërkesat e Urdhrit nr. 201, nr. 202, datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e Zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, dhe bitumet” (Zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore) pika 3, “Formati dhe përmbajtja e planit vjetor të punës të parashikuar për t'u realizuar gjatë veprimtarisë minerare të vitit në vazhdim, të përcaktuar në përputhje me datën efektive të dhënies së lejes nga zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometallore, qymyret dhe bitumet, duhet të jetë në përputhje me planin e zhvillimit të veprimtarisë minerare të miratuar në lejen e tyre minerare dhe sipas formatit të përshkruar në aneksin 3 të këtij urdhri. Ky plan duhet të dërgohet on line (portali: raport.akbn.gov.al), pranë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN),”.

- Në disa raporte “Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private”, të hartuar nga Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore (Drejtoria Minerare e AKBN) (Numri i projektit 3060):

- (leja 27...) rezultojnë me shënimin se: Subjektit i ka mbaruar afati 20 vjeçar i lejes minerare dhe nuk ka kërkuar shtyrje të saj, Subjekti ka

kërkuar mbyllje të aktivitetit pasi në objekt kanë mbaruar rezervat e mineralit të kromit, ose (leja 44...) Shoqëria ka pezullim të aktivitetit mineral të miratuar nga MIE me shkresë nr. prot: 4171/3, date 05.07.2021, (leja 297) Diktuar nga situata e krijuar nga COVID – 19, në zbatim edhe të detyrimeve ligjore të përcaktuara në VKM nr. 43, datë 24.03.2020 “Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore”, nga institucioni i AKBN-së, verifikimi në terren i zonës së lejuar minerare nuk është realizuar për vitin 2020,

- Leja minerare nr. 29... datë 02.07.1996, me shkresën e MIE nr. prot: 314/3, datë 18.02.2021, është me statusin e pezullimit të përkohshëm, kur në sistemin REVZONE paraqitet prodhimi i parashikuar dhe i realizuar por nuk ka një akt konstatimi për mbikëqyrjen e monitorimin e kryer nga grupi i specialistëve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore në subjektet me qëllim verifikimin nëse punohet ose jo, pra nëse ka aktivitet mineral, në kundërshtim me kërkesat e nenit 43, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, “Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare” pika 3. “Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare ...”.
- AKBN, strukturat përgjegjëse nuk kanë një udhëzues të detajuar, ku të pasqyrohen të dhënat mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen në kuadër të vlerësimeve në një subjekt, zotërues të lejeve minerare të shfrytëzimit, etj.
- Kështu, duke analizuar raportet zyrtare të monitorimit të hartuara nga ana e strukturës përgjegjëse të AKBN dhe të depozituara periodikisht në MIE, rezultojnë se janë përfshirë në sistemin e raportimit periodik përmbledhës subjekte të ndryshme, zotërues të lejeve minerare, në 30 raste, për vitin 2018, dhe për mbi 50 subjekte për vitet 2019 dhe 2020 për të cilat nuk është kryer asnjë mbikëqyrje dhe monitorim pranë këtyre subjekteve për vitin referues, dhe se informacioni i përfshirë në raportim është vetëm sipas vetë deklarimeve të subjekteve zotëruese të lejeve minerare në sistemin rezonë.
- Nuk ka një përputhje të dhënave të rezultuar nga një proces rakordimi mujor nga ana e organeve të qeverisjes vendore me qëllim rakordimin me drejtoritë rajonale të tatimeve dhe degët e doganave për rentën minerare të mbledhur prej tyre, e cila ka sjellë si pasojë që pushtetit vendor të mos i kalohet saktësisht pjesa e rentës minerare, llogaritur si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria, pasi destinacioni i pjesës së të ardhurat nga renta minerare është të përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore në përmbushje të pikës nr. 4 e nenit 4 “Niveli i taksave kombëtare”, të Ligjit Nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar: “Taksa e rentës minerare caktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit metalor në nënproduktin mineral është në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 në masën 0% për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri në fund të vitit 2023 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2024 e në vijim së përcaktuar në shtojcën nr. 2, “Grupi i parë (I) Minerale metalike” që i bashkëlidhet këtij ligji.

- Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura të subjekteve që kanë qenë zotërues të lejeve minerare referuar të dhënave të vëna në dispozicion, për periudhën 2018-2022 rezultoi se ekziston një nivel i lartë i detyrimeve për garanci rehabilitimi sipas lejes, të papaguara deri në datën e kryerjes së auditimit, nga 72 subjekte që kanë qenë zotërues të lejeve minerare dhe që u është revokuar leja, por që rezultojnë me detyrime të papaguara për garanci rehabilitimi gjatë kohës që këto leje kanë qenë efektive, detyrim i cili për periudhën e audituar është në vlerën prej 21,999,067 lekë dhe përbën shkelje e disiplinës financiare, si të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit dhe me pasoja në sigurimin e fondeve për rehabilitimin e mjedisit, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- Nga auditimi u konstatua se në raste të veçanta, zotëruesit e lejeve minerare kanë patur periudha të gjata kohore (deri në 3 vite) pa kryer pagesat e fondeve për garancinë e rehabilitimit dhe nuk janë iniciuar nga ana e strukturës përgjegjëse, veprimet sipas përcaktimeve ligjore për revokimin e lejes minerare.

Sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Neni 2, pika 34 "Garanci financiare për rehabilitimin e mjedisit" është vlera monetare që depozitohet çdo vit, në formën e një garancie bankare në favor të shtetit, në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri, që përdoret për realizimin e planit të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligji". Neni 31 "Garancitë financiare për zhvillimin e veprimtarive minerare", pika 1: Garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit përllogaritet në vlerë monetare dhe përdoret nga zotëruesi i lejes ose shteti për realizimin e planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Garancia financiare depozitohet pas marrjes së lejes minerare çdo vit, në datën efektive të marrjes së lejes dhe vlera vjetore përcaktohet në bazë të vlerës së përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e planit për rehabilitimin e mjedisit, të miratuar nga ministri, të viteve të jetëgjatësisë së lejes minerare dhe të sasisë së mineralit të programuar për t'u shfrytëzuar çdo vit, sipas planit vjetor të veprimtarisë minerare. Vlera totale e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe realizimin e planit të aktiviteteve për mbylljen e veprimtarisë minerare vlerësohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga ministri. Ajo përfshin garancinë financiare për mbylljen e veprimtarisë minerare, mbylljen e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit. Neni 36 "Detyrimet e përgjithshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerare": "Përveç sa parashikohet në këtë ligj, për çdo tip lejeje minerare, zotëruesi i saj, gjatë periudhës së vlefshmërisë, ka edhe këto detyrime: 1. Të paraqesë në çdo vit të vlefshmërisë së lejes dhe brenda datës së vitit vazhdues, që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes, dokumentin e garancisë financiare, për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare. Neni 49, "Detyrimet e zotëruesit pas revokimit të lejes", 1. Pas revokimit të lejes, sipas nenit 48 të këtij ligji, zotëruesi i lejes detyrohet të zbatojë planin e rehabilitimit. 2. Zbatimi i sanksioneve administrative të pezullimit apo revokimit të lejes nuk e liron zotëruesin nga detyrimet e këtij ligji dhe nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar, sipas legjislacionit në fuqi. 3. Kur revokohet leja

	<i>minerare, sipas parashikimeve të këtij ligji, ministri ndjek pa kufizim çdo të drejtë ligjore dhe ndërmerret çdo veprim ligjor, për të vjelë dëmshpërblimin përkatës për dëmet shkaktuar shtetit nga shkeljet e zotëruesit të lejes minerare.”</i>
Kriteri:	Nenet 43, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, “Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare”, pika 3, “Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare....., Urdhrit nr. 201, nr. 202, datë 20.06.2016, Urdhri nr. 202, datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e Zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, dhe bitumet” pika 3. VKM nr. 43, datë 24.03.2020 “Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore”, Pika nr. 4 e nenit 4 “Niveli i taksave kombëtare”, të Ligjit Nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Udhëzimit nr.19, dt. 23.01.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planit vjetor të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit”.
Ndikimi:	Në veprimtarinë minerare ka problematika në realizimin e mbikëqyrjes e monitorimit dhe në konstatimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatimin të lejeve minerare.
Shkaku	AKBN gjatë periudhës 2018-2022 nuk ka arritur inspektimin çdo 6 muaj të të gjitha subjekteve minerare; nga ana e subjekteve-zotërues të lejes minerare nuk janë miratuar planet vjetore të punës; në raportet e monitorimit ka përsëritje të cilësimeve për të njëjtat subjekte nga viti në vit; nga strukturat përgjegjëse, në zbatim të detyrimit ligjor dhe autoritetit shtetëror, nuk është hartuar një program periodik ose i posaçëm, për të ushtruar kontrole në çdo veprimtari minerare; nuk ka raporte për mbikëqyrjen e monitorimin e këtyre subjekteve për çdo 6-mujor; në konstatimet nga mbikëqyrja e grupeve të specialistëve paraqitur në raportet 6 mujore rezultojnë se grupet e specialisteve nuk janë shprehur për numrin e punëtorëve, realizimin e prodhimit, treguesit teknologjikë, realizimin e investimeve, realizimi i shitjeve brenda dhe jashtë vendit, të ardhurat e realizuara nga shitjet brenda vendit dhe eksportet, realizimi i rentës minerare; nga krahasimi i treguesve të paraqitur në raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit me treguesit e raportuar në sistemin REVZONE dhe treguesit e planit të miratuar rezultojnë se vlerat e paraqitura nuk janë të njëjta; rezultojnë se në sistemin REVZONE janë hedhur pjesërisht (në disa raste treguesit nuk janë hedhur) treguesit e planit vjetor të veprimtarisë minerare të dërguara on line nga subjektet AKBN; strukturat përgjegjëse nuk kanë një udhëzues të detajuar, ku të pasqyrohen të dhënat mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKBN, Strukturat Përgjegjëse në plotësim të kuadrit ligjor dhe rregullator të miratuar: - Të hartojnë dhe miratojnë një udhëzues të detajuar, ku të pasqyrohen të dhënat mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen. - të kryejnë inspektimin çdo 6 muaj të të gjitha subjekteve minerare dhe të miratojnë planet vjetore të punës të subjekteve-zotërues të lejes minerare;

	<p>- të miratojnë programe periodike ose të posaçëm, për të ushtruar kontrolle në çdo veprimtari minerare; duke hartuar raporte për mbikëqyrjen e monitorimin e këtyre subjekteve për çdo 6-mujor; ku të shprehen për numrin e punëtoreve, realizimin e prodhimit, treguesit teknologjikë, realizimin e investimeve, realizimi i shitjeve brenda dhe jashtë vendit, të ardhurat e realizuara nga shitjet brenda vendit dhe eksportet, realizimi i rentës minerare; etje.</p> <p>- Të marrin masat për të përputhur treguesit e paraqitur në raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit me treguesit e raportuar në sistemin REVZONE dhe treguesit e planit vjetor të miratuar të veprimtarisë minerare të dërguara on line nga subjektet AKBN.</p>
--	--

Titulli gjetjes:	i Nga strukturat përgjegjëse, në zbatim të detyrimit ligjor dhe autoritetit shtetëror, janë konstatuar problematika në veprimtarinë minerare me qëllim realizimin e mbikëqyrjes e monitorimin dhe konstatimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatimin të lejeve minerare.
Situata:	<p>Nga auditimi i dosjes së monitorimit të Subjektit “Q.”, rezultoi se;</p> <p>a. Nuk ka asnjë dokument të administruar në dosje dhe asnjë deklaram në sistemin rev-zonë nga ana e këtij subjekti që të konfirmojë kryerjen pagesën e garancisë së rehabilitimit deri në datën e kryerjes së auditimit.</p> <p>b. Mungojnë veprimet e strukturës përgjegjëse pas revokimit të lejes minerare, për të kërkuar shlyerjen e detyrimeve financiare të garancisë së rehabilitimit, për të cilat administratori i subjektit ka nënshkruar procesverbalin e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit.</p> <p>c. Në mbledhjen e Komisionit të zhvilluar me dt. 06.12.2017 ka munguar drejtuesi teknik në kundërshtim me parashikimet e Nenit 6, pika 2, të Udhëzimit nr.19, dt. 23.01.2018 <i>“Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planit vjetor të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit”</i>, të AKBN, ku përcaktohet se subjekti në çdo rast përfaqësohet nga drejtuesi teknik, ndërsa procesverbali është nënshkruar nga administratori N. Q.</p> <p>d. Subjektit i është revokuar leja minerare me shkesën e MIE me nr. 9105/3 prot, datë 19.12.2019, për shkelje të nenit 47, germa ç, të ligjit minerar që cilëson se: <i>“ç) zotëruesi i lejes minerare, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e çdo viti në vazhdim, që i korrespondon datës së hyrjes në fuqi të lejes, nuk paraqet dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të planit të rehabilitimit, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të programit minimal të punës, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të investimit”</i>.</p> <p>Procesi i revokimit është iniciuar sipas raport propozimit të AKBN me nr. 9727 prot., date 09.11.2016, fillimi i procedurave të revokimit nga ana e MIE i është njoftuar ZLM me shkresën nr.729/1 prot., date 15.01.2018 dhe revokimi i lejes minerare është bërë nga MIE me shkresën nr.4905/1 prot., datë 28.05.2018.</p> <p>Sa më sipër, në lidhje me mos shlyerjen e detyrimeve të Lejes Minerare të Shfrytëzimit me nr. 12..., datë 18.12.2008, është vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 304, datë 15.7.2010 <i>“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”</i>, i ndryshuar, Neni 2, pika 34. Neni 31 <i>“Garancitë financiare për zhvillimin e veprimtarive minerare”</i>, pika 1, Neni 36 <i>“Detyrimet e përgjithshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerar”</i> Neni 47 <i>“Revokimi i lejes”</i>, pika 1.</p>

Pikën nr. 2 dhe 3, të Udhëzimit nr. 201 datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore e vjetore përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit në karriera për grupin e mineraleve jometalore” të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Aneksi 4 “Formati i tabelës informuese vjetore”, ku në nr. rendor 7, kërkon të dhëna mbi parashikimin dhe realizimin e vlerës në lekë dhe në % të garancisë së rehabilitimit, si dhe tek tabelat e planit, tabela nr. 1 “Formati i tabelës së planit vjetor minerar”, rreshti me nr. 7, “Garancia e rehabilitimit” e detajuar sipas tremujoreve dhe gjithsej vjetor.

Nenin 6, “Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komision”, pika 5 të Udhëzimit nr.19, dt.23.01.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planit vjetor të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit”, të AKBN, ku përcaktohet se: subjekti i cili gjatë shqyrtimit të dosjes së planeve rezultojnë mangësi dhe të meta i caktohet një afat jo më shumë se 10 ditë para mbarimit të datës, që i korrespondon kthimit të përgjigjes. Dhe se subjekti duhet të paraqesë në komision sipas afatit të caktuar dokumentacionin e plotësuar ose të rregulluar., në të kundërt, “ndaj subjektit që zotëron leje minerare të shfrytëzimit në bazë të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2021, merret vendimi për mosmiratim të planit vjetor të ushtrimit të aktivitetit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës”.

- Me datën 27.4.2018 nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit në AKBN, është mbajtur procesverbali për miratimin e planit, ku në faqen e parë të tij është vënë shënimi që “Për materialin gjendje të bëjë shitje”.

- Në mbledhjen e Komisionit të zhvilluar me dt 27.4.2018 ka munguar drejtuesi teknik, veprim në kundërshtim me parashikimet e Nenit 6, pika 2, të Udhëzimit nr.19, dt.23.01.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planit vjetor të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit”, i ndryshuar, të AKBN, ku përcaktohet se subjekti në çdo rast përfaqësohet nga drejtuesi teknik. Audituesit e autorizuar të KLSH konstatojnë se dhe për administratorin N. Q.,ka një nënshkrim të një personi, tjetër, por që nuk është identifikuar se cili ka nënshkruar për administratorin.

- Subjektit për periudhën 2018-2019 nuk i është miratuar plani vjetor për prodhimin dhe shfrytëzimin e mineraleve jometalor (të llojit gëlqeror pllakor), në përputhje me detyrimet e parashikuara në lejen minerare të miratuar nga ana e Ministrit, por vetëm për shitje të stokut të mineralit jometalor gjendje, ndërkohë që detyrimet për prodhim sipas pikës nr. 7, germa c, të lejes minerare të shfrytëzimit, përcaktojnë se prodhimi mineralit në vit duhet të jetë 3,600 m³/vit dhe fuqia punëtore për realizimin e projektit do të jetë 15 punonjës. Në fakt, sigurimi i jetës është kryer vetëm për 3 punonjës pranë sha “I.” për përudhen 9.5.2018-8.5.2019.

- Nga ana e subjektit zotërues i lejes minerare nuk janë ngarkuar në sistemin rev-zonë raportimet mbi sasinë e prodhimit, rentën, garancitë financiare të rehabilitimit etj. për vitin 2019.

- Subjektit i është revokuar Leja e Mjedisit nga ministria përgjegjëse sipas shkresës nr.159 prot., datë 07.05.2018, për të cilën ka sigurim padie, dhe gjithashtu, subjektit i është revokuar Leja Minerare sipas shkresës së MIE me nr. 9105/3 prot, datë 19.12.2019, për shkelje të nenit 47, pika 1,

	<p>shkronja “dh”, të ligjit minerar që cilëson se: “dh) zotëruesi i lejes së shfrytëzimit minerar të grupit të mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet apo grupit të mineraleve ndërtimore vazhdon të përdorë praktika të dëmshme të shfrytëzimit të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, ose i drejton operacionet e punës në kundërshtim me projektin e miratuar”, për të cilën ka vendim të ndërmjetëm për sigurim padie.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se revokimi nuk ka marrë si bazë përcaktimet sipas nenit 47, pika 1, germa “h”, që parashikon revokimin e lejes minerare, nëse “organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, ka revokuar lejen mjedisore”. Procesi i revokimit është iniciuar sipas raport propozimit të AKBN me nr. 6364 prot., date 21.10.2019, fillimi i procedurave të revokimit nga ana e MIE i është njoftuar ZLM me shkresën nr. 9105/1 prot., datë 29.10.2019 dhe revokimi i lejes minerare është bërë nga MIE me shkresën nr. 9105/4 prot., datë 19.12.2019.</p> <p>Në kushtet që, si për revokimin e lejes mjedisore ashtu edhe për revokimin e lejes minerare, ka sigurim të objektit të padisë, referuar edhe përcaktimeve të dhëna me shkresat e MIE me nr. 12151/1, datë 16.10.2018 dhe shkresës së DSHL të AKBN me nr. 3882/4, datë 27.7.2018, si dhe vendimit të ndërmjetëm për sigurimin e objektit të padisë datë 19.02.2020, subjekti “Q.” SHPK duhet ti ishte nënshtruar procedurave të miratimit të programit vjetor si dhe monitorimit periodik e vjetor nga ana e AKBN-së në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 i ndryshuar, gjë e cila nuk ka ndodhur.</p> <p>b. Nga shqyrtimi i informacionit vjetor të pasqyruar në sistemin revzonë të strukturës përgjegjëse AKBN rezulton se nga ana e subjektit janë evidentuar në revzonë të dhënat vetëm në raportimin vjetor të vitit 2018 dhe nuk ka asnjë të dhënë për raportimin për vitin 2019, 2020 dhe 2021</p> <p>Për periudhën 15.10.2018 që është hequr leja mjedisore, pavarësisht aplikimeve dhe ri aplikimeve nga ana e subjektit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (me datën 02.04.2019, 17.6.2019, 19.8.2019, 12.11.2020, nuk ka miratim të lejes mjedisore. Pas riaplikimit me datën 14.4.2021 është miratuar miratimi i ndryshimit të kushteve të lejes mjedisore me nr. PN - 55..... Sa më sipër, për periudhën Tetor 2018 deri më 14.4.2021 është pa leje mjedisore dhe ka vijuar procesin e prodhimit dhe shitjes së mineralit, dhe nga ana e strukturës përgjegjëse ka miratuar programin vjetor për vitin 2019 dhe sipas raportit të monitorimit 2019 rezulton se për 6-mujorin e parë të vitit 2019 janë prodhuar 32,000 m³ gur gëlqeror.</p>
Kriteri:	<p>Udhëzimit nr.19, dt. 23.01.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planit vjetor të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit”, Ligjin Nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Udhëzimit nr. 201 datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore e vjetore përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit në karriera për grupin e mineraleve jometalore”.</p>
Ndikimi:	<p>Rezulton se nga shqyrtimi i dosjes së planeve nuk është respektuar forma e informacioneve tremujore e vjetore përfundimtare dhe përmbajtja e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesit të lejes minerare të shfrytëzimit në karriera për grupin e mineraleve jometalore duke sjellë mos shlyerjen e detyrimeve të Lejes Minerare të Shfrytëzimit.</p>
Shkaku	<p>Mungojnë veprimet e strukturës përgjegjëse pas revokimit të lejes minerare, për të kërkuar shlyerjen e detyrimeve financiare të garancisë së</p>

	rehabilitimit, për të cilat administratori i subjektit ka nënshkruar procesverbalin e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga AKBN të merren masat gjatë shqyrtimit të dosjeve të planeve të respektohen forma e informacioneve tremujore e vjetore përfundimtare dhe përmbajtja e planeve vjetore të punës nga ana e zotëruesit të lejes minerare të shfrytëzimit në karriera për grupin e mineraleve jometalore me qëllim shlyerjen e detyrimeve të Lejes Minerare të Shfrytëzimit.

Pretendimi i subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar AKBN me shkresën nr. 983/14, datë 31.07.2023 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt Raportin, janë sjellë observacionet të cilat shkurtimisht po i paraqesim në raport konkretisht:

Gjetja nr. 5.

- "Mungesa e mjeteve të transportit, karburantit, diteve të reduktuara (nga 4 dite në tre dite) dhe mungesa e fondeve, periudha e Pandemise "Covid 19" etj.

Për vitin 2018. në raportin vjetor të Drejtorisë Minerare dërguar në MIE, është shkruar arsyeja e mosrealizimit të kontrollit për subjekte minerare me citimin: Mosrealizimi i kontrollit të këtyre lejeve ka ardhur për mungesë të fondeve dhe karburantit. Drejtoria Minerare, për këtë arsye ka vënë në dijeni MIE-n nëpërmjet raporteve 6 mujore dhe vjetore. Prandaj edhe në raport, aktiviteti mineral i subjekteve (të pa inspektuara) që ushtrojnë aktivitet mineral në këto bashki do të jete i paplote dhe i cunguar. Për vitin 2019. në raportin vjetor të Drejtorisë Minerare dërguar në MIE, është shkruar arsyeja e mosrealizimit të kontrollit për subjekte minerare me citimin: Mosrealizimi i kontrollit të këtyre lejeve ka ardhur për mungesë të fondeve, mjeteve dhe karburantit si dhe fatkeqësisë natyrore (tërmeti me qendër në Thumane). Për këtë problem është vënë në dijeni MIE, në raportin vjetor aktiviteti mineral i subjekteve nga ana e AKBN-se. Për vitin 2020, në raportin vjetor të Drejtorisë Minerare dërguar në MIE, është shkruar arsyeja e mosrealizimit të kontrollit të subjekteve minerare me citimin: Kontrolli i aktivitetit mineral për gjithë vitin 2020 nuk është realizuar i plote nga specialistet e AKBN-se. Shkak ka qenë situata e pandemise së virusit "Covid 19", që u shoqërua edhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.03.2020, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore".

Për vitin 2021, në raportin vjetor të Drejtorisë Minerare dërguar në MIE, është shkruar arsyeja e mosrealizimit të kontrollit subjekte minerare me citimin: Kryerja e kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit mineral është realizuar pothuajse në gjithë vendin. Përjashtimin bëjnë disa bashki dhe subjekte që aktiviteti mineral i tyre ka qenë i cunguar dhe shoqëritë kanë qenë me pezullim të aktivitetit mineral të miratuar nga MIE si dhe ndikimi i situatës së pandemise "Covid 19".

- Formati zyrtar i Akt Konstatimit, është miratuar me Urdhrin e Ministrit të MIE-s, Nr.382, 20.05.2011, sipas aneksit 1, të këtij urdhri. Në këtë format zyrtar, nuk ka asnjë rubrikë ku duhet të shkruhet data e miratimit të programit vjetor të punës. Në vitin 2019, AK.BN-ja e gjykoi që për ta përmirësuar formatin e Akt Konstatimit, të shtohet rubrika e "Miratimit të programit vjetor të punës së bashku me datën, numrin e punëtorëve, prodhimin, rezervat gjeologjike".

- Për detyrat e lëna nga grupet e inspektimit, që janë kryesisht në aspektin teknik, për subjektet e sipërcituara ato janë në aktivitet të rregullt mineral dhe detyrat e lëna nga grupi i punës kryesisht ekzekutohen në një kohë relativisht të shkurtër nga drejtuesi teknik i subjektit dhe ato janë verifikuar nga grupi pasardhës në mbikëqyrjen e 6 mujorit të radhës.

- Në raportet që AKBN dërgon në MIE 6 mujore dhe vjetore paraqet treguesit e mësipërm, duam të theksojmë se do të kushtojmë vëmendje për disa tregues sipas gjetjes suaj.

- Përsa i përket sistemit Revzone është një sistem ku subjektet bëjnë vet deklarimet sipas Ligjit mineral nr.10304, datë 15.07.2010 dhe Urdhrit 201 dhe 202, datë 20.06.2016. Sektori i Statistikave në Drejtorinë Minerare ndjek në mënyrë të vazhdueshme raportimet e subjekteve në programin Revzone mbi treguesit e prodhimit, numrit të punonjësve total dhe atyre me sigurim jete, vlera e investimit, shitjeve, garancia rehabilitimit etj. Gjetja e grupit të auditimit është e drejte.

- Duke filluar që nga deklarimet e 6-mujorit të I-re 2023, kjo gjetje e grupit të auditimit është zbatuar nga DM pranë AKBN-se. Infonnacionet e deklaruara në sistemin RevZone (6 mujore) dhe/ose me protokoll, janë plotësuar në mënyrë korrekte nga deklaruesit. Në raste të mosplotësimit, informacioni i kthehet mbrapsht deklaruesit për saktësimet e nevojshme. Vetëm pasi ky informacion është i plate, dokumenti administrohet nga DM.

- Për sa i përket rentës minerare dhe vjeljes së saj, subjektet deklarojnë shitjet dhe rentën sipas faturave të shitjeve, prandaj të dhënat e sakta janë në sistemin e Tatimeve e Doganave dhe aty linden detyrimet që ai ka për të paguar rentën minerare, taksa dhe tatime të tjera, dhe vetëm ato janë agjentet tatimore që vjelin rentën minerare. Në Revzone subjekti bën vetë deklarim pa detyrimin e pagimit të rentës minerare, prandaj dhe të dhënat nuk merren shumë për bazë sepse ky deklarim behet sipas vitit kalendarik. Ndërsa detyrimi i pagesës së rentës në komision e programeve vjetore behet referuar vitit ushtrimor nga data e marrjes së lejes, që dote thotë, psh. një subjekt mineral e ka në maj datën e miratimit të lejes, atëherë periudha për të cilën subjekti

duhet te deklarohet ne komisioni i perketet per iudhës ushtrimore nga prilli i vitit te kaluar deri ne mars ose prillin e vitit aktual qe bën mbrojtjen.

- Nga 72 subjekte qe janë revokuar, 55 prej tyre i perkasin per iudhës para vitit 2018 duke filluar nga 2013 qe nuk kane kryer pagesat prandaj dhe janë dërguar dhe ridërguar propozirnet nga AKBN-ja dhe para vitit 2018.

Gjetja nr. 6.

- Ne dosjen e fundit te administruar per subjektin "Q." shpk, është dokumenti i pagesës se garancisë se rehabilitimit për periudhën 2018 - 2019. (faturë për arkëtim nr. 181, date 02.05.2018 dhe mandat arkëtimi përkatës nga R. B., date 05.05.2018). Për faturën paraardhëse te garancisë se Rehabilitimit dhe investimit, subjekti ka paguar detyrimet sipas faturave përkatëse te lëshuara nga MIE (fat. për arkëtim nr. 3314 date 08.08.2017 për Garancinë e Rehabilitimit 2017-2018 dhe fat. për arkëtim nr. 3315 date 08.08.2017 për Garancinë Financiare te Investimit. Secila fature ka edhe mandat pagesën ne R. B., dhe janë dorëzuar ne QKB për aplikimin me LC-00.....).

- Ne proces verbal është cilësuar qe subjekti "Q." shpk mund te kryejë vetëm shitje te materialit gjendje.
- Ne këtë pike te projekt raportit citohen dy leje te ndryshme qe zotëroheshin nga subjekti "Q." shpk, përkatësisht Leja Minerare e shfrytëzimit Nr. 10... ne objektin e Gelqerorit Pllakor "N." bashkia Skrapar (Revokuar me shkresën nr.9105/4 prot., date 19.12.2019) dhe Leja Minerare e shfrytëzimit Nr. 12... ne objektin e Gëlqerorit Pllakor "Zh. M." bashkia Pelican (Revokuar me shkresën nr. 4905/1 prot., date 28.05.2018). Leja Nr. 12... është propozuar për revokim nga DM ne AKBN-se me shkresën Nr. 9727 prot. AKBN, date 09.11.2016 "Për mos pagesë te Garancisë Financiare te Rehabilitimit te Mjedisit për vitin 2016 - 2017". Ne objekt, nga shfrytëzimi minerar është prekur një sipërfaqe prej 0.11 ha. Subjekti "Q..." shpk, për këtë objekt minerar, ka paguar vlerën prej 631 150 leke (periudha 2011- 2014) duke tejkualuar ne këtë mënyrë vlerën e dëmtimit te sipërfaqes se prekur ne fakt.

- Nuk ka shkelje te rregullores ne rastin e sipërcituar. Ne mbledhjen e datës 27.04.2018, subjektit nuk i është dhënë e drejta për ushtrim aktiviteti minerar (zona ishte shpallur ndërkohë zone e mbrojtur dhe kishin filluar procedurat për revokimin e Lejeve Minerare te Shfrytëzimit ne këtë zone), por vetëm për shitje te materialit gjendje ne shesh depozitim. Pra, subjekti "Q." shpk, nuk ka detyrim ligjor për drejtues teknik për kryerjen e aktivitetit te tij tregtar.

- Sistemi RevZone është një sistem vetedeklarimi për te lehtësuar subjektet ne deklarimet e tyre. Ne rastin konkret, por edhe për leje te tjera te cilat janë revokuar (objekti N... ne bashkinë Skrapar) kane deklaruar ne RevZone vetëm për mineralin qe kane shitur nga gjendja dhe jo për prodhim te realizuar nga aktiviteti minerar. Këto deklarime nuk janë marre parasysh ne raportet 6 mujore/vjetore te mbikëqyrjes se aktivitetit minerar për sektorin jometalor.

- Nuk mundet te deklarohet prodhim nje subjekt qe nuk ushtron aktivitet minerar shfrytëzimi.

- Ne kushtet kur subjekti "Q." shpk nuk ka Leje Minerare shfrytëzimi aktive, nuk ushtron asnjë lloj aktiviteti minerar shfrytëzimi, është ne proces gjyqësor ne vazhdim, mbi cilën baze ligjore te Republikës se Shqipërisë, DM ne AKBN-se duhet te procedonte për shqyrtim/miratim te planit vjetor te punës për këtë subjekt (i cituar ne Projekt Raport) ose për subjekte te tjera qe ndodhen ne te njëjtën situatë ligjore.

- Per 6 mujorin e I-re te vitit 2018 subjekti "V. LL" shpk është mbikëqyruar ne muajin Prill 2018. Subjekti ka pasur te miratuar Planin Vjetor te Punës për 2017-2018 me nr.3383/1 prot., date 02.06.2017. Ne momentin e kontrollit, ne objekt janë raportuar prodhim prej 4000 m³ ndërsa ne raportimin 6 mujorit te I-re 2018, ne RevZone, subjekti ka vetë raportuar nje prodhim prej 12300 m³ (faqe 89-90 Raporti 6 mujorit I-re 2018).

Përgjigje nga Sektori Jometalor dhe Komisioni për rekomandimin 6.1.

Rekomandimi i grupit auditues ne këtë projekt raport është i drejte dhe DM pranë AKBN-se e ka realizuar menjëherë atë. Çdo dosje është trajtuar ne komisionin e shqyrtimit te planeve vjetore te punës brenda afateve ligjore te percaktuara sipas rregullores se miratuar. Ne rastet kur dosja ka patur mangësi te dokumentacionit sipas përcaktimeve ne Urdhrin 201 & 202 te Ministrisë, subjektit i është lënë një afat prej 7 ditësh për plotësim. Ne komisionin e radhës, subjekti ka bere plotësimet për te cilat është mbajtur një proces-verbal i ri me dokumentet e plotësuar te firmosur nga specialistet përkatës, përfaqësuesi i shoqërisë dhe sekretari dhe kryetari i komisionit. Ne rastet kur, edhe pas lënies se afatit, subjekti nuk plotëson dokumentacionin e munguar, subjektit i është dërguar pezullimi për aktivitetin minerar për vitin përkatës, duke vene ne dijeni edhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtorinë Vendore te Policisë. Ne rastet e plotësimit te dokumentacionit, subjekteve u është dërguar Miratimii përkatës. Ne përfundim te dosjes behet inventarizimi i dosjes me dokumentacionin qe ndodhet ne dosje e firmosur nga sekretari i komisionit dhe dorëzohet ne arkivin teknike. Për një funksionim me efikas dhe ne zbatim te ligjit 10304, i ndryshuar, Drejtoria Minerare ka bere ndryshimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit te planeve vjetore te punës të zotëruesve te leve minerare" me Urdhrin Nr. 153 (nr. 2690/2 prot., date 27.07.2022). Gjithashtu, u be një ndryshim i kësaj rregullore sipas Urdhrit Nr. 122 (nr. 490/6 prot., date 05.06.2(23), ku janë përcaktuar koha e dorëzimit re dosjeve nga Sektori i Statistikës ne Komisionin e shqyrtimit te planeve vjetore 15 dite para përfundimit te afatit ligjor te lejes.

informacionet e deklaruar ne sistemin RevZone (6 mujore dhe Vjetore) dhe/ose me protokoll, janë plotësuar ne mënyrë korrekte nga deklaruesit. Ne raste te mosplotësimit, informacioni i kthehet mbrapsht deklaruesit për saktësimet e nevojshme. (Bashkëlidhur shkresat e sipërcituara)

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me observacionet e bëra nga subjekti i audituar MIE për Projekt Raportin e auditimit, dërguar me shkresën nr. 983/14, datë 031.07.2023 edhe pse të përsëritura pa sjellë argumente të reja, grupi i auditimit gjykon se:

Për Gjetjen nr. 5:

- Si e kemi konstatuar edhe në gjetjen nuk është hartuar një udhëzues të detajuar, ku të pasqyrohen të dhënat mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen.

- Si e pranoni edhe ju nuk janë kryer inspektime çdo 6 muaj të të gjitha subjekteve minerare dhe nuk janë miratuar planet vjetore të punës të subjekteve-zotërues të lejes minerare;

- Nuk janë miratuar programe periodike ose të posaçëm, për të ushtruar kontrolle në çdo veprimtari minerare;; -
- Nuk përputhen treguesit e paraqitur në raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit me treguesit e raportuar në sistemin REVZONE dhe treguesit e planit vjetor të miratuar të veprimtarisë minerare të dërguara on line nga subjektet AKBN.

Për Gjetjen nr. 6:

- Nga auditimi i dosjes së monitorimit të Subjektit “Q.”, rezultoi se:

a. Nuk ka asnjë dokument të administruar në dosje dhe asnjë deklaram në sistemin rev-zonë nga ana e këtij subjekti që të konfirmojë kryerjen pagesën e garancisë së rehabilitimit deri në datën e kryerjes së auditimit.

b. Mungojnë veprimet e strukturës përgjegjëse pas revokimit të lejes minerare, për të kërkuar shlyerjen e detyrimeve financiare të garancisë së rehabilitimit, për të cilat administratori i subjektit ka nënshkruar procesverbalin e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit.

c. Në mbledhjen e Komisionit të zhvilluar me dt. 06.12.2017 ka munguar drejtuesi teknik.

d. Subjektit i është revokuar leja minerare me shkresën e MIE me nr. 9105/3 prot, datë 19.12.2019, për shkelje të nenit 47, germa ç, të ligjit minerar.

Sa më sipër, në lidhje me mos shlyerjen e detyrimeve të Lejes Minerare të Shfrytëzimit me nr. 12..., datë 18.12.2008, është vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 2, pika 34. Neni 31 “Garancitë financiare për zhvillimin e veprimtarive minerare”, pika 1, Neni 36 “Detyrimet e përgjithshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerar” Neni 47 “Revokimi i lejes”, pika 1 dhe pikën nr. 2 dhe 3, të Udhëzimit nr. 201 datë 20.06.2016 “

Ne Përgjigje nga Sektori Jometalor dhe Komisioni për rekomandimin 6.1. ju konstatojmë se Rekomandimi i grupit të auditimit në këtë projekt raport është i drejtë dhe DM pranë AKBN-se e ka realizuar menjëherë atë.

Gjykojmë se nga AKBN nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart argumentet e sjella, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

2.1 Mbi shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, pezullimeve dhe revokimeve nga ana e AKBN

Në referencë dhe në zbatim të pikës 4 të nenit 43 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, *struktura përgjegjëse ka të drejtë të kryejë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij ligji, të lërë detyra, të marrë masa administrative apo të propozojë marrjen e tyre nga ministri.*

Në vijim, një e drejtë e tillë për strukturën përgjegjëse AKBN është sanksionuar në VKM nr.232, date 23.02.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë”, në pikën 2, germa “a”.

Sipas të dhënave të AKBN në periudhën 2018-2022 janë dhënë masa administrative, propozuar pezullime dhe revokime si më poshtë.

Tabela nr. 16 Masat administrative, pezullimet dhe revokimet 2018-2022

							<i>Numër</i>
Nr.	Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
A	Leje aktive	587	542	513	516	503	532
1	Kundërvajtjet administrative	34	93	33	21	29	210
	<i>Lekë</i>	<i>4,000,000</i>	<i>12,600,000</i>	<i>3,700,000</i>	<i>2,350,000</i>	<i>5,450,000</i>	<i>28,100,000</i>
2	Pezullime të propozuara	4	12	43	37	28	124
3	Revokime të propozuara	51	40	20	29	13	153
	Gjithsej	89	145	96	87	70	487

Në % ndaj subjekteve aktive	15	27	19	17	14	18
-----------------------------	----	----	----	----	----	----

Burimi: Të dhëna të AKBN të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga sa më sipër rezulton se janë ndëshkuar dhe/ose propozuar mesatarisht 18 % e zotëruesve lejeve aktive në periudhën 2018-2022, në pjesën më të madhe me masa administrative gjobë, pastaj revokime dhe në fund janë pezullimet, përfshirë dhe ato me kërkesën e vetë zotëruesve të lejeve.

Duhet theksuar se AKBN nuk ka mbajtur të azhurnuar regjistrin e lejeve sipas viteve të periudhës 2018-2022 me rastet e pezullimeve dhe revokimeve, pasi në regjistra pezullime gjithsej për këtë periudhë janë 212 dhe revokime 96.

a. Kundërvajtjet administrative

Kundërvajtjet administrative janë shkeljet e ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, të cilat kur nuk përbëjnë vepër penale dënohen me gjobë sipas përcaktimeve të nenit 45 të ligjit të mësipërm.

Sipas dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga struktura përgjegjëse AKBN, rezulton se shkeljet administrative janë për mosparaqitje dhe/ose për paraqitje me vonesë të informacionit vjetor dhe atij 3/6 mujor, si dhe për mosdorëzim të plani vjetor, pra në pjesën më të madhe i përkasin penalizimeve administrative për mungesë raportimi, si dhe në një rast për mos krijim kushtesh për inspektim.

Referuar nenit 45 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, rezulton se struktura përgjegjëse AKBN nuk ka ushtruar në mënyrë të plotë të drejtat dhe detyrimet e veta lidhur me rastet e penalizimit me masën administrative gjobë për mos zbatimin planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare dhe planit të menaxhimit të mbetjeve minerare; për mos sigurimin jetës dhe shëndetit të punonjësve; për mos njoftimin jo më pak se 30 ditë kalendarike më parë, nëse kërkon ta zvogëlojë më shumë se 20 për qind sasinë e prodhimit, të parashikuar në planin e miratuar të prodhimit, pjesë e lejes përkatëse; për mos realizimin e programit të investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre veprimtarive; të mos njoftimit ose të mungesës së informacioneve dhe shpjegimeve, jo më pak se 1 vit para, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar etj. AKBN ka vepruar në mënyrë të njëanshme dhe me pasoja si në zhvillimin dhe përparimin e sektorit minerar, ashtu dhe me ndikim në të ardhurat buxhetore nga burime të planifikuara (renta minerare) dhe të paplanifikuara (gjobat).

Tabela nr. 17 Masat administrative sipas llojit 2018-2022

Nr.	Emërtimi	2018		2019		2020		2021		2022		Gjithsej	
		nuk ka sjelle	ka sjelle me vonesë	nuk ka sjelle	ka sjelle me vonesë	nuk ka sjelle	ka sjelle me vonesë	nuk ka sjelle	ka sjelle me vonesë	nuk ka sjelle	ka sjelle me vonesë	nuk ka sjelle	ka sjelle me vonesë
1	Tremujori I			5	8	7		5	2			17	10
2	Tremujori II			17	4	6		7	2			30	6
3	Tremujori III	10	2	19	4	6						35	6
4	Tremujori IV	9	1			6						15	1
5	6-mujori I									12		12	
6	6-mujori II												

7	Inform. vjetor	8	4	5	16	8		5				26	20
8	Raporti Vjetor			15						10	7	25	7
Gjithsej		27	7	61	32	33	0	17	4	22	7	160	50

Burimi: Të dhëna të AKBN të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Duhet theksuar se masat administrative të periudhës 2018-2022, gjithsej prej 210, janë marrë kryesisht në vitin 2022 prej 167, pasi në vitin 2019 janë marrë 28 masa dhe në vitin 2021 janë 12 të tilla. Kjo tregon se nga AKBN nuk janë zbatuar në kohë masat administrative, duke krijuar hapësira për deformimin ligjor të kësaj veprimtarie, duke mos vepruar në kohë sipas kërkesave të nenit 45 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar për dënimin me gjobë të shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative.

Konstatohet që nga ana e AKBN shkeljet për mos dorëzimin e informacionit periodik 3/6 mujor dhe atij vjetor janë bërë edhe 4 vite më pas, në një kohë që kërkesat e nenit 45 të ligjit minerar, pika 4 kërkojnë vendosjen e sanksioneve jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e konstatimit të shkeljes dhe njohjes së shkelësit dhe i njoftimin me shkrim të tij.

Duhet theksuar se një pjese e këtyre masave administrative janë inicuar, bazuar në rekomandimet e KLSH nga auditimet e mëparshme dhe jo nga konstatimet që duhej të bënte struktura përgjegjëse AKBN, pasi ka qenë inaktive në drejtim të zbatimit të legjislacionit për shkeljet administrative, të përcaktuara në nenin 45 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar.

Nga të dhënat e AKBN rezulton se vlera gjithsej e gjobave për 210 rastet e periudhës 2018-2022 është në vlerën 28,100 mijë lekë. AKBN nuk ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH, të dhëna për datën e njoftimit të subjektit për shkeljen, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 45, pika 3 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar: “Shkeljet konstatohen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit i njoftohet subjektit menjëherë, duke përshkruar shkeljen.”.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga AKBN rezulton se janë ankimuar në MIE gjithsej 32 raste (15% e gjobave) dhe janë shfuqizuar nga MIE 8 masa, që ju përkasin dy zotëruesve të lejeve minerare: leja nr. 16..., datë 15.01.2013-K... për 1 dhe nr. 84..., datë 18.03.2005 A. për 7 raste për vlerën gjithsej 900 mijë lekë, të cilat përfaqësojnë 25 % të vlerës së masave administrative gjithsej.

Drejtoria e Minierave nuk ka të dhëna për vjeljen e gjobave dhe ka filluar komunikimin për këtë çështje me Sektorin e Mbështetjes Ligjore (Drejtoria e Shërbimeve Ligjore) më datë 10.10.2022, nëpërmjet shkresës nr.4257 dhe nr.4487, datë 25.10.2022, sipas rekomandimit të KLSH. Duhet theksuar se 19 gjoba të vitit 2022 i janë dërguar Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore në shkurt 2023, gjë që tregon për punën e pamjaftueshme të Drejtorisë Minerare në këtë drejtim.

Nga të dhënat e këtij sektori rezulton se, nga 150 masat administrative të vitit 2022 të dhëna nga Drejtoria e Minierave, në 8 raste gjoba është ekzekutuar vullnetarisht, vetëm në 3 prej tyre nga gjykata është lëshuar urdhri i ekzekutimit, për 21 raste është kërkuar në gjykatë nxjerrja e urdhrat të ekzekutimit dhe për pjesën tjetër janë marrë përgjigjet nga posta për dijeninë ose jo nga ana e subjekteve, pra për 121 prej tyre ose për 85 % të gjobave nuk ka nisur procedura e vjeljes tyre. Kjo tregon se AKBN e ka trajtuar nga ana formale vendosjen e gjobave për ndëshkimin e subjekteve që nuk veprojnë sipas kërkesave të ligjit minerar, me pasoja të dëmshme për të ardhurat e buxhetit të shtetit (të ardhurat e tjera dhe të ardhurat nga renta minerare), si dhe në vetë zhvillimin dhe disiplinimin e sektorit minerar.

Nga sa më sipër, konstatohet se, AKBN nuk ka zbatuar kërkesat e pikës 6 të nenit 45 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar: “Gjoba paguhet brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj, përveçse kur vendimi për dhënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit në fuqi.” duke ulur ndjeshëm efektet e masave të ndëshkimit me gjobë të zotëruesve të lejeve minerare në drejtim të disiplinimit të veprimtarisë së sektorit minerar.

Kështu, sipas të dhënave të vëna në dispozicion mbeten për t'u velur 27,200 mijë lekë, të cilat deri në përfundim të auditimit nuk janë arkëtuar.

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga AKBN për masat administrative, rezultojnë se janë 35 subjekte të cilat janë penalizuar më shumë se dy herë dhe nga ana e AKBN është vendosur e njëjta vlerë e gjobës, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 45, pika 7. “Kryerja për herë të dytë nga i njëjti subjekt i shkeljeve të parashikuara në shkronjat “d” dhe “dh” të pikës 1 të këtij neni dënohet me dyfishin e gjobës së parashikuar dhe mund të shoqërohet me pezullimin e lejes minerare deri në plotësimin detyrimit.”, pra që duhej të ishte dyfishi i saj, deri në pezullim me plotësimin e detyrimit.

Veç sa më lart, konstatohet se struktura përgjegjëse AKBN nuk ka dënuar me gjobë të gjitha rastet e mos dorëzimit dhe ose dorëzimit me vonesë të informacionit periodik 3/6 mujor dhe atij vjetor dhe të planeve vjetore të cilat rezultojnë në fakt sipas afateve në periudhën 2018-2022.

Pasqyra nr. 18 Subjektet që kanë raportuar me vonesë informacionin periodik, si dhe subjektet e penalizuara 2018-2022.

				<i>Numër</i>
Viti	Emërtimi	Nr. subjekteve që nuk kanë raportuar ose raportuar me vonesë	Nr. subjekteve të ndëshkuara me gjobë	Diferenca
2018	Vjetor	18	12	-6
	Tremujori III	17	12	-5
	Tremujori IV	14	10	-4
2019	Vjetor	25	21	-4
	Tremujori I	21	13	-8
	Tremujori II	11	21	10
	Tremujori III	14	23	9
	Tremujori IV	9	0	-9
	Plani vjetor	15	15	
2020	Vjetor	8	8	
	Tremujori I	15	7	-8
	Tremujori II	6	6	
	Tremujori III	6	6	
	Tremujori IV	6	6	
	Plani vjetor	0	0	
2021	Vjetor	7	5	-2
	Tremujori I	11	7	-4
	Tremujori II	9	9	
	Tremujori III	30	0	-30
	Tremujori IV	15	0	-15
	Plani vjetor	0	0	0
2022	Vjetor	15	7	-8
	Gjashtëmujori I	12	12	
	Gjashtëmujori II	28	0	-28
	Plani vjetor	16	10	-6
Gjithsej subjekte		328	210	-118

Burimi: Të dhëna të AKBN të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga sa më sipër rezultojnë se një numër i konsiderueshëm i subjekteve megjithëse dorëzojnë informacionet me vonesë, nuk penalizohen nga ana e AKBN duke përdorur dy standarde: nga 328 subjekte që nuk kanë raportuar ose raportuar me vonesë, janë gjobitur 210 prej tyre ose 64%, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 45 të ligjit minerar.

b. Shqyrtimi i pezullimeve

Grupi i auditimit të KLSH bazuar në të dhënat e kërkuara dhe të vëna në dispozicion nga AKBN rezulton se në periudhën 2018-2022 janë propozuar për pezullim nga ana e saj dhe me kërkesë të subjekteve 124 leje, me numrin më të lartë 43 në vitin 2020 dhe më të ulët 4 në vitin 2018. Një tregues i tillë, tregon për veprimtari me mangësi në monitorimin e veprimtarisë minerare nga ana e AKBN, pasi nuk mund të konsiderohet që aktiviteti minerar të ndryshojë (përkeqësoj apo përmirësoj) veprimtarinë e tij në vite të veçanta.

AKBN nuk ka vënë në dispozicion të dhëna për shkaqet e pezullimit për 71 subjekte gjithsej ose 57 % e tyre, më e theksuar kjo në vitin 2020 dhe 2021, ndërsa pjesa e tjetër janë penalizime kryesisht për mosmiratim plani dhe me kërkesë të vetë subjekteve etj.

Veç kësaj, në të dhënat e vëna në dispozicion janë 27 raste të cilësuar si arsye të propozimit për pezullim, bazuar në “*Neni 18, pika 1, germa ç/ Mosmiratim të planit vjetor të punës*”, në një kohë që në nenin 46- Pezullimi i lejes ligjit minerar të ndryshuar, nuk përfshihet referenca ligjore e mësipërme.

Në kushtet e mungesës së të dhënave të vëna në dispozicion dhe të vendosjes së referencës së gabuar për pezullimin e përkohshëm, AKBN nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 46, të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, si dhe të VKM nr. 232, datë 23.02.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë”, pika 2, germa “j”: “*Propozimin Ministrit për masat e penalitetet që duhet të ndërmerren ndaj subjekteve që nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit minerar mbi bazën e rezultateve të mbikëqyrjes dhe monitorimit të veprimtarive minerare*”

Pasqyra nr. 19 Të dhëna për propozimet dhe pezullimet e lejeve minerare 2018-2022

Nr.	Emërtimi	Gjithsej	2018	2019	2020	2021	2022
I	Përmbledhëse	124	4	12	43	37	28
1.	Akt konstatime AKBN	8	1	0	0	3	4
B	Vendime të drejtorit të AKBN	25	1	0	11	13	0
C	Vendime të MIE	92	3	12	33	19	26
D	Pa të dhëna për vendime	7	0	0	0	5	2
2.	Arsye të pezullimeve	124	4	12	43	37	28
a	<i>Mos miratim plani</i>	26	2		10	12	2
b	<i>Kërkesë subjekti</i>	17				1	16
c	<i>Shmangie punime të rrezikshme</i>	5				3	2
d	<i>Detyrime të përgjithshme</i>	1				1	
e	<i>Njoftim nga subjekti për ndërprerje</i>	4					4
f	<i>Nuk ka të dhëna</i>	71	2	12	33	20	4
3.	Rifillim aktiviteti	15	0	5	4	2	4
a	<i>Pas 3 muaj</i>	5		2			3
b	<i>Pas 6 muaj</i>	12		2	3	6	1
c	<i>Pas 12 muaj</i>	0					
d	<i>Pas 18 muaj</i>	3		1	1	1	

Burimi: Të dhëna të AKBN të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se AKBN nuk ka ushtruar në mënyrë të plotë të drejtën që i jep neni 46 i ligjit minerar për të pezulluar lejet minerar të cilat nuk bëjnë sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë; nuk respektojnë të gjitha kërkesat për depozitimin, trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve minerare dhe trajtimin e ujërave që dalin nga objektet minerare dhe ato të depozitimit të mbetjeve; nuk rehabilitojnë zonën e lejuar minerare, në mënyrë progresive etj.

Nga Raportet e Monitorimit të periudhës 2018-2022 të përgatitura nga Drejtoria Minerare në AKBN, rezulton se megjithëse në subjektet zotëruese të lejeve janë evidentuar diferenca midis punonjësve gjithsej dhe atyre të siguruar për aksidentet në punë, nuk ka asnjë propozim për pezullim lejeje, duke mos zbatuar kompetencat ligjore të pikës 5 të nenit 36 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*” të ndryshuar, sipas të cilit

zotëruesi i lejes minerare është i detyruar: *“Të bëjë sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë, sipas rregullave të sigurimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave”* dhe në rast të shkeljes së kësaj dispozite leja pezullohet.

Bazuar në VKM nr.11..., datë 30.7.2008 *“Për sigurimin punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë”*, personat, që zotërojnë leje për të ushtruar veprimtari minerare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, detyrohen të kryejnë sigurimin e punonjësve të tyre nga aksidentet personale në punë, sipas një kontrate, pranë një shoqërie sigurimi (pika 1).

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj deklarimet e raportimeve online të vetë subjekteve në sistemin RevZone, në administrim të AKBN dhe në përdorim të subjekteve për plotësimin e të dhënave të aktivitetit të tyre, përfshirë dhe numrin e të punësuarve gjithsej dhe atyre të siguruar.

Pasqyra nr. 5 Të dhënat e raportuara për subjektet me punonjës të pa siguruar.

Nr.	Emërtimi	Numër				
		2018	2019	2020	2021	2022
1	Subjekte që kane raportuar 0 punonjës	145	116	136	139	100
2	Subjekte që raportojnë se nuk sigurojnë të gjithë punonjësit	282	119	234	251	171
3	Numri gjithsej i punonjësve të raportuar	4016	297...	3088	3416	1972
4	Numri i punonjësve të raportuar të siguruar	2182	1852	1723	1963	1190
5	Numri i punonjësve që rezultojnë të pasiguar	1834	1122	1365	1453	782
6	Numri i punonjësve të pasiguar në %	46	38	44	42	40

Burimi: Të dhëna të RevZone të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga pasqyra e mësipërme rezulton se mesatarisht në çdo vit 42 % e subjekteve nuk sigurojnë të gjithë punonjësit e punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë, për të cilët AKBN nuk ka ndërmarrë masën e pezullimit, dhe për subjektet që kanë vijuar me këtë shkelje ligjore nuk ju është revokuar leja, duke mos zbatuar kërkesat e nenit 47, pika 1, germa “g” të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar. Gjithashtu, mos veprimi i AKBN në këtë drejtim, ka ndikuar negativisht në jetën ekonomike dhe sociale të të punësuarve të këtij sektori dhe në të njëjtën kohë në disiplinimin e kësaj veprimtarie të rëndësishme të ekonomisë sonë kombëtare.

Nga 124 propozime vetëm për 8 prej tyre janë paraqitur të dhënat e akt-konstatimeve të specialistëve të Drejtorisë Minerare, për vitet 2019 dhe 2020 megjithëse nuk ka të dhëna në se ato janë të lidhura me periudhën e pandemisë COVID 19, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 46, pika 4: *“Shkeljet që bëhen shkak për pezullim konstatohen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit i njoftohet subjektit menjëherë me përshkrimin e arsyes së pezullimit”*.

Nga ana e AKBN nuk janë paraqitur të dhëna për numrin dhe datën e vendimeve për 7 subjekte, ndërsa për pjesën tjetër janë 25 vendime të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, ku në mungesë të dhënave për datën e akt-konstatimit grupi i auditimit të KLSH e kishte të pamundur të verifikojë zbatimin e afatit 10 ditor për marrjen e vendimit nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN, sipas kërkesave pikës 3 të nenit 46, të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar: *“Vendimi i pezullimit merret nga titullari i strukturës përgjegjëse jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga konstatimi i shkakut të pezullimit dhe njohjes së shkelësit dhe i njoftohen me shkrim shkelësit”*.

Në zbatim të pikës 2 të nenit 46 të ligjit minerar: *“Pezullimi i lejes nga struktura e përgjegjëse shoqërohet me lënien e detyrave për korrigjimin e shkeljeve. Detyrat zbatohen nga zotëruesi i lejes minerare brenda afatit të pezullimit, përveçse kur përcaktohet ndryshe në aktin e pezullimit. Struktura përgjegjëse verifikon korrigjimin e shkeljeve jo më vonë se 10 ditë nga data e lënë për korrigjimin e shkeljeve. Kur ky afat nuk respektohet, shkeljet quhen të korrigjuara dhe subjekti mund të rifillojë nga puna.”*, AKBN duhej të kishte lënë detyra për korrigjimin e shkeljeve si dhe kryerja e verifikimit për zbatimin e tyre.

Gjithashtu konstatohet se, rastet e pezullimeve nuk janë të reflektuara në raportet e monitorimit të subjekteve minerare. Kështu, në raportin e monitorimit të vëllimit të parë të metaloreve të vitit 2018 jepet vetëm përshkrimi ligjor lidhur me garancitë financiare, por pa përcaktuar numrin e subjekteve të cilët nuk plotësojnë këto kritere dhe penalizimin e tyre. Në këtë raport cilësohet se është pezulluar aktiviteti minerar në 3 subjekte, pa cilësuar shkakun, periudhën, situatën etj.

Gjithashtu, cilësohet se janë 24 subjekte për të cilët është propozuar revokimi i lejes, por pa përcaktuar se në çfarë faze janë nga ana e shqyrtimit të MIE. Midis të tjerave cilësohet se për lejen nr.14... është në proces revokimi që nga data 03.10.2014 dhe 14... që nga data 23.07.2014, leja nr.16... që nga data 15.03.2017. Pra në këtë mënyrë, AKBN nuk ka ushtruar kompetencat e veta sipas pikës 3 të nenit 46, të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, duke shkaktuar vonesa në ndëshkimin e subjekteve dhe ulje të eficiencës së veprimit të ligjit.

Në vëllimin e dytë të po këtij viti cilësohen se ka subjekte që kanë kërkuar vetë pezullimin, pa përcaktuar në se është respektuar nga ana e tyre kërkesa e germës “d” e pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në se është dhënë informacion dhe shpjegime 1 vit më parë, për ndërprerjen e prodhimit në zonën e lejuar. Ka edhe njoftime nga ana e AKBN, si p.sh leja me nr.11... është në pezullim të përkohshëm që nga data 06.10.2016, nr.98... që nga data 07.11.2016; 15... datë 16.09.2015.

Raporti i monitorimit të mineraleve jo metalore, bën përshkrimin e garancive financiare, njëlloj si metaloret, por pa cilësuar subjektet që nuk e kanë paguar dhe penalizimin e tyre.

Sipas raportit të jometalorëve të vitit 2019 cilësohet se janë 21 leje minerare të shfrytëzimit që bien në zonë të mbrojtur, pa cilësuar se çfarë do të bëhet më tej me këto leje. Janë njoftuar për pezullim aktiviteti 3 subjekte dhe 3 subjekte për revokim.

Në vitin 2020 janë 52 subjekte minerare metalore që kanë kërkuar pezullim të aktivitetit dhe 4 leje që janë propozuar për revokim, dhe në sektorin jometalor janë revokuar 2 leje, si dhe cilësohet se *“Theksojmë se në regjistrin elektronik të Lejeve Minerare të Shfrytëzimit kemi leje që ende nuk janë revokuar edhe pse nga ana e AKBN janë bërë propozimet të herëpashershme”*. Kjo tregon se nga ana e MIE nuk janë shqyrtuar propozimet e bëra nga AKBN.

c. Revokimet e lejeve

Për vitin 2021, në sektorin e metaloreve janë propozuar për revokim 9 leje minerare dhe për pezullim 15, janë revokuar 3, dhe cilësohen masa administrative për dy subjekte për mos plotësim kushtesh për Inspektim, që tek masat administrative të vena në dispozicion figuron vetëm një prej tyre.

Për sektorin minerar jo metalor janë revokuar 4 leje minerare dhe 5 subjekte janë propozuar për revokim. Për subjektin “P.” SHPK me Nr. leje minerare: 17... - Data e marrjes së lejes: 21.05.2014, cilësohet se: Në objekt nuk është punuar asnjëherë që nga marrja e lejes minerare, prandaj, kjo leje është revokuar me Urdhrin e Ministrit nr. 4657/2 prot M.I.E, datë 19.10.2021, gjë që tregon për mangësi monitorimi pasi ka kaluar një periudhë 7 vjeçare deri në revokimin e lejes, kur sipas dispozitave ligjore duhej të revokohej që në vitin 2014.

Raporti i monitorimit të vitit 2018 shoqërohet me një listë prej 19 subjektësh që janë propozuar në MIE për revokim për mos-pagesë të garancisë së rehabilitimit dhe në vëllimin e dytë Në këtë raport në vëllimin e parë cilësohet se janë propozuar për revokim gjithsej 45 leje minerare shfrytëzimi, për 37 leje minerare shfrytëzimi ka filluar procedura e revokimit dhe gjatë vitit 2018 janë revokuar 43 leje minerare.

Struktura përgjegjëse AKBN, për rastet e propozimit për revokim për shkak të shkeljes ligjore të mos-pagesës së garancisë së rehabilitimit, nuk ka mbajtur akt-konstatimi, por ka dërguar direkt raportin e propozimit në MIE, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit të Ministrit të METE nr.382, date 20.05.2011 “Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare”, pikat 5, 6 dhe 7.

Nga shqyrtimi i raporteve të monitorimit të AKBN 2018-2022, rezulton se për katër leje të subjektit B. SHA: lejet me nr.15..., datë 22.02.2012; nr. 16..., datë 07.12.2014; nr. 16..., datë 07.02.2014 dhe nr.16..., datë 07.02.2014, megjithëse nuk kanë fare prodhim në periudhën 2014-2021, pra nuk kanë zhvilluar aktivitetet minerar pas marrjes së lejes, AKBN vetëm në vitin 2020, pra pas 6 vitesh i ka propozuar MIE revokimin e tyre, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 47, pika 1, germa "c", i cili përcakton afatin 180 ditë mos fillim të veprimtarisë minerare si shkak për revokimin e lejes.

Veç kësaj, edhe pas propozimeve të AKBN për revokim leje: - leja minerare nr. 64..., datë 27.08.2001, bazuar në nenin 47, pika 1, germa c, me shkresë nr. 4493, datë 09.12.2020;

- leja minerare nr. 15..., date 22.02.2012, bazuar në nenin 47, pika 1, germa c, me shkresë nr. 4491, datë 09.12.2020;

- leja minerare nr. 16..., date 07.02.202014, bazuar në nenin 47, pika 1, germa ii dhe f, me shkresë nr. 4490, datë 09.12.2020;

- leja minerare nr. 16..., date 07.02.2014, bazuar në nenin 47, pika 1, germa ii dhe f, me shkresë nr. 4492, datë 09.12.2020;

- leja minerare e shfrytëzimit nr. 16..., datë 07.02.2014, me shkresë nr. 4482 datë 14.12.2021 MIE, sipas raportit të monitorimit të AKBN të 6 mujorit të parë të vitit 2022, nuk ka dhënë asnjë përgjigje lidhur me statusin e këtyre propozimeve, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 47- Procedura e revokimit të lejes, pikat 1, 2, 3 dhe 5 të këtij neni.

Për lejen nr.16..., datë 30.07.2013, rezultojnë dy njoftime për fillimin e procedurave të revokimit: e argumentuar për revokim për mos fillim pune në objekt të verifikuar më datë 27.02.2014 (shkelje e afatit 180 ditë); njoftim me date 15.03.2017, pasi nuk janë përmbushur detyrimet e përcaktuara në marrëveshjen e koncesionit për realizimin e investimeve dhe prodhimit për objektin "M. K. K", ndërkohë që zotëruesi i lejes minerare nuk ka paraqitur sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit për asnjërin nga njoftimet, e drejtë e përcaktuar në paragrafin e dytë të pikës 2 të nenit 48. Subjekti në regjistrin e lejeve të periudhës 2018 - 2022 figuron aktiv, dhe sipas të dhënave të sistemit RevZone ka zhvilluar aktivitetet me plane vjetore të miratuara. Mungesa e finalizimit me revokim nga ana e Ministrisë të MIE është në kundërshtim me pikën 3, të nenit 48 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, i cili përcakton: "*Ministri vendos revokimin e lejes minerare 30 ditë kalendarike pas kalimit të afateve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni*".

Lidhur me Lejen nr.16..., datë 06.09.2016, konstatohet se është njoftuar nga MIE për fillimin e procedurave të revokimit të kësaj leje minerare më datë 15.11.2021, në bazë të propozimit të strukturës përgjegjëse AKBN të datës 08.03.2021, pasi nuk është punuar që nga momenti i marrjes së lejes dhe deri në datën e propozimit, pra prej më shumë se 5 vitesh, gjë që tregon për dobësi në ushtrimin e veprimtarisë monitoruese nga kjo strukturë përgjegjëse. Kjo pasi, shkak ligjor për propozimin për revokim lidhet me mosfillimin e aktivitetit për më shumë 180 ditë nga aktivizimi i lejes, gjë që do të thotë që në muajin mars të vitit 2017.

Nga sa më sipër, konstatohet se ka munguar monitorimi në vijimësi nga struktura përgjegjëse AKBN për subjektet që nuk kanë respektuar ligjin për afatin e fillimit të aktivitetit.

Theksojmë se, AKBN nuk ka ushtruar të drejtën e strukturës përgjegjëse për t'i propozuar MIE revokimin e lejes edhe për rastet e tjera të parashikuara nga neni 47 i ligjit minerar të ndryshuar si në rastet kur: zotëruesi i lejes minerare nuk respekton kërkesat e planit të rehabilitimit, të planit të mbylljes së veprimtarisë minerare e të planit të menaxhimit të mbetjeve; zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për dy vjet radhazi dështon në realizimin e 90 për qind të vlerës së investimit, që ka parashikuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare; zotëruesi nuk i paraqet informacionet e kërkuara nga struktura përgjegjëse, paraqet informacione të pavërteta etj.

Nga shqyrtimi i vetë deklarimeve online të subjekteve rezulton një numër i konsiderueshëm subjektësh me informacion 0 ose bosh (të paplotësuar), si dhe pa pasur numër punonjësish por me aktivitet prodhues, investues ose shitës, të cilat duheshin përcaktuar si informacione të pavërteta.

Tabela nr. 20 Të dhënat e raportuara për subjektet me punonjës të pasiguar

Nr.	Emërtimi	Numër				
		2018	2019	2020	2021	2022
1	Subjekte me raportim 0, bosh ose të pasaktë	138	116	134	139	124

Burimi: Të dhëna të RevZone të AKBN të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga sa më sipër, rezulton se për periudhën 2018 - 2022 mesatarisht për 130 subjekte, AKBN në cilësinë e strukturës përgjegjëse nuk ka ushtruar kompetencat e saj për t'i propozuar MIE revokimin e lejes minerare për mungesë informacioni dhe/ose informacione të pavërteta, sipas kërkesave të pikës 1, germa "gj" të nenit 47, të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar: "Leja revokohet kur: gj) zotëruesi nuk i paraqet informacionet e kërkuara nga struktura përgjegjëse, paraqet informacione të pavërteta apo pengon strukturën përgjegjëse në ushtrimin e funksioneve të inspektimit, në zbatim të këtij ligji;"

Nga ana e AKBN nuk është analizuar zbatimi i kriterëve të nenit 18, pika 1, germa "e" dhe 25 "e", në se zotëruesi i lejes së shfrytëzimit ka njoftuar jo më pak se 30 ditë kalendrike më parë, për kërkesën e zvogëlimit në më shumë se 20 për qind të sasisë së prodhimit, të parashikuar në planin e miratuar të prodhimit, pjesë e lejes përkatëse. Kjo pasi nga shqyrtimi i të dhënave të deklaruara nga subjektet minerare për periudhën 2018-2022 janë 182 subjekte që rezultojnë së paku një vit me realizim nën 80% krahasuar me sasinë e prodhimit vjetor të përcaktuar në lejen përkatëse, gjë për të cilën AKBN nuk ka vepruar në zbatim të kërkesave të germës "j" të pikës 1 të nenit 47 të ligjit të mësipërm për të propozuar revokimin e lejes.

Gjithashtu, nga ana e AKBN nuk është kryer asnjë analizë dhe monitorim lidhur me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 18, pika 1, germa "a" për zotëruesit e lejeve të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, dhe të nenit 25 germa "a" për lejet të shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore në se ka realizuar programin e investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre veprimtarive.

Sipas të dhënave të subjekteve të deklaruara online në sistemin RevZone të AKBN rezulton se mesatarisht 25 % e subjekteve deklarojnë plan investimi, si dhe nga këto janë 57 % e zotëruesve të lejeve minerare që nuk zbatojnë detyrimin për realizimin e planit të investimeve.

Tabela nr. 21 Raportime nga subjektet mbi realizimin e planit të investimeve 2018-2022

Numër

Nr.	Emërtimi	2018	2019	2020	2021	2022
1	Subjekte gjithsej në regjistrin e lejeve	601	573	546	559	562
2	Subjekte që raportojnë plan investimi	147	185	101	163	147
	<i>Në përqindje ndaj subjekteve ne regjistër</i>	<i>24</i>	<i>32</i>	<i>18</i>	<i>29</i>	<i>26</i>
3	Subjekte qe raportojnë se realizojnë planin e investimeve deri në 90 %	67	68	56	91	67
	<i>Ne përqindje ndaj subjekteve qe raportojnë plan investimi</i>	<i>46</i>	<i>37</i>	<i>55</i>	<i>56</i>	<i>46</i>
4	Subjekte qe realizojnë deri ne 90 % te planit të investimeve dy vite radhazi	x	18	20	32	43
	<i>Ne përqindje ndaj subjekteve qe raportojnë plan investimi</i>	<i>x</i>	<i>49</i>	<i>36</i>	<i>20</i>	<i>29</i>

Burimi: Të dhëna të RevZone (AKBN) të përpunuara nga grupi i auditimit

AKBN, në këtë kuadër nuk ka shqyrtuar dhe analizuar zbatimin e kërkesave të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar, neni 47, pika 1, germa "f", i cili përcakton që në se "zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për dy vjet radhazi dështon në realizimin e 90 për qind të vlerës së investimit, që ka parashikuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare" leja revokohet.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj informacionet e vënë në dispozicion për periudhën 2020-2022, dhe rezultojnë se në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 janë përkatësisht 18, 20, 32 dhe 43 subjekte, të cilët kanë dështuar në realizimin e 90 për qind të vlerës së investimit për dy vite radhazi, dhe për të cilët AKBN nuk ka ushtruar kompetencat e veta ligjore në propozimin për revokimin e lejes minerare, sipas kërkesave të nenit 47, pika 1, germa “f” të ligjit minerar.

<p>Titulli gjetjes:</p>	<p><u>i Kundërvajtjet administrative.</u> Nga auditimi rezultojnë se nga AKBN janë ndëshkuar dhe/ose propozuar mesatarisht 18 % e zotëruesve lejeve aktive në periudhën 2018-2022, në pjesën më të madhe me masa administrative gjobë, pastaj revokime dhe në fund janë pezullimet, përfshirë dhe ato me kërkesën e vetë zotëruesve të lejeve.</p>
<p>Situata:</p>	<p>- AKBN nuk ka mbajtur të azhurnuar regjistrin e lejeve sipas viteve të periudhës 2018-2022 me rastet e pezullimeve dhe revokimeve, pasi në regjistra pezullime gjithsej për këtë periudhë janë 212 dhe revokime 96.</p> <p>- Referuar nenit 45 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, rezultojnë se struktura përgjegjëse AKBN nuk ka ushtruar në mënyrë të plotë të drejtat dhe detyrimet e veta lidhur me rastet e penalizimit me masën administrative gjobë për mos zbatimin planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare dhe planit të menaxhimit të mbetjeve minerare; për mos sigurimin jetës dhe shëndetit të punonjësve; për mos njoftimin jo më pak se 30 ditë kalendrike më parë, nëse kërkon ta zvogëlojë më shumë se 20 për qind sasinë e prodhimit, të parashikuar në planin e miratuar të prodhimit, pjesë e lejes përkatëse; për mos realizimin e programit të investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre veprimtarive; të mos njoftimit ose të mungesës së informacioneve dhe shpjegimeve, jo më pak se 1 vit para, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar etj. <u>AKBN ka vepruar në mënyrë të njëanshme dhe me pasoja si në zhvillimin dhe përparimin e sektorit minerar, ashtu dhe me ndikim në të ardhurat buxhetore nga burime të planifikuara (renta minerare) dhe të paplanifikuara (gjobat).</u></p> <p>- Masat administrative për periudhën 2018-2022, gjithsej prej 210, janë marrë kryesisht në vitin 2022 prej 167, në vitin 2019 janë marrë 28 masa dhe në vitin 2021 janë 12 të tilla. Kjo tregon se nga AKBN nuk janë zbatuar në kohë masat administrative, duke krijuar hapësira për deformimin ligjor të kësaj veprimtarie, duke mos vepruar në kohë sipas kërkesave të nenit 45 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “<i>Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë</i>” i ndryshuar për dënimin me gjobë të shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative.</p> <p>- Konstatohet që nga ana e AKBN shkeljet për mos dorëzimin e informacionit periodik 3/6 mujor dhe atij vjetor janë bërë edhe 4 vite më pas, në një kohë që kërkesat e nenit 45 të ligjit minerar, pika 4 kërkojnë vendosjen e sanksioneve jo më vonë se 30 ditë kalendrike nga data e konstatimit të shkeljes dhe njohjes së shkelësit dhe i njoftimin me shkrim të tij. Theksojmë se një pjesë e këtyre masave administrative janë inicuar, bazuar në rekomandimet e KLSH nga auditimet e mëparshme dhe jo nga konstatimet që duhej të bënte struktura përgjegjëse AKBN, pasi ka qenë inaktive në drejtim të zbatimit të legjislativitetit për shkeljet administrative, të përcaktuara në nenin 45 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar.</p> <p>- Nga të dhënat e AKBN rezultojnë se vlera gjithsej e gjobave për 210 rastet e periudhës 2018-2022 është në vlerën 28,100 mijë lekë. AKBN nuk ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH, të dhëna për datën e njoftimit të subjektit për shkeljen, duke vepruar në kundërshtim me</p>

	<p>kërkesat e nenit 45, pika 3 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar që kërkon që shkeljet kur konstatohen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit i njoftohet subjektit menjëherë, duke përshkruar shkeljen.</p> <p>- Nga të dhënat e AKBN rezulton se, nga 150 masat administrative të vitit 2022 të dhëna nga Drejtoria e Minierave, në 8 raste gjoba është ekzekutuar vullnetarisht, vetëm në 3 prej tyre nga gjykata është lëshuar urdhri i ekzekutimit, për 21 raste është kërkuar në gjykatë nxjerrja e urdhrin të ekzekutimit dhe për pjesën tjetër janë marrë përgjigjet nga posta për dijeninë ose jo nga ana e subjekteve, pra për 121 prej tyre ose për 85 % të gjobave nuk ka nisur procedura e vjeljes tyre. AKBN nuk ka zbatuar kërkesat e pikës 6 të nenit 45 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar që gjoba të paguhet brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj, përveçse kur vendimi për dhënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit në fuqi, duke ulur ndjeshëm efektet e masave të ndëshkimit me gjobë të zotëruesve të lejeve minerare në drejtim të disiplinimit të veprimtarisë së sektorit minerar. Kështu, sipas të dhënave të vëna në dispozicion mbeten për t'u velur 27,200 mijë lekë, të cilat deri në përfundim të auditimit nuk janë arkëtuar.</p> <p>- Referuar të dhënave nga AKBN për masat administrative, rezulton se janë 35 subjekte të cilat janë penalizuar me masa administrative më shumë se dy herë duke vendosur të njëjtën vlerë të gjobës, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 45, pika 7. "Kryerja për herë të dytë nga i njëjti subjekt i shkeljeve të parashikuara në shkronjat "d" dhe "dh" të pikës 1 të këtij neni dënohet me dyfishin e gjobës së parashikuar dhe mund të shoqërohet me pezullimin e lejes minerare deri në plotësimin detyrimit.", pra që duhej të ishte dyfishi i saj, deri në pezullim me plotësimin e detyrimit.</p> <p>- Gjithashtu, konstatohet se struktura përgjegjëse AKBN nuk ka dënuar me gjobë të gjitha rastet e mos dorëzimit dhe ose dorëzimit me vonesë të informacionit periodik 3/6 mujor dhe atij vjetor dhe të planeve vjetore të cilat rezultojnë në fakt sipas afateve në periudhën 2018-2022.</p> <p>- Nga auditimi rezulton se një numër i konsiderueshëm i subjekteve megjithëse dorëzojnë informacionet me vonesë, nuk janë penalizuar nga ana e AKBN duke mos përdorur të njëjtat standarde: nga 328 subjekte që nuk kanë raportuar ose raportuar me vonesë, janë gjobitur 210 prej tyre ose 64%, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 45 të ligjit minerar.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010 " <i>Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë</i> " të ndryshuar.
Ndikimi:	<p>- Nga të dhënat e AKBN rezulton se, nga 150 masat administrative të vitit 2022 të dhëna nga Drejtoria e Minierave, në 8 raste gjoba është ekzekutuar vullnetarisht, vetëm në 3 prej tyre nga gjykata është lëshuar urdhri i ekzekutimit, për 21 raste është kërkuar në gjykatë nxjerrja e urdhrin të ekzekutimit dhe për pjesën tjetër janë marrë përgjigjet nga posta për dijeninë ose jo nga ana e subjekteve, pra për 121 prej tyre ose për 85 % të gjobave nuk ka nisur procedura e vjeljes tyre. Rezulton se mbeten për t'u velur 27,200 mijë lekë, të cilat deri në përfundim të auditimit nuk janë arkëtuar. AKBN nuk ka zbatuar kërkesat e pikës 6 të nenit 45 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar që gjoba të paguhet brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj, përveçse kur vendimi për dhënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit në fuqi, duke ulur ndjeshëm efektet e masave të ndëshkimit me gjobë të zotëruesve të lejeve minerare në drejtim të disiplinimit të veprimtarisë së sektorit minerar.</p>

Shkaku	AKBN nuk ka ushtruar në mënyrë të plotë të drejtat dhe detyrimet e veta lidhur me rastet e penalizimit me masën administrative gjobë për mos zbatimin planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare dhe planit të menaxhimit të mbetjeve minerare; për mos sigurimin jetës dhe shëndetit të punonjësve; për mos njoftimin jo më pak se 30 ditë kalendarike më parë, nëse kërkon ta zvogëlojë më shumë se 20 për qind sasinë e prodhimit, të parashikuar në planin e miratuar të prodhimit, pjesë e lejes përkatëse; për mos realizimin e programit të investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre veprimtarive; të mos njoftimit ose të mungesës së informacioneve dhe shpjegimeve, jo më pak se 1 vit para, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar etj. AKBN ka vepruar në mënyrë të njëanshme dhe me pasoja si në zhvillimin dhe përparimin e sektorit minerar, ashtu dhe me ndikim në të ardhurat buxhetore nga burime të planifikuara (renta minerare) dhe të paplanifikuara (gjobat).
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	- AKBN të marrë masat për të mbajtur të azhurnuar regjistrin e lejeve sipas viteve me rastet e pezullimeve dhe revokimeve. - AKBN, struktura përgjegjëse të marrin masat për të ushtruar të drejtat dhe detyrimet e tyre lidhur me plotësimin dhe zbatimin nga subjektet minerare të planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare dhe planit të menaxhimit të mbetjeve minerare; sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve; realizimin e programit të investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre veprimtarive; të informacioneve dhe shpjegimeve, jo më pak se 1 vit para, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar etj. Në rastet e mosplotësimit dhe mos zbatimit të tyre të kërkojë vendosjen e masa administrative gjobë, për subjektet minerare.

Titulli gjetjes:	<u>Pezullimi i lejeve minerare</u> Nga auditimi rezulton se nga AKBN janë ndëshkuar dhe/ose propozuar mesatarisht 18 % e zotëruesve lejeve aktive në periudhën 2018-2022, në pjesën më të madhe me masa administrative gjobë, pastaj revokime dhe në fund janë pezullimet, përfshirë dhe ato me kërkesën e vetë zotëruesve të lejeve.
Situata:	- Grupi i auditimit të KLSH bazuar në të dhënat e kërkuara dhe të vëna në dispozicion nga AKBN rezulton se në periudhën 2018-2022 janë propozuar për pezullim nga ana e saj dhe me kërkesë të subjekteve 124 leje, me numrin më të lartë 43 në vitin 2020 dhe më të ulët 4 në vitin 2018. Një tregues i tillë, tregon për veprimtari me mangësi në monitorimin e veprimtarisë minerare nga ana e AKBN, pasi nuk mund të konsiderohet që aktiviteti minerar të ndryshojë (përkeqësoj apo përmirësojë) veprimtarinë e tij në vite të veçanta. - AKBN nuk paraqiti të dhëna për shkaqet e pezullimit për 71 subjekte gjithsej ose 57 % e tyre, më e theksuar kjo në vitin 2020 dhe 2021, ndërsa pjesa e tjetër janë penalizime kryesisht për mosmiratim plani dhe me kërkesë të vetë subjekteve etj. Veç kësaj, në të dhënat e vëna në dispozicion janë 27 raste të cilësuar si arsye të propozimit për pezullim, bazuar në “Neni 18, pika 1, germa ç/ Mosmiratim të planit vjetor të punës”, në një kohë që në nenin 46- Pezullimi i lejes ligjit minerar të ndryshuar, nuk përfshihet referenca ligjore e mësipërme. AKBN nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 46, të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, si dhe të VKM nr. 232, datë 23.02.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë”,

pika 2, germa “j”: *“Propozimin Ministrit për masat e penalitetet që duhet të ndërmerren ndaj subjekteve që nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit minerar mbi bazën e rezultateve të mbikëqyrjes dhe monitorimit të veprimtarive minerare”*.

- AKBN nuk ka ushtruar plotësisht të drejtën që i jep neni 46 i ligjit minerar për të pezulluar lejet minerar të cilat nuk bëjnë sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë; nuk respektojnë të gjitha kërkesat për depozitimin, trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve minerare dhe trajtimin e ujërave që dalin nga objektet minerare dhe ato të depozitimit të mbetjeve; nuk rehabilitojnë zonën e lejuar minerare, në mënyrë progresive etj.

- Nga Raportet e Monitorimit të periudhës 2018-2022 të përgatitura nga Drejtoria Minerare në AKBN, rezulton se megjithëse në subjektet zotëruese të lejeve janë evidentuar diferenca midis punonjësve gjithsej dhe atyre të siguruar për aksidentet në punë, nuk ka asnjë propozim për pezullim lejeje, duke mos zbatuar kompetencat ligjore të pikës 5 të nenit 36 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 *“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”* të ndryshuar, sipas të cilit zotëruesi i lejes minerare është i detyruar: *“Të bëjë sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë, sipas rregullave të sigurimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave”* dhe në rast të shkeljes së kësaj dispozite leja pezullohet. Personat, që zotërojnë leje për të ushtruar veprimtari minerare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk kanë kryer sigurimin e punonjësve të tyre nga aksidentet personale në punë, sipas një kontrate, pranë një shoqërie sigurimi (pika 1) në kundërshtim me VKM nr.1109, datë 30.7.2008 *“Për sigurimin punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë”*.

- Nga pasqyra e AKBN-së rezulton se mesatarisht në çdo vit 42 % e subjekteve nuk sigurojnë të gjithë punonjësit e punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë, për të cilët AKBN nuk ka ndërmarrë masën e pezullimit, dhe për subjektet që kanë vijuar me këtë shkelje ligjore nuk ju është revokuar leja, duke mos zbatuar kërkesat e nenit 47, pika 1, germa “g” të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar. Gjithashtu, mos veprimi i AKBN në këtë drejtim, ka ndikuar negativisht në jetën ekonomike dhe sociale të të punësuarve të këtij sektori dhe në të njëjtën kohë në disiplinimin e kësaj veprimtarie të rëndësishme të ekonomisë sonë kombëtare.

- Nga 124 propozime vetëm për 8 prej tyre janë paraqitur të dhënat e akt-konstatimeve të specialistëve të Drejtorisë Minerare, për vitet 2019 dhe 2020 megjithëse nuk ka të dhëna në se ato janë të lidhura me periudhën e pandemisë COVID 19, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 46, pika 4: *“Shkeljet që bëhen shkak për pezullim konstatohen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit i njoftohet subjektit menjëherë me përshkrimin e arsyes së pezullimit”*.

- Nga ana e AKBN nuk janë paraqitur të dhëna për numrin dhe datën e vendimeve për 7 subjekte, ndërsa për pjesën tjetër janë 25 vendime të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, ku në mungesë të dhënave për datën e akt-konstatimit grupi i auditimit të KLSH e kishte të pamundur të verifikojë zbatimin e afatit 10 ditor për marrjen e vendimit nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN, sipas kërkesave pikës 3 të nenit 46, të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar: *“Vendimi i pezullimit merret nga titullari i strukturës përgjegjëse jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga konstatimi i shkakut të pezullimit dhe njohtes së shkelësit dhe i njoftohen me shkrim shkelësit.”*

	<p>- Konstatohet se, rastet e pezullimeve nuk janë të reflektuara në raportet e monitorimit të subjekteve minerare. Kështu, në raportin e monitorimit të vëllimit të parë të metaloreve të vitit 2018 jepet vetëm përshkrimi ligjor lidhur me garancitë financiare, por pa përcaktuar numrin e subjekteve të cilët nuk plotësojnë këto kritere dhe penalizimin e tyre.</p> <p>- Gjithashtu, cilësohet se janë 24 subjekte për të cilët është propozuar revokimi i lejes, por pa përcaktuar se në çfarë faze janë nga ana e shqyrtimit të MIE.</p> <p>- Sipas raportit të jometalorëve të vitit 2019 cilësohet se janë 21 leje minerare të shfrytëzimit që bien në zonë të mbrojtur, pa cilësuar se çfarë do të bëhet më tej me këto leje. Janë njoftuar për pezullim aktiviteti 3 subjekte dhe 3 subjekte për revokim.</p> <p>- Në vitin 2020 janë 52 subjekte minerare metalore që kanë kërkuar pezullim të aktivitetit dhe 4 leje që janë propozuar për revokim, dhe në sektorin jometalor janë revokuar 2 leje, si dhe cilësohet se “Theksojmë se në regjistrin elektronik të Lejeve Minerare të Shfrytëzimit kemi leje që ende nuk janë revokuar edhe pse nga ana e AKBN janë bërë propozimet të herëpashershme”. Kjo tregon se nga ana e MIE nuk janë shqyrtuar propozimet e bëra nga AKBN.</p>
Kriteri:	ligji nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, VKM nr.1109, datë 30.7.2008 “Për sigurimin punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë”, VKM nr. 232, datë 23.02.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë”.
Ndikimi:	Në monitorimin e veprimtarisë minerare nga ana e AKBN, konstatohen mangësi pasi nuk mund të konsiderohet që aktiviteti minerar të ndryshojë (përkeqësoj apo përmirësojë) veprimtarinë e tij në vite të veçanta.
Shkaku	- Për periudhën 2018-2022 janë propozuar për pezullim nga ana e AKBN dhe me kërkesë të subjekteve 124 leje, me numrin më të lartë 43 në vitin 2020 dhe më të ulët 4 në vitin 2018.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKBN të marrë masat për njoftimin e subjektit menjëherë me përshkrimin e arsyes së pezullimit për shkeljet që bëhen shkak për pezullim, të konstatuara nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit dhe në të njëjtën kohë ti propozojnë Ministrit për masat e penalitetet që duhet të ndërmerren ndaj subjekteve që nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit minerar mbi bazën e rezultateve të mbikëqyrjes dhe monitorimit të veprimtarive minerare.

Titulli gjetjes:	i <u>Revokimi i lejeve minerare</u> Nga auditimi rezulton se nga AKBN janë ndëshkuar dhe/ose propozuar mesatarisht 18 % e zotëruesve lejeve aktive në periudhën 2018-2022, në pjesën më të madhe me masa administrative gjobë, pastaj <u>revokime</u> dhe në fund janë pezullimet, përfshirë dhe ato me kërkesën e vetë zotëruesve të lejeve.
Situata:	- Për vitin 2021, në sektorin e metaloreve janë propozuar për revokim 9 leje minerare dhe për pezullim 15, janë revokuar 3, dhe cilësohen masa administrative për dy subjekte për mos plotësim kushtesh për Inspektim, qe tek masat administrative të vena në dispozicion figuron vetëm një prej tyre. - Për sektorin minerar jo metalor janë revokuar 4 leje minerare dhe 5 subjekte janë propozuar për revokim.

- Raporti i monitorimit të vitit 2018 shoqërohet me një listë prej 19 subjektësh që janë propozuar në MIE për revokim për mos-pagesë të garancisë së rehabilitimit dhe në vëllimin e dytë. Në këtë raport në vëllimin e parë cilësohet se janë propozuar për revokim gjithsej 45 leje minerare shfrytëzimi, për 37 leje minerare shfrytëzimi ka filluar procedura e revokimit dhe gjatë vitit 2018 janë revokuar 43 leje minerare. Struktura përgjegjëse AKBN, për rastet e propozimit për revokim për shkak të shkeljes ligjore të mos-pagesës së garancisë së rehabilitimit, nuk ka mbajtur akt-konstatimi, por ka dërguar direkt raportin e propozimit në MIE, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit të Ministrit të METE nr.382, datë 20.05.2011 *“Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare”*, pikat 5, 6 dhe 7.

- Nga shqyrtimi i raporteve të monitorimit të AKBN 2018-2022, rezulton se për katër leje të subjektit B. SHA: lejet me nr.15..., datë 22.02.2012; nr. 16..., datë 07.12.2014; nr. 16..., datë 07.02.2014 dhe nr.16..., datë 07.02.2014, megjithëse nuk kanë fare prodhim në periudhën 2014-2021, pra nuk kanë zhvilluar aktivitet minerar pas marrjes së lejes, AKBN vetëm në vitin 2020, pra pas 6 vitesh i ka propozuar MIE revokimin e tyre, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 47, pika 1, germa “c”, i cili përcakton afatin 180 ditë mos fillim të veprimtarisë minerare si shkak për revokimin e lejes.

- Veç kësaj, edhe pas propozimeve të AKBN për revokim 5 leje minerare MIE, sipas raportit të monitorimit të AKBN të 6 mujorit të parë të vitit 2022, nuk ka dhënë asnjë përgjigje lidhur me statusin e këtyre propozimeve, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 47- Procedura e revokimit të lejes, pikat 1, 2, 3 dhe 5 të këtij neni.

- Gjithashtu rezulton se për periudhën 2018 - 2022 mesatarisht për 130 subjekte, AKBN në cilësinë e strukturës përgjegjëse nuk ka ushtruar kompetencat e saj për t'i propozuar MIE revokimin e lejes minerare për mungesë informacioni dhe/ose informacione të pavërteta, sipas kërkesave të pikës 1, germa “gj” të nenit 47, të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar: *“Leja revokohet kur: gj) zotëruesi nuk i paraqet informacionet e kërkuara nga struktura përgjegjëse, paraqet informacione të pavërteta apo pengon strukturën përgjegjëse në ushtrimin e funksioneve të inspektimit, në zbatim të këtij ligji;”*

- Nga ana e AKBN nuk është analizuar zbatimi i kriterëve të nenit 18, pika 1, germa “e” dhe 25 “e”, në se zotëruesi i lejes së shfrytëzimit ka njoftuar jo më pak se 30 ditë kalendarike më parë, për kërkesën e zvogëlimit në më shumë se 20 për qind të sasisë së prodhimit, të parashikuar në planin e miratuar të prodhimit, pjesë e lejes përkatëse.

Kjo pasi nga shqyrtimi i të dhënave të deklaruara nga subjektet minerare për periudhën 2018-2022 janë 182 subjekte që rezultojnë së paku një vit me realizim nën 80% krahasuar me sasinë e prodhimit vjetor të përcaktuar në lejen përkatëse, gjë për të cilën AKBN nuk ka vepruar në zbatim të kërkesave të germës “j” të pikës 1 të nenit 47 të ligjit të mësipërm për të propozuar revokimin e lejes.

- Gjithashtu, nga ana e AKBN nuk është kryer asnjë analizë dhe monitorim lidhur me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 18, pika 1, germa “a” për zotëruesit e lejeve të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, dhe të nenit 25 germa “a” për lejet së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore në se ka realizuar programin e investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre veprimtarive.

	<p>- Sipas të dhënave të subjekteve të deklaruara online në sistemin RevZone të AKBN rezulton se mesatarisht 25 % e subjekteve deklarojnë plan investimi, si dhe nga këto janë 57 % e zotëruesve të lejeve minerare që nuk zbatojnë detyrimin për realizimin e planit të investimeve.</p> <p>- AKBN, nuk ka shqyrtuar dhe analizuar zbatimin e kërkesave të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar, neni 47, pika 1, germa “f”, i cili përcakton që nëse “zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për dy vjet radhazi dështon në realizimin e 90 për qind të vlerës së investimit, që ka parashikuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare” leja revokohet.</p> <p>- Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj informacionet e vënë në dispozicion për periudhën 2020-2022, dhe rezulton se në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 janë përkatësisht 18, 20, 32 dhe 43 subjekte, të cilët kanë dështuar në realizimin e 90 për qind të vlerës së investimit për dy vite radhazi, dhe për të cilët AKBN nuk ka ushtruar kompetencat e veta ligjore në propozimin për revokimin e lejes minerare, sipas kërkesave të nenit 47, pika 1, germa “f” të ligjit minerar.</p>
Kriteri:	ligji nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Urdhrit i Ministrit të METE nr.382, datë 20.05.2011 “Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare”.
Ndikimi:	Zotëruesit e lejeve minerare nuk i paraqesin informacionet e kërkuara nga struktura përgjegjëse, ose paraqesin informacione të pavërteta apo pengojnë strukturën përgjegjëse në ushtrimin e funksioneve të inspektimit, në zbatim të ligji.
Shkaku	Struktura përgjegjëse AKBN, për rastet e propozimit për revokim për shkak të shkeljes ligjore të mos-pagesës së garancisë së rehabilitimit, nuk ka mbajtur akt-konstatimi, por ka dërguar direkt raportin e propozimit në MIE, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit të Ministrit të METE nr.382, date 20.05.2011 “Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare”, pikat 5, 6 dhe 7.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKBN në cilësinë e strukturës përgjegjëse të marrë masat dhe të ushtrojë kompetencat e saj për t’i propozuar MIE revokimin e lejeve minerare për ato subjekte që ushtrojnë veprimtari minerare dhe nuk japin informacionin e kërkuar nga strukturat përgjegjëse, paraqesin informacione të pavërteta, apo pengojnë strukturën përgjegjëse në ushtrimin e funksioneve të inspektimit, në zbatim të këtij ligji.

Pretendimi i subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar AKBN me shkresën nr. 983/14, datë 31.07.2023 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt Raportin, janë sjellë observacionet të cilat shkurtimisht po i paraqesim në raport konkretisht:

Gjetja nr. 7. Kundërvajtjet administrative.

- Ne regjistrit e lejeve minerare te azhornuar Drejtoria Minerare ne AKBN mban pezullimet me kërkesë te subjektit dhe miratuar r.ga MIE dhe jo pezullimet te cilat janë propozuar nga AKBN për një shkelje te konstatuar. Duke mare ne konsiderate rekomandimin tuaj ne akt konstatimet e para ne vijueshmëri te azhornuar ne regjistrit e lejeve do te mbajmë dhe pezullimet dhe me kërkesë te vete subjektit.

- Ne lidhje me mos zbatimin e planit te rehabilitimit te mjedisit te zones minerare bëjmë me dije se, përveç 2 fabrikave te çimentos ne Fushe Kruje qe kane kryer rehabilitimin progresiv, lejet e tjera minerare nuk mund te kryejnë rehabilitim momentalisht sepse janë akoma ne zhvillim te aktivitetit minerar.

- Për mos realizimin e planit te investimit, te parashikuar ne planin vjetor te veprimtarisë minerare dhe projektin e zhvillimit te këtyre veprimtarive ju informojmë si me poshtë: *Investimet ne objektet minerare kryhen zakonisht ne 2-3 vitet e para ku përfshihen: përgatitjen e infrastrukturës se nevojshme për zhvillimin e aktivitet (hapje rruge, ndërtim objektesh etj.), investime ne makineri e pajisje (impiante perpunim-fraksionim ne*

lejet e licencuara për mineralet ndërtimore). Çdo investim tjetër i realizuar ndër vite bën pjesë në koston e prodhimit të mineralit.

- Në zbatim të ligjit mineral nr.10304, dt.15.07.2010, neni 45, pika 2, sanksionet mund të ndërmerren nga struktura përgjegjëse, nëse nga data e kryerjes së shkeljes nuk ka kaluar një periudhë me e madhe se 5 vite kalendarike.

- Nga Drejtoria e Shërbimeve Ligjore janë ndërmarre të gjitha veprimet e nevojshme për kthimin e këtyre masave në tituj ekzekutiv.

- Me vendosjen e masave administrative në vitin 2022, pas kalimit të afatit të ankimit në MIE, drejtoria minerare i ka dërguar shkresë drejtorisë së shërbimeve ligjore si vijon: shkresa nr. prot. 2145 dt.24.04.2023; shkresa rr. prot. 1195 dt.2C.02.2023; shkresa nr. prot. 4487 dt.25.10.2022; shkresa nr. prot. 3375, dt.11.08.2022, shkresa nr. prot. 4257 dt.10.10.2022. Në bashkëpunim të mëtejshëm me drejtorinë e shërbimeve Ligjore do të ndiqen në vijimësi pagesat mbi masat administrative.

Gjetja nr. 8. Pezullimi i lejeve minerare

- Pra 71 subjektet e cituara më lart janë pezullime me kërkesë të vete subjektit (për arsye të kushteve atmosferike, mungesa e tregut ndërkombëtar, fuqia punëtore etj.) Në shkresat për pezullimet e aktivitetit mineral për mosmiratim të planit vjetor është rënë në konsideratë neni 18, pika 1, germa 9, për mospërbushje të detyrimeve ligjore. Në vijueshmëri, do merret në konsideratë rekomandimi juaj, duke iu përmbajtur neni 46, pika 1, germa c, të ligjit mineral.

- Për sa i përket pyetjes Suaj se në raportin e vitit 2019 nga sektori Jometalor ku cilësohet se janë 21 subjekte minerare që bien në zonë të mbrojtur Ju informojmë se kjo nuk është objekt i AKBN-se por i Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që bëjnë politikat mjedisore.

Gjetja nr. 9. Revokimi i lejeve minerare

- Shumë propozime për revokim bëhen për shkak të mos pagesës së garancisë së rehabilitimit dhe pushohet në momentin që kryhet pagesa nga ana e zotëruesit të lejes minerare.

- Në zbatim të Ligjit Mineral nr. 10304, datë 15.07.2010, i arënuar, neni 43, pika 4 "Struktura përgjegjëse ka të drejtë të kryejë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij ligji, të lere detyra, të marrë masa administrative apo të propozojë marrjen e tyre nga Ministri. A.K.B.N-ja, si struktura në varësi të M.I.E-s, ka të drejtën e propozimit të masave (përfshirë propozonin për revokim) në organin kompetent. Fillimi/Anullimi i procedurave si dhe Revokimi/Anullimi i masës së revokimit është kompetencë e M.I.E-s.

- Gjithashtu rezultoi se për periudhën 2018 - 2022 rresatarisht për 130 subjekte, AKBN në cilësimin e strukturës përgjegjëse nuk ka ushtruar kompetencat e saj për t'i propozuar MIE revokimin e lejes minerare për mungesë informacioni dhe/ose informacione të pavërteta, sipas kërkesave të pikës 1, germa "gj" të neni 47, të ligjit mineral nr. 10304, datë 15.7.2010.

Gjetja juaj lidhur me këtë çështje qëndron. Arsyet e mosveprimit të lidhen me: Njeri nga problemet kryesore është mungesa e tregut të shitjes. Problemi tjetër i 3 (tre) apo 4 (katër) viteve të fundit janë dhe fenomenet si tërmeti i vitit 2019 apo pandemia e vitit 2020.

- Investimet në objektet minerare kryhen zakonisht në 2-3 vitet e para ku përfshihen: përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e aktivitetit (hapje rrugë, ndërtim objektesh etj.), investime në makineri e pajisje (impiante perpunim-fraksionim në lejet e licencuara për mineralet ndërtimore). Çdo investim tjetër i realizuar ndër vite bën pjesë në koston e prodhimit të mineralit.

Gjetje nga Auditimi:

- Sipas të dhënave të subjekteve të deklaruara online në sistemin RevZone të AKBN rezultoi se mesatarisht 25 % e subjekteve deklarojnë plan investimi, si dhe nga këto janë 57 % e zotëruesve të lejeve minerare që nuk zbatojnë detyrimin për realizimin e planit të investimeve.

Sqarim mbi gjetjen: Një rekomandim i tillë qëndron. Edhe në Raportet Vjetore të kryera ndër vite, nga sektorët, është vënë re dhe është konstatuar që disa vlera mund të jenë gabim ose edhe të pashënuara. Kjo vjen si pasojë se shumë subjekte apo punonjës të tyre e kanë të vështirë përshtatjen me sistemin online RevZone.

- Gjate kontrollit është vënë re që ka edhe subjekte të cilat nuk kanë investuar akoma, por kjo vjen për shkak të arsyeve si: procese gjyqësore, konflikte të ndryshme me banoret përreth ose institucione të ndryshme si dhe procedurave të zgjatura për heqjen e sipërfaqes nga fondi pyjor/kullor.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me observacionet e bëra nga subjekti i audituar MIE për Projektin e auditimit, dërguar me shkresën nr. 983/14, datë 031.07.2023 dhe pse të përsëritura pa sjellë argumente të reja, grupi i auditimit gjykon se:

Për Gjetjen nr. 7. Kundërvajtjet administrative...

- Referuar neni 45 të ligjit mineral nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, rezultoi se struktura përgjegjëse AKBN nuk ka ushtruar në mënyrë të plotë të drejtat dhe detyrimet e veta lidhur me rastet e penalizimit të masës administrative gjorbë për mos zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare dhe planit të menaxhimit të mbetjeve minerare; për mos sigurimin jetës dhe shëndetit të punonjësve; për mos njoftimin jo më pak se 30 ditë kalendarike më parë, nëse kërkohet ta zvogëlojë më shumë se 20 për qind sasinë e prodhimit, të parashikuar në planin e miratuar të prodhimit, pjesë e lejes përkatëse; për mos realizimin e programit të investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre

veprimtarive; të mos njoftimit ose të mungesës së informacioneve dhe shpjegimeve, jo më pak se 1 vit para, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar etj. duke vepruar në mënyrë të njëanshme dhe me pasoja si në zhvillimin dhe përparimin e sektorit minerar, ashtu dhe me ndikim në të ardhurat buxhetore nga burime të planifikuara (renta minerare) dhe të paplanifikuara (gjobat).

- Nga të dhënat e AKBN rezultojnë se vlera gjithsej e gjobave për 210 rastet e periudhës 2018-2022 është në vlerën 28,100 mijë lekë. AKBN nuk ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH, të dhëna për datën e njoftimit të subjektit për shkeljen, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 45, pika 3 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar që kërkon që shkeljet kur konstatohen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit i njoftohet subjektit menjëherë, duke përshkruar shkeljen.

- Referuar të dhënave nga AKBN për masat administrative, rezultojnë se janë 35 subjekte të cilat janë penalizuar me masa administrative më shumë se dy herë duke vendosur të njëjtën vlerë të gjobës, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 45, pika 7. “Kryerja për herë të dytë nga i njëjti subjekt i shkeljeve të parashikuara në shkronjat “d” dhe “dh” të pikës 1 të këtij neni dënohet me dyfishin e gjobës së parashikuar dhe mund të shoqërohet me pezullimin e lejes minerare deri në plotësimin detyrimit.”, pra duhej të ishte dyfishi i saj, deri në pezullimin me plotësimin e detyrimit.

Për Gjetjen nr. 8. Pezullimi i lejeve minerare

- Pra 71 subjektet e cituara janë pezullime me kërkesë të vete subjektit (për arsye të kushteve atmosferike, mungesa e tregut ndërkombëtar, fuqia punëtore etj.) Ne shkresat për pezullimet e aktivitetit minerar për mosmiratim të planit vjetor është rnarre në konsideratë neni 18, pika 1, germa 9, për mos përbushje të detyrimeve ligjore. Është marrë në konsideratë rekomandimi, duke iu përmbajtur nenit 46, pika 1, germa c, të ligjit minerar.

- Në vitin 2020 janë 52 subjekte minerare metalore që kanë kërkuar pezullim të aktivitetit dhe 4 leje që janë propozuar për revokim, dhe në sektorin jometalor janë revokuar 2 leje, si dhe cilësohet se “Theksojmë se në regjistrin elektronik të Lejeve Minerare të Shfrytëzimit kemi leje që ende nuk janë revokuar edhe pse nga ana e AKBN janë bërë propozimet të herëpashershme”. Kjo tregon se nga ana e MIE nuk janë shqyrtuar propozimet e bëra nga AKBN.

Për Gjetjen nr. 9. Revokimi i lejeve minerare

- Raporti i monitorimit të vitit 2018 shoqërohet me një listë prej 19 subjektësh që janë propozuar në MIE për revokim për mos-pagesë të garancisë së rehabilitimit dhe në vëllimin e dytë. Në këtë raport në vëllimin e parë cilësohet se janë propozuar për revokim gjithsej 45 leje minerare shfrytëzimi, për 37 leje minerare shfrytëzimi ka filluar procedura e revokimit dhe gjatë vitit 2018 janë revokuar 43 leje minerare. Struktura përgjegjëse AKBN, për rastet e propozimit për revokim për shkak të shkeljes ligjore të mos-pagesës së garancisë së rehabilitimit, nuk ka mbajtur akt-konstatimi, por ka dërguar direkt raportin e propozimit në MIE, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit të Ministrit të METE nr.382, datë 20.05.2011 “Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare”, pikat 5, 6 dhe 7.

- Gjithashtu rezultojnë se për periudhën 2018 - 2022 mesatarisht për 130 subjekte, AKBN në cilësinë e strukturës përgjegjëse nuk ka ushtruar kompetencat e saj për t'i propozuar MIE revokimin e lejes minerare për mungesë informacioni dhe/ose informacione të pavërteta, sipas kërkesave të pikës 1, germa “gj” të nenit 47, të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010.

- AKBN, nuk ka shqyrtuar dhe analizuar zbatimin e kërkesave të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar, neni 47, pika 1, germa “f”, i cili përcakton që nëse “zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për dy vjet radhazi dështon në realizimin e 90 për qind të vlerës së investimit, që ka parashikuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare” leja revokohet.

Gjykojmë se nga AKBN nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart argumentet e sjella, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

C-Veprimtaria postminerare e AKBN 2018-2022

Referuar ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 43, pika 2, germa “ç”, përcakton se struktura përgjegjëse ka për funksion: “monitorimin minerar e postminerar të minierave të mbyllura dhe në regjim konservimi”, si dhe “monitorimin e depozitimeve të mbetjeve minerare të minierave në veprimtari të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi” (germa “d”).

Sipas VKM nr. 232, datë 23.02.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë”, në pikën 2 të tij janë përcaktuar detyrat e AKBN lidhur me monitorimin minerar dhe post minerar të minierave të mbyllura në regjim konservimi (germa “f”) dhe mbikëqyrjen dhe monitorimin e depozitimeve të mbetjeve

minerare në veprimtari shfrytëzimi, të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi (germa “f”).

Në zbatim të Statut-rregullores së funksionimit të AKBN, në nenin 16 ka përcaktuar objektin e veprimtarisë së Drejtorisë Minerare, ku midis të tjerave është edhe mbikëqyrja e veprimtarisë minerare e postminerare dhe raportimi për gjendjen aktuale; monitorimi i mbylljes së veprimtarisë minerare etj.

Në Rregulloren e brendshme të AKBN, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 23.01.2018 të Drejtorit Ekzekutiv, në nenin 2 ka të përcaktuar për mision, midis të tjerave: mbikëqyrjen e veprimtarisë minerare, postminerare; monitorimin e mbylljes së veprimtarisë minerare; administrimin ekskluzivisht të të gjitha të dhënave parësore të sektorit hidrokarbur dhe të dhënat që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare etj., dhe në nenin 4, pika 3/a: *“Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së, është titullari i institucionit të AKBN-së, dhe ka përgjegjësinë për zbatimin e politikave qeveritare në fushën e zhvillimit, mbikëqyrjes, shfrytëzimit racional të burimeve natyrore dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar”*.

Referuar pikës 24 të nenit 2 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar. *“Monitorim minierar dhe postminierar” është vëzhgimi, regjistrimi, mbajtja nën kontroll i ndryshimeve fiziografike të tokës, ajrit, ujërave, sipërfaqësore apo nëntokësore, dhe ekosistemit në përgjithësi, në zonat ku ushtrohet apo është ushtruar veprimtari minerare, në zonat përreth tyre, si dhe marrja e masave parandaluese për fenomenet negative, që shfaqen gjatë apo pas veprimtarisë minerare.”*

Nga ana organizative, Drejtoria Minerare në AKBN ka në përbërje Sektorin e Monitorimit Postminierar (1 shef sektori dhe 3 specialistë), i cili përgjigjet për monitorimin minierar dhe postminierar të minierave të mbyllura në regjim konservimi dhe për mbikëqyrjen dhe monitorimin e depozitimeve të mbetjeve minerare të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi.

Lidhur me këtë çështje, grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj raportet e vëna në dispozicion në mbi “Monitorimin e fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura” për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, të cilët pasqyrojnë veprimtarinë e AKBN në lidhje me monitorimin postminierar, sipas kërkesave të kuadrit ligjor dhe nënligjor të mësipërm.

Nga ana e Drejtorisë Minerare të AKBN, këto raporte cilësohen projekte pjesë e investimeve publike të parashikuara në buxhetin vjetor, dhe jo si pjesë të veprimtarisë funksionale dhe të raportimit, në përputhje me detyrat përkatëse.

Sipas tyre, në këto raporte trajtohen të dhëna të përgjithshme për minierat e mbyllura, statusi aktual i tyre, gjendja dhe problematika e objekteve minerare në përbërje të tyre, shoqëruar me foto dhe analiza, si dhe jepen rekomandime institucioneve vendimmarrëse, për zgjidhjen e problemeve. Pra nuk ezaurohen plotësisht çështjet e monitorimit postminierar në lidhje me regjistrimin, mbajtjen nën kontroll të ndryshimeve fiziografike të tokës, ajrit, ujërave, sipërfaqësore apo nëntokësore, dhe ekosistemit në përgjithësi, në zonat ku është ushtruar veprimtari minerare, në zonat përreth tyre, si dhe marrja e masave parandaluese për fenomenet negative, që shfaqen pas veprimtarisë minerare.

Nga shqyrtimi këtyre projekteve konstatohet se, në listën e minierave shtetërore, konsiderohen miniera te mbyllura si më poshtë:

- 25 miniera bakri gjithsej, nga të cilat 25 të mbyllura dhe 3 pa status;
- 19 miniera qymyrguri gjithsej me statusin mbyllur;
- 2 miniera hekur-nikel dhe nikel-silikat pa status;
- 17 miniera të mineraleve te tjera, nga të cilat 1 e licencuar, 2 pa status dhe 14 të mbyllura;
- 11 fabrika pasurimi, të mbyllura;
- 2 miniera hekur-nikeli me statusin revokuar dhe mbyllur;
- 14 miniera bakri te tjera, nga të cilat 7 me leje dhe 7 të licencuara.

Këto raporte për gjithë periudhën 4 vjeçare 2018 - 2021 ruajnë strukturë të njëjtë në përmbajtje: hyrje, bazën ligjore, listën e minierave shtetërore të braktisura, problematikat e shfaqura në sektorin privat me minierat e braktisura dhe të revokuara, të ndara për minierat e kromit, qymyrgurit, bakrit, hekur nikelit, jometalore me nëntokë, monitorimi i ujerave nëntokësore, problemet që lindin nga mbyllja e minierave, si dhe përfundime e rekomandime.

Raporti i vitit 2019 është kopjim i raportit të vitit 2018, me harta, fotografi në disa raste të shtuara, si dhe tekst, i shoqëruar me shënimin “*Gjatë vitit 2019 nuk ka qenë e mundur të bëhet kontrolli i mbylljes së këtyre punimeve të miratuar për mbyllje që në vitin 2018.*” ose “*Nuk jemi në dijen të kryerjes së investimeve për mbylljen e këtyre punimeve minerare gjatë vitit 2019*”.

Raporti përkatësisht prej 196 faqe në vitin 2018 dhe 207 faqe në vitin 2019 është i mbushur me përshkrime të minierave lidhur me vendndodhjen, hapjen dhe shfrytëzimin e vendburimit etj., por që nuk kanë të bëjnë me çështjet e monitorimit.

Monitorimi është trajtuar teorikisht por nuk merret përgjigje për zbatimin e kësaj detyre nga ana e sektorit përkatës. Nuk arrihet të merret informacion se cili është numri i minierave të monitoruara të mbyllura në regjim konservimi dhe nuk gjen trajtim monitorimi i depozitimeve të mbetjeve minerare të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi.

Raportet e secilit vit 2019, 2020 dhe 2021 nuk ndryshojnë midis tyre lidhur me pasayrimin e aktiviteteve të ndryshme të monitorimit. Në këtë mënyrë nuk marrin përgjigje çështjet e monitorimit që kanë të bëjnë me vëzhgimin, regjistrimin, mbajtjen nën kontroll të ndryshimeve fiziografike të tokës, ajrit, ujërave, sipërfaqësore apo nëntokësore, dhe ekosistemit në përgjithësi, në zonat ku është ushtruar veprimtari minerare, në zonat përreth tyre, si dhe marrja e masave parandaluese për fenomenet negative, që shfaqen pas veprimtarisë minerare.

Nga shqyrtimi raporteve nga audituesit e KLSH, nuk evidentohen informacione mbi zbatimin e procedurave të mbylljes së objektit mineral të minierave të braktisura të shfrytëzuar nga shteti, minierat e kaluara në regjim mbylljeje për të cilat zotëruesi i lejes minerare ka braktisur veprimtarinë minerare, si dhe kontrollin e zbatimit të planit të rehabilitimit, sipas kërkesave të nenit 53 të ligjit mineral.

Gjithashtu, nuk gjejnë pasqyrim në se i janë propozuar MIE zonat e lejeve minerare për konservim, në bazë të një projekti konservimi, që përfshin një plan konservimi dhe monitorimi postmineral, duke mbikëqyrur e procesin e konservimit, në zbatim të kërkesave të nenit 54 të ligjit mineral.

Sipas Raporteve, në vitin 2018 (faqe 9-10) janë 39 leje të revokuara dhe deri në këtë vit janë gjithsej 313 leje të revokuara dhe 25 në proces revokimi; gjatë vitit 2019 janë revokuar 50 leje minerare; gjatë vitit 2020 janë revokuar 9 leje minerare dhe gjatë vitit 2021 janë revokuar 13 leje minerare, me rezultat progresiv në fund të vitit 2021 gjithsej 385 leje minerare të revokuara. Pra konstatohet një numër i konsiderueshëm i lejeve minerare të revokuara, për të cilat AKBN nuk disponon informacion mbi statusin aktual të tyre.

Gjithashtu, AKBN nuk ka informacion dhe nuk ka monitoruar zbatimin e planit të rehabilitimit, i cili është detyrim i zotëruesit të lejes që duhet të veprojë pas revokimit të lejes, në referencë të pikës 1 të nenit 49 të ligjit mineral.

Nuk gjejnë pasqyrim çështjet monitorimit të depozitimeve të mbetjeve minerare të minierave në veprimtari të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi, të përcaktuara në germën “d” të pikës 2 të nenit 43 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Duhet theksuar, hartimi i këtyre projekteve “*Monitorimi i fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura*” të mangëta dhe të kopjuara nga viti në vit, janë pjesë e investimeve publike të parashikuara në buxhetet vjetore, bazuar në ligjin e buxhetit për MIE me vlerat si më poshtë.

Tabela nr. 22 Vlerat e investimit për hartimin e projekteve për monitorimin e minierave të mbyllura 2018-2021

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	2018	2019	2020	2021	Gjithsej
1	Programi 04430, kodi i projektit të investimeve M 064062	8,000	5,400	6,400	6,400	26,200

Burimi: Të dhëna të AKBN të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi hartuesit e raportit “Monitorimi i fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura” sipas viteve.

Titulli gjetjes:	i Veprimtaria monitoruese e AKBN lidhur me monitorimin mineral dhe post mineral të minierave të mbyllura në regjim konservimi; me mbikëqyrjen dhe monitorimin e depozitimeve të mbetjeve minerare në veprimtari shfrytëzimi, të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi dhe me raportimin për gjendjen aktuale të tyre ka rezultuar me mangësi.
Situata:	<p>- Nga ana e AKBN, këto raporte monitorimi cilësohen projekte pjesë e investimeve publike të financuara në buxhetin vjetor, dhe jo si pjesë të veprimtarisë funksionale dhe të raportimit, në përputhje me detyrat përkatëse;</p> <p>- Raportet nuk ezaurojnë plotësisht çështjet e monitorimit postmineral në lidhje me regjistrimin, mbajtjen nën kontroll të ndryshimeve fiziografike të tokës, ajrit, ujërave, sipërfaqësore apo nëntokësore, dhe ekosistemit në përgjithësi, në zonat ku është ushtruar veprimtari minerare, në zonat përreth tyre, si dhe marrja e masave parandaluese për fenomenet negative, që shfaqen pas veprimtarisë minerare, në kundërshtim me përcaktimet e funksionet e monitorimit mineral dhe postmineral, të përcaktuara në pikën 24 të nenit 2 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar.</p> <p>- Raportet ruajnë strukturë të njëjtë dhe nuk ndryshojnë thelbësisht në përmbajtje gjë që tregon për mungesë thellimi të veprimtarisë në këtë drejtim, si dhe dhe mungesë efektivitetit të funksionimit të strukturës përgjegjëse.</p> <p>- Sipas Raporteve, deri në fund të vitit 2021 janë gjithsej 385 leje minerare të revokuara, për të cilat AKBN nuk disponon informacion mbi statusin aktual të tyre, gjë që tregon mangësi komunikimi nga ana e MIE kundrejt strukturës përgjegjëse.</p> <p>- Në raporte nuk gjejnë pasqyrim çështjet monitorimit të depozitimeve të mbetjeve minerare të minierave në veprimtari të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi, sipas përcaktimeve në germën “d” të pikës 2 të nenit 43 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar.</p> <p>- Nga shqyrtimi i raporteve konstatohet se, AKBN nuk ka një informacion të plotë dhe të detajuar për zbatimin e planit të rehabilitimit, zbatimin e procedurave të mbylljes së minierave të braktisura të shfrytëzuar nga shteti, si dhe mungon një pasqyrim plotë për zonat e lejeve minerare të propozuara për konservim.</p> <p>- Mangësitë e mësipërme kanë sjellë për pasojë uljen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike në vlerën gjithsej prej 26,200 mijë lekë të përdorura në periudhën 2018-2021 si investime në hartimin e raporteve vjetore “Monitorimi i fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura”.</p>
Kriteri:	ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregulloren e brendshme të AKBN, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 23.01.2018, VKM nr. 232, date 23.02.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin mineral të Republikës së Shqipërisë”.
Ndikimi:	Mangësitë e konstatuara kanë sjellë për pasojë uljen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike në vlerën gjithsej prej 26,200 mijë lekë të

	përdorura në periudhën 2018-2021 si investime në hartimin e raporteve vjetore “ <i>Monitorimi i fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura</i> ”.
Shkaku	AKBN nuk ka një informacion të plotë dhe të detajuar për zbatimin e planit të rehabilitimit, zbatimin e procedurave të mbylljes së minierave të braktisura të shfrytëzuar nga shteti, si dhe mungon një pasqyrim plotë për zonat e lejeve minerare të propozuara për konservim.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKBN në të ardhmen të mara masat për hartimin e raporteve të monitorimit me një informacion të plotë dhe të detajuar për zbatimin e planit të rehabilitimit, zbatimin e procedurave të mbylljes së minierave të braktisura të shfrytëzuar nga shteti, si dhe hartimi i një pasqyrimi të plotë për zonat e lejeve minerare të propozuara për konservim me qëllim rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike si investime në hartimin e raporteve vjetore mbi monitorimin e fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura.

Pretendimi i subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar AKBN me shkresën nr. 983/14, datë 31.07.2023 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt Raportin, janë sjellë observacionet të cilat shkurtimisht po i paraqesim në raport konkretisht:

Gjetja nr. 10. Mbi veprimtarinë postminerare të AKBN 2018-2022.

- Për realizimin e projektit të monitorimit të fenomeneve post-minerare, AKBN-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe si i tillë ky projekt cilësohet pjesë e investimeve publike të parashikuara në buxhetet vjetore përkatëse kjo e bazuar në ligjin e buxhetit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

- Nuk ka qene e mundur te kryhet realizimi i plote i projektit "Monitorimi i fenomeneve te post-shfrytëzimit minerar" për vitet nga 2018 deri 2022 për shkak të mungesës së fondeve dhe mjeteve të transportit.

- Fenomenet post-minerare janë probleme që ndodhin rrallë aq më tepër që minierat e mbyllura kanë rreth 30 vjet në atë gjendje dhe presionet minerare janë stabilizuar. Ndryshimet që kemi konstatuar i kemi pasqyruar në raportet vjetore. Po kështu edhe baza ligjore nuk ka ndryshuar dhe kjo është arsyeja që këto raporte ruajnë të njëjtën strukturë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me observacionet e bëra nga subjekti i audituar MIE për Projekt Raportin e auditimit, dërguar me shkresën nr. 983/14, datë 031.07.2023 edhe pse të përsëritura pa sjellë argumente të reja, grupi i auditimit gjykon se:

Për Gjetjen nr. 10. Mbi veprimtarinë postminerare të AKBN 2018-2022.:

- *Raportet nuk ezaurojnë plotësisht çështjet e monitorimit postminerar në lidhje me regjistrimin, mbajtjen nën kontroll të ndryshimeve fiziografike të tokës, ajrit, ujërave, sipërfaqësore apo nëntokësore, dhe ekosistemit në përgjithësi, në zonat ku është ushtruar veprimtari minerare, në zonat përreth tyre, si dhe marrja e masave parandaluese për fenomenet negative, që shfaqen pas veprimtarisë minerare, në kundërshtim me përcaktimet e funksionet e monitorimit minerar dhe postminerar, të përcaktuara në pikën 24 të nenit 2 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar.*

- *Raportet ruajnë strukturë të njëjtë dhe nuk ndryshojnë thelbësisht në përmbajtje gjë që tregon për mungesë thellimi të veprimtarisë në këtë drejtim, si dhe mungesë efektivitetit të funksionimit të strukturës përgjegjëse.*

- *Në raporte nuk gjejmë pasqyrim çështjet monitorimit të depozitimeve të mbetjeve minerare të minierave në veprimtari të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi, sipas përcaktimeve në germën “d” të pikës 2 të nenit 43 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar.*

- *Nga shqyrtimi i raporteve konstatohet se, AKBN nuk ka një informacion të plotë dhe të detajuar për zbatimin e planit të rehabilitimit, zbatimin e procedurave të mbylljes së minierave të braktisura të shfrytëzuar nga shteti, si dhe mungon një pasqyrim plotë për zonat e lejeve minerare të propozuara për konservim.*

Gjykojmë se nga AKBN nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart argumentet e sjella, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

2.3 Auditim mbi përdorimin e fondit pyjor dhe kullor publik nga subjektet e licencuara në fushën e minierave dhe procedurat e ndjekura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në përdorimin e territorit për këtë qëllim.

Në referencë të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 15, pika 5 dhe neni 24, pika 10, me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, si dhe për lejet e shfrytëzimit me karrierë, të grupit të metaleve ndërtimore, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullor, pronë shtetërore, zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrohet në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

Sipas pikës 32, të nenit 2 të ligjit të mësipërm, nga heqja e sipërfaqes nga fondi pyjor e kullor krijohet “Kadastra minerare”, që është një regjistër i veçantë inventarizimi sistematik i të dhënave për sendet e paluajtshme, mbështetëse të veprimtarisë minerare, tokë, ndërtesa dhe instalime të sipërfaqes apo nëntokës, në aspektin teknik, ekonomik, dhe të dhëna të tjera për zonat e lejuara minerare, të cilat regjistrohen pas heqjes nga fondi pyjor e kullor.

Në zbatim të nenit 44 të ligjit të mësipërm, ish-Ministri i METE, (ministri përgjegjës për politikën e sektorit minerar), ka nxjerrë Urdhrin nr.384, datë 20.05.2011 “Për miratimin e procedurave të regjistrimit dhe dokumentacionit që regjistrohet në Kadastrën Minerare dhe në Regjistrin Minerar, si dhe forma dhe procedurat e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare”. Megjithatë ky Urdhër nuk pasqyron ndryshimet që kanë ndodhur më pas në ligjin minerar: ligji nr. 9/2013, datë 14.02.2013; ligji nr. 134/2014, datë 10.09.2014 dhe nr. 65/2021, datë 20.5.2021, në pikën 12 është përcaktuar: “Të dhënat që kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme të krijuara nga zotëruesi i lejes minerare që përfshihen në kadastrën minerare në regjistrohen në këtë kadastrë pas kërkesës së zotëruesit të lejes minerare që vërteton pronësinë e tyre në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për pronësinë e paluajtshme”. Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) është institucioni që mban kadastrën minerare.

Sipas VKM nr.1353, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor” i ndryshuar, janë personat, fizikë ose juridikë apo bashkitë, për pyjet bashkiake, të cilët legjitimohen të paraqesin kërkesën për heqjen e një sipërfaqeje nga fondi pyjor në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, (pika 1 dhe 4 e tij).

Pas depozitimit të kërkesës së shoqëruar me dokumentacionin përkatës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki identifikimin e ngastrave e të nën ngastrave të kërkuara dhe hartimin e raportit teknik për to, brenda 1 jave nga data e marrjes së kërkesës dhe ky raport i përcillet ministrisë brenda 10 ditëve nga data që ajo e ka kërkuar.

Koha e përcaktuar për shqyrtimin e dokumentacionit nga ministria është caktuar 1 muaj, pa përfshirë kohën për plotësimin dhe saktësimin e dokumentacionit, në se kërkohet një gjë e tillë.

Pra, koha normale për procedurën e shqyrtimit të kërkesës për heqjen e një sipërfaqeje nga fondi pyjor në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit duhet të zgjasë rreth 1 muaj e gjysmë (47 ditë=7+10+30).

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (Departamenti i Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura), gjatë periudhës 2018-2022, janë finalizuar **8 praktika** të heqjes nga fondi pyjor, (*nxjerrë urdhra të ministrit ose miratuar VKM*), nga të cilat, në 2 subjekte- zotërues të lejes minerare të shfrytëzimit (ZLMSH) me sipërfaqe deri në 1 (një) ha dhe në 6 ZLMSH të tjera me sipërfaqe mbi 1 (një) ha dhe për këtë

kategori të fundit është propozuar dhe miratuar VKM, në një kohë që gjatë kësaj periudhe, referuar të dhënave të gjeneruara nga sistemi RevZone i AKBN-së, janë pajisur me leje minerare të shfrytëzimit **79 subjekte** gjithsej, (përkatësisht 17 leje të reja gjatë v.2018, 16 leje të reja gjatë v.2019, 13 leje të reja gjatë v.2020, 22 leje të reja gjatë v.2021 dhe 11 leje të reja gjatë v.2022).

Rezulton se, miratimet e dhëna nga ana e ministrisë përgjegjëse për mjedisin gjatë periudhës 2018-2022, u përkasin kërkesave dhe aplikimeve të viteve të mëparshme, pasi: 1 kërkesë është paraqitur që në vitin 2016, 4 kërkesa janë iniciuar në vitin 2017, 2 në vitin 2018 dhe 1 në vitin 2020. Për sa më sipër, konstatohet se, nga 79 leje të dhëna për 2018-2022, janë kryer procedurat e heqjes nga fondi pyjor vetëm për 3 prej tyre, ose për **3.7% të tyre**.

Tabela nr.23 Procedurat e heqjes nga fondi pyjor/kullosor të MTM në periudhën 2018-2022

Nr	Subjekti	Kërkesa (nr... datë)	Lloji Aktivitetit	Raporti teknik nga bashkia (Nr., datë)	miratimi me VKB (Nr., datë)	Statusi	Sip hequr HA	Shënimi i MTM
1	S. XH	nr. 2247, dt. 3.01.2018	shfrytëzim kromi, objekti K., bashkia Tropoje, leje shfrytëzimi nr. 18..., dt. 1.11.2017	nr. 2487/1, dt. 19.04.2018	nr. 1346/4, dt. 12.04.2018	miratuar urdhër nr. 238, dt. 19.06.2018	0.987	
2	P. N	nr.1886, dt. 13.12.2017	shfrytëzimin e mineralit ranor silicor, objekti Z., bashkia Skrapar, leje shfrytëzimi nr. 18..., dt. 9.11.2017	nr. 1562, dt. 23.02.2018	dt. 21.02.2018	miratuar me VKM nr. 427, dt. 11.07.2018	3.1	
3	D.	dt. 20.02.2017	shfrytëzimin e mineralit ranor pllakor, objekti B. K., bashkia Skrapar, leje shfrytëzimi nr.17..., dt. 21.09.2015	dt. 10.04.2017	nr. 39, dt. 5.07.2017	miratuar me VKM nr. 574, date 3.10.2018	3.13	periudhe zgjedhesh
4	F. G	dt. 11.04.2016 (plotësimi dok dt 16.01.2017)	shfrytëzimin e mineralit ranor pllakor, objekti G. Z, bashkia Elbasan, leje shfrytëzimi nr. 17..., datë 5.11.2015	10.05.2017	2086/1, dt. 10.05.2017	miratuar me VKM nr. 575, dt. 3.10.2018	4	periudhe zgjedhesh
5	S.(D. H)	317/2, dt. 3.11.2017	shfrytëzim gur gëlqeror, objekti P., bashkia Maliq, leje shfrytëzimi nr. 18..., dt. 4.09.2017	dt. 3.01.2018	nr. 6, dt. 28.01.2019	miratuar me VKM nr. 152, dt. 20.03.2019	12	
6	K.	8048, dt. 8.10.2018	shfrytëzimin e gurit gëlqeror, objekti P., bashkia Devoll, leje minerare nr.10..., datë 23.09.2017	1678, dt. 18.02.2019	nr. 7, dt. 23.01.2019	miratuar urdhër nr. 258, dt. 19.07.2019	0.95	
7	K.	62, dt. 7.05.2017	shfrytëzim kromi, objekti K. Th, bashkia Bulqize, leja minerare nr. 58..., dt. 7.12.2000	dt. 16.02.2018	nr. 39, dt. 24.10.2019	miratuar VKM nr. 309, dt. 26.05.2021	5.37449	
8	V.	5707, dt. 17.08.2020	për shfrytëzimin e mineralit të bazaltit , objekti R., bashkia Mirdite, leje shfrytëzimi nr. 18..., dt. 27.02.2020	6920, dt.19.10.2020	nr.87, dt. 30.09.2020	miratuar VKM nr. 310, dt. 26.05.2021	2.874	

Burimi: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Departamentin e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura.

Veç kësaj, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në ato **8 raste** të miratuara, nuk ka respektuar afatet e procedurës së shqyrtimit të kërkesave për heqjen nga fondi pyjor, pasi ka zgjatur nga 5 - 48 muaj, kur sipas VKM nr.1353, datë 10.10.2008 afati optimal është rreth 1.5 muaj. Kështu, p.sh., vetëm për ZLMSH “K.” SHPK, kërkesa e depozituar me datën 7 maj 2017 ka marrë statusin e heqjes së zonës pronë shtetërore, nga zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore” dhe riklasifikimin e këtij zëri kadastral, vetëm me datën 26 maj 2021.

Sipas komunikimit zyrtar me Departamentin e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura/MTM, procedura për heqjen nga fondi pyjor/kullosor karakterizohet nga vonesa dhe mungesë respektimi të afateve nga këshillat bashkiake dhe strukturat e tjera vendore në hartimin e raporteve të ndryshme, etj.

Rrjedhimisht, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka vepruar për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve të lejeve minerare për zotëruesit e lejeve minerare, duke u bërë shqetësim për subjektet aktive të kësaj fushe, pavarësisht faktit se nga ana e ZLMSH janë përmbushur të gjithë detyrimet ligjore duke përfshirë edhe pagesat e kostove të ndryshme, (të tilla si, ata për hartimin e raporteve tekniko-ekonomike, pagesa e tarifës zyrtare të shërbimit për llogari të MTM-së dhe që dorëzohet së bashku me kërkesën për aplikim të heqjes nga fondi pyjor-kullosor, shpenzimet për noterizimin e dokumentacionit etj.).

Nga shqyrtimi dhe analizimi i procedurave të ndjekura nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në lidhje me lejet minerare në Bashkinë Bulqizë dhe Bashkinë Dimal për vitet 2018-2022) evidentohet se: pas një procedure të gjatë burokratike e zyrtare që ndjekin ZLMSH për heqjen nga fondi pyjor, në një numër rastesh (sidomos për situatat që kërkohet hartimi dhe miratimi i VKM përkatëse), MTM ka njoftuar subjektet private aplikuese se “...duke qenë se sipërfaqja e kërkuar për shfrytëzim minerar është mbi 1 ha, parashikohet miratimi me VKM dhe jo me urdhër ministri. ...Ju bëjmë me dije se Ministria është në fazën e analizës së situatës që ka prodhuar heqja nga fondi pyjor duke dëmtuar shpesh mjedisin, nëpërmjet nxjerrjes së akteve nënligjore si dhe në zbatim të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”. Më hollësisht, për subjektet e testuara konstatohet kjo ecuri në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore mbi ushtrimin e veprimtarisë minerare në zonat minerare pasi janë cilësuar të tilla në zërin kadastral përkatës:

1. **Sh. SHPK**, paraqitur në MTM kërkesa datë 26.02.2018 dhe dërguar plotësim të dokumentacionit me datë 13.03.2018. Nga ana e ministrisë më pas i është kërkuar bashkisë Bulqizë për hartim të raportit tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakortësisë (shkesa nr. 1340/1, datë 16.03.2018). Është kthyer përgjigje me shkesën nr. 10371/1, datë 24.12.2019 për dakortësinë me vendim të këshillit bashkiak, (vendimi i rregullt i këshillit bashkiak datë 22.02.2022). Nga ana e MTM i është kthyer përgjigje subjektit kërkues dhe Bashkisë për statusin e procedurës me shkresën nr. 2915/1, datë 25.03.2022, ku është arsyetimi se: “...duke qenë se sipërfaqja e kërkuar për shfrytëzim minerar është mbi 1 ha, parashikohet miratimi me VKM dhe jo me urdhër ministri. ...Ju bëjmë me dije se Ministria është në fazën e analizës së situatës që ka prodhuar heqja nga fondi pyjor duke dëmtuar shpesh mjedisin, nëpërmjet nxjerrjes së akteve nënligjore si dhe në zbatim të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”.
2. **A. S. SHPK**, me datë 8.01.2018 është depozituar kërkesa e subjektit dhe i është dërguar bashkisë Bulqizë për raportin teknik dhe dhënien e dakortësisë me shkresën nr. 949/3, datë 12.02.2018. Sa sipër, dokumentacioni nga subjekti është dorëzuar me datë 16.12.2019, kurse përgjigja me nr. 10347/1, datë 27.12.2019 për dakortësinë me vendim të këshillit bashkiak kthyer përgjigje për statusin e procedurës 2984/1, dt. 31.03.2022, se “...Ju bëjmë me dije se Ministria është në fazën e analizës së situatës që ka prodhuar heqja nga fondi pyjor duke dëmtuar shpesh mjedisin, nëpërmjet nxjerrjes së akteve nënligjore si dhe në zbatim të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”.
3. **K.SHPK**, dërguar plotësimi i dokumentacionit të kërkuar me shkresën nr. 5660/1, dt.19.09.2016. Ministri i ka kërkuar bashkisë Bulqizë për hartim të raportit tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakortësisë nr. 1206/2, dt. 21.03.2018. Dakortësia është dhënë me dt. 16.12.2019, por është kërkuar rregullimi me nr. 10369/1, dt. 24.12.2019. Vendimi i rregullt i këshillit bashkiak është i dt. 28.02.2022, dhe në përfundim i është kthyer përgjigje për statusin e procedurës me shkresën nr. 2917/1, dt. 25.03.2022, u është arsyetimi se: “...duke qenë se sipërfaqja e kërkuar për shfrytëzim minerar është mbi 1 ha, parashikohet miratimi me VKM dhe jo me urdhër ministri. ...Ju bëjmë me dije se Ministria është në fazën e analizës së situatës që ka prodhuar heqja nga fondi pyjor duke dëmtuar shpesh mjedisin, nëpërmjet nxjerrjes së akteve nënligjore si dhe në zbatim të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”.
4. **F. P. K. B SHPK**, kërkesa është depozituar në ministri me dt. 6.07.2020 , po është kërkuar plotësim dokumentacioni (sipas shkresës nr. 4711/1, dt. 29.07.2020), etj.
5. **V. LL**, në lidhje me kërkesë e dt. 6.12.2021, MTM është përgjigjur me shkresën nr. 8648/1, dt. 9.12.2021, lidhur me ndryshimin e koordinatave kërkuar nga MIE, dërguar plotësimet me dt. 3.02.2023, dhe bashkisë Dimal i është kërkuar për hartim të raportit

tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakortësisë me shkresën nr. 871/1, dt. 13.02.2023, dërguar zyrtarisht nga kjo bashki me shkresën nr. 489/1, dt. 4.05.2023.

6. **A. SHPK**, ardhur kërkesa nga MIE dt. 4.06.2021, kërkuar plotësim dokumentacioni me shkresën nr. 3900/1, dt. 17.06.2021, ardhur plotësimi dt. 19.07.2021, dërguar bashkisë Dimal për hartim të raportit tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakortësisë nr. 3900/2, dt. 22.07.2021, ardhur raporti teknik dhe vendimi i këshillit bashkiak dt. 19.01.2022, draftuar akti dt. 16.02.2022.
7. **A. SHPK**, nga ana e subjektit është dërguar kërkesa dt. 13.05.2020, për të cilën janë kërkuar plotësime me shkresën nr. 3154/2, dt. 2.06.2020, dhe janë dërguar plotësimet me dt. 28.09.2020. Bashkisë Dimal i është kërkuar për hartim të raportit tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakortësisë me nr. 3154/3, dt. 1.10.2020, të cilën bashkia e ka realizuar në nëntor 2020. Praktika e heqjes nga fondi pyjor është draftuar dhe hedhur në sistemin e-aktet për bashkërendim dt. 29.01.2021. Aktualisht është në sistemin e-aktet, pa u miratuar etj.

Rezultatet e auditimit të KLSH-së në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në lidhje me heqjen nga fondi pyjor të këtyre sipërfaqeve të cilat janë dërguar në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, për vazhdimin e procedurave të mëtejshme të heqjes nga fondi pyjor e kullor :

I. Nga të dhënat për 7 leje minerare në territorin e **Bashkisë Berat**, rezultojnë se sipërfaqja gjithsej 75.9 ha as nuk është hequr nga fondi pyjor/kullor dhe në të njëjtën kohë nga ana e zotëruesve të lejeve minerare nuk paguhet tarifë qiraje në bashki, për dy raste i është drejtuar gjykatës për vjeljen e këtyre detyrimeve.

Konstatohen se janë 3 raste për të cilat MTM i është drejtuar bashkisë Berat për përgatitjen e raportit tekniko-financiar për kryerjen e aktivitetit minerar për heqjen nga fondi pyjor/kullor, përfshirë dhe miratimin në këshillin bashkiak, procedurë e cila ka zgjatur mesatarisht 82 ditë, në një kohë që duhej të zgjaste 1 javë sipas VKM nr.1353, datë 10.10.2008. Më konkretisht, situata e kësaj bashkie dhe e detyrimeve të ZLMSH paraqitet në këtë tabelë.

Tabela nr.24 Detyrime të ZLMSH për territorin e bashkisë Berat

Nr.	Nr lejes	Data	Emri Subjektit	Vendndodhja	Sip ha	Tarifa lek/ha	Vlera 1 vit	Muaj Shfrytëzimi	Vlera ne leke
1	13...	18.06.2009	B.	Sinjë	7	440000	3080000	33	8470000
2	16...	27.03.2014	T. B	Sinje	11	440000	4840000	75	30250000
3	13...	03.07.2009	B. S	Roshnik	16.7	440000	7348000	33	20207000
4	13...	08.06.2009	P. R. S	Roshnik	11.5	440000	5060000	33	13915000
5	11...	10.10.2017	T. E	Roshnik	7	440000	3080000	75	19250000
6	15...	19.11.2012	E.	Roshnik	9.2	440000	4048000	70	23613000
7	19...	19.05.2021	K. Shpk	Sinje	13.5	440000	5940000	22	10890000
Totali					75.9				126,595,000

Burimi: Të dhëna të Bashkisë Berat

Veç kësaj, MTM nuk ka vepruar më tej, për të miratuar heqjen nga fondi pyjor për këto tre raste, duke vepruar në kundërshtim me pikën 8, të VKM nr.1353, datë 10.10.2008, e cila në germen “a” përcakton: “*Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mësipërm: a) ministri nxjerr urdhrin për heqjen nga fondi pyjor, për pyje dhe toka, me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha.*”

II. Nga auditimi i **Bashkisë Selenicë** ka rezultuar se janë aktive 19 leje minerare me sipërfaqe gjithsej sipas lejeve 1.411.1 ha dhe të verifikuar nga ana e bashkisë sipërfaqja e shfrytëzuar deri në fund të vitit 2022 është 3.31 ha, për të cilat nga ana e bashkisë nuk ka asnjë të dhënë në se është hequr nga fondi pyjor/kullor apo të jenë paguar nga zotëruesit e lejeve tarifat e heqjes nga fondi pyjor kullor, si dhe bashkia ka të hartuar dhe nënshkruar vetëm tre kontrata qiraje për sipërfaqe të lejeve shfrytëzimi, dhe dy subjekte të tjera për shesh depozitimi të materialit minerar zhavorr bituminoz dhe ndërtim i çmontueshëm. Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave në këtë bashki ka

formular/nënshkruar raportin tekniko-ekonomik për sipërfaqen e katër subjekteve, por që nuk ka vijim të mëtejshëm shqyrtimi.

Pra, për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare nuk është kryer procedura e ndryshimit të përdorimit të fondit pyjor, si dhe bashkia Selenicë nuk ka përfituar të ardhura nga tarifa për heqjen e sipërfaqes apo nga tarifat lek/ha/vit për përdorim territori për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë).

III. Nga auditimi i Bashkisë Has, në kuadër të administrimit të aseteve për krijimin e të ardhurave ka lidhur 26 kontrata për dhënie me qira të aseteve që ka në pronësi apo në përdorim. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik për afate kohore nga 1-30 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, për venddepozitim minerali dhe ngritje fabrike përpunimi, studim-kërkim-zbulim, etj. Referuar tabelës së kontratave të qirave me të dhënat të nxjerrë dokumentacioni i dosjeve nga rezultojnë se në fund të vitit 2022 paraqiten 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 2,965,416 lekë** të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has.

Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezultojnë se në territorin e Bashkisë Has ushtrojnë aktivitetin 21 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullimor, asete të Bashkisë Has. Nga bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për vend depozitim mineralit në rastet e subjekteve me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali si dhe shfrytëzim karriere dhe shtrati lumi, me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim inertesh, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Has. Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

IV. Nga auditimi i Bashkisë Fier, duke u bazuar në të dhënat e pasqyruara në Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në Regjistrin e Lejeve Minerare të muajit nëntor të vitit 2022, Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstatohet se për periudhën nga data 01.07.2021 deri më 30.09.2022, në territorin e Bashkisë Fier ushtrojnë aktivitetet tre subjekte, të cilat nuk paguajnë detyrime për aktivitetin që kryejnë, pasi nuk janë të evidentuara nga Bashkia Fier.

Këto subjekte janë:

1. **Subjekti “S.” SHPK** me NIPT J6..... i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 11..., datë 06.12.2017, për shfrytëzimin e vendburimit Grykë Topojë për llojin e mineral argjilë me sipërfaqe 0.092 km².
2. **Subjekti “Q. A” SHPK** me NIPT K73..... i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 12..., datë 06.09.2008, për shfrytëzimin e vendburimit Metalli për llojin e mineralit argjilë me sipërfaqe 0.105 km².
3. **Subjekti “K.” SHPK** me NIPT K02..... i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 17..., datë 10.02.2015, për shfrytëzimin e vendburimit Frakull e Vogël për llojin e mineralit konglomeratë me sipërfaqe 0.428 km².
4. **Subjekti “N. Sh. P” SHPK** me NIPT K52..... i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 18..., datë 01.08.2018, për shfrytëzimin e vendburimit Visokë Portëz për llojin e mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 0.071 km².

Veprime këto në kundërshtim me nenin 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin kullimor”, pikat 3, 7, 9, 10, 11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008,

“Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullisor”.

Nga verifikimet e kryera nga ana e audituesve të autorizuar të KLSH-së në AKBN në lidhje me miratimin e programit vjetor të veprimtarisë minerare, rezulton se për këto subjekte është miratuar programi vjetor, për të cilin parakusht është vërtetimi i lëshuar nga NJQV për shlyerjen në afat të detyrimeve për aktivitetin minerar që kryejnë brenda territorit të Bashkisë Fier, si në vijim.

Tabela nr.25 Detyrime të ZLMSH për territorin e bashkisë Fier

Nr. Leje	Muaji	Data Akt-Miratimit	Data QKB	Emri subjektit	NIPT	Bashkia	Viti 2021	Viti 2022
11...	12	06.12.2007	06.12.2007	S. shpk	J62.....	Fier	Miratim 4133/1 prot 16.12.2020	Miratim 4587/1 prot date 30.12.2022
12...	9	16.09.2008	16.09.2008	Q. A shpk	K73.....	Fier	Refuzim1324 prot. Date 29.03.2021	Proces Gjyqesor
17...	2	10.02.2015	11.02.2015	K. shpk	K02.....	Fier	Miratim 198 prot.date 14.01.2021	Procedure Zgjerimi
18...	8	01.08.2018	03.08.2018	N. Sh. P. F. shpk	K52...	Fier	Miratim 1212 prot. Date 17.03.2021	Mbarim Afati

Burimi: Të dhëna të AKBN, Drejtoria Minerare

V. Nga auditimi i Bashkisë Skrapar ka rezultuar se kanë ushtruar aktivitet për periudhën 1.1.2017-31.12.2019, 17 subjekte private për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore për nxjerrje guri pllakor, guri gëlqeror, gëlqeror mermeror, dhe gëlqeror masiv , sipas lejeve të miratuara nga ana e MIE. Nga Bashkia Skrapar, Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor nuk janë marrë masa për të lidhur kontratë qiraje me këto subjekte private për sipërfaqen totale prej 958,43 ha me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën prej 889,715,200 lekë. Veprime këto në kundërshtim me nenin 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin kullisor”, pikat 3, 7, 9, 10, 11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, “Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullisor”.

VI. Nga auditimi i Bashkisë Bulqizë mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhën raportuese (viti 2020) u konstatua se; në territorin e bashkisë Bulqizë dhe Njësitë Administrative ushtrojnë aktivitet tregtar me status “aktiv” në fushën minerare të pajisur me leje minerare nga (MEI) gjithsej 123 operatorë ekonomikë (OE), të cilët kanë marrë në përdorim nga fondi pyjor/kullisor i përcaktuar në lejen minerare, sipërfaqen totale prej S=108.51 km² e konvertuar në sipërfaqe prej S=10851 Ha, ndërsa rezulton se;

a) Bashkia Bulqizë për sipërfaqen e fondit pyjor/kullisor e marrë në përdorim nga subjekte privat ka lidhur vetëm 12 kontrata qiraje për sipërfaqen prej 40.975 ha dhe ka arkëtuar shumën prej 187.729 lekë me nivel tarife në referim të VKM nr.106, datë 22.12.2010, këto kontrata janë mbikëqyrur e administruar nga Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, ndërkohë në regjistrin e lejeve minerare të AKBN sipërfaqja e përcaktuar në leje për këta 12 OE është 543.22Ha, pra me diferencë sipërfaqe e pa kontraktuar prej 502.245ha (543.22- 40.975), me pasojë nuk është përllogaritur niveli tarifës për sipërfaqen e pa kontraktuar me vlerën prej 40,903,980 lekë, ndërsa vlera prej 40,716,251 lekë (40903980-187,729), konsiderohet e ardhur e munguara e pa programuar për buxhetin e bashkisë Bulqizë, si diferencë ndërmjet vlerës së nivelit të pa përllogaritur e vlerës së arkëtuar të evidentuara në (anekset nr.24;25;26, pika nr.1/6) bashkëlidhur raportit.

b) Bashkia Bulqizë me 12 subjekte privat të cilët kanë në përdorim sipërfaqe nga fondi pyjor/kullosor ka lidhur kontrata qiraje për sipërfaqen 573 ha, sipërfaqe e përcaktuar në lejen minerare, ndërkohë në territorin e bashkisë Bulqizë kryejnë aktivitet tregtar në fushën minerare gjithsej 123 OE të cilët kanë në përdorim sipërfaqen totale prej 10,278 ha, në këto kushte bashkia Bulqizë për këta 111 (123-12) OE, nuk ka asnjë informacion, administrim dhe asnjë dokument në lidhje me aktivitetin në fushën minerare, në lidhje me sipërfaqen e marrë në përdorim prej tyre, për pasojë nuk ka programuar të ardhura vendore në paketën fiskale viti 2020, nuk ka lidhur kontrata qiraje megjithëse kryejnë aktivitet në territorin e bashkisë. Në këto kushte shuma e përlllogaritur prej 801,684,000 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxheti bashkisë Bulqizë (10,278ha x78,000 lekë/ha/vit), si pasojë e mos administrimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor dhe mos lidhjes kontrata qiraje me nivelin e tarifës minimale, veprime në mospërputhje me pika (2); lidhja nr.2, pika 6/1; pika 9/4, të VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për Përcaktimin e Tarifave në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”.

Nga të dhënat për 9 leje minerare në territorin e **Bashkisë Librazhd**, rezultojnë dy subjekte të cilët kanë kontratë qiraje me bashkinë për përdorim fondi pyjor, por që sipërfaqja e të gjitha lejeve nuk është hequr nga fondi pyjor për t’iu kaluar në përdorim zotëruesve të lejeve minerare. Për 8 subjekte ose 11 leje shfrytëzimi të dhëna nga MIE, nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit të bashkisë Librazhd, janë hartuar raportet tekniko-ekonomike dhe është dhënë dakordësia për heqje nga fondi pyjor të këtyre sipërfaqeve të cilat janë dërguar në Ministrinë e Mjedisit për vazhdimin e procedurave të mëtejshme të heqjes nga fondi pyjor e kullosor, por nuk është dhënë miratimi zyrtar për heqje nga ana e kësaj të fundit.

Si përfundim, mos heqja nga fondi pyjor e kullosor i sipërfaqeve të lejeve minerare ka shkaktuar probleme në ecurinë e zhvillimit të sektorit minerar nga raportet me njësitë vendore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre. Kjo sepse, sipas VKM nr.1353, datë 10.10.2008, i ndryshuar pika 11: “Vlera e sipërfaqes pyjore të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga kërkuesi para hyrjes në fuqi të aktit të miratimit, të përmendur në shkronjat "a", "b" e "c", të pikës 8, të këtij vendimi, dhe derdhet në llogarinë bankare të bashkisë, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore e cila do t'i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor”.

Ndërsa sipas VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, në lidhjen nr.2, pika 6 përcakton tarifën lek/ha/vit për përdorim territori për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë) inproduktive me intervale 1 vit, 2-5 vjet dhe 6-10 vjet përkatësisht 540,000; 495,000 dhe 440,000 lekë. Gjithashtu në pikën 9 përcaktohen tarifën për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit gjeologjike e minerare dhe objekteve të ndryshme në sipërfaqe.

Pra, mungesa e heqjes nga fondi pyjor e kullosor i sipërfaqeve të lejeve minerare, i detyron zotëruesit e lejeve të paguajnë tarifa vjetore qiraje në njësitë e qeverisjes vendore, duke rritur koston e tyre, në një kohë që ligji dhe VKM nr.1353, datë 10.10.2008 i ndryshuar, ju mundësojnë pagesën e vlerës së sipërfaqes pyjore të hequr.

Rrjedhimisht, kadastra minerare që administrohet nga QKL nuk pasqyron në mënyrë të drejtë sipas përcaktimeve ligjore sipërfaqen e lejeve minerare, pasi regjistrimi i kësaj pasurie të paluajtshme duhet të bëhet pas heqjes nga fondi pyjor e kullosor, për të cilën nuk është vepruar nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe të Turizmit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme për heqjen nga fondi pyjor ngarkohen me përgjegjësi Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, si dhe për mos ushtrimin e përgjegjësive në zbatimin e politikave dhe strategjisë së zhvillimit të sektorit minerar dhe ushtrimin e një roli më aktiv në drejtim të heqjes nga fondi pyjor e kullosor, të zonave të lejuara të shfrytëzimit pronë shtetërore si dhe ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullosor, nga zëri “Tokë

e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrimit në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, përgjegjësi ka Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Titulli gjetjes:	i Kadastra minerare që administrohet nga QKL nuk pasqyron në mënyrë të drejtë sipas përcaktimeve ligjore sipërfaqen e lejeve minerare, pasi regjistrimi i kësaj pasurie të paluajtshme nuk është bërë pas heqjes nga fondi pyjor e kullisor, nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe të Turizmit.
Situata:	<p>- Nën sistemi i heqjes nga fondi pyjor e kullisor, të zonave të lejuara të shfrytëzimit pronë shtetërore si dhe ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullisor, nga zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrimit në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas legjislacionit në fuqi, nuk ka rezultuar efektiv për periudhën objekt auditimi, Pavarësisht akteve ligjore për transferimin në pronësi të bashkive të fondit pyjor dhe kullisor, realisht bashkive iu janë transferuar vetëm koordinatat takuese në dokumente, pa rakorduar fizikisht sipërfaqet takuese të secilës njësi ekonomie pyjore duke bllokuar mundësinë e krijimit të të ardhurave që ky sektor ofron për institucionet e vetëqeverisjes vendore.</p> <p>- Mosveprimet e MTM dhe MIE për heqjen e sipërfaqeve takuese nga fondi pyjor, pas dhënies së lejeve minerare të shfrytëzimit, u ka krijuar subjekteve-zotërues të lejeve, të drejtën për ta përdorur këtë fakt, si shkak/arsye për të kërkuar “pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë”. Kështu, për shembull, mund të përmendim LMSH nr. 79..., datë 3.12.2014 për subjektin “D. G.” shpk, ka kërkuar miratim të pezullimit të përkohshëm me arsyen “për mos heqje nga fondi pyjor”, (kjo në referim të të dhënave të regjistrimit minerar të AKBN për v.2019).</p> <p>- Parregullsitë, e konstatuara në fushën e veprimtarisë minerare, dhe në kushtet që kadastra minerare administrohet nga QKL, bëjnë të mundur mos pasqyrimin në mënyrë të drejtë sipas përcaktimeve ligjore të kadastrës minerare, të sipërfaqeve të lejeve minerare, pasi regjistrimi i kësaj pasurie të paluajtshme në kadastrë, duhet të bëhet pas heqjes nga fondi pyjor e kullisor, për të cilën nuk është vepruar nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe të Turizmit, duke vepruar në kundërshtim me: Nenin 3, pika 32. të ligjit minerar, që shprehimisht ka përcaktuar se, "Kadastra minerare" është një regjistër i veçantë inventarizimi sistematik i të dhënave për sendet e paluajtshme, mbështetëse të veprimtarisë minerare, tokë, ndërtesa dhe instalime të sipërfaqes apo nëntokës, në aspektin teknik, ekonomik, dhe të dhëna të tjera për zonat e lejuara minerare; Neni 15/5, Leja e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet: Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullisor, prone shtetërore “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore” dhe regjistrohet në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullisor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin; Neni 24/10, Leja e shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtimore: Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtimore zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullisor, prone shtetërore, zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrohet në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas</p>

	<p>legislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullisor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë 23 përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin; dhe Neni 44, Kadastra minerare: 1. Kadastra minerare dhe regjistri minerar administrohen nga struktura përgjegjëse. 2. Të dhënat e hollësishme e dokumentet përkatëse, që regjistrohen në kadastrën minerare e në regjistrin minerar, procedurat e raportimit nga zotëruesi i lejes minerare dhe rregullat për mbajtjen e regjistrimit e të dhënave përcaktohen me urdhër të ministrit.</p> <p>- Konstatohet një mungesë harmonizimi midis përcaktimeve të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 15, pika 5 dhe neni 24, pika 10 dhe VKM nr.1353, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”, pika 1, në lidhje me aplikuesin për heqjen nga fondi pyjor dhe kullisor të sipërfaqes së përcaktuar në lejen minerare. Ligji i mësipërm përcakton se zotëruesi i lejes minerare përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin, ndërsa VKM i mësipërm ju a mundëson personave fizikë ose juridikë apo bashkive paraqitjen e kërkesës për heqjen e sipërfaqeve nga fondi pyjor e kullisor në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Gjithashtu, konstatohet inkoherencë midis përcaktimeve të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Urdhrit nr.384, datë 20.05.2011 “Për miratimin e procedurave të regjistrimit dhe dokumentacionit që regjistrohet në Kadastrën Minerare dhe në Regjistrin Minerar, si dhe forma dhe procedurat e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare”, pasi ky Urdhër nuk pasqyron ndryshimet që kanë ndodhur më pas në ligjin minerar: ligji nr. 9/2013, datë 14.02.2013; ligji nr. 134/2014 datë 10.09.2014 dhe nr. 65/2021 datë 20.5.2021.</p> <p>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme për heqjen nga fondi pyjor ngarkohen me përgjegjësi Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, si dhe për mos ushtrimin e përgjegjësive në zbatimin e politikave dhe strategjisë së zhvillimit të sektorit minerar dhe ushtrimin e një roli më aktiv në drejtim të heqjes nga fondi pyjor e kullisor, të zonave të lejuara të shfrytëzimit pronë shtetërore si dhe ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullisor, nga zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrimit në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, përgjegjësi ka Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Urdhrit nr.384, datë 20.05.2011 “Për miratimin e procedurave të regjistrimit dhe dokumentacionit që regjistrohet në Kadastrën Minerare dhe në Regjistrin Minerar, si dhe forma dhe procedurat e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare”.
Ndikimi:	Kadastra minerare që administrohet nga QKL, nuk pasqyron në mënyrë të drejtë sipas përcaktimeve ligjore të kadastrës minerare, të sipërfaqeve të lejeve minerare.
Shkaku	Regjistrimi i pasurie të paluajtshme në kadastër, nuk është bërë pas heqjes nga fondi pyjor e kullisor, për të cilën nuk është vepruar nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe të Turizmit, në kundërshtim me: Nenin 3, pika

	32. të ligjit mineralar, që shprehimisht ka përcaktuar se, "Kadastra minerare" është një regjistër i veçantë inventarizimi sistematik i të dhënave për sendet e paluajtshme, mbështetëse të veprimtarisë minerare, tokë, ndërtesa dhe instalime të sipërfaqes apo nëntokës, në aspektin teknik, ekonomik, dhe të dhëna të tjera për zonat e lejuara minerare.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të ushtrojë përgjegjësinë sipas përcaktimeve ligjore në zbatimin e politikave dhe strategjisë së zhvillimit të sektorit mineralar dhe ushtrimin e një roli më aktiv në drejtim të heqjes nga fondi pyjor e kullësor, të zonave të lejuara të shfrytëzimit pronë shtetërore si dhe ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullësor, nga zëri <i>"Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore"</i> , dhe regjistrimit në zërin <i>"Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare"</i> .

Pretendimi i subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar MIE me shkresën nr. 983/15, datë 04.08.2023 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt Raportin, janë sjellë observacionet të cilat shkurtimisht po i paraqesim në raport konkretisht:

- Detyrimi i MIE për procedurën e heqjes nga fondi pyjor e kullësor i zonës së lejuar minerare është vetëm përgatitja e aplikimit dhe e dërgimit pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin. Institucioni përgjegjës për kryerjen dhe vazhdimësinë e procedurës për heqjen e fondit pyjor e kullësor është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

- Për sa i përket veprimeve ose mosveprimeve të njëjësive të qeverisjes vendore apo Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit në lidhje me procedurën e heqjes nga fondi pyjor e kullësor MIE nuk ka asnjë kompetencë dhe nuk mban asnjë përgjegjësi. MIE ka përgatitur aplikimin për heqjen nga fondi pyjor e kullësor si de e ka dërguar në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit brenda 10 ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit përkatës i zotëruesit të lejes minerare. Ju sqarojmë se të gjitha Akt miratimet e lejeve minerare pas firmosjes nga Ministri janë dërguar në institucionin e QKB-së.

- Në lidhje me konstatimin e inkoherencës midis përcaktimeve të ligjit nr./ 10304, datë 15.07.2010 dhe urdhrit nr. 384, datë 20.05.2011 MIE do të përgatisë draftin për ndryshimet e nevojshme të Urdhrit nr. 384, datë 20.05.2011.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje observacionet e bëra nga subjekti i audituar MIE për Projekt Raportin e auditimit, dërguar me shkresën nr. 983/15, datë 04.08.2023 edhe pse të përsëritura pa sjellë argumente të reja, grupi i auditimit gjykon se:

- Mosveprimet e MTM dhe MIE për heqjen e sipërfaqeve takuese nga fondi pyjor, pas dhënies së lejeve minerare të shfrytëzimit, u ka krijuar subjekteve-zotërues të lejeve, të drejtën për ta përdorur këtë fakt, si shkak/arsye për të kërkuar "pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë".

- Gjithashtu, konstatohet inkoherencë midis përcaktimeve të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe Urdhrit nr.384, datë 20.05.2011 "Për miratimin e procedurave të regjistrimit dhe dokumentacionit që regjistrohet në Kadastrën Minerare dhe në Regjistrin Mineralar, si dhe forma dhe procedurat e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare", pasi ky Urdhër nuk pasqyron ndryshimet që kanë ndodhur më pas në ligjin mineralar: ligji nr. 9/2013, datë 14.02.2013; ligji nr. 134/2014 datë 10.09.2014 dhe nr. 65/2021 datë 20.5.2021.

Gjykojmë se nga MIE nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart argumentet e sjella, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

2.4.Çështje të tjera të dala gjatë auditimit.

A. Mbi veprimtarinë e AKSEM:

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera është institucion i krijuar në mbështetje të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 135/2016, me Vendimin nr. 214, datë 20.04.2018 të Kryeministrit, "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera" dhe funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhër nr. 103, datë 18.07.2018, të Kryeministrit "Për miratimin e

strukturës dhe Organizimit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera”. Rregullorja e brendshme është miratuar me Urdhrin nr. 214, datë 15.07.2020, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për miratimin e Rregullores së brendshme”. Nga Raporti “Mbi veprimtarinë inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera AKSEM gjatë vitit 2018, 2019, 2020, 2021, 2022” rezultojnë këto të dhëna:

1. Inspektimet

Tabela nr.26 Të dhëna mbi inspektimet e AKSEM 2018-2021

Viti	Të planifikuara	Të kryera	Jashtë Programit	Autorizime me programim
2018	869	630	19	616
2019	610	623	27	596
2020	644	494	20	474
2021	564	519	40	479

Burimi: Të dhëna të AKSEM

2. Masat

Tabela nr.27 Të dhëna mbi masat e dhëna nga AKSEM 2018-2021

Viti	Urgjente (Vendime të ndërmjetme)	Administrative	Ankime adminis	Vendime të revokuara	Vendime gjyqësore
2018	11	11 (gjoba)	4	1	0
2019	19	22 (11 paralajmërime 11 gjoba)	1		1 në proces
2020		4 (gjoba)			
2021	25	55 (42 paralajmërime, 13 gjoba)			

Burimi: Të dhëna të AKSEM

3. Gjobat

Tabela nr.28 Të dhëna mbi gjobat e vëna nga AKSEM 2018-2021

Viti	Nr. i gjobave gjithsej	Nr. i gjobave të paguara	Vlera totale e gjobave	Vlera e gjobave të paguara
2018	11	6	1,570,000 lekë	560,000 lekë
2019	11		1,450,000 lekë	
2020	4		2,100,000 lekë	
2021	13		3,050,000 lekë	
2022				

Burimi: Të dhëna të AKSEM

Për vitin 2018

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera kishte planifikuar 819 inspektime, prej të cilave kreu 616 me programim, 19 jashtë programit, gjithsej kreu 630 inspektime. Sipas VKM Nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera” pika 5/a, AKSEM-i në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij ushtron këto kompetenca kryesore:

Kryen inspektime në veprimtaritë minerare dhe ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave energjetike për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në:

Minierat nëntokësore me regjim gazi, të cilat inspektohen *jo më pak se 3 (tre) herë në vit;*

Minierat nëntokësore pa regjim gazi dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, të cilat inspektohen *jo më pak se 2 (dy) herë në vit;*

Minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve, të cilat inspektohen *jo më pak se 1 (një) herë në vit.*

Nga 819 subjektet e planifikuara, nuk u inspektuan 253 subjekte, pra nuk janë inspektuar të gjitha subjektet në kundërshtim me VKM e cituar më lartë. Subjektet me regjim gazi janë inspektuar në përputhje me pikën i të VKM, rreth 45 subjekte nëntokësore janë inspektuar

vetëm 1 herë dhe jo 2 sipas pikës ii, rreth 108 subjekte sipërfaqësore nuk janë inspektuar gjatë vitit 2018, ndërkohë që duhet të ishin inspektuar jo më pak se 1 herë në vit sipas pikës iii.

Në Raportin vjetor *“Mbi veprimtarinë inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera AKSEM gjatë vitit 2018”* nuk është dhënë asnjë arsye mbi mungesën e inspektimit të këtyre subjekteve, madje është shkruar se *“Këto norma teknike (referuar pikës 5, shkronja a të VKM Nr. 214, datë 20.04.2018) kanë qenë bazë e programit vjetor të inspektimit duke pasur në konsideratë dhe rrisqet apo problematikat specifike, tipet e lejeve minerare dhe llojin e veprimtarisë.”*

Gjatë vitit, 2018, në inspektimin e lejeve minerare sipërfaqësore, koha e inspektimit ka qenë mesatarisht 3- 4 orë. Në minierat nëntokësore pa regjim gazi çdo inspektim ka zgjatur 4-6 orë. Në minierën e kromit Bulqizë, minierë e madhe me regjim gazi, një inspektim zgjat 3 ditë. Në minierën e Katjelit dhe Selenicës, miniera me regjim gazi, një inspektim zgjat deri dy ditë. Në vitin 2018, sipas Analizës Statistike të Treguesve të Inspektimit përgatitur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore rezultojnë 44 punëmarrës të aksidentuar dhe 6 punëmarrës të aksidentuar me vdekje në miniera, karriera (konkretisht A., A. L. I, D. P., A. N, V. G, P. K) . Numri më i madh i inspektimeve për rast aksidenti në punë dhe i punëmarrësve të aksidentuar është në degën rajonale Dibër (në aktivitete minerare). Janë inspektuar 35 subjekte minerare për shkak të aksidenteve në punë. Minierat zënë vendin e dytë (pas ndërmarrjeve prodhuese) për inspektime për aksident në punë sipas llojit të aktivitetit, pavarësisht se në 2018 në miniera ka pasur 2 punëmarrës të aksidentuar me vdekje më shumë se sa në ndërmarrjet prodhuese.

Ndërkohë që në Raportin vjetor *“Mbi veprimtarinë inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera AKSEM gjatë vitit 2018”* nuk ka asnjë të dhënë mbi aksidentet në punë, inspektimet e AKSEM, rezultatet etj.

Në vitin 2018 u morën 11 Masa Urgjente (Vendime të Ndërmjetme), 11 Masa Administrative në formën e gjobave, 4 Ankime Administrative, 1 Vendim i Revokuar. Nga 11 gjobat e dhëna u paguan 6 me vlerë 1,570,000 lekë.

Për vitin 2019

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera kishte planifikuar 610 inspektime, prej të cilave kreu 604 me njoftim paraprak, 27 jashtë programit, gjithsej kreu 623 inspektime.

Nga 610 subjektet e planifikuara, nuk u inspektuan të gjitha subjektet në kundërshtim me VKM Nr. 214, datë 20.04.2018 *“Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera”* pika 5/a. Një prej subjekteve me regjim gazi (S. B.) është inspektuar më pak se 3 herë, konkretisht 2 herë dhe nuk është në përputhje me pikën i të VKM, rreth 19 subjekte nëntokësore janë inspektuar vetëm 1 herë dhe rreth 22 subjekte të tjera nuk janë inspektuar fare përsëri në kundërshtim me pikën ii sipas të cilës duhet të ishin inspektuar jo më pak se 2 herë. Rreth 112 subjekte sipërfaqësore nuk janë inspektuar gjatë vitit 2019, ndërkohë që duhet të ishin inspektuar jo më pak se 1 herë në vit sipas pikës iii.

Ekziston një mospërputhje mes Raportit dhe Databazës me Totalin e Inspektimeve dhe Lejet Minerare për vitet 2018-2022 që i është dorëzuar Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në Raportin Vjetor shkruhet se janë planifikuar 610 inspektime, por në vitin 2019 janë 622 subjekte që kanë Leje Minerare dhe që duhet të inspektohen minimalisht një herë (rreth 171 prej tyre duhet të inspektohen jo më pak se dy herë). Ndaj mund të dalim në përfundimin se AKSEM në këtë planifikim nuk ka përfshirë të gjitha subjektet që kanë Leje Minerare. Në Raportin vjetor *“Mbi veprimtarinë inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera AKSEM gjatë vitit 2019”* janë dhënë arsye për Inspektimet që nuk janë kryer dot. Në muajin Shkurt nuk janë realizuar 15 inspektime dhe AKSEM shkruan se pati anulime të inspektimeve me urdhër të ministrisë në zonën e Krusës. Në muajin Mars nuk u realizuan 4 inspektime nga të planifikuarat dhe arsyeja është se 4 Subjekte deklaruan që nuk kanë filluar aktivitetin minerar të diktuar nga kushtet klimaterike. Për muajin Prill arsyeja është se 3 Subjekte deklaruan që kishin ndërprerë aktivitetin minerar përkohësisht.

Në vitin 2019 sipas Analizës Statistike të Treguesve të Inspektimit përgatitur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore rezultojnë 134 punëmarrës të aksidentuar dhe 23 punëmarrës të aksidentuar me vdekje. Në databazën e dërguar nga AKSEM janë shënuar vetëm 2 humbje jete për vitin 2019, konkretisht në subjektet A. Ch, dhe E. S.

Në vitin 2019 u morën 22 paralajmërime, 6 gjoba në vlerë 1,450,000 lekë, 19 masa urgjente, 26 masa të dhëna nga trupa inspektues. Gjithashtu nga 6 gjoba të vendosura është ankimuar 1.

Për vitin 2020

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera kishte planifikuar 644 inspektime, prej të cilave kreu 616 me programim, 20 inspektime të realizuara jashtë programit (ku 9 aksidente, 9 inspektime të lëna të përealizuara në muajin Mars dhe 2 inspektime verifikimi), gjithsej kreu 494 inspektime.

Nga 610 subjektet e planifikuara, nuk u inspektuan të gjitha subjektet në kundërshtim me VKM Nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera” pika 5/a. Dy prej subjekteve me regjim gazi (S. B, dhe M. K. K shpk) janë inspektuar më pak se 3 herë, konkretisht 2 herë dhe nuk është në përputhje me pikën i të VKM. Rreth 35 subjekte nëntokësore janë inspektuar vetëm 1 herë dhe rreth 43 subjekte të tjera nuk janë inspektuar fare përsëri në kundërshtim me pikën ii sipas të cilës duhet të ishin inspektuar jo më pak se 2 herë. Rreth 134 subjekte sipërfaqësore nuk janë inspektuar gjatë vitit 2019, ndërkohë që duhet të ishin inspektuar jo më pak se 1 herë në vit sipas pikës iii.

Ekziston një mospërputhje mes Raportit dhe Databazës me Totalin e Inspektimeve dhe Lejet Minerare për vitet 2018-2022 që i është dorëzuar Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në Raportin Vjetor shkruhet se janë planifikuar 644 inspektime, por në vitin 2020 janë 632 subjekte që kanë Leje Minerare dhe që duhet të inspektohen minimalisht një herë (rreth 172 prej tyre duhet të inspektohen jo më pak se dy herë). Ndaj mund të dalim në përfundimin se AKSEM në këtë planifikim nuk ka përfshirë të gjitha subjektet që kanë Leje Minerare. Në Raportin vjetor “*Mbi veprimtarinë inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Emergjencave dhe Shpëtimin në Miniera AKSEM gjatë vitit 2020*” arsyeja kryesore që është dhënë mbi Inspektimet që nuk janë kryer dot ka qenë gjendja e jashtëzakonshme, pandemia që ndër të tjera ka qenë shkak që shumë subjekte të mos vazhdonin dot aktivitetin e tyre normalisht. Në vitin 2020 u morën 4 masa administrative “gjobë” me vlerë 2,100,000 lekë.

Në vitin 2020 sipas Analizës Statistike të Treguesve të Inspektimit përgatitur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore rezultojnë 28 punëmarrës të aksidentuar dhe 3 punëmarrës të aksidentuar me vdekje në subjektet K., B. shpk, H. shpk. Në subjektin H. shpk ka pasur 3 punëmarrës të aksidentuar me vdekje, ndaj rezulton që totali të jetë 5.

Për vitin 2021

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera kishte planifikuar 564 inspektime, prej të cilave kreu 479 me programim, 40 inspektime të realizuara jashtë programit, gjithsej kreu 519 inspektime.

Subjektet me regjim gazi janë inspektuar në përputhje me pikën i të VKM Nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera” pika 5/a, rreth 24 subjekte nëntokësore janë inspektuar vetëm 1 herë dhe jo 2 dhe rreth 57 subjekte nuk janë inspektuar në kundërshtim me pikën ii të së njëjtës VKM, rreth 101 subjekte sipërfaqësore nuk janë inspektuar gjatë vitit 2018, ndërkohë që duhet të ishin inspektuar jo më pak se 1 herë në vit sipas pikës iii.

Në Raportin Vjetor shkruhet se janë planifikuar 564 inspektime, por në vitin 2021 janë 630 subjekte që kanë Leje Minerare dhe që duhet të inspektohen minimalisht një herë (rreth 246 prej tyre duhet të inspektohen jo më pak se dy herë). Ndaj mund të dalim në përfundimin se

AKSEM në këtë planifikim nuk ka përfshirë të gjitha subjektet që kanë Leje Minerare në kundërshtim me VKM Nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera” pika 5/a. Në Raportin vjetor “Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Inspektimit në vitin 2021” nuk është dhënë asnjë arsye për mosrealizimin e këtyre inspektimeve.

Në vitin 2021 sipas Analizës Statistike të Treguesve të Inspektimit përgatitur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore rezultojnë 22 punëmarrës të aksidentuar dhe 6 punëmarrës të aksidentuar me vdekje në subjektet K. I, M. I, A., R. M, K., F. P. K. B.

Gjatë inspektimeve të kryera në vitin 2021 janë marre masa administrative sipas shkeljeve ligjore të konstatuara, konkretisht: 42 paralajmërime, 25 ndërprerje pune të përkohshme me vendime të ndërmjetme, si dhe 13 gjoba. Vlera totale e gjobave 3,050,000 lekë.

Për vitin 2022

Raporti vjetor “Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Inspektimit në vitin 2022” i AKSEM nuk na është dorëzuar, por është kryer një krahasim mes databazës së lejeve minerare të vitit 2022 dhe totalit të inspektimeve për vitin 2022. Nga ky krahasim rezulton se një nga subjektet me regjim gazi (konkretisht M. K. K.shpk) nuk është inspektuar 3 herë ose më shumë sipas VKM Nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera” pika 5/a. 44 subjekte nëntokësore janë inspektuar 1 herë dhe 57 nuk janë inspektuar fare dhe jo 2 ose më tepër herë sipas VKM. 200 subjekte sipërfaqësore nuk janë inspektuar, në kundërshtim me pikën 5/a iii ku duhet të inspektohen minimalisht 1 herë. Gjithashtu nga Raporti Vjetor i ISHPSHSH rezulton se në miniera, karriera ka patur 30 punëmarrës të aksidentuar dhe 5 punëmarrës të aksidentuar me vdekje, ndërsa në databazën e dorëzuar nga AKSEM rezultojnë 4 punonjës të aksidentuar me vdekje, 2 prej tyre në subjektin E. shpk, 1 në subjektin A. N, 1 në subjektin Z.

Titulli gjetjes:	i Nga AKSEM për vitet 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 nuk janë inspektuar të gjitha subjektet e planifikuara, në kundërshtim me VKM Nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera” pika 5/a.
Situata:	- Nga AKSEM për vitin 2018 nga 819 subjektet e planifikuara, nuk janë inspektuar 253 subjekte; për vitin 2019 nga 610 subjektet e planifikuara, nuk u inspektuan të gjitha subjektet; për vitin 2020 nga 610 subjektet e planifikuara, nuk u inspektuan të gjitha subjektet;; për vitin 2022 rezulton se 200 subjekte sipërfaqësore nuk janë inspektuar në kundërshtim me VKM Nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera” pika 5/a. Në Raportin vjetor “Mbi veprimtarinë inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera AKSEM gjatë vitit 2018” dhe Raportin vjetor “Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Inspektimit në vitin 2021” nuk janë paraqitur arsyet për mosrealizimin e këtyre inspektimeve. - Për vitin 2018, sipas Analizës Statistike të Treguesve të Inspektimit përgatitur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore rezultojnë 44 punëmarrës të aksidentuar dhe 6 punëmarrës të aksidentuar me vdekje në miniera, Janë inspektuar 35 subjekte minerare për shkak të aksidenteve në punë, kur në Raportin vjetor “Mbi veprimtarinë inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera AKSEM gjatë vitit 2018” nuk ka asnjë të dhënë mbi aksidentet në punë, inspektimet e AKSEM, rezultatet etj. Për vitin 2019 rezultojnë 134 punëmarrës të aksidentuar dhe 23 punëmarrës të aksidentuar me vdekje. Në databazën e dërguar nga AKSEM janë shënuar vetëm 2 humbje jete për vitin 2019. Për vitin 2020 rezultojnë 28 punëmarrës të aksidentuar dhe 3 punëmarrës të aksidentuar me vdekje. Për vitin 2022 rezulton se në miniera, karriera ka patur 30 punëmarrës të aksidentuar dhe 5 punëmarrës të aksidentuar me

	vdekje, ndërsa në databazën e dorëzuar nga AKSEM rezultojnë 4 punonjës të aksidentuar me vdekje. Sa konstatuar më lart në kundërshtim me VKM Nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera” pika 5/a.
Kriteri:	VKM Nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera”.
Ndikimi:	Nga mos kryerja e inspektimeve janë cenuar siguria në punë e mbrojtja e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në minierat nëntokësore dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve.
Shkaku	Mos kryerja nga AKSEM e inspektimeve në veprimtaritë minerare dhe ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave energjetike për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në minierat nëntokësore me regjim gazi, minierat nëntokësore pa regjim gazi dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKSEM të marrë masat për kryerjen e plotë dhe në mënyrë të vazhdueshme të inspektimeve në veprimtaritë minerare dhe ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave energjetike për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në minierat nëntokësore dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve.

B. Çështje të shoqërive minerare në likuidim.

Grupi i auditimit të KLSH analizoi veprimtarinë e tre shoqërive anonime shtetërore në likuidim e sipër që operojnë në sistemin mineral dhe konstatoi se:

- I. **Shoqëria “A.” Sh.a në likuidim e sipër:** Sipas VKM Nr.92, datë 12.03.1992 është krijuar Bashkësia Ekonomike e Kromit (“A.”), e cila në datën 18.01.1996 është shndërruar në shoqërinë anonime “A.” SH.A, si shoqëri aksionere me pronar të vetëm shtetin, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me kapital themeltar prej 3.405.413.240 lekë, e regjistruar me Vendimin e gjykatës së Tiranës nr 14014, datë 29.02.1996. Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë me Nr. 14014/5, datë 24.03.2004 dhe Urdhrit Nr.38 datë 01.03.2004 të Ministrisë të Ekonomisë, Shoqëria kalon nga “A.” Sh.a. Tiranë, në “A.” Sh.a. (në likuidim e sipër) Tiranë.

Shoqëria është e regjistruar në QKR dhe në administratën tatimore, me numër identifikimi NIPT J6..... Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë ka qenë: nxjerrja, pasurimi dhe përpunimi mineral kromi dhe eksportimi i tij.

Me vendimet e regjistruara në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në me nr. 14014/1 deri nr.14014/4 të viteve 1999, 2000 dhe 2004, si dhe të Urdhrit nr. 38, datë 01.03.2004; dhe që është regjistruar në regjistrin tregtar sipas vendimit nr. 14014/5, datë 26.03.2004, është vendosur prishja e shoqërisë dhe kalimi i saj **në likuidim**. Ndaj edhe objekti i veprimtarisë së saj pas kësaj date, si shoqëri në likuidim e sipër, janë transaksionet e likuidimit të të gjitha aktiveve të shoqërisë. Në bazë të Urdhrit Nr.38, datë 01.03.2004, të Ministrisë së Ekonomisë, është urdhëruar prishja në rrugë gjyqësore e shoqërisë “A.” për shkak të vështirësive ekonomike. Statusi i shoqërisë nga "Aktiv" kaloi në "Shoqëri në likuidim e sipër" dhe likuidator i saj u emërua M. P

Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme Nr.55/3 Prot, datë 02.06.2022, nënshkruar nga Ministri D. I., është caktuar Likuidator G. D.

Çështje ligjore gjatë periudhës së auditimit:

i. Në datën 22.12.2017: Është bërë depozitim i Urdhrit Nr. 3821-15 Regj., Nr. 40732 Prot., datë 13.12.2017, të lëshuar nga shoqëria përmbarimore “Shërbimi Përmbarimor A.”, ku është urdhëruar: "Vendosja e masës së sekuestros konservative mbi aktivet e shoqërisë “A...” sh.a, me Nipt- J61..... ". Pala kreditore është Shoqëria "Y..." Sh.p.k, me NUIS J78.....

ii. Në datën 19.07.2019: Në bazë të depozitimit të Urdhrit Nr.478 Prot, datë 15.07.2019 të lëshuar nga Përmbaruesja Gjyqësore Private I.B., është urdhëruar: "Vendosja e masës së sekuestros konservative në aksionet, kuotat e debitorit shoqëria “A.” sh.a me NIPT- J61..... si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre aksioneve/kuotave, duke ndaluar tjetërsimin dhe ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër."

iii. Në datën 06.03.2020: Në baze të Urdhrit Nr.Nr.948/D, Nr.948/5Prot., datë 24.02.2020 të lëshuar nga Shoqëria Përmbarimore Gjyqësore "A..." është urdhëruar: Qendra Kombetare e Biznesit Tiranë, të bëjë bllokimin dhe sekuestrimin e palës debitore: Shoqëria “A.” sh.a me administrator A. B., me NIPT- J61....." Kjo masë është hequr në datën 25.03.2020, sipas Urdhrit Nr.948/D & Nr.948/8 D, datë 26.02.2020 të lëshuar nga shoqëria e përmbarimit "A." Sh.p.k.

Nga shqyrtimi i të dhënave rezulton qartësisht se financimi i aktivitetit është kryer në pjesën më të madhe ose dhe në nivelin 100 % të shpenzimeve vjetore nga fondet e buxhetit të shtetit, si struktura ekstra buxhetore. Vlera e AAM te privatizuar është shumë e ulët dhe për disa vite zero. Një pasqyrë e përgjithshme e shpenzimeve vjetore, të ardhurave të administruara dhe rezultatit (fitimi/humbja e vitit) për sha në likuidim e sipër paraqitet në tabelë:

Në lekë

		Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
1	Shitjet neto	3,721,751	1,047,922	-	6,962,810	-
2	Te ardhura të tjera nga	19,670,156	15,315,027	12,942,917	10,080,407	21,816,568
	Gjithsej të ardhura	23,391,907.00	16,363,801.49	12,942,917.22	17,043,288	21,816,874.11
	Totali i shpenzimeve	41,078,672.00	16,317,843.53	15,147,330	17,114,102	22,679,844
	Fitimi/Humbja e vitit	-17,686,765	45,958	-2,204,413	-70,814	-862,970

Burimi: “A.” sha në likuidim e sipër, përpunimi nga grupi i auditimit

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës:

U shqyrtua dokumentacioni i administruar nga ana e grupit të auditimit të KLSH dhe rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë caktuar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës së shoqërisë (tre anëtarë) dhe janë kryer pagesat për periudhën 2018-2022 në shumën neto prej **3,734,374 lekë** si më poshtë vijon:

Nr.	viti	Shpërblimi bruto	Shpërblimi neto
1.	2018	1,017,600	864,960
2.	2019	948,682	806,379
3.	2020	763,200	648,720
4.	2021	983,400	835,890
5.	2022	680,500	578,425
6.	gjithsej	4.393.382	3.734.374

Burimi: “A.” sha në likuidim e sipër, përpunimi nga grupi i auditimit

Më hollësisht, analizuar sipas viteve dhe referuar ditarit të pagave evidentohet kjo situatë e pagesave:

Viti 2018

S. Dh.,

A. Sh., zëvendësuar me Urdhër te MFE Nr.29 date 14.02.2018 nga E. K., M. L.

Pershkrimi i veprimit	641	431(S.Shoq)	442(T.Page)	424	423+467	cel egle 4672	421
	Debi	Kre Debi Kredi	Debi Kredi	De Kredi	Debi Kredi	Debi Kredi	Debi Kredi

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës dhe pagesat e kryera për Vitin 2021:

I. D.,
E. Sh.,
E. K..

Përshkrimi i veprimit	641		431(S.Shoq)		442(T.Page)		424		423+467		cel egle 4672		421	
	Debi	Kred	Debi	Kredi	Debi	Kredi	Debi	Kredi	Debi	Kredi	Debi	Kredi	Debi	Kred
Bordero Keshilli Mbik.Janar	84,800					12,720								72,080
Bordero Keshilli Mbik.Shkurt	84,800					12,720								72,080
Bordero Keshilli Mbik.Mars	84,800					12,720								72,080
Bordero Kesh. Mbikq. Prill	84,800					12,720								72,080
Bordero Kesh. Mbik. Maj 2021	84,800					12,720								72,080
Bord.Kesh. Mbik. Qershor	84,800					12,720								72,080
Bord.Kesh. Mbik. Korrik 2021	84,800					12,720								72,080
Bord.Kesh. Mbik. Gusht 2021	84,800					12,720								72,080
Bord.Kesh. Mbik. Shtator 2021	84,800					12,720								72,080
Bord.Kesh. Mbik. Tetor 2021	84,800					12,720								72,080
Bord.Kesh. Mbik. Nentor 2021	84,800					12,720								72,080
Bord.Kesh. Mbik. Dhjetor 2021	50,600					7,590								43,010
	983,400					147,510								835,890

Burimi: "A." sha në likuidim e sipër

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës dhe pagesat e kryera për Vitin 2022:

E. D. emëruar me UrdherNr.3 date 06.01.2022 e cila është larguar me emërimin e E. K. me Urdhër Nr.76 date 04.07.2022
E. Sh.

Përshkrimi i veprimit	641		431(S.Sho		442(T.Page)		424		423+467		cel egle 4672		421	
	Debi	Kre	Debi	Kredi	Debi	Kredi	Debi	Kredi	Debi	Kredi	Debi	Kredi	Debi	Kred
Bordero Keshilli Mbik.Janar 2021	50,600					7,590								43,010
Bordero Keshilli Mbik.Shkurt 2021	50,600					7,590								43,010
Bordero Keshilli Mbik.Mars 2021	50,600					7,590								43,010
Bordero Kesh. Mbikq. Prill 2021	50,600					7,590								43,010
Bordero Kesh. Mbik. Maj 2021	50,600					7,590								43,010
Bord.Kesh. Mbik. Qershor 2021	50,600					7,590								43,010
Bord.Kesh. Mbik. Korrik 2021	50,600					7,590								43,010
Bord.Kesh. Mbik. Gusht 2021	50,600					7,590								43,010
Bord.Kesh. Mbik. Shtator 2021	50,600					7,590								43,010
Bord.Kesh. Mbik. Tetor 2021	53,400					8,010								45,390
Bord.Kesh. Mbik. Nentor 2021	82,000					12,300								69,700
Bord.Kesh. Mbik. Dhjetor 2021	89,700					13,455								76,245
	680,500					102,075								578,425

Burimi: "A." sha në likuidim e sipër

U audituan praktikat e emërimit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar nga ana e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për periudhën objekt auditimi 2018-2022 dhe pagesat e kryera për shërbimet e ekspertizës së pasqyrave financiare vjetore nga audituesit ligjorë në shumën gjithsej prej lekë dhe rezultoi sa vijon:

Konstatohet se, në fund të v. 2023, sipas shkresës nr. 30/1 datë 20.2.2023 të shoqërisë drejtuar MFE, detyrimet e mbartura të shoqërisë për moslikuidim të audituesve ligjorë për shërbimet e kryera mbi auditimin e pasqyrave financiare të periudhës 2015- 2021 janë në shumën prej 3,300 mijë lekë. Gjatë vitit 2018-2020 janë kryer pagesat për ekspertët kontabël në shumën prej 1,440 mijë lekë.

✓ **Për Vitin 2018:**

Referuar shkresës së dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Nr.22817/27 Prot, datë 27.12.2018, është bërë caktimi audituesve ligjorë N. C., dhe K. H.

Pagesa për shërbimin e auditimit ligjo të pasqyrave financiare vjetore është kryer në shumën **480,000 lekë** me TVSH, sipas kontratës së nënshkruar me Nr.2/1, date 29.03.2019.

✓ **Për Vitin 2019:**

Referuar shkresës së dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Nr.2465/2 Prot, datë 11.09.2020, është bërë caktimi i audituesve ligjorë, shoqëria “A. A. C” Shpk dhe Sh. H.

Pagesa për shërbimin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore është kryer në shumën **480,000 lekë** me TVSH sipas kontratës me Nr.17/10 Prot, datë 24.10.2020.

✓ **Për Vitin 2020:**

Referuar shkresës së dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Nr.2793 Prot, datë 10.02.2021, është bërë caktimi audituesve ligjorë “A. C. Shpk” dhe “T. A. Shpk”

Pagesa për shërbimin e auditimit ligjo të pasqyrave financiare vjetore është kryer në shumën **480,000 lekë** me TVSH sipas kontratës Nr.21/6, datë 29.04.2021

✓ **Për Vitin 2021:**

Referuar shkresës së dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Nr.22366 Prot., datë 14.12.2021, është bërë caktimi i audituesve ligjorë, “R. A.” shpk dhe B. O.

Nuk është lidhur kontratë dhe nuk ka informacion për kryerje pagesash.

✓ **Për Vitin 2022:**

Referuar shkresës së dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me MFE Nr.3043 Prot, datë 13.02.2023, është bërë caktimi i audituesve ligjorë K. C dhe L. P

Nuk është lidhur kontratë dhe nuk ka informacion për kryerje pagesash.

II. Shoqëria “A.” **SH.A në likuidim e sipër**, është shoqëri aksionere me pronar te vetëm shtetin, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE).

Sipas urdhrit të Ministrit të Ekonomisë me nr. 28, datë 20.02.2004 “Për prishjen e sha “A.” si dhe vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me nr. 211521/1, dt. 03.11.2004 është vendosur regjistrimi i kësaj shoqërie si sha në likuidim e sipër, regjistruar në regjistrin tregtar sipas vendimit nr. 14014/5, datë 26.03.2004, është vendosur prishja e shoqërisë dhe kalimi i saj **në likuidim**. Ndaj edhe objekti i veprimtarisë së saj pas kësaj date, si shoqëri në likuidim e sipër, janë transaksionet e likuidimit të të gjitha aktiveve të shoqërisë. *Në datë 03.11.2004:* Në bazë të Urdhrit të Ministrisë së Ekonomisë, Nr.28, datë 20.02.2004, është miratuar prishja e shoqërisë, dhe emërimi i likuidatorit H. Sh. Status i shoqërisë nga “Aktiv” u bë “Shoqëri në likuidim e sipër” A. H., është likuidator i shoqërisë nga data 20 Prill 2022 e në vazhdim.

Mbyllja pjesore apo tërësore dhe kalimi për privatizimin e aseteve e Minierave të Bakrit është bërë në çdo rast me Vendim të Këshillit të Ministrave, siç janë referuar në vijim:

VKM Nr. 617, datë 6.11.1995 “Për mbylljen tërësore të disa minierave të bakrit”.

- VKM Nr. 242, datë 18.5.2000 “Për mbylljen tërësore të disa minierave të bakrit, metaleve të tjera dhe Fabrikave të Pasurimit në rrethet Has, Pukë, Mirditë, Shkodër dhe Korçë”.
- VKM Nr.365, datë 14.7.2000 “Për trajtimin e punonjësve që shkurtohen nga ristrukturimi i Industrisë së bakrit”.

- VKM Nr.230, datë 24.5.2002 “Për mbylljen tërësore të disa minierave të hekur-nikelit e minierave të tjera në Librazhd, Mirditë, Pukë, Shkodër, Malësi e Madhe, Tropojë, Korçë, Kukës dhe Tiranë si dhe privatizimin e disa njësive të shërbimit të “A.”-shasë”.
- VKM Nr.555, datë 1.8.2003 “ Për mbylljen tërësore të disa minierave të hekurnikelit, bakrit, fosforiteve dhe kromit”.
- VKM Nr.30, datë 13.01.2005 “Për konservimin e Fabrikës së Rafinimit në Uzinën e Bakrit Rubik dhe për mbylljen e Fabrikës së Pasurimit të Bakrit Mjedë, Shkodër”.

Për mbylljen e këtyre minierave të bakrit është hartuar projekt nga Instituti i Minierave (sot AKBN).Grykat e punimeve të minierave të bakrit janë mbyllur e rimbyllur sipas projekteve të hartuara.

Masa Konservative:

i. Në datë 28.05.2018, Në bazë të Kërkesës për “Vendosje Barre Sigurie mbi titujt e pronësisë”, Nr.28564/4 Prot., datë 22.03.2015, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, është kërkuar: “Të mos lejohet tjetërsimi i titujve të pronësisë përfshi edhe shitblerje aksionesh të subjektit "A. B" Sh.a, me NIPT-J81....., deri në shlyerjen e detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesit debitorë”.

ii. Në datë 24.05.2018: Në bazë të Urdhrit Nr. 6423 Prot, datë 10.05.2018, të lëshuar nga Zyra Përmbarimore Tiranë të Përmbaruesit Gjyqësor A. G., është urdhëruar: “Vendosja e masës së sekuestros konservative mbi kuotat që mund të zotërojë në çdo shoqëri tregtare apo personi fizik debitori “A.B.” sha me NIPT J81..... Pala kreditore: F. L. Objekti: Pagim shume. Kjo masë e seuestros konservative është hequr në datë 10.07.2018, në bazë të Urdhrit Nr. Nr.8706 Prot., datë 27.06.2018, protokolluar nga QKB me Nr.7687 Prot., datë 02.07.2018, të lëshuar nga Zyra Përmbarimit Tiranë.

Nga ana e audituesve të KLSH u analizuan shpenzimet e likuidimit (për periudhën e auditimit) dhe evidentohet ky nivel i shpenzimeve vjetore:

Në lekë

Emërtimi i shpenzimeve	Periudha që auditohet				
	2018	2019	2020	2021	2022
Pagat e punonjësve	15 602 128	16 230 000	14 475 000	13 572 318	11 734 683
Shpërblimi këshillit mbikëqyrës	1 004 800	1 077 600	739 800	1 077 600	1 082 800
Pagesa e ekspertit kontabël te pavarur	400 000	400 000	400 000	400 000	480 000
Sigurime shoqërore e shëndetësore	2 589 119	2 684 352	2 391 291	2 250 395	1 934 750
Likuidime Vendime gjyqësore	0	0	0	0	0
Shpenzime Blerje	1 278 459	1 267 000	600 719	1 846 631	912 344
Ruajtje e Uzinës Rubik	1200 000	1 200 000	1 200 000	1 200 000	100 000
Te Ndryshme	765 414	155 653	49 621	1 706 590	60 911
Gjithsej	22 839 920	23 014 605	19 856 431	22 053 534	16 183 666

Burimi: “A.” sha në likuidim e sipër

Përbërja dhe pagesat e Këshillit Mbikëqyrës (shkresat e emërimit):

U shqyrtua dokumentacioni i administruar nga ana e grupit të auditimit të KLSH dhe rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë caktuar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës së shoqërisë (tre anëtarë) dhe janë kryer pagesat për periudhën 2018-2022 në shumën neto prej **4.982.600 lekë** si më poshtë vijon:

Nr.	viti	Shpërblimi neto
1.	2018	1 004 800
2.	2019	1 077 600
3.	2020	739 800
4.	2021	1 077 600
5.	2022	1 082 800
6.	gjithsej	4.982.600

Burimi: “A.” sha në likuidim e sipër, përpunimi nga grupi i auditimit

Shoqëria “A...” në likuidim e sipër, ka patur gjithmonë 3 (tre) anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, përkatësisht një anëtar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe dy anëtarë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Kështu, përfaqësimi i këtyre institucioneve për periudhën 2018 dhe 2019, ka qenë si më poshtë:

- A. D., Kryetare e Këshillit Mbikëqyrës, përfaqësuese e MFE
- K. R., anëtare nga MFE dhe
- A. S., anëtare nga MIE.

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës aktualisht është:

- K. S., emëruar me datën 06.01.2022 si Kryetare e Këshillit Mbikëqyrës, përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- B. M., emëruar me datën 06.01.200, përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- E. B. (B.), emëruar 07.06.2019, përfaqësuese e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për shërbimet e auditimit të pasqyrave financiare vjetore, janë kryer pagesat e audituesve ligjorë (Ekspertët Kontabël të Autorizuar), për çdo vit, në shumën totale prej 2,080 mijë lekë, nga ku: për vitin 2018 është paguar shuma prej 480 mijë lekë dhe gjatë periudhës tjetër 2019-2022 është kryer likuidimi i shumës prej 400 mijë lekë në vit. Aktet e caktimit të audituesve ligjore sipas viteve janë:

- ✓ *Për vitin 2018:* Referuar shkresës së dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Nr. 22819/12, datë 27.12.2018, është bërë caktimi i audituesve ligjorë, K. K dhe L. P. Pagesa për shërbimin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore është kryer në shumën **480,000 lekë** me TVSH.
- ✓ *Për vitin 2019 :* Referuar shkresës së dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Nr. 2462, date 4.2.2020 është bërë caktimi i audituesve ligjorë, H. M., dhe R. R. Pagesa për shërbimin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore është kryer në shumën **400,000 lekë** me TVSH.
- ✓ *Për vitin 2020:* Referuar shkresës së dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Nr 2792, date 10.02.2021 është bërë caktimi i audituesve ligjorë, MFE C. A, shpk dhe E. A. C. C. Pagesa për shërbimin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore është kryer në shumën **400,000 lekë** me TVSH.
- ✓ *Për vitin 2021:* Referuar shkresës së dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Nr. 22378, date 14.12.2021 është bërë caktimi i audituesve ligjorë E. P., dhe A. A, shpk. Pagesa për shërbimin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore është kryer në shumën **480,000 lekë** me TVSH.
- ✓ *Për vitin 2022:* Shkrese e MFE. Referuar shkresës së dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Nr. 3034, date 13.02.2023 është bërë caktimi i audituesve ligjorë, L. Gj., dhe E. Rr. Pagesa për shërbimin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore është kryer në shumën **480,000 lekë** me TVSH.

Statusi i Aktiveve Afatgjata Materiale/AAM (ndërtesa, mjete transporti, instalime teknike, punime minerare, etj. ;

Për të gjitha pasuritë e paluajtshme të sektorit të bakrit, është hartuar Vendimi i Këshillit të Ministrave dhe këto aktive ndodhen në administrim të shoqërisë “A.” sha në likuidim e sipër përkatësisht:

- VKM Nr. 336, datë 1.6.2004 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrative “A.” sha-së”, i ndryshuar me
- VKM Nr. 685, datë 19.10.2007 dhe
- VKM Nr. 349, datë 12.05.2010.

Në kapitalin dhe inventarin e shoqërisë “A.” sha në likuidime sipër, më datën 31.12.2022 vlera e pasurive/ asete (*pa përfshirë ato në koncesion*) është regjistruar si në tabelë:

<i>Ndërtesa e ndërtime</i>	1 196 372 065 lekë
<i>Punime minerare</i>	46 315 920 lekë
<i>Investime të papërfunduara (punime, traverbange etj)</i>	150 859 843 lekë
<i>Makineri e Paisje</i>	473 671 261 lekë

Burimi: “A.” sha në likuidim e sipër, përpunimi nga grupi i auditimit

Gjatë periudhës 2001 deri 2022 nga sistemi i industrisë së bakrit janë dhënë **në koncesion** sipas dispozitave ligjore asete me vleftë neto (*vlera kontabël fillestare e rivlerësuar minus amortizimin*), si më poshtë:

<i>Toka, troje e terrene</i>	40 029 320 lekë
<i>Ndërtesa e ndërtime</i>	109 138 550 lekë
<i>Punime minerare</i>	20 057 028 lekë
<i>Makineri e paisje</i>	45 494 403 lekë
<i>Mjete transporti</i>	2 339 300 lekë

Burimi: “A.” sha në likuidim e sipër, përpunimi nga grupi i auditimit

III. Shoqëria “A.” SH.A në likuidim e sipër, është shoqëri aksionere me pronar të vetëm shtetin, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE).

Likuidimi:

- *Në datë 11.01.2016:* Në bazë të Urdhrit të aksionarit Nr.9627/1 datë 22.12.2015 është miratuar prishja e shoqërisë dhe shpallja e likuidimit. Likuidator është emëruar P. P. Statusi i shoqërisë nga “Aktiv” do të bëhet “Në proces likuidimi”.
- *Në datë 01.12.2017:* Në bazë të Urdhrit të aksionarit Nr.140 datë 17.11.2017, është miratuar emërimi i likuidatorit V. D., dhe largimi i likuidatorit P. P.
- *Në date 26.03.2021:* Në baze të Vendimit të Asamblesë Nr.20 date 23.03.2021 është miratuar emërimi i likuidatorit P. N., dhe largimi i likuidatorit V. D.

Shoqëria “A.” Sh.a është themeluar me datën 05 Tetor 2007, në bazë të Urdhrit nr. 189, datë 20.03.2007 të Ministrit të METE, nga bashkimi i:

- 6 (gjashtë) Shoqërive Anonime të poshtë shënuara:
(*M. Sh.a, B. Sh.a, P. Sh.a, N., M. Sha, M. – D. Sh.a, G. Sh.a,*)
- si dhe në baze të Urdhrit nr. 853, datë 19.11.2007 të Ministrit të METE, nga bashkimi i 6 (gjashtë) Ndërmarrjeve Minerare të poshtëshënuara:
(*N. Krrabë Tirane; N. Memaliaj; N. Pogradec; F. N. P. Prrenjas; F. N G. K. Pogradec; F. N. B. K.*)

Shoqëria “A.” sh.a, në likuidim, ushtron aktivitetin e saj likuidues dhe monitorues të punimeve minerare të mbyllura dhe objekteve ndërtimore sipërfaqësore të ish minierave, në territoret e **34 ish-minierave**, konkretisht.

Tiranë: *Minierat Mushqeta, Krrabe, Priske, Bokside, Valias*

Gjirokastër: *Minierat Memaliaj (Fusha e I-re, II-te, III-te);*

Elbasan: *Minierat Prrenjas, Xixillas, Pishkash Veri, Rrodokal, Bushtrice, Katjel, Skroske;*

Korçë: *Minierat Guri i Kuq, Çervenake, Guri Pergjegjur, Dardhas, Verdove, Gradishte, Alarup, Petrushe, Podgozhan, Kollovoz, Homezh, Barbadesh, Bitincke, Babien, Qencke, Krosnisht, Selce, Mborje – Drenove, Bezhan.*

Konstatim:

Shoqëria Anonime “A.” Sh.a, në krijimin e saj, nuk ka trashëguar dokumentacionin e duhur për asetet e gjashtë Sh.a-ve bashkëthemeluese të saj, (të tilla si, harta topografike, planimetri të minierave, koordinata të vendndodhjes së punimeve minerare, etj.). Kjo situatë e mungesës së dokumentacionit teknik ka krijuar probleme për administrimin e aseteve të kësaj shoqërie dhe për përcaktimin e saktë të zonave minerare të rrezikshme në territoret ne juridksionin e saj. Bashkimi i 6 (gjashte) Sh.a-ve, bashkëthemeluese te “A.” Sh.a, , është realizuar nga bashkimi i vlerave te bilanceve te ish-shoqërive, ne te cilët vlerat e pasqyruara me postet e aktivitetit dhe pasivit rezultojnë pa analize, pa mbështetje dhe rakordim me inventarë te rregullta te vlerave te Aktiveve Qarkullueshme te Trupëzuara dhe Aktiveve Qarkulluese. Rrjedhimisht, shoqëria ka trashëguar një bilanc jo realist nga shoqëritë anonime bashkëthemeluese të “A.” Sh.a

- Bashkimi i bashkëthemelueseve është shoqëruar, krahas te tjerave dhe me mungese pothuajse totale, *jo vetëm te dokumentacionit ekonomik - financiar, por dhe atij teknik, si për objektet ndërtimore sipërfaqësore dhe për punimet minerare të 34 minierave ne juridksionin e Shoqërisë.*
- *Nuk kane patur bilance ekonomike te sakta, për periudhën kur ato kane funksionuar si subjekte me vete.*
- *Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga A., llogarite inventariale të shoqërive bashkëthemeluese kanë qenë të paargumentuara.*
- *Detyrimet debitore e kreditore te Shoqërive anonime, bashkëthemeluese te ‘A.’ Sh.a, kenë qene te pashoqëruara me dokumentacion baze e origjinal justifikues (flete-dalje, fatura, kontrata etj).*
- *Ne bilancin e Shoqërisë janë përfshirë dhe objekte ndërtimore sipërfaqësore te cilat, ne momentin e themelimit te saj ishin te zëna nga banore.*

Përbërja e këshillit Mbikëqyrës

- ✓ *Në datë 07.03.2018:* Në bazë të Urdhrit të aksionarit Nr.9303 datë 22.11.2016, është miratuar emërimi i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës V. M., (M.) dhe largimi anëtarit R. V.
- ✓ *Në datë 09.03.2018:* Në bazë të Vendimit të Asamblesë Nr.24 datë 14.02.2018, është miratuar emërimi i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës I. B., dhe largimi anëtarit V. M., (M.).
- ✓ *Në datë 20.09.2019:* Në bazë të Vendimit të Asamblesë Nr.76 datë 19.08.2019, është miratuar emërimi i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës S. T., dhe largimi anëtarit E. S.
- ✓ *Në datë 03.06.2020:* Në bazë të Vendimit të Asamblesë Nr.49 datë 15.05.2020, është miratuar emërimi i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës S. Q., dhe largimi anëtarit I. B.
- ✓ *Në datë 28.09.2020:* Në bazë të Vendimit të Asamblesë Nr. datë 19.08.2019, është miratuar emërimi i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës S. T., dhe largimi anëtarit E. S.

Shoqëria në vite është ekspozuar me vështirësi financiare pasi nuk ka siguruar të ardhura, dhe si pasojë nuk ka patur aftësi paguese për shlyerjen e rregullt të detyrimeve për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve.

Ref. Nr.	A K T I V E T	31.12.2018	31.12.2019	31.12.2020	31.12.2021	31.12.2022
I	Aktive Afatshkurtra					
I	Mjetet Monetare	41,344	50,280	347,329	374,537	4,709,221
	Totali	41,344	50,280	347,329	374,537	4,709,221

3	Aktivet te tjera financiare afatshkurtera					
a)	Llogari kerkesa te Arketueshme (kliente), mbartur nga krijimi	123,540,936	123,543,938	123,543,938	123,547,688	123,602,688
b)	Shteti tatme dhe taksa, mbartur nga krijimi	29,707,716	29,707,716	29,707,716	29,707,716	29,707,716
c)	- Kerkesa ndaj organizmave shtetore (tvsh)	79,525	182,784	313,836	456,233	636,121
d)	- Kerkesa te tjera tatim fitimi	43,160	43,160	43,160	43,160	43,160
e)	Te drejta e detyrime ndaj ortakeve, mbartur nga krijimi	33,425,721	33,425,721	33,425,721	33,425,721	33,425,721
f)	Të ardhura nga Buxheti 2018, arketuar ne 2019	5,500,000	-		1,050,000	880,000
	Totali	192,297,058	186,903,319	187,034,371	188,230,518	188,295,406
4	Inventari					
a)	Lendet e para te mbartura nga bashkimi +levizjet e magazines	3,412,024	3,383,790	3,410,903	3,294,908	3,463,049
b)	Prodhimi ne proces	-	-	-	-	-
c)	Produkte te gatshme (mbeturine)	-	-	-	-	-
d)	Inventari i imet, Te mbartura + Blerje ne vite	2,758,885	2,758,885	2,758,885	2,758,885	2,878,285
e)	Mallra per rishitje	-	-	-	-	-
f)	Parapagesat per furnizime	-	-	-	-	-
	Totali	6,170,909	6,142,675	6,169,788	6,053,793	6,341,335
7	Parapagime dhe shpenzime te shtyra	62,172,795	62,172,795	62,172,795	62,172,795	62,172,795
a)	Shpenzime te periudhave te ardhshme, mbartur nga krijimi	41,853,852	41,853,852	41,853,852	41,853,852	41,853,852
b)	Aktive afat shkurtra te paarketueshme, mbartur nga krijimi	20,318,943	20,318,943	20,318,943	20,318,943	20,318,943
	Total i Aktiveve Afatshkurtra	260,682,106	255,269,069	255,724,283	256,831,643	261,518,757
II	Aktive Afatgjata					
	Totali	-	-	-	-	-
2	Aktive Afatgjata Materiale					
a)	Toka	294,851,699	288,473,006	288,473,006	287,798,437	287,798,437
b)	Ndërtesa (neto)	215,095,753	210,859,552	208,319,359	200,429,196	198,424,904
c)	Ndërtime instalime te përgjithshme	215,364,126	215,364,126	215,364,126	215,364,126	215,364,126
c)	Makineri dhe pajisje	4,329,759	3,847,491	3,194,679	2,837,639	2,525,009
c)	Aktive te tjera afatgjata materiele	105,256	102,098	99,035	96,064	93,182
	Totali	729,746,593	718,646,273	715,450,205	706,525,462	704,205,657
5	Kapitali aksionar i papaguar, mbartur nga krijimi	17,281,156	17,281,156	17,281,156	17,281,156	17,281,156
6	Aktive te tjera afatgjata (ne proces)					
	Totali i Aktiveve Afatgjata	747,027,749	735,927,429	732,731,361	723,806,618	721,486,813
	TOTALI AKTIVEVE	1,007,709,855	991,196,497	988,455,644	980,638,261	983,005,570
	Llogari jasht bilancit	77,615,624	77,615,624	74,679,524	74,679,524	74,679,524

Titulli gjetjes:	i Nga analiza e veprimtarisë së shoqërive anonime shtetërore në likuidim e sipër që operojnë në sistemin minerar u konstatua se Shoqëritë në likuidim e sipër, në vite janë ekspozuar me vështirësi financiare pasi nuk kanë siguruar të ardhura, dhe si pasojë nuk ka patur aftësi paguese për shlyerjen e rregullt të detyrimeve.
-------------------------	---

<p>Situata:</p>	<p>- Për Shoqërinë “A.” Sh.a në likuidim e sipër u audituan praktikat e emërimit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar nga ana e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për periudhën objekt auditimi 2018-2022 dhe pagesat e kryera për shërbimet e ekspertizës së pasqyrave financiare vjetore nga audituesit ligjorë në shumën gjithsej prej lekë dhe rezultoi se, në fund të v. 2023, sipas shkresës nr. 30/1 datë 20.2.2023 të shoqërisë drejtuar MFE, detyrimet e mbartura të shoqërisë për moslikuidim të audituesve ligjorë për shërbimet e kryera mbi auditimin e pasqyrave financiare të periudhës 2015- 2021 janë në shumën prej 3,300 mijë lekë. Gjatë vitit 2018-2020 janë kryer pagesat për ekspertët kontabël në shumën prej 1,440 mijë lekë:</p> <p>- Për Shoqërinë “A.” SH.A në likuidim e sipër, u konstatua se për shërbimet e auditimit të pasqyrave financiare vjetore, janë kryer pagesat e audituesve ligjorë (Ekspertët Kontabël të Autorizuar), për çdo vit, në shumën totale prej 2,08,0 mijë lekë, nga ku: për vitit 2018 është paguar shuma prej 480 mijë lekë dhe gjatë periudhës tjetër 2019-2022 është kryer likuidimi i shumës prej 400 mijë lekë në vit.</p> <p>- Për Shoqërinë “A.” SH.A në likuidim e sipër, u konstatua:</p> <p>1- Shoqëria Anonime “A.” Sh.a, në krijimin e saj, nuk ka trashëguar dokumentacionin e duhur për asetet e gjashtë Sh.a-ve bashkëthemeluese të saj, <i>(të tilla si, harta topografike, planimetri të minierave, koordinata të vendndodhjes së punimeve minerare, etj.)</i>. Kjo situatë e mungesës së dokumentacionit teknik ka krijuar probleme për administrimin e aseteve të kësaj shoqërie dhe për përcaktimin e saktë të zonave minerare të rrezikshme në territoret në juridiksionin e saj. Bashkimi i 6 (gjashtë) Sh.a-ve, bashkëthemeluese të “A.” Sh.a, , është realizuar nga bashkimi i vlerave të bilanceve të ish-shoqërive, në të cilët vlerat e pasqyruara me postet e aktivitetit dhe pasivitetit rezultojnë pa analize, pa mbështetje dhe rakordim me inventarë të rregullta të vlerave të Aktiveve Qarkulluese të Trupëzuara dhe Aktiveve Qarkulluese. Rrjedhimisht, shoqëria ka trashëguar një bilanc jo realist nga shoqëritë anonime bashkëthemeluese të “A.” Sh.a.</p> <p>2 - Bashkimi i gjashtë sh.a-ve, bashkëthemeluese të “A.” Sh.a, është realizuar nga bashkimi formal matematikor, i vlerave të bilanceve të ish-shoqërive, në të cilët, vlerat e pasqyruara me postet e aktivitetit dhe pasivitetit rezultojnë pa analizë, pa mbështetje dhe rakordim me inventarë të rregullt të vlerave të Aktiveve Qarkulluese të Trupëzuara dhe Aktiveve Qarkulluese. Rrjedhimisht, sipas testimeve të kryera mbi verifikimin e saktësisë së të dhënave të kontabilitetit, por edhe sipas raporteve të ekspertëve kontabël të autorizuar, është trashëguar në bilanc joreal i kësaj Shoqërie, nga Shoqëritë Anonime bashkëthemeluese të “A.” Sh.a, pasi:</p> <p>- <i>Bashkimi i bashkëthemelueseve është shoqëruar, krahas të tjerave dhe me mungesë pothuajse totale, jo vetëm të dokumentacionit ekonomik - financiar, por dhe atij teknik, (harta topografike, planimetri të minierave, koordinata të vendndodhjes së punimeve minerare, etj.), si për objektet ndërtimore sipërfaqësore dhe për punimet minerare të 34 minierave në juridiksionin e Shoqërisë, duke krijuar probleme të vazhdueshme në administrimin e aseteve të Shoqërisë, por dhe në përcaktimin e saktë të zonave minerare të rrezikshme në territoret e juridiksionit të kësaj shoqërie.</i></p> <p>- <i>Nuk kanë patur bilance ekonomike të sakta, për periudhën kur ato kanë funksionuar si subjekte më vete.</i></p> <p>- <i>Llogarite inventariale të tyre kanë qenë të paargumentuara.</i></p>
------------------------	--

- Detyrimet debitorë e kreditore të Shoqërive anonime, bashkëthemeluese të "A." Sh.a, kanë qenë të pashoqëruara me dokumentacion bazë e origjinal justifikues (fletë-dalje, fatura, kontrata etj).

- Në bilancin e Shoqërisë janë përfshirë dhe objekte ndërtimore sipërfaqësore të cilat, në momentin e themelimit të saj ishin të zëna nga banorë, etj.

3. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, mbi 352 aktive afatgjata/ pasuri sipërfaqësore që administrohen nga "A." sha në likuidim e sipër, me vlerë fillestare në kontabilitet prej 499,724,696 lekë gjithsej, në fakt janë të kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasin periudhës 1970 e në vijim dhe kjo tregon për mospërputhje të gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me konfirmimin e dokumentacionit financiar dhe se ky informacion kontabl nuk pasqyron gjendjen e vërtetë vlerore të këtyre pasurive. Janë raportuar nga "A." me status të ndryshëm aktive në Sektorin Tiranë, Degën Pogradec, Korçë, etj., të tilla si, zënë nga banorët, dëmtuar, përdoret nga C..... përdoret nga komuna, dëmtuar 80%, ekzistojnë vetëm muret anësore, ekziston vetëm një rresht me kolona, zënë nga banorët, ekziston vetëm si truall, dëmtuar pjesërisht (në këtë kategori janë rreth 70-80 % e aktiveve që janë në inventarin e shoqërisë) etj.

Referuar dhe dokumentacionit zyrtar të administruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (raporti bashkëlidhur shkresës nr. 23652/7 prot, e kësaj ministrie, datë 8.3.2021), rezultojnë 613 pasuri të miratuara për privatizim ndër vite, për të cilat procesi i vlerësimit nuk ka vijuar për arsye të ndryshme.

4. Procesi ligjor i likuidimit të këtyre shoqërive është vonuar dhe tej zgjatur dhe nuk është përfunduar në kohë, deri në shkrirjen dhe çregjistrimin përfundimtar të këtyre shoqërive. Shpenzimet që i ngarkohen buxhetit të shtetit për kostot e stafit administrativ të minierave me status "Sha në likuidim e sipër" janë të konsiderueshme. Ndaj rekomandohet që, të studiohet mundësia e bashkimit me anë të përthithjes së të këtyre tre sha-ve që operojnë në sektorin e industrisë minerare, në një shoqëri më vete, e cila duhet të realizojë procedurat e likuidimit të shoqërisë dhe të përjashtohet nga skema e financimit buxhetor.

5. Konstatohet se ka një mungesë koordinimi dhe bashkërendimi midis MIE dhe shoqërive në likuidim e sipër, për rastet kur këto pasuri, galeri dhe zona minerare, jepen për shfrytëzim sipas lejeve të shfrytëzimit, për zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit, që janë pjesë e këtyre shoqërive në likuidim e sipër.

6. Shkurtimi dhe evitimi i kostove financiare për zëra të tillë shpenzimesh si "Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës", Pagesat e kryera për ekspertët kontabël të autorizuar etj. pasi për periudhën objekt auditimi këto tre sha në likuidim e sipër kanë funksionuar si institucione të pastra buxhetore, ku janë financuar në masën 100 % të tyre dhe ndonëse qëllimi i likuidimit është shitja e aseteve dhe likuidimi i kreditoreve, aktiviteti i shitjes së aktiveve ka qenë i pezulluar, duke përbërë një barrë të paargumentuar për buxhetin e shtetit. Për aq kohë që, këto shoqëri nuk kanë asnjë aktivitet prodhimi, ato kryejnë vetëm monitorimin e minierave dhe aseteve, dhe paguajnë vetëm një nomenklaturë të reduktuar shpenzimesh, (pasi duke qenë sha pa aktivitet, kryejnë shpenzime vetëm për pagat e punonjësve dhe sigurimet shoqërore) dhe se shpenzimet për kontraktimin e ekspertëve kontabël janë një kosto shtesë, pasi nuk sjell ndonjë efektivitet për këto subjekte dhe rrjedhimisht nuk janë të justifikuar. Për më tej, ky proces është kontestuar edhe nga likuidatorët e këtyre shoqërive, (si psh shkresa nr. 30/1 datë 20.2.2023 i "A." sha Tiranë për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku theksohet edhe fakti se për pamundësi financiare, shoqëria nuk ka

	<p>likuiduar detyrimet ndaj eksperteve kontabël të autorizuar/ audituesve ligjore për periudhën 2015-2021 me vlerë detyrimi prej 3,300,000 lekë.</p> <p>Gjithashtu, në pjesën e IV-rt, titulli I, “Likuidimi i zakonshëm në gjendjen e aftësisë paguese”, neni 198, “Bilancet”, i ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, është përcaktuar se: “Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme”.</p>
Kriteri:	Ligji nr.9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Urdhri i Ministrit të Ekonomisë Nr.38 datë 01.03.2004, urdhri i Ministrit të Ekonomisë me nr. 28, datë 20.02.2004 “Për prishjen e sha “A.”.
Ndikimi:	Shoqëritë anonime shtetërore në likuidim e sipër që operojnë në sistemin minerar ndër vite janë ekspozuar me vështirësi financiare pasi nuk kanë siguruar të ardhura, dhe si pasoje nuk ka patur aftësi paguese për shlyerjen e rregullt të detyrimeve.
Shkaku	Procesi ligjor i likuidimit të këtyre shoqërive është i vonuar dhe tej zgjatur dhe nuk është përfunduar në kohë, deri në shkrirjen dhe çregjistrimin përfundimtar të këtyre shoqërive. Shpenzimet që i ngarkohen buxhetit të shtetit për kostot e stafit administrativ të minierave me status “Sha në likuidim e sipër” janë të konsiderueshme.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>- MIE dhe “A.” sha të marrin masat për rivlerësimin e aktiveve afatgjata pasuri sipërfaqësore që administrohen nga “A.” sha në likuidim e sipër, të cilat janë kontabilizuar sipas të dhënave që i përkasin periudhës 1970 e në vijim, për përputhjen e gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me dokumentacionin financiar me qellim pasqyrimin e vërtetë të vlerave të këtyre pasurive.</p> <p>- Nga MIE të përshpejtohet procesi ligjor i likuidimit të këtyre shoqërive, deri në shkrirjen dhe çregjistrimin përfundimtar të këtyre shoqërive duke evituar shpenzimet e konsiderueshme që i ngarkohen buxhetit të shtetit për kostot e stafit administrativ të minierave, shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe shpenzimet për kontraktimin e ekspertëve kontabël me status “Sha në likuidim e sipër” pasi këto shoqëri nuk kryejnë asnjë aktivitet prodhues por vetëm monitorimin e minierave dhe asetëve. Gjithashtu nga MIE, të studiohet dhe gjykohet mundësia e bashkimit me anë të përthithjes së të këtyre tre sha-ve që operojnë në sektorin e industrisë minerare, në një shoqëri më vete, e cila duhet të realizojë procedurat e likuidimit të shoqërisë dhe të përjashtohet nga skema e financimit buxhetor.</p> <p>- Nga MIE të merren masat për koordinimin dhe bashkërendimin me shoqëritë në likuidim e sipër, për rastet kur këto pasuri, galeri dhe zona minerare, jepen për shfrytëzim sipas lejeve të shfrytëzimit, për zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit, që janë pjesë e këtyre shoqërive në likuidim e sipër.</p>

C. Shqyrtimi i ankesës së “H. E. T. H”, shoqëria “H.”

Në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka ardhur ankesa e “H. E. T. H”, shoqëria “H.” me nr.275 prot., datë 27.03.2023 “Kërkesë për informacion dhe denoncim ndaj veprimeve të Bashkisë Ersekë në dëm të koncesionit të hidrocentraleve “K.”, “H. 1” dhe “H. 2”.

Në këtë ankesë çështjet që ngrihen janë:

Në periudhën 2014-tetor 2022 HEC-et kane punuar normalisht; Komunikimi me MIE (njoftime, kërkesa, shkresa) nga dhjetori i vitit 2020, për marrjen në mënyrë të paligjshme nga bashkia Ersekë, Ndërmarrja e Ujësjellës -Kanalizime të burimeve të K..., furnizuesi i HEC-eve K. dhe H. 1 dhe H. 2, krahas përroit të Bezhanit dhe Shtikës; për shkak të marrjes së ujit nga ujësjellësi i ri i Ersekës prej tetorit 2022 këto burime nuk kanë furnizuar këto vepra hidroenergjetike;

Bashkia Ersekë ka dhunuar pronën e hipotekuar nga kjo shoqëri për ZK 1948 H., ZK 3969 K. dhe 3423 Shtike, duke shkelur arbitrarisht kontratën koncesionare që nuk lejon ndërtim veprash hidroteknike mbi ato ekzistuese të bëra nga kjo shoqëri;

Ka vetëm një komunikim të Sekretarit të Përgjithshëm të MIE me shkresën nr.3186/1 prot., datë 27.08.2021 drejtuar Bashkisë Ersekë ku i kërkohet të respektohet kontrata koncesionare; I janë drejtuar me shkresë Drejtorit të Ujësjellës kanalizimeve Ersekë më datë 15.06.2022 për ndërprerjen e këtyre veprimeve arbitrare në pronën e shoqërisë “H.”, dhe ka marre të gjithë prurjet e burimeve të ..., duke mos u lejuar mundësi HEC-eve të furnizohen me ujë për prodhim energjie; Për pasoje është ulur prodhimi i energjisë për 5 muaj në vlerën 16,200 mijë lekë dhe shtetit një dëm në vlerën 6,960 mijë lekë (43%);

Në zbatim të nenit 6 të kontratës koncesionare i është kërkuar MIE që të sigurojë monitorim zyrtar për burimet e .;

Në korrespondencat me MIE, AMBU, AKBN dhe ERRE janë dhënë informacione të arsyetuar në prova dhe fakte në lidhje me pamundësinë e zbatimit korrekt të kontratës koncesionare që rrjedh nga moszbatimi me faj i detyrimeve kontraktore të MIE dhe institucioneve të varësisë;

Sipas nenit 7.7 të kontratës, dëmi që shteti duhet t'i kompensojë shoqërisë i kalon 13.6 milion lekë në vit dhe që për 30 vjet minimumi arrin 410 milion lekë dhe në rastin më të keq MIE duhet të paguaje vlerën e ndërtimit dhe investimit që llogaritet rreth 3.5 milion euro, duke shtuar këtu dhe përqindjet e kredive të papaguara nga shoqëritë;

Shprehet gatishmëria për gjetur një zgjidhje urgjente për të shmangur dëmet financiare Autoriteti Kontraktor (MIE) është në kushtet e mosveprimit, në kundërshtim me nenin 7.6 të kontratës koncesionare; Kërkohet marrja e masave konkrete urgjente për të ndaluar këtë paligjshmëri dhe arbitraritetet dhe dëmet shtetit të cilat do të jene të parikuperueshme.

Për shqyrtimin e ankesës së koncesionarit H. E. T. H”, shoqëria “H.”, më datë 27.04.2023 është marrë takim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me Sekretaren e Përgjithshme V. H., E. K., Drejtor i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë dhe R. B., Drejtore e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Efiçencën e Energjisë T. B., Drejtorja e Partneritetit Publik Privat në Fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe nga KLSH Gj. P., B. Z., dhe Q. C.

Përfaqësuesit e KLSH, nga shqyrtimi paraprak i kësaj ankese, parashtruan çështjen e rrezikut të dëmit financiar që mund t'i shkaktohet buxhetit të shtetit nga pretendimet e koncesionarit kundrejt veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Kontraktor (MIE) për plotësimin e detyrimeve kontraktore.

Nga ana përfaqësueseve të MIE, është bërë e ditur që janë të njohur së fundmi me pretendimet e koncesionarit për rënie të prodhimit të energjisë elektrike për shkak të rënies së prurjeve, si dhe kanë komunikuar me shkresa me Bashkinë e Ersekës, duke i sjellë në vëmendje që në burimet e K... është në fuqi kontrata koncesionare për prodhim energjie elektrike. Duke e konsideruar veten institucionalisht të pafuqishëm për të vepruar më tej ndaj bashkisë Ersekë përveç njoftimit, për shkak të autonomisë të vetëqeverisjes vendore, MIE e konsideron veten që, me praktikat administrative të ndjekura, është në zbatim të plotë të detyrimeve të përcaktuara në kontratën e formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e Hidrocentraleve “K.”, “H. 1” dhe “H. 2”, të datës 12.01.2011, të nënshkruar nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Gjithashtu, është cilësuar nga ana e tyre se nuk janë ato nënshkruesit e kontratës së koncesionit, të cilët në zbatim të nenit 7.6 të kësaj kontrate, në cilësinë Autoritetit Kontraktor të garantojnë që ndërtimi i veprave të tjera Hidroteknike nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e projektit të koncesionit.

Nga ana e tjetër, MIE u shpreh se janë duke zhvilluar një monitorim që nga fillim të kësaj kontrate, me qëllim që nëse kontraktori do të kërkojë dëmshpërblim në zbatim të detyrimeve kontraktore të Autoritetit Kontraktor, t' i llogarisë penalitete që nga fillimi për mosrealizim të prodhimit vjetor.

Në fund të takimit, për vënien në dispozicion të komunikimit shkresor për këtë çështje, nga ana e MIE u kërkua që t' i drejtohem me shkresë të veçantë në plotësim të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj ankese.

MIE, në përgjigje të shkresës së KLSH nr.275/1 prot., datë 28.04.2023 “Kërkesë për dokumente për shqyrtim ankese”, me shkresën nr.275/2, datë 25.05.2023, cilëson midis të tjerave se Autoriteti Kontraktues në përmbushje të detyrimeve kontraktore ka marrë të gjitha masat për të garantuar zbatimin e kësaj kontrate.

Autoriteti kontraktor në mënyrë të vazhdueshme, që nga viti 2021 deri në korrik 2022 ka njoftuar bashkinë Kolonjë, AKBN, AMBU, AKUKI dhe Ujësjetës Kanalizime Ersekë SHA, se është lidhur kontrata e koncesionit më datë 12.01.2011 e cila është në fuqi dhe e detyrueshme për zbatim, hidrocentralet janë në operim, si dhe është kërkuar nga të gjitha institucionet përgjegjëse marrja e masave për trajtimin e kërkesës, me qëllim shmangien e çdo pasoje, qoftë edhe financiare mes palëve të përfshira në këtë proces.

Me shkresat e datës 23.03.2023, 27.03.2023 dhe 06.04.2023 shoqëria koncesionare “H.” ka shprehur shqetësimin mbi uljen e prodhimit të energjisë elektrike për hidrocentralet “K.”, “H. 1” dhe “H. 2”, si rrjedhojë e marrjes së ujit të burimeve të Sharrës dhe Kozelit nga ndërtimi i ujësjetës të ri Ersekë, Bashkia Ersekë, të cilat shfrytëzohen nga kjo shoqëri në zbatim të kontratës koincesionare, si dhe ndërprerje të vazhdueshme të shkaktuar nga remontet e nënstacionit Mollas, duke sjellë probleme në shpërndarjen e energjisë elektrike të gjeneruar nga këto HEC-e. Për sa më sipër, MIE me shkresat e datës 02.05.2023 ka kërkuar nga AKBN dhe AMBU verifikimin e pretendimeve, si dhe nga FTL SHA informacion mbi prodhimin energjisë elektrike të realizuar nga hidrocentralet “K.”, “H. 1” dhe “H. 2”, duke filluar nga viti 2014.

Titulli gjetyes:	MIE nuk ka ezauruar plotësisht dhe në kohë detyrimin për mbarëvajtjen e koncesionit, të përcaktuar në pikën 7.6 të kontratës koncesionare me nr.119 Rep., dhe nr.94 Kol., të datës 12.01.2011 midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “K. K” SHPK dhe “L. V. T” SHPK.
Situata:	<p>MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të kontratës koncesionare të formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve “K.”, “H. 1” dhe “H. 2” nënshkruar më datë 12.01.2011, ka vepruar në mënyrë jo të plotë dhe me reagim të vonuar.</p> <p>MIE ka vepruar në mënyrë shkresore kryesisht në vitin 2023 duke njoftuar institucionet për kontratën koncesionare me vonesa, kur informacioni për çështjen e marrjes së burimeve ujore që furnizojnë HEC-et nga Ndërmarrja e Ujësjetës - Kanalizime Ersekë është në dhjetor të vitit 2020.</p> <p>Shoqëria koncesionare ka kërkuar nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - MIE që të sigurojë monitorim zyrtar për burimet e K., por akoma nuk ka një rezultat në këtë drejtim; - AKBN monitorimin që nga viti 2014, në një kohë që ky institucion në varësi të MIE ka për detyrë monitorimin e përvitshëm të HECE-ve. <p>MIE nuk ka ezauruar plotësisht dhe në kohë detyrimin për mbarëvajtjen e koncesionit, të përcaktuar në pikën 7.6 të kontratës koncesionare me nr.119 Rep., dhe nr.94 Kol., të datës 12.01.2011 midis Ministrisë së Ekonomisë,</p>

	Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “K. K” SHPK dhe “L. V. T” SHPK.
Kriteri:	Kontrata koncesionare me nr.119 Rep., dhe nr.94 Kol., të datës 12.01.2011 midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “K. K” SHPK dhe “L. V. T” SHPK.
Ndikimi:	Rreziku i një dëmi financiar që mund t’i shkaktohet buxhetit të shtetit nga pretendimet e koncesionarit kundrejt veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Kontraktor (MIE) për plotësimin e detyrimeve kontraktore.
Shkaku	Shqetësimi i Shoqëria koncesionare “H.” mbi uljen e prodhimit të energjisë elektrike për hidrocentralet “K.”, “H. 1” dhe “H. 2”, si rrjedhojë e marrjes së ujit të burimeve të Sharrës dhe Sharrës nga ndërtimi i ujësjellësit të ri Ersekë, Bashkia Ersekë, të cilat shfrytëzohen nga kjo shoqëri në zbatim të kontratës koncesionare, si dhe ndërprerje të vazhdueshme të shkaktuar nga remontet e nënstacionit Mollas, duke sjellë probleme në shpërndarjen e energjisë elektrike të gjeneruar nga këto HEC-e.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	MIE dhe AKBN të marrin masa të përsheptuara për të siguruar nga: - MIE monitorimin zyrtar për burimet e K., duke arritur në një rezultat në këtë drejtim; - AKBN, institucion në varësi të MIE monitorimin që nga viti 2014, si detyrim për monitorimin e përvitshëm të HECE-ve. - MIE të ezaurojë plotësisht dhe në kohë detyrimin për mbarëvajtjen e koncesionit, të përcaktuar në pikën 7.6 të kontratës koncesionare me nr.119 Rep., dhe nr.94 Kol., të datës 12.01.2011 midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “K. K” SHPK dhe “L. V. T” SHPK.

Pretendimi i subjektit:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar AKBN me shkresën nr. 983/13, datë 21.07.2023 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt Raportin, janë sjellë observacionet të cilat shkurtimisht po i paraqesim në raport konkretisht:

- Mbi pamjaftushmërinë e buxhetit për monitorimin e të gjitha kontratave për të cilin është venë në dijeni edhe MIE.

- Bazuar në mundësitë tona financiare për monitorimedhe nëse do kishim kërkesa nga koncesionari kjo kontratë nuk do të ishte pjesë e planit të monitorimit në terren...

Gjithashtu me shkresën nr. 714, datë 14.08.2023 nga subjekti “E.T.H.H” shpk është dërguar informacioni shoqëruar me Raportin e Vlerësimit dhe Ekspertizën Teknike me vlerësimin e dëmit ekonomik.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

B. MASA ORGANIZATIVE.

2.1 Mbi zbatimin e procedurës së licencimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së licencimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare ka rezultuar se nga ana e MIE nuk është respektuar VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura” si më poshtë:

- Nga ana e MIE nuk është respektuar afati maksimal prej 240 ditë (120+120) për nxjerrjen e aktit të miratimit ose të refuzimit të lejes së shfrytëzimit, kërkim-zbulim-shfrytëzimit në 49 raste ose 54 % të lejeve gjithsej (91) të miratuara në periudhën 2018-2022, pasi janë jashtë

afatit në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”, pika 10, germa B.3.

Lejet e miratuara sipas subjekteve në tejkjalim të afatit përkatës janë si më poshtë:

Lejet nr. 18... “B.” SHPK, 18... “D.” SHPK, 18... “H. SHPK”, 18... “A.” SHPK, 18... “T.” SHPK, 18... “F. P. K. B” SHPK, 18... “S. M” SHPK, 18... “N. Sh. P. F” SHPK, 18... “D.” SHPK, 18... “K. S” SHPK, 18... “A.” SHPK, 18... “T. A. T. M.” sha, 18... “T. A. T. M” SHA, 18... “V.” SHPK, 18... “M.” SHPK, 18... “B. C” SHPK, 18... “E. C. E. M. I” SHPK, 18... “R.” SHPK, 18... “I.” SHPK, 18... “A.”, 18... “T.” SHPK, 18... “K.” SHPK, 18... “V. D. I. E” SHPK, 18... “C. G. I” SHPK, 18... “K. CH. M” SHPK, 18... “A. S” SHPK, 18... “P.”, 18... “P. G”, 18... “V.” SHPK, 18... “A.”, 18... “K. D” SHPK, 18... “L. T” sha, 19... “R. G”, 19... “M. Gj” SHPK, 19... “F.” SHPK, 19... “M. V” SHPK, 19... “P. M” SHPK, 19... “D. E” SHPK, 19... “A...” SHPK, 19... “2. G” SHPK, 19... “A. S” SHPK, 19... “E. M” SHPK, 19... “C.”, 19... “K. K” SHPK, 19... “K.” SHPK, 19... “E.” SHPK, 19... “K. I” SHPK, 19... “A. G” SHPK, 19... “N.” SHPK.

- Në periudhën 2018-2022 është konstatuar se iu është dhënë e drejta për riaplikim 19 subjekteve (20.9 % e numrit gjithsej), për të cilët është dalë më parë me akt refuzimi, për mosplotësim dokumentacioni brenda afatit, kryesisht për mungesën e pajisjes me leje mjedisore duke mos respektuar kushtet e detajuara dhe dokumentet shoqëruese për vlerësimin e përmbushjes së këtyre kushteve që duhet të plotësojnë aplikuesit për një leje minerare dhe procedura e trajtimit të kërkesave me afatet, të përcaktuara në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura” pika 10, 11.

Riaplikimet e lejuara nga ana e MIE për 19 subjektet janë për lejet si më poshtë:

Lejet nr. 18... “E. M. N” SHPK, 18... “T.” SHPK, 18... “S. M” SHPK, 18... “E. C. E. M. I” SHPK, 18... “A. L” SHPK, 18... “B. C” SHPK. 18... “S.” SHPK. 18... “A.”, 18... “R. E” SHPK, 18... “P. S”, 18... “M. H”, 19... “M.” SHPK, 19... “M. Gj”, 19... “Xh. SHPK”, 19... “M. V” SHPK, 19... “K.” SHPK, 19... “K. I” SHPK, 19... “A. G”, 19... “Xh. M. A”.

- Nga shqyrtimi i dosjeve për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, në 33 raste (36% e numrit total të dosjeve) kontrata me Drejtuesin Teknik nuk është e vlefshme në datën e nxjerrjes së Akt Miratimit, në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”, pika 10, germa A.1/c dhe germa B.1/c.

Kjo mangësi është konstatuar në 33 dosje për lejet në vijim:

Lejet nr. 18... “P. Q” SHPK, 18... “D.” SHPK, 18... “H.” SHPK, 18... “A.” SHPK, 18... “T.” SHPK, 18... “S. M” SHPK, 18... “N. Sh. P. F”, 18... “D.” SHPK, 18... “K. S”, 18... “T. A. T. M” SHPK, 18... “A.” SHPK, 18... “T. A. T. M.” SHPK, 18... “B. P”, 18... “T. A. T. M” Sha, 18... “T. A. T. M” Sha, 18... “V.” SHPK, 18... “B. C” SHPK, 18... “R.” SHPK, 18... “K.” SHPK, 18... “C. G. I” SHPK, 18... “K. CH. M” SHPK, 18... “A. S” SHPK, 18... “A. L” SHPK, 18... “V.” SHPK, 18... “A.”, 18... “P. S” SHPK, 19... “A. G” SHPK, 19... “P. M” SHPK, 19... “A. S” SHPK, 19... “C.”, 19... “E.” SHPK, 19... “K. I.” SHPK, 19... “A. G”.

- Nga auditimi janë konstatuar se 10 subjekte, aplikuese për miratim leje minerare nuk kanë plotësuar depozitimin e burimeve financiare për 20% të vlerës totale të investimit, në kundërshtim me VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”, pika 10, germa A.1/ç/i dhe germa B.1/ç/i.

Lejet minerare për 10 subjekte të cilët nuk kanë plotësuar detyrimin si më sipër janë:

Lejet nr. 18... “K. I” SHPK, 1862 “T.” SHPK, 863/1 “S. M” SHPK, 18... “D.” SHPK, 18... “V. SHPK”, 19... “M.” SHPK, 19... “A.” SHPK, 19... “E. M” SHPK, 19... “K. K” SHPK, 19... “A. SHPK”.

- Gjithashtu nga auditimi, konstatohet se ka vonesa kohore të konsiderueshme midis datës në dokumentacionin bankar të paraqitur nga subjekti dhe datës së aplikimit në QKB që lëviz nga 4 deri në 12 muaj, me pasoja në sigurinë dhe garancinë e realizimit të investimit të parashikuar në projektin përkatës, dhe me vetë zhvillimin e sektorit minerar.

- Nga shqyrtimi i dosjes minerare nr. 18... "B. A" SHPK, u konstatuar mospërputhje e emërtesës së mineralit në objektin e kërkuar, nga minerali për të cilin është kryer procedura, e cilësuar kjo nga Këshilli Teknik i AKBN, me pasoja për monitorimin dhe mbikëqyrjen e pagesës së rentës minerare nga ana e zotëruesit të lejes minerare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-53 të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi:

- Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të merren masat për zbatimin e procedurës së licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare duke respektuar kushtet e detajuara dhe dokumentet shoqëruese për vlerësimin e përmbushjes së kushteve që duhet të plotësojnë aplikuesit për një leje minerare dhe procedura e trajtimit të kërkesave me afatet, të përcaktuara me aktet ligjore.

- MIE si organ i drejtimit politik i cili ushtron detyrat dhe funksionet e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, nëpërmjet Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minerave, midis të tjerave të sigurojë mbajtjen e kontakteve edhe me strukturat paralele në ministritë e linjës, duke i dhënë MIE të gjitha kompetencat dhe mekanizmat ligjor për zgjidhjen e të gjitha çështjeve me institucionet e varësisë (AKBN) si dhe me ministritë e linjës (MTM), për të shmangur procedurat e ri aplikimit për pajisje me leje minerare.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të marrë masat për revokimin e licensave të mësipërme me parregullsi dhe shkelje të rënda ligjore, nënligjore dhe rregullative në zbatimin e kriterëve për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare.

Brenda vitit 2023 dhe në vijimësi

1.1 Mbi zbatimin e kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullativ në procedurat e shqyrtimit të masave të pezullimit dhe të revokimit të lejeve minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Gjetje nga auditimi:

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për pezullimet të përkohshme të lejeve minerare me kërkesë të subjektit, si dhe nga komunikimet me zyrtarë të subjekteve nën auditim konstatohet se, mungon një akt administrativ nënligjor për të përcaktuar procedurën dhe afatet e pezullimit të përkohshëm, për rastin e kërkesës së vetë subjektit dhe të ndëshkimit nga strukturat përgjegjëse, në funksion të disiplinimit dhe zhvillimit të sektorit minerar. Mungesa e një akti të tillë ka sjellë për pasojë që pezullimet e përkohshme për subjekte të veçanta të zgjasin edhe 5-6 vite, duke bërë të pavlefshme zhvillimin e procedurës së konkurrimit të zonës minerare.

- Nga auditimi konstatohet gjithashtu se, me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 me ligjin nr. 65/2021 datë 20.5.2021, (botuar në Fletoren Zyrtare nr.107, datë 15.07.2021), MIE-s i është hequr kompetenca e miratimit të pezullimeve të përkohshme. Për periudhën nga data 21.07.2021 deri në fund të vitit 2022, Ministri i MIE ka miratuar 29 të pezullime të përkohshme (3 të vitit 2021 dhe 26 të vitit 2022), në kundërshtim me nenin 18, pika 1 dhe 2 dhe të nenit 25 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pasi MIE ka marrë atributet e strukturës përgjegjëse, në këtë rast AKBN.

- Nga të dhënat për periudhën 2018-2022 konstatohet se, nga 185 raport - propozimet e AKBN për fillimin e procedurave të revokimit, nga ana e MIE i janë dërguar subjekteve njoftimet për fillimin e procedurës, 40 propozime që i përkasin periudhës deri në vitin 2017. Veprimet e MIE janë ndërmarrë mesatarisht për një periudhë prej 4 muaj pas marrjes së propozimit nga struktura përgjegjëse. Megjithëse kjo periudhë ka ardhur duke u zvogëluar në mesatarisht rreth 25 ditë në vitin 2022, përsëri ka vonesa, kjo në kundërshtim me përcaktimet e nenit 48, pika 1, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ku përcaktohet se procedura e revokimit të lejes fillon, si rregull, me raportin e propozimit të strukturës përgjegjëse ose me kërkesë të zotëruesit të saj, kur ky i fundit ka plotësuar të gjitha detyrimet e saj.

- Janë konstatuar 11 raste kur MIE nuk ka vijuar më tej procedurën e revokimit, pas propozimeve të strukturës përgjegjëse AKBN, kryesisht për vitin 2017 dhe 2018, duke detyruar këtë të fundit të ri propozojë revokimin për herë të dytë apo dhe të tretë.

- Sipas të dhënave të MIE lidhur me propozimet e AKBN për fillimin e procedurave të revokimit, konstatohen gjithsej 19 leje minerare për të cilat megjithëse është dërguar propozimi dhe është bërë njoftimi i subjektit për fillimin e procedurave të revokimit, nga ana e ministrit të MIE, nuk është dalë me vendim përkatës.

- Konstatohet se 29 % e vendimeve (të marra gjithsej nga MIE në vitin 2022), janë marrë jashtë afateve të përcaktuar në pikën 3 të nenit 48 të ligjit minerar ku Ministri vendos revokimin e lejes minerare 30 ditë kalendarike pas kalimit të afateve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni. Në rast se brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e dytë, të pikës 2, zotëruesi i lejes minerare paraqet argumente dhe prova të mjaftueshme që provojnë mungesën e shkaqeve, për të cilat është iniciuar revokimi, ministri vendos pushimin e procedurës së revokimit. Gjithashtu, tejkalimi i afateve ligjore të vendim-marrjes së MIE, konstatohet dhe në 15 raste të pushimit të procedurave të revokimit nga 23 gjithsej.

- Konstatohet se MIE ka ndërprerë procedurën e revokimit të lejeve, për rastet kur propozimi nga AKBN ka qenë për mos-pagesë në afat të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit nga ana e zotëruesve të lejeve minerare, pasi këto pagesa janë kryer pas njoftimit për fillimin e procedurës së revokimit dhe mandatet e pagesës nuk janë rivendosje në afat dhe mungesë të shkaqeve për të iniciuar revokimin. Në këtë rast, MIE ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 të nenit 48 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, i cili përcakton: *“Në rast se brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e dytë, të pikës 2, zotëruesi i lejes minerare paraqet argumente dhe prova të mjaftueshme që provojnë mungesën e shkaqeve, për të cilat është iniciuar revokimi, ministri vendos pushimin e procedurës së revokimit”*.

- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AKBN dhe MIE janë konstatuar 13 raste që revokimi i lejes është bërë me shkresë dhe/ose me urdhër nga ministri i MIE, nga të cilat 7 raste u përkasin periudhave para vitit 2018. Anulimi/shfuqizimi/riaktivizimi i lejes së revokuar nga ana e Ministrit të MIE është në kundërshtim me pikën 6 të nenit 48 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar: *“Kundër vendimit të ministrit bëhet ankim në Gjykatën Administrative, sipas legjislacionit në fuqi”*, duke mos lënë hapësirë veprimeve të mëtejshme të anulimit/shfuqizimit/riaktivizimit të lejes së revokuar. Pra, në tejkalim të kompetencave ligjore të fushës minerare, pasi ka marrë kompetencat të Gjykatës Administrative. Gjithashtu, trajtimi nga MIE si ankim i aktit administrativ, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative, pasi nuk ka verifikuar në fillimin e procedurës administrative nëse organi publik ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi, si dhe të nenit 136 -Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi publik kompetent, pika 1, i cili përcakton se: *“Ankimi ndaj një akti administrativ shqyrtohet, në radhë të parë, nga vetë organi publik kompetent, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj”*.

- Veprimet e mëtejshme të AKBN dhe MIE, në bashkëpunim dhe MTM, pas daljes së VKM nr. 468, datë 26.07.2018 *“Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë-Verjon “Peizazh i mbrojtur”* dhe VKM nr.467, datë 26.07.2018 *“Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar “Mali Tomorrit”*, për revokimin e 29 lejeve mjedisore, shpërfill dhe nuk merr në konsideratë kërkesat e neneve 6, 7, 8 dhe 9 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar, pasi vendimarrja për zhvillimin e veprimtarive minerare në vend mbështetet në kuadrin strategjik të zhvillimit minerar.

Gjithashtu, nuk është marrë në konsideratë VKM nr.479, datë 26.09.2011 *“Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë”* 2010-2025; VKM nr.347, datë 29.04.2011, *“Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”* i cili përcakton drejtimit e zhvillimit të sektorit minerar për periudhën 3 (tre) vjeçare, të përcaktuara me koordinata në aneksin 1 bashkëlidhur këtij vendimi: zona, prefektura, minerali, sipërfaqja, pika x dhe y; Urdhrit përkatës të Ministrit të MIE *“Për miratimin e planit vjetor minerar”*, si dhe lejet e mjedisit të dhëna nga Ministria e Mjedisit, duke rrezikuar me pasojë financiare për buxhetin e shtetit.

- Veprimet dhe mosveprimet e MIE në lidhje me zbatimin e procedurave dhe të afateve të pezullimit dhe revokimit të lejeve minerare, kanë vënë në vështirësi veprimtarinë monitoruese dhe inspektuese të strukturave përgjegjëse, veçanërisht të AKBN gjatë kësaj periudhe, në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e planeve vjetore, ndëshkimin për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit teknik dhe financiar, si dhe kryerjen e raportimin e monitorimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-53 të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi:

MIE, AKBN të marrë iniciativat për hartimin e akteve administrative nënligjore për të përcaktuar procedurën dhe afatet e pezullimit të përkohshëm, për rastin e kërkesës së vetë subjektit dhe të ndëshkimit nga strukturat përgjegjëse, në funksion të disiplinimit dhe zhvillimit të sektorit minerar, me qëllim lehtësimin e veprimtarinë monitoruese dhe inspektuese të strukturave përgjegjëse, veçanërisht të AKBN në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e planeve vjetore, ndëshkimin për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit teknik dhe financiar, si dhe kryerjen e raportimin e monitorimeve.

Në vijimësi

1.2. Mbi zbatimin e procedurës dhe të kriterëve të konkurrimit për marrjen e lejes minerare në zonën konkurruese nr.27... për objektin B., Selenicë, Qarku Vlorë.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së konkurrimit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, (MIE), për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën Kombëtare të Biznesit për zonën minerare konkurruese nr.27... për objektin B., Selenicë, Qarku Vlorë rezultoi:

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar me pikët maksimale plotësimin e kriterëve nga subjekti shpallur fitues “B. S” SHPK, për aftësitë tekniko profesionale në kushtet kur ky ofertues nuk ka eksperiencë në veprimtarinë minerare; në përbërje të stafit mungon fuqia punëtore e nevojshme; drejtuesi teknik nuk ka eksperiencë në fushën minerare etj.; në dosjen e aplikimit i mungojnë dokumentet që provojnë burimet e financimit të shoqërive që e mbështesin financiarisht; etj., në kundërshtim me përcaktimet në Aneksin IV-A “Formulari i ofertës tekniko-financiare për leje minerare”, të DSPK.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar shpallur fitues në mënyrë të padrejtë subjektin “B. S” për procedurën dhe kriteret e konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën kombëtare të Biznesit për zonën minerare konkurruese nr.27... për objektin B., Selenicë, Qarku Vlorë, **pasi:**

- Dy kontratat noteriale me shoqëritë të cilët garantojnë mbështetjen financiare të subjektit të shpallur fitues nuk janë shoqëruar me dokumente që provojnë burimet financiare të shoqërive “G. C.” dhe “P. M. G”, pasi mungojnë kopjet e pasqyrave financiare të dy viteve të fundit të certifikuar nga Administrata Tatimore, si dhe mungojnë vërtetimet nga Banka që konfirmojnë se personi juridik ka të depozituara në numrin e llogarisë të paktën 20 % të vlerës së investimit të parashikuar për t’u realizuar në objektin e hedhur për konkurrimin e publikuar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2 të Kriterëve specifike të kualifikimit të kreut-Pjesëmarrja dhe kualifikimi, të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. Mbi këtë bazë, oferta e shoqërisë “B. S” duhej të quhej e pavlefshme dhe ky ofertues të skualifikohej, pasi investitorët me të cilin është lidhur kontrata e bashkëpunimit për mbështetje financiare, nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara Dokumentet Standarde të Procedurës Konkurruese.

- Në mungesë të përvojës në fushën e shfrytëzimit minerar subjekti i shpallur fitues ka paraqitur tre kontrata noteriale me investitorë të cilët shprehin vullnetin për mbështetje teknike për këtë shoqëri, ku Kontrata e bashkëpunimit me nr. repertori 17..., nr. koleksioni nr.98..., datë 20.09.2022 është midis “B.” SHPK dhe shoqërisë “G. C SHPK” për mbështetjen me makineri dhe pajisje të shoqërisë “B.” SHPK, dhe jo për mbështetje të subjektit të shpallur fitues “B. S”. Në kontratat e mësipërme listat e mjeteve nuk janë shoqëruar me dokumente që të vërtetojnë të drejtat reale që subjekti “B. S.” gëzon ndaj mjetit: pronësi, qira, përdorim apo lloj tjetër posedimi. Në këto kushte kjo ofertë duhet të quhej e pavlefshme dhe ofertuesi të skualifikohej, për mos plotësim të kapaciteteve tekniko-profesionale, pika 7 e Kriterëve

Specifike të Kualifikimit, të Kreut – Pjesëmarrja dhe Kualifikimi të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

• Subjekti i shpallur fitues “B. S.” nuk dëshmon se ka fuqinë punëtore të nevojshme, pasi ka paraqitur kontratë bashkëpunimi me kohë të pjeshme me 1 jurist; me 1 kontabilist; kontratë pune me Drejtuesin teknik pa eksperiencë në fushën minerare, si dhe në listë pagesat e sigurimeve shoqërore figuron 1 kontribues në muajt qershor dhe gusht, si dhe në muajin shtator janë 6 punonjës: Në këto kushte, në zbatim të pikës 5 të Kriterëve Specifike të Kualifikimit, oferta duhej të quhej e pavlefshme dhe ofertuesi “B. S.” duhej të skualifikohej. Në dosjen e aplikimit konstatohet se, vlera e Sigurimit të ofertës prej 3,466,000 lekë është në llogari rrjedhëse dhe jo në llogari depozitë; konfirmimi i gjendjes së llogarisë është lëshuar nga B.-Dega Lushnjë, kur vendi i cilësuar në shkresë i përket Tiranës; subjekti “B. S” SHPK i ka llogaritë në B.-Dega Lushnjë, ndërsa selinë në Vlorë.

Bazuar në konstatimet sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka zbatuar përcaktimet e germës “b” të pikës 7.20 të VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese” i ndryshuar, për të deklaruar të pavlefshme ofertën e subjektit “B. S”, pasi nuk ka plotësuar dy nga tre kërkesat e ftesës për procedurë konkurruese: kriterin profesional dhe ekonomiko-financiar, për rrjedhim, procedura konkurruese për zonën minerare nr.27... në objektin B..., Selenicë qarku Vlorë, për llojin e mineralit “Ranor, silicor, masiv”, duhej të konsiderohej e pasuksesshme, pasi asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përmbush kërkesat për procedurë konkurruese, në zbatim të pikës 7.21, germa “a” të VKM nr.320, datë 21.04.2011 i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-53 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi:

- MIE, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masat për të kualifikuar shpallur fitues subjekte të cilët në përputhje me procedurën konkurruese plotësojnë kriteret e konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën kombëtare të Biznesit për zonat minerare konkurruese.

- Për sa konstatuar nga auditimi mbi procedurën e shpalljes dhe konkurrimit të zonës minerare nr.27..., MIE të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për revokimin e lejes minerare nr. 1943, datë 17.02.2023 të subjektit “B. S” SHPK, për shkak se shoqëria e mësipërme nuk plotëson asnjë nga kushtet thelbësore të kërkesave ekonomiko-financiare, teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin e kontratës.

Brenda vitit 2023

2.2 Mbi zbatimin e procedurave dhe rezultatet e monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare, si dhe të shoqërive minerare publike.

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për problematikën e konstatuar nga vlerësimi dhe shqyrtimi i zbatimit të procedurave dhe rezultatet e monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare, si dhe të shoqërive minerare publike janë konstatuar problematika në veprimtarinë minerare me qëllim realizimin e mbikëqyrjes e monitorimin dhe konstatimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatimin të lejeve minerare:

- Nga auditimi rezulton se AKBN gjatë periudhës 2018-2022 nuk ka arritur inspektimin çdo 6 muaj të të gjitha subjekteve minerare, pasi janë inspektuar në vend dy herë 21-65 % e subjekteve, dhe midis 12-31 % e lejeve minerare nuk inspektohen. Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, i ndryshuar, neni 43, pika 2 për të kryer inspektime në funksion të hartimit dhe paraqitjes ministrit çdo 6 muaj të një raporti për mesatarisht 344 veprimtari minerare për periudhën 2018-2022. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nuk ka nxjerrë e përgjegjësini apo rishikimin e kapaciteteve njerëzore dhe fondeve në dispozicion të kësaj strukture (AKBN).

- Në shtatë raste, nga ana e Grupit të Mbikëqyrjes së strukturës përgjegjëse AKBN, është evidentuar fakti se, nga ana e subjekteve-zotërues të lejeve minerare, nuk janë miratuar planet vjetore të punës, dhe nuk është proceduar në vend me vendosjen e sanksioneve administrative gjombë sipas parashikimeve të nenit 45, të ligjit për sektorin minerar.
- Në një numër Akt Konstatimesh të mbajtura (në 6 raste të testuara), nga mbikëqyrja e shfrytëzimit të burimeve minerare dhe ushtrimit të veprimtarisë minerare në Bashkinë Bulqizë, është konstatuar se grupi i mbikëqyrjes, referuar materialit të publikuar, është mjaftuar vetëm me shprehjen “*Subjekti ka miratuar programin vjetor të punës në AKBN*”, pa identifikuar asnjë të dhënë të aktit dhe të datës së miratimit të këtij programi.
- Në raportet e monitorimit ka përsëritje të cilësimeve për të njëjtat subjekte nga viti në vit dhe megjithëse prodhimi për periudhën 2015-2019 është zero, është vijuar normalisht pa asnjë ndëshkim për subjektin.
- Nga strukturat përgjegjëse, në zbatim të detyrimit ligjor dhe autoritetit shtetëror, nuk është hartuar një program periodik ose i posaçëm, për të ushtruar kontrole në çdo veprimtari minerare me qëllim realizimin e mbikëqyrjes e monitorimin e veprimtarive minerare dhe konstatimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatimin të lejeve minerare, sipas kërkesave të Urdhrit nr. 382, datë 20.05.2011 “*Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare*”, pika 16 dhe Pika 17.
- Në konstatimet nga mbikëqyrja e grupeve të specialistëve paraqitur në raportet 6 mujore “*Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private*” rezulton se grupet e specialisteve nuk janë shprehur për numrin e punëtoreve, realizimin e prodhimit, treguesit teknologjikë, realizimin e investimeve, realizimi i shitjeve brenda dhe jashtë vendit, të ardhurat e realizuara nga shitjet brenda vendit dhe eksportet, realizimi i rentës minerare etj tregues sipas kërkesave të: Nenit 43, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*”, ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 dhe ligjin nr. 134/2014, “*Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare*”, pika 3, “*Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare..... dhe Urdhrit nr. 202, datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e Zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, dhe bitumet” pika 3.*
- Gjithashtu në konstatimet nga mbikëqyrja e grupeve të specialistëve paraqitur në raportet 6 mujore “*Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare metalore nga subjektet private*” rezulton se grupet nuk janë shprehur në mënyrë specifike për treguesit e paraqitur në Aneksi 3, formatin nr.1 të tabelës së planit vjetor të veprimtarisë minerare i dërguar on line, (portali: raport.akbn.gov.al) (REVZONE) pranë AKBN-së ku paraqiten në mënyrë të specifikuar dhe të detajuar në tremujorë, kapacitetet e prodhimit, vlera e investimeve dhe operacionet që do të kryhen nga ana e subjektit gjatë veprimtarisë së tij minerare njëvjeçare.
- Nga krahasimi i treguesve të paraqitur në raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit me treguesit e raportuar në sistemin REVZONE dhe treguesit e planit të miratuar rezulton se vlerat e paraqitura nuk janë të njëjta si: numri i punonjësve në objekt, numri punonjësve me siguracion jete, prodhimi i planifikuar, prodhimi i raportuar, realizimi i investimeve, Sasitë e mineralit të shitur, të ardhurat e planifikuara dhe ato të realizuar, renta minerare etj.
- Gjithashtu rezulton se në sistemin REVZONE janë hedhur pjesërisht (në disa raste treguesit nuk janë hedhur) treguesit e planit vjetor të veprimtarisë minerare të dërguara on line nga subjektet si: Prodhimi minerar, Realizimi i investimeve dhe punimeve gjeologjike minerare, Vlera e produkteve minerare të shitura ne total, në të njëjtën monedhë, Rehabilitimi i mjedisit, Pagesa e taksës lokale, Garancia e investimeve, Garancia e rehabilitimit, Fuqia punëtore në total, Fuqia punëtore me sigurim jete, Pagesa e rentës minerare etj. kjo në kundërshtim me kërkesat e Urdhrit nr. 201, nr. 202, datë 20.06.2016 “*Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e Zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, dhe bitumet” pika 3.*

- AKBN, strukturat përgjegjëse nuk kanë një udhëzues të detajuar, ku të pasqyrohen të dhënat mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen në kuadër të vlerësimeve në një subjekt, zotërues të lejeve minerare të shfrytëzimit, etj.

- Kështu, duke analizuar raportet zyrtare të monitorimit të hartuara nga ana e strukturës përgjegjëse të AKBN dhe të depozituara periodikisht në MIE, rezulton se janë përfshirë në sistemin e raportimit periodik përmbledhës subjekte të ndryshme, zotërues të lejeve minerare, në 30 raste, për vitin 2018, dhe për mbi 50 subjekte për vitet 2019 dhe 2020 për të cilat nuk është kryer asnjë mbikëqyrje dhe monitorim pranë këtyre subjekteve për vitin referues, dhe se informacioni i përfshirë në raportim është vetëm sipas vetë deklarimeve të subjekteve zotëruese të lejeve minerare në sistemin Revzone.

Sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 2, pika 34, Neni 31, pika 1, Neni 36, Neni 49. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-120 të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi:

AKBN, Strukturat Përgjegjëse në plotësim të kuadrit ligjor dhe rregullator të miratuar:

- Të hartojnë dhe miratojnë një udhëzues të detajuar, ku të pasqyrohen të dhënat mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen.

- Të kryejnë inspektimin çdo 6 muaj të të gjitha subjekteve minerare dhe të miratojnë planet vjetore të punës të subjekteve-zotërues të lejes minerare;

- Të marrin masat për të përputhur treguesit e paraqitur në raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit me treguesit e raportuar në sistemin Revzone dhe treguesit e planit vjetor të miratuar të veprimtarisë minerare të dërguara online nga subjektet AKBN.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për rastet e moskryerjes së inspektimeve dhe mbikëqyrjeve nga AKBN sipas ligjit të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive apo rishikimin e kapaciteteve njerëzore dhe fondeve në dispozicion të kësaj strukture.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dosjes së monitorimit të subjektit “Q.”, hartuar nga strukturat përgjegjëse, në zbatim të detyrimit ligjor dhe autoritetit shtetëror, janë konstatuar problematika në veprimtarinë minerare me qëllim realizimin e mbikëqyrjes e monitorimin dhe konstatimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatimin të lejeve minerare, ku rezultoi se:

a. Nuk ka asnjë dokument të administruar në dosje dhe asnjë deklaram në sistemin Revzone nga ana e këtij subjekti që të konfirmojë kryerjen e pagesës së garancisë së rehabilitimit deri në datën e kryerjes së auditimit.

b. Mungojnë veprimet e strukturës përgjegjëse pas revokimit të lejes minerare, për të kërkuar shlyerjen e detyrimeve financiare të garancisë së rehabilitimit, për të cilat administratori i subjektit ka nënshkruar procesverbalin e komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit.

c. Në mbledhjen e Komisionit të zhvilluar me dt. 06.12.2017 ka munguar drejtuesi teknik në kundërshtim me parashikimet e Nenit 6, pika 2, të Udhëzimit nr.19, dt. 23.01.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planit vjetor të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit”, të AKBN, ku përcaktohet se subjekti në çdo rast përfaqësohet nga drejtuesi teknik, ndërsa procesverbali është nënshkruar nga administratori N. Q.

d. Subjektit i është revokuar leja minerare me shkesën e MIE me nr. 9105/3 prot, datë 19.12.2019, për shkelje të nenit 47, germa ç, të ligjit minerar. Procesi i revokimit është iniciuar sipas raport propozimit të AKBN me nr. 9727 prot., datë 09.11.2016, fillimi i procedurave të revokimit nga ana e MIE i është njoftuar ZLM me shkresën nr.729/1 prot., date 15.01.2018 dhe revokimi i lejes minerare është bërë nga MIE me shkresën nr.4905/1 prot., datë 28.05.2018.

Sa më sipër, në lidhje me mos shlyerjen e detyrimeve të Lejes Minerare të Shfrytëzimit me nr. 12..., datë 18.12.2008, është vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 2, pika 34. Neni 31 “Garancitë financiare për zhvillimin e veprimtarive minerare”, pika 1, Neni 36 “Detyrimet e përgjithshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerare” Neni 47 “Revokimi i lejes”, pika 1 dhe pikën nr. 2 dhe 3, të Udhëzimit nr. 201 datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore e vjetore përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit në karriera për grupin e mineraleve jometalore” të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Aneksi 4 “Formati i tabelës informuese vjetore”, ku në nr. rendor 7, kërkon të dhëna mbi parashikimin dhe realizimin e vlerës në lekë dhe në % të garancisë së rehabilitimit, si dhe tek tabelat e planit, tabela nr. 1 “Formati i tabelës së planit vjetor mineral”, rreshti me nr. 7, “Garancia e rehabilitimit” e detajuar sipas tremujoreve dhe gjithsej vjetor.

Gjithashtu në kundërshtim edhe me Nenin 6, “Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit në komision”, pika 5 të Udhëzimit nr.19, dt.23.01.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planit vjetor të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit”, të AKBN.

- Me datën 27.4.2018 nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit në AKBN, është mbajtur procesverbali për miratimin e planit, ku në faqen e pare të tij është vënë shënimi që “Për materialin gjendje të bëjë shitje”.

- Në mbledhjen e Komisionit të zhvilluar me dt. 27.4.2018 ka munguar drejtuesi teknik, veprim në kundërshtim me parashikimet e Nenit 6, pika 2, të Udhëzimit nr.19, dt.23.01.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planit vjetor të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit”, i ndryshuar, të AKBN, ku përcaktohet se subjekti në çdo rast përfaqësohet nga drejtuesi teknik.

- Subjektit për periudhën 2018-2019 nuk i është miratuar plani vjetor për prodhimin dhe shfrytëzimin e mineraleve jometalor (të llojit gëlqeror pllakor), në përputhje me detyrimet e parashikuara në lejen minerare të miratuar nga ana e Ministrit, por vetëm për shitje të stokut të mineralit jometalor gjendje, ndërkohë që detyrimet për prodhim sipas pikës nr. 7, germa c, të lejes minerare të shfrytëzimit, përcaktojnë se prodhimi mineralit në vit duhet të jetë 3,600 m3/vit dhe fuqia punëtore për realizimin e projektit do të jetë 15 punonjës. Në fakt, sigurimi i jetës është kryer vetëm për 3 punonjës pranë sha “I.” për përudhën 9.5.2018-8.5.2019.

- Nga ana e subjektit zotërues i lejes minerare nuk janë ngarkuar në sistemin rev-zonë raportimet mbi sasinë e prodhimit, rentën, garancitë financiare të rehabilitimit etj. për vitin 2019.

- Subjektit i është revokuar Leja e Mjedisit nga ministria përgjegjëse sipas shkresës nr.159 prot., datë 07.05.2018, për të cilën ka sigurim padie, dhe gjithashtu, subjektit i është revokuar Leja Minerare sipas shkresës së MIE me nr. 9105/3 prot, datë 19.12.2019, për shkelje të nenit 47, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit mineral për të cilën ka vendim të ndërmjetëm për sigurim padie.

- Nga auditimi konstatohet se revokimi nuk ka marrë si bazë përcaktimet sipas nenit 47, pika 1, germa “h”, që parashikon revokimin e lejes minerare, nëse “organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, ka revokuar lejen mjedisore”. Procesi i revokimit është iniciuar sipas raport propozimit të AKBN me nr. 6364 prot., date 21.10.2019, fillimi i procedurave të revokimit nga ana e MIE i është njoftuar ZLM me shkresën nr. 9105/1 prot., datë 29.10.2019 dhe revokimi i lejes minerare është bërë nga MIE me shkresën nr. 9105/4 prot., datë 19.12.2019.

Në kushtet që, si për revokimin e lejes mjedisore ashtu edhe për revokimin e lejes minerare, ka sigurim të objektit të padisë, referuar edhe përcaktimeve të dhëna me shkresat e MIE me nr. 12151/1, datë 16.10.2018 dhe shkresës së DSHL të AKBN me nr. 3882/4, datë 27.7.2018, si dhe vendimit të ndërmjetëm për sigurimin e objektit të padisë datë 19.02.2020, subjekti “Q.” SHPK duhet ti ishte nënshtruar procedurave të miratimit të programit vjetor si dhe

monitorimit periodik e vjetor nga ana e AKBN-së në përputhje më përcaktimet e ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 i ndryshuar, gjë e cila nuk ka ndodhur.

- Nga shqyrtimi i informacionit vjetor të pasqyruar në sistemin revzonë të strukturës përgjegjëse AKBN rezulton se nga ana e subjektit janë evidentuar në revzonë të dhënat vetëm në raportimin vjetor të vitit 2018 dhe nuk ka asnjë të dhënë për raportimin për vitin 2019, 2020 dhe 2021.

Për periudhën 15.10.2018 që është hequr leja mjedisore, pavarësisht aplikimeve dhe ri aplikimeve nga ana e subjektit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (me datën 02.04.2019, 17.6.2019, 19.8.2019, 12.11.2020, nuk ka miratim të lejes mjedisore. Pas riaplikimit me datën 14.4.2021 është miratuar miratimi i ndryshimit të kushteve të lejes mjedisore me nr. PN - 55. Sa më sipër, për periudhën Tetor 2018 deri më 14.4.2021 është pa leje mjedisore dhe ka vijuar procesin e prodhimit dhe shitjes së mineralit, dhe nga ana e strukturës përgjegjëse ka miratuar programin vjetor për vitin 2019 dhe sipas raportit të monitorimit 2019 rezulton se për 6-mujorin e parë të vitit 2019 janë prodhuar 32.000 m³ gur gëlqeror. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-120 të Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi:

Nga AKBN të merren masat që gjatë shqyrtimit të dosjeve të planeve të respektohen forma e informacioneve tremujore e vjetore përfundimtare dhe përmbajtja e planeve vjetore të punës nga ana e zotëruesit të lejes minerare të shfrytëzimit në karriera për grupin e mineraleve jometalore me qëllim shlyerjen e detyrimeve të Lejes Minerare të Shfrytëzimit.

Në vijimësi

2.1 Mbi shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, pezullimeve dhe revokimeve nga ana e AKBN

6. Gjetje nga auditimi: Kundërvajtjet administrative.

Nga auditimi rezulton se nga AKBN janë ndëshkuar dhe/ose propozuar mesatarisht 18 % e zotëruesve lejeve aktive në periudhën 2018-2022, në pjesën më të madhe me **masa administrative gjobë**, pastaj revokime dhe në fund janë pezullimet, përfshirë dhe ato me kërkesën e vetë zotëruesve të lejeve:

- AKBN nuk ka mbajtur të azhurnuar regjistrin e lejeve sipas viteve të periudhës 2018-2022 me rastet e pezullimeve dhe revokimeve, pasi në regjistra pezullime gjithsej për këtë periudhë janë 212 dhe revokime 96.

- Masat administrative për periudhën 2018-2022, gjithsej prej 210, janë marrë kryesisht në vitin 2022 prej 167, në vitin 2019 janë marrë 28 masa dhe në vitin 2021 janë 12 të tilla. Kjo tregon se nga AKBN nuk janë zbatuar në kohë masat administrative, duke krijuar hapësira për deformimin ligjor të kësaj veprimtarie, duke mos vepruar në kohë sipas kërkesave të nenit 45 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar për dënimin me gjobë të shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative.

- Konstatohet që nga ana e AKBN masat për shkeljet për mos dorëzimin e informacionit periodik 3/6 mujor dhe atij vjetor janë bërë edhe 4 vite më pas, në një kohë që kërkesat e nenit 45 të ligjit minerar, pika 4 kërkojnë vendosjen e sanksioneve jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e konstatimit të shkeljes dhe njohjes së shkelësit dhe i njoftimin me shkrim të tij. Theksojmë se një pjese e këtyre masave administrative janë inicuar, bazuar në rekomandimet e KLSH nga auditimet e mëparshme dhe jo nga konstatimet që duhej të bënte struktura përgjegjëse AKBN, pasi ka qenë inaktive në drejtim të zbatimit të legjisllacionit për shkeljet administrative, të përcaktuara në nenin 45 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar.

- Nga të dhënat e AKBN rezulton se vlera gjithsej e gjobave për 210 rastet e periudhës 2018-2022 është në vlerën 28,100 mijë lekë. AKBN nuk ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH, të dhëna për datën e njoftimit të subjektit për shkeljen, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 45, pika 3 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar që kërkon që shkeljet kur konstatohen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit i njoftohet subjektit menjëherë, duke përshkruar shkeljen.

- Referuar të dhënave nga AKBN për masat administrative, rezulton se janë 35 subjekte të cilat janë penalizuar me masa administrative më shumë se dy herë duke vendosur të njëjtën vlerë të gjobës, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 45, pika 7. “Kryerja për herë të dytë nga i njëjti subjekt i shkeljeve të parashikuara në shkronjat “d” dhe “dh” të pikës 1 të këtij neni dënohet me dyfishin e gjobës së parashikuar dhe mund të shoqërohet me pezullimin e lejes minerare deri në plotësimin detyrimit.”, pra duhej të ishte dyfishi i saj, deri në pezullimin me plotësimin e detyrimit.

- Gjithashtu, konstatohet se struktura përgjegjëse AKBN nuk ka dënuar me gjobë të gjitha rastet e mos dorëzimit dhe ose dorëzimit me vonesë të informacionit periodik 3/6 mujor dhe atij vjetor dhe të planeve vjetore të cilat rezultojnë në fakt sipas afateve në periudhën 2018-2022.

- Nga auditimi rezulton se një numër i konsiderueshëm i subjekteve megjithëse dorëzojnë informacionet me vonesë, nuk janë penalizuar nga ana e AKBN: nga 328 subjekte që nuk kanë raportuar ose raportuar me vonesë, janë gjobitur 210 prej tyre ose 64%, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 45 të ligjit minerar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-120 të Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi:

- AKBN të marrë masat për të mbajtur të azhornuar regjistrin e lejeve sipas viteve me rastet e pezullimeve dhe revokimeve.

- AKBN, struktura përgjegjëse të marrin masat për të ushtruar të drejtat dhe detyrimet e tyre lidhur me plotësimin dhe zbatimin nga subjektet minerare të planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare dhe planit të menaxhimit të mbetjeve minerare; sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve; realizimin e programit të investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre veprimtarive; të informacioneve dhe shpjegimeve, jo më pak se 1 vit para, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar etj. Në rastet e mosplotësimit dhe mos zbatimit të tyre të kërkojë vendosjen e masa administrative gjobë, për subjektet minerare.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Pezullimi i lejeve minerare.

Nga auditimi rezulton se nga AKBN janë ndëshkuar dhe/ose propozuar mesatarisht 18 % e zotëruesve lejeve aktive në periudhën 2018-2022, në pjesën më të madhe me masa administrative gjobë, pastaj revokime dhe në fund janë pezullimet, përfshirë dhe ato me kërkesën e vetë zotëruesve të lejeve:

- Bazuar në të dhënat e kërkuara dhe të vëna në dispozicion nga AKBN rezulton se në periudhën 2018-2022 janë propozuar për pezullim nga ana e saj dhe me kërkesë të subjekteve 124 leje, me numrin më të lartë 43 në vitin 2020 dhe më të ulët 4 në vitin 2018. Një tregues i tillë, tregon për veprimtari me mangësi në monitorimin e veprimtarisë minerare nga ana e AKBN, pasi nuk mund të konsiderohet që aktiviteti minerar të ndryshojë (përkeqësoj apo përmirësojë) veprimtarinë e tij në vite të veçanta.

- Nga AKBN nuk paraqitën të dhëna për shkaqet e pezullimit për 71 subjekte gjithsej ose 57 % e tyre, më e theksuar kjo në vitin 2020 dhe 2021, ndërsa pjesa e tjetër janë penalizime kryesisht për mosmiratim plani dhe me kërkesë të vetë subjekteve etj. Veç kësaj, në të dhënat e vëna në dispozicion janë 27 raste të cilësuar si arsye të propozimit për pezullim, sipas AKBN bazuar në nenin 18, pika 1, germa ç/ “Mosmiratim të planit vjetor të punës”, në një kohë që në nenin 46- “Pezullimi i lejes” sipas ligjit minerar të ndryshuar, nuk përfshihet referenca ligjore e mësipërme, duke përdorur referencë ligjore të gabuar. AKBN ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 46, të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, si dhe të VKM nr. 232, datë 23.02.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë”, pika 2, germa “j”.

- AKBN nuk ka ushtruar plotësisht të drejtën që i jep neni 46 i ligjit minerar për të pezulluar lejet minerar të cilat nuk bëjnë sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë; nuk respektojnë të gjitha kërkesat për depozitimin, trajtimin dhe

menaxhimin e mbetjeve minerare dhe trajtimin e ujërave që dalin nga objektet minerare dhe ato të depozitimit të mbetjeve; nuk rehabilitojnë zonën e lejuar minerare, në mënyrë progresive etj.

- Nga Raportet e Monitorimit të periudhës 2018-2022 të përgatitura nga Drejtoria Minerare në AKBN, rezulton se megjithëse në subjektet zotëruese të lejeve janë evidentuar diferenca midis punonjësve gjithsej dhe atyre të siguruar për aksidentet në punë, nuk ka asnjë propozim për pezullim lejeje, duke mos zbatuar kompetencat ligjore të pikës 5 të nenit 36 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr.1109, datë 30.7.2008 “Për sigurimin punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë”.

- Nga pasqyrat e hartuara nga AKBN rezulton se mesatarisht në çdo vit 42 % e subjekteve nuk sigurojnë të gjithë punonjësit e punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë, për të cilët AKBN nuk ka ndërmarrë masën e pezullimit, dhe për subjektet që kanë vijuar me këtë shkelje ligjore nuk ju është revokuar leja, duke mos zbatuar kërkesat e nenit 47, pika 1, germa “g” të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar. Gjithashtu, mos veprimi i AKBN në këtë drejtim, ka ndikuar negativisht në jetën ekonomike dhe sociale të të punësuarve të këtij sektori dhe në të njëjtën kohë në disiplinimin e kësaj veprimtarie të rëndësishme të ekonomisë sonë kombëtare

- Nga 124 propozime vetëm për 8 prej tyre janë paraqitur të dhënat e akt-konstatimeve të specialistëve të Drejtorisë Minerare, për vitet 2019 dhe 2020 megjithëse nuk ka të dhëna në se ato janë të lidhura me periudhën e pandemisë COVID 19, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 46, pika 4: “Shkeljet që bëhen shkak për pezullim konstatohen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit i njoftohet subjektit menjëherë me përshkrimin e arsyes së pezullimit”.

- Nga ana e AKBN nuk janë paraqitur të dhëna për numrin dhe datën e vendimeve për 7 subjekte, ndërsa për pjesën tjetër janë 25 vendime të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN, ku në mungesë të dhënave për datën e akt-konstatimit u bë e pamundur të verifikohet zbatimi i afatit 10 ditor për marrjen e vendimit nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN, sipas kërkesave pikës 3 të nenit 46, të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar: “Vendimi i pezullimit merret nga titullari i strukturës përgjegjëse jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga konstatimi i shkakut të pezullimit dhe njohjes së shkelësit dhe i njoftohen me shkrim shkelësit.”

- Konstatohet se, rastet e pezullimeve nuk janë të reflektuara në raportet e monitorimit të subjekteve minerare. Kështu, në raportin e monitorimit të vëllimit të parë të metaloreve të vitit 2018 jepet vetëm përshkrimi ligjor lidhur me garancitë financiare, por pa përcaktuar numrin e subjekteve të cilët nuk plotësojnë këto kritere dhe penalizimin e tyre.

- Gjithashtu, cilësohet se janë 24 subjekte për të cilët është propozuar revokimi i lejes, por pa përcaktuar se në çfarë faze janë nga ana e shqyrtimit të MIE.

- Sipas raportit për jometalorët të vitit 2019 cilësohet se janë 21 leje minerare të shfrytëzimit që bien në zonë të mbrojtur, pa cilësuar se çfarë do të bëhet më tej me këto leje.

- Në vitin 2020 janë 52 subjekte minerare metalore që kanë kërkuar pezullim të aktivitetit dhe 4 leje që janë propozuar për revokim, dhe në sektorin jometalor janë revokuar 2 leje, si dhe cilësohet se “Theksojmë se në regjistrin elektronik të Lejeve Minerare të Shfrytëzimit kemi leje që ende nuk janë revokuar edhe pse nga ana e AKBN janë bërë propozimet të herëpashershme”. Kjo tregon se nga ana e MIE nuk janë shqyrtuar propozimet e bëra nga AKBN. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-120 të Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi:

AKBN të marrë masat për njoftimin e subjektit menjëherë me përshkrimin e arsyes së pezullimit për shkeljet që bëhen shkak për pezullim, të konstatuara nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit dhe në të njëjtën kohë ti propozojnë Ministrin për masat e penaltitetit që duhet të ndërmerren ndaj subjekteve që nuk respektojnë kërkesat e legjisllacionit minerar mbi bazën e rezultateve të mbikëqyrjes dhe monitorimit të veprimtarive minerare.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Revokimi i lejeve minerare.

Nga auditimi rezulton se nga AKBN janë ndëshkuar dhe/ose propozuar mesatarisht 18 % e zotëruesve lejeve aktive në periudhën 2018-2022, në pjesën më të madhe me masa administrative gjobë, pastaj **revokime** dhe në fund janë pezullimet, përfshirë dhe ato me kërkesën e vetë zotëruesve të lejeve:

- Për vitin 2021, në sektorin e metaloreve janë propozuar për revokim 9 leje minerare dhe për pezullim 15, janë revokuar 3, dhe cilësohen masa administrative për dy subjekte për mos plotësim kushtesh për Inspektim, që tek masat administrative të vena në dispozicion figuron vetëm një prej tyre. Për sektorin minerar jo metalor janë revokuar 4 leje minerare dhe 5 subjekte janë propozuar për revokim.

- Raporti i monitorimit të vitit 2018 shoqërohet me një listë prej 19 subjektesh që janë propozuar në MIE për revokim për mos-pagesë të garancisë së rehabilitimit dhe në vëllimin e dytë. Në këtë raport në vëllimin e parë cilësohet se janë propozuar për revokim gjithsej 45 leje minerare shfrytëzimi, për 37 leje minerare shfrytëzimi ka filluar procedura e revokimit dhe gjatë vitit 2018 janë revokuar 43 leje minerare. Struktura përgjegjëse AKBN, për rastet e propozimit për revokim për shkak të shkeljes ligjore të mos-pagesës së garancisë së rehabilitimit, nuk ka mbajtur akt-konstatimi, por ka dërguar direkt raportin e propozimit në MIE, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit të Ministrit të METE nr.382, datë 20.05.2011 “Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare”, pikat 5, 6 dhe 7.

- Nga shqyrtimi i raporteve të monitorimit të AKBN 2018-2022, rezulton se për katër leje të subjektit “B.” SHA: lejet me nr.15..., datë 22.02.2012; nr. 16..., datë 07.12.2014; nr. 16..., datë 07.02.2014 dhe nr.16..., datë 07.02.2014, megjithëse nuk kanë fare prodhim në periudhën 2014-2021, pra nuk kanë zhvilluar aktivitetet minerar pas marrjes së lejes, AKBN vetëm në vitin 2020, pra pas 6 vitesh i ka propozuar MIE revokimin e tyre, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 47, pika 1, germa “c”, i cili përcakton afatin 180 ditë mos fillim të veprimtarisë minerare si shkak për revokimin e lejes.

- Veç kësaj, edhe pas propozimeve të AKBN për revokim 5 leje minerare MIE, sipas raportit të monitorimit të AKBN të 6 mujorit të parë të vitit 2022, nuk ka dhënë asnjë përgjigje lidhur me statusin e këtyre propozimeve, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 47- Procedura e revokimit të lejes, pikat 1, 2, 3 dhe 5 të këtij neni.

- Gjithashtu rezulton se për periudhën 2018 - 2022 mesatarisht për 130 subjekte, AKBN në cilësinë e strukturës përgjegjëse nuk ka ushtruar kompetencat e saj për t'i propozuar MIE revokimin e lejes minerare për mungesë informacioni dhe/ose informacione të pavërteta, sipas kërkesave të pikës 1, germa “gj” të nenit 47, të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010.

- Nga ana e AKBN nuk është analizuar zbatimi i kritereve të nenit 18, pika 1, germa “e” dhe 25 “e”, në se zotëruesi i lejes së shfrytëzimit ka njoftuar jo më pak se 30 ditë kalendarike më parë, për kërkesën e zvogëlimit në më shumë se 20 për qind të sasisë së prodhimit, të parashikuar në planin e miratuar të prodhimit, pjesë e lejes përkatëse. Nga shqyrtimi i të dhënave të deklaruara nga subjektet minerare për periudhën 2018-2022 janë 182 subjekte që rezultojnë së paku një vit me realizim nën 80% krahasuar me sasinë e prodhimit vjetor të përcaktuar në lejen përkatëse, gjë për të cilën AKBN nuk ka vepruar në zbatim të kërkesave të germës “j” të pikës 1 të nenit 47 të ligjit të mësipërm për të propozuar revokimin e lejes.

- Gjithashtu, nga ana e AKBN nuk është kryer asnjë analizë dhe monitorim lidhur me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 18, pika 1, germa “a” për zotëruesit e lejeve të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, dhe të nenit 25 germa “a” për lejet e shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore në se ka realizuar programin e investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre veprimtarive.

- Sipas të dhënave të subjekteve të deklaruara online në sistemin RevZone të AKBN rezulton se mesatarisht 25 % e subjekteve deklarojnë plan investimi, si dhe nga këto janë 57 % e zotëruesve të lejeve minerare që nuk zbatojnë detyrimin për realizimin e planit të investimeve.

- AKBN, nuk ka shqyrtuar dhe analizuar zbatimin e kërkesave të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 të ndryshuar, neni 47, pika 1, germa “f”, i cili përcakton që në se “zotëruesi i lejes

së shfrytëzimit për dy vjet radhazi dështon në realizimin e 90 për qind të vlerës së investimit, që ka parashikuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare” leja revokohet.

- Nga shqyrtimi i informacioneve të vënë në dispozicion për periudhën 2020-2022, rezulton se në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 janë përkatësisht 18, 20, 32 dhe 43 subjekte, të cilët kanë dështuar në realizimin e 90 për qind të vlerës së investimit për dy vite radhazi, dhe për të cilët AKBN nuk ka ushtruar kompetencat e veta ligjore në propozimin për revokimin e lejes minerare, sipas kërkesave të nenit 47, pika 1, germa “f” të ligjit minerar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-120 të Raportit të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi:

AKBN në cilësinë e strukturës përgjegjëse të marrë masat dhe të ushtrojë kompetencat e saj për t’i propozuar MIE revokimin e lejeve minerare për ato subjekte që ushtrojnë veprimtari minerare dhe nuk japin informacionin e kërkuar nga strukturat përgjegjëse, paraqesin informacione të pavërteta, apo pengojnë strukturën përgjegjëse në ushtrimin e funksioneve të inspektimit, në zbatim të këtij ligji.

Në vijimësi

2.3 Mbi përdorimin e fondit pyjor dhe kullor publik nga subjektet e licencuara në fushën e minierave dhe procedurat e ndjekura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në përdorimin e territorit për këtë qëllim.

9. Gjetje nga auditimi:

Kadastra minerare që administrohet nga QKL nuk pasqyron në mënyrë të drejtë sipas përcaktimeve ligjore sipërfaqen e lejeve minerare, pasi regjistrimi i kësaj pasurie të paluajtshme nuk është bërë pas heqjes nga fondi pyjor e kullor, nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe të Turizmit:

- Nën sistemi i heqjes nga fondi pyjor e kullor, të zonave të lejuara të shfrytëzimit pronë shtetërore si dhe ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullor, nga zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrimit në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas legjislacionit në fuqi, *nuk ka rezultuar efektiv* për periudhën objekt auditimi, Pavarësisht akteve ligjore për transferimin në pronësi të bashkive të fondit pyjor dhe kullor, *realisht bashkive iu janë transferuar vetëm koordinatat takuese në dokumente, pa raketuar fizikisht sipërfaqet takuese të secilës njësi ekonomie pyjore* duke bllokuar mundësinë e krijimit të të ardhurave që ky sektor ofron për institucionet e vetëqeverisjes vendore.

- *Mosveprimet e MTM dhe MIE për heqjen e sipërfaqeve takuese nga fondi pyjor, pas dhënies së lejeve minerare të shfrytëzimit, u ka krijuar subjekteve-zotërues të lejeve, të drejtën për ta përdorur këtë fakt, si shkak/arsye për të kërkuar “pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë”.* Kështu, për shembull, mund të përmendim LMSH nr. 79..., datë 3.12.2014 për subjektin “D. G.” shpk, ka kërkuar miratim të pezullimit të përkohshëm me arsyen “për mos heqje nga fondi pyjor”, (kjo në referim të të dhënave të regjistrimit minerar të AKBN për v.2019).

- Parregullsitë, e konstatuara në fushën e veprimtarisë minerare, dhe në kushtet që kadastra minerare administrohet nga QKL, bëjnë të mundur mos pasqyrimin në mënyrë të drejtë sipas përcaktimeve ligjore të kadastrës minerare, të sipërfaqeve të lejeve minerare, *pasi regjistrimi i kësaj pasurie të paluajtshme në kadastrë, duhet të bëhet pas heqjes nga fondi pyjor e kullor, për të cilën nuk është vepruar nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe të Turizmit,* duke vepruar në kundërshtim me: Nenin 3, pika 32. të ligjit minerar; Neni 15/5, Neni 24/10,

- Konstatohet një mungesë harmonizimi midis përcaktimeve të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 15, pika 5 dhe neni 24, pika 10 dhe VKM nr.1353, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”, pika 1,

- Gjithashtu, konstatohet inkoherençë midis përcaktimeve të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Urdhrit nr.384, datë 20.05.2011 “Për miratimin e procedurave të regjistrimit dhe dokumentacionit që regjistrohet

në Kadastrën Minerare dhe në Regjistrin Minerar, si dhe forma dhe procedurat e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare”, pasi ky Urdhër nuk pasqyron ndryshimet që kanë ndodhur më pas në ligjin minerar: ligji nr. 9/2013, datë 14.02.2013; ligji nr. 134/2014 datë 10.09.2014 dhe nr. 65/2021 datë 20.5.2021.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme për heqjen nga fondi pyjor ngarkohen me përgjegjësi Ministria e Mjediset dhe Turizmit, si dhe për mos ushtrimin e përgjegjësive në zbatimin e politikave dhe strategjisë së zhvillimit të sektorit minerar dhe ushtrimin e një roli më aktiv në drejtim të heqjes nga fondi pyjor e kullësor, të zonave të lejuara të shfrytëzimit pronë shtetërore si dhe ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullësor, nga zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrimit në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, përgjegjësi ka Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 120-130 të Raportit të Auditimit).

9.1. Rekomandimi:

Ministria e Mjediset dhe Turizmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të ushtrojë përgjegjësinë sipas përcaktimeve ligjore në zbatimin e politikave dhe strategjisë së zhvillimit të sektorit minerar dhe ushtrimin e një roli më aktiv në drejtim të heqjes nga fondi pyjor e kullësor, të zonave të lejuara të shfrytëzimit pronë shtetërore si dhe ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullësor, nga zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrimit në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”.

Në vijimësi

A. Mbi veprimtarinë e Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM):

10. Gjetje nga auditimi:

AKSEM për periudhën e audituar 2018 - 2022 nuk ka inspektuar të gjitha subjektet e planifikuara, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera” pika 5/a.

Më hollësisht, nga AKSEM për vitin 2018 nga 819 subjektet e planifikuara, nuk janë inspektuar 253 subjekte; për vitin 2019 dhe 2020 nuk janë i janë nënshtruar inspektimit të përgjithshëm të gjitha subjektet e planifikuara, si dhe për vitin 2022 rezultojnë se nuk janë inspektuar 200 subjekte sipërfaqësore.

Gjithashtu, në Raportin vjetor “Mbi veprimtarinë inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera AKSEM gjatë vitit 2018” dhe Raportin vjetor “Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Inspektimit në vitin 2021” nuk janë paraqitur arsyet për mosrealizimin e këtyre inspektimeve.

- Për vitin 2018, sipas Analizës Statistike të Treguesve të Inspektimit përgatitur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore rezultojnë 44 punëmarrës të aksidentuar dhe 6 punëmarrës të aksidentuar me vdekje në miniera, Nga AKSEM janë inspektuar 35 subjekte minerare për shkak të aksidenteve në punë, kur në Raportin vjetor “Mbi veprimtarinë inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera AKSEM gjatë vitit 2018” nuk ka asnjë të dhënë mbi aksidentet në punë, inspektimet e AKSEM, rezultatet etj.

- Për vitin 2019 rezultojnë 134 punëmarrës të aksidentuar dhe 23 punëmarrës të aksidentuar me vdekje. Në databazën e dërguar nga AKSEM janë shënuar vetëm 2 humbje jete për vitin 2019.

- Për vitin 2020 rezultojnë 28 punëmarrës të aksidentuar dhe 3 punëmarrës të aksidentuar me vdekje. - Për vitin 2022 rezulton se në miniera, karriera ka patur 30 punëmarrës të aksidentuar dhe 5 punëmarrës të aksidentuar me vdekje, ndërsa në databazën e dorëzuar nga AKSEM rezultojnë 4 punonjës të aksidentuar me vdekje.

Sa konstatuar më lart është në kundërshtim me VKM Nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera” pika 5/a. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 130-149 të Raportit të Auditimit).

10.1. Rekomandimi:

AKSEM të marrë masat për kryerjen e plotë dhe në mënyrë të vazhdueshme të inspektimeve në veprimtaritë minerare dhe ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave energjetike për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në minierat nëntokësore dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve

Në vijimësi

C. Shqyrtimi i ankesës së “H. E. T. H”, shoqëria “H.”

11. Gjetje nga auditimi:

Nga shqyrtimi i ankesës rezultoi se MIE nuk ka ezauruar plotësisht dhe në kohë detyrimin për mbarëvajtjen e koncesionit, të përcaktuar në pikën 7.6 të kontratës koncesionare me nr.119 Rep., dhe nr.94 Kol., të datës 12.01.2011 midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “K. K.” SHPK dhe “L. V. T” SHPK. MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të kontratës koncesionare të formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve “K.”, “H. 1” dhe “H. 2” nënshkruar më datë 12.01.2011, ka vepruar në mënyrë jo të plotë dhe me reagim të vonuar. MIE ka vepruar në mënyrë shkresore kryesisht në vitin 2023 duke njoftuar institucionet për kontratën koncesionare me vonesa, kur informacioni për çështjen e marrjes së burimeve ujore që furnizojnë HEC-et nga Ndërmarrja e Ujësjellës - Kanalizime Ersekë është në dhjetor të vitit 2020.

Shoqëria koncesionare ka kërkuar nga:

- MIE që të sigurojë monitorim zyrtar për burimet e K., por akoma nuk ka një rezultat në këtë drejtim;
- AKBN monitorimin që nga viti 2014, në një kohë që ky institucion në varësi të MIE ka për detyrë monitorimin e përvitshëm të HECE-ve.

MIE nuk ka ezauruar plotësisht dhe në kohë detyrimin për mbarëvajtjen e koncesionit, të përcaktuar në pikën 7.6 të kontratës koncesionare me nr.119 Rep., dhe nr.94 Kol., të datës 12.01.2011 midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “K. K” SHPK dhe “L. V. T” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 130-149 të Raportit të Auditimit).

11.1. Rekomandimi:

MIE dhe AKBN të marrin masa të përshpejtuara për të siguruar nga:

- MIE monitorimin zyrtar për burimet e K., duke arritur në një rezultat në këtë drejtim;
- AKBN, institucion në varësi të MIE monitorimin e përvitshëm këtyre HEC-eve.
- MIE të ezaurojë plotësisht dhe në kohë detyrimin për mbarëvajtjen e koncesionit, të përcaktuar në pikën 7.6 të kontratës koncesionare me nr.119 Rep., dhe nr.94 Kol., të datës 12.01.2011 midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “K. K” SHPK dhe “L. V. T.” SHPK.

Në vijimësi

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE, SI DHE MUNGESË TË ARDHURASH.

1.3 Mbi përputhshmërinë ligjore të veprimtarisë së Njesisë së Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për shfuqizimin e masave administrative të marra ndaj zotëruesve të lejes minerare nga Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative janë konstatuar:

- Në mbledhjen e datës 27.07.2018 ka vlerësuar dhe shqyrtuar provat dhe ka njoftuar vendimin e marrë, jashtë afatit prej 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit për 13 raste, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 15 të Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015 “*Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara*”;
- Në mbledhjen e datës 12.07.2018 ka marrë në shqyrtim 1 ankesë e cila nuk ka pasur bashkëngjitur aktin administrativ, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, shkronja “ç” të Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015;
- Në mbledhjen e datës 03.05.2018, në një rast ankesa e marrë në shqyrtim nuk ka pasur aktin administrativ, dhe është dalë me vendim në kundërshtim me pikën 12 shkronja “a”, pasi ankesa nuk ka plotësuar kushtet formale për shqyrtim;
- Në mbledhjen e datës 03.05.2018, në një rast ankesa e marrë në shqyrtim në mënyrë të pa legjitimuar, pasi ankesën është bërë nga struktura përgjegjëse AKBN e cila ka vendosur masën administrative, duke vepruar në kundërshtim me pikën 11, germa “b” të Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015;
- Vendimi nr.431, datë 16.09.2022 për shfuqizimin e 7 masave administrative të marra ndaj zotëruesit të lejes minerare nr.84..., datë 18.03.2005 “A.” SHPK në vlerën **800,000 lekë** është marrë në mungesë të shqyrtimit të plotë të provave shtesë nga struktura përgjegjëse AKBN që ka vendosur masën administrative duke sjellë të ardhura të munguara. Në këtë mënyrë, Njësia ka vepruar në kundërshtim me pikën 14, të Udhëzimit të Ministrit të MIE nr.10, datë 26.01.2015, pasi provat e sjella nga subjekti nuk janë të mjaftueshme për të marrë këtë vendim, dhe duhej vendimi për lënien në fuqi të aktit administrativ, me argumentimin e zbatimit të drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankuesi ka pretenduar shkelje. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-53 të Raportit të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi:

Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative të vlerësojë dhe shqyrtojë provat e sjella nga subjekti për shfuqizimin e masave administrative të marra ndaj zotëruesve të lejeve minerare nëse janë të mjaftueshme për të marrë vendim shfuqizimi ose lënien në fuqi të aktit administrativ, me argumentimin e zbatimit të drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankuesi ka pretenduar shkelje.

Në vijimësi

2.2 Mbi zbatimin e procedurave dhe rezultatet e monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare, si dhe të shoqërive minerare publike.

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për problematikën e konstatuar nga vlerësimi dhe shqyrtimi i zbatimit të procedurave dhe rezultatet e monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare, si dhe të shoqërive minerare publike janë konstatuar problematika në veprimtarinë minerare me qëllim realizimin e mbikëqyrjes e monitorimin dhe konstatimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatimin të lejeve minerare:

- Nuk janë kryer rakordimet mujore të njësive të vetëqeverisjes vendore ku ushtrohet aktivitetet minerar me drejtoritë rajonale të tatimeve dhe degët e doganave për rentën minerare të mbledhur prej tyre, duke sjellë si pasojë që pushtetit vendor të mos i kalohet pjesa takuese sipas ligjit të rentës minerare, duke krijuar të ardhura të munguara për institucionet e pushtetit vendor.

- Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura të subjekteve që kanë qenë zotërues të lejeve minerare referuar të dhënave të vëna në dispozicion, për periudhën 2018-2022 rezultoi se ekziston një nivel i lartë i detyrimeve për garanci rehabilitimi sipas lejes, të papaguara deri në datën e kryerjes së auditimit, nga 72 subjekte që kanë qenë zotërues të lejeve minerare dhe që u është revokuar leja, por që rezultojnë me detyrime të papaguara për garanci rehabilitimi gjatë kohës që këto leje kanë qenë efektive, detyrim i cili për periudhën e audituar është në vlerën prej **21,999,067 lekë** dhe përbën shkelje e disiplinës financiare, si të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit dhe me pasoja në sigurimin e fondeve për rehabilitimin e mjedisit, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

- Nga auditimi u konstatua se në raste të veçanta, zotëruesit e lejeve minerare kanë patur periudha të gjata kohore (deri në 3 vite) pa kryer pagesat e fondeve për garancinë e rehabilitimit dhe nuk janë iniciuar nga ana e strukturës përgjegjëse, veprimet sipas përcaktimeve ligjore për revokimin e lejes minerare dhe me impakt në financat e pushtetit vendor për rehabilitimet e ardhshme të mjedisit.

Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Neni 2, pika 34, Neni 31, pika 1, Neni 36 , Neni 49. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-120 të Raportit të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi:

AKBN, Strukturat Përgjegjëse në plotësim të kuadrit ligjor dhe rregullator të miratuar:

- të miratojnë programe periodike ose të posaçëm, për të ushtruar kontrolle në çdo veprimtari minerare; duke hartuar raporte për mbikëqyrjen e monitorimin e këtyre subjekteve për çdo 6-mujor; ku të shprehen për numrin e punëtoreve, realizimin e prodhimit, treguesit teknologjikë, realizimin e investimeve, realizimi i shitjeve brenda dhe jashtë vendit, të ardhurat e realizuara nga shitjet brenda vendit dhe eksportet, realizimi i rentës minerare; etje.

Në vijimësi

2.1 Mbi shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, pezullimeve dhe revokimeve nga ana e AKBN.

3. Gjetje nga auditimi: Kundërvajtjet administrative.

Nga auditimi rezulton se nga AKBN janë ndëshkuar dhe/ose propozuar mesatarisht 18 % e zotëruesve lejeve aktive në periudhën 2018-2022, në pjesën më të madhe me **masa administrative gjorbë**, përfshirë dhe ato me kërkesën e vetë zotëruesve të lejeve:

- Referuar nenit 45 të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar, rezulton se struktura përgjegjëse AKBN nuk ka ushtruar në mënyrë të plotë të drejtat dhe detyrimet e veta lidhur me rastet e penalizimit me masën administrative gjorbë për mos zbatimin planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare dhe planit të menaxhimit të mbetjeve minerare; për mos sigurimin jetës dhe shëndetit të punonjësve; për mos njoftimin jo më pak se 30 ditë kalendrike më parë, nëse kërkon ta zvogëlojë më shumë se 20 për qind sasinë e prodhimit, të parashikuar në planin e miratuar të prodhimit, pjesë e lejes përkatëse; për mos realizimin e programit të investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre veprimtarive; të mos njoftimit ose të mungesës së informacioneve dhe shpjegimeve, jo më pak se 1 vit para, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar etj. duke vepruar në mënyrë të njëanshme dhe me pasoja si në zhvillimin dhe përparimin e sektorit minerar, ashtu dhe me ndikim në të ardhurat buxhetore nga burime të planifikuara (renta minerare) dhe të paplanifikuara (gjobat).

- Nga të dhënat e AKBN rezulton se, nga 150 masat administrative të vitit 2022 të dhëna nga Drejtoria e Minierave, në 8 raste gjoba është ekzekutuar vullnetarisht, vetëm në 3 prej tyre nga gjykata është lëshuar urdhri i ekzekutimit, për 21 raste është kërkuar në gjykatë nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit dhe për pjesën tjetër janë marrë përgjigjet nga posta për dijeninë ose jo nga ana e subjekteve, pra për 121 prej tyre ose për 85 % të gjobave nuk ka nisur procedura e vjeljes tyre. AKBN nuk ka zbatuar kërkesat e pikës 6 të nenit 45 të ligjit minerar nr. 10304,

datë 15.7.2010 i ndryshuar që gjoba të paguhet brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj, përveçse kur vendimi për dhënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit në fuqi, duke ulur ndjeshëm efektet e masave të ndëshkimit me gjobë të zotëruesve të lejeve minerare në drejtim të disiplinimit të veprimtarisë së sektorit minerar. Kështu, sipas të dhënave të vëna në dispozicion mbetet për t'u arkëtuar shuma prej **27,200 mijë** lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-120 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi:

- AKBN në zbatim të kërkesave të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 të marrë masat për nisjen e procedurës së vjeljes së detyrimit në shumën **27,200 mijë** lekë si masa administrative ndaj 121 subjekteve zotërues të lejeve minerare me qëllim disiplinimin e veprimtarisë së sektorit minerar.

Në vijimësi

C-Mbi veprimtarinë postminerare të AKBN 2018-2022.

4. Gjetje nga auditimi:

Veprimtaria monitoruese e AKBN lidhur me monitorimin minerar dhe post minerar të minierave të mbyllura në regjim konservimi; me mbikëqyrjen dhe monitorimin e depozitimeve të mbetjeve minerare në veprimtari shfrytëzimi, të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi dhe me raportimin për gjendjen aktuale të tyre ka rezultuar me mangësi:

- Nga ana e AKBN, këto raporte monitorimi cilësohen projekte pjesë e investimeve publike të financuara në buxhetin vjetor, dhe jo si pjesë e veprimtarisë funksionale dhe e raportimit, në përputhje me detyrat përkatëse;

- Raportet nuk ezaurojnë plotësisht çështjet e monitorimit postminerar në lidhje me regjistrimin, mbajtjen nën kontroll të ndryshimeve fiziografike të tokës, ajrit, ujërave, sipërfaqësore apo nëntokësore, dhe ekosistemit në përgjithësi, në zonat ku është ushtruar veprimtari minerare, në zonat përreth tyre, si dhe marrja e masave parandaluese për fenomenet negative, që shfaqen pas veprimtarisë minerare, në kundërshtim me përcaktimet e funksionet e monitorimit minerar dhe postminerar, të përcaktuara në pikën 24 të nenit 2 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar.

- Raportet ruajnë strukturë të njëjtë dhe nuk ndryshojnë thelbësisht në përmbajtje gjë që tregon për mungesë thellimi të veprimtarisë në këtë drejtim, si dhe mungesë efektivitetit të funksionimit të strukturës përgjegjëse.

- Sipas Raporteve, deri në fund të vitit 2021 janë gjithsej 385 leje minerare të revokuara, për të cilat AKBN nuk disponon informacion mbi statusin aktual të tyre, gjë që tregon mangësi komunikimi nga ana e MIE kundrejt strukturës përgjegjëse.

- Në raporte nuk gjejnë pasqyrim çështjet e monitorimit të depozitimeve të mbetjeve minerare të minierave në veprimtari të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi, sipas përcaktimeve në germen "d" të pikës 2 të nenit 43 të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 i ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i raporteve konstatohet se, AKBN nuk ka një informacion të plotë dhe të detajuar për zbatimin e planit të rehabilitimit, zbatimin e procedurave të mbylljes së minierave të braktisura të shfrytëzuar nga shteti, si dhe mungon një pasqyrim plotë për zonat e lejeve minerare të propozuara për konservim.

Mangësitë e konstatuara kanë sjellë për pasojë uljen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike në vlerën gjithsej prej **26,200 mijë lekë** të përdorura në periudhën 2018-2021 si investime në hartimin e raporteve vjetore "Monitorimi i fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-120 të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi:

AKBN në të ardhmen të mara masat për hartimin e raporteve të monitorimit me një informacion të plotë dhe të detajuar për zbatimin e planit të rehabilitimit, zbatimin e procedurave të mbylljes së minierave të braktisura të shfrytëzuar nga shteti, si dhe hartimi i një pasqyrimi të plotë për zonat e lejeve minerare të propozuara për konservim me qëllim

rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike si investime në hartimin e raporteve vjetore mbi monitorimin e fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura.

Në vijimësi

B. Mbi shoqëritë minerare në likuidim.

5. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi rezultoi se për Shoqërinë “A.” Sh.a në likuidim e sipër pagesat e kryera për shërbimet e ekspertizës së pasqyrave financiare vjetore nga audituesit ligjorë në shumën gjithsej prej lekë dhe rezultoi se, në fund të v. 2023, sipas shkresës nr. 30/1 datë 20.2.2023 të shoqërisë drejtuar MFE, detyrimet e mbartura të shoqërisë për moslikuidim të audituesve ligjorë për shërbimet e kryera mbi auditimin e pasqyrave financiare të periudhës 2015- 2021 janë në shumën prej 3,300 mijë lekë. Gjatë vitit 2018-2020 janë kryer pagesat për ekspertët kontabël në shumën prej 1,440 mijë lekë. **Vlera e pagesës për ekspertët kontabël prej 4,740 mijë lekë përbën shpenzim pa ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit.**

- Për Shoqërinë “A.” SH.A në likuidim e sipër, u konstatua se për shërbimet e auditimit të pasqyrave financiare vjetore, janë kryer pagesat e audituesve ligjorë (Ekspertët Kontabël të Autorizuar), për çdo vit, në shumën totale prej 2,080 mijë lekë, nga ku: për vitit 2018 është paguar shuma prej 480 mijë lekë dhe gjatë periudhës tjetër 2019-2022 është kryer likuidimi i shumës prej 400 mijë lekë në vit. **Vlera e pagesës për ekspertët kontabël prej 2,080 mijë lekë përbën shpenzim pa ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit.**

- Për Shoqërinë “A.” SH.A në likuidim e sipër, u konstatua:

1- Shoqëria Anonime “A.” Sh.a, në krijimin e saj, nuk ka trashëguar dokumentacionin e duhur për asetet e gjashtë Sh.a-ve bashkëthemeluese të saj, situatë që ka krijuar probleme për administrimin e asetëve të kësaj shoqërie dhe për përcaktimin e saktë të zonave minerare të rrezikshme në territoret në juridiksionin e saj.

2 - Bashkimi i gjashtë sh.a-ve, bashkëthemeluese të “A.” Sh.a, është realizuar nga bashkimi formal matematikor, i vlerave të bilanceve të ish-shoqërive, në të cilët, vlerat e pasqyruara me postet e aktivitetit dhe pasivitetit rezultojnë pa analizë, pa mbështetje dhe rakordim me inventarë të rregullt të vlerave të Aktiveve Qarkullueshme të Trupëzuara dhe Aktiveve Qarkulluese duke trashëguar një bilanc joreal të kësaj Shoqërie **pa si:**

- Nuk kanë patur bilance ekonomike të sakta, për periudhën kur ato kanë funksionuar si subjekte më vete; Llogarite inventariale të tyre kanë qenë të paargumentuara; Detyrimet debitorë e kreditorë të Shoqërive anonime, bashkëthemeluese të “A.” Sh.a, kanë qenë të pashoqëruara me dokumentacion bazë e origjinal justifikues (fletë-dalje, fatura, kontrata etj); Në bilancin e Shoqërisë janë përfshirë dhe objekte ndërtimore sipërfaqësore të cilat, në momentin e themelimit të saj ishin të zëna nga banorë, etj.

3. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, mbi 352 aktive afatgjata/pasuri sipërfaqësore që administrohen nga “A.” sha në likuidim e sipër, me vlerë fillestare në kontabilitet prej 499,724,696 lekë gjithsej, në fakt janë të kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasin periudhës 1970 e në vijim dhe kjo tregon për mospërputhje të gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me konfirmimin e dokumentacionit financiar dhe se ky informacion kontabl nuk pasqyron gjendjen e vërtetë vlerore të këtyre pasurive. **Mos kryerja e rivlerësimit të aktiveve afatgjata ka sjellë rrezikun e amortizimit total të tyre duke shmangur krijimin e të ardhurave nga shitja e këtyre aktiveve.**

4. Procesi ligjor i likuidimit të këtyre shoqërive është vonuar dhe tej zgjatur dhe nuk është përfunduar në kohë, deri në shkrirjen dhe çregjistrimin përfundimtar të këtyre shoqërive. **Shpenzimet që i ngarkohen buxhetit të shtetit për kostot e stafit administrativ të minierave me status “Sha në likuidim e sipër” janë të konsiderueshme dhe përbejnë shpenzime pa ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit.**

5. Konstatohet se ka një mungesë koordinimi dhe bashkërendimi midis MIE dhe shoqërive në likuidim e sipër, për rastet kur këto pasuri, galeri dhe zona minerare, jepen për shfrytëzim sipas lejeve të shfrytëzimit, për zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit, që janë pjesë e këtyre shoqërive në likuidim e sipër.

6. Shkurtimi dhe evitimi i kostove financiare për zëra të tillë shpenzimesh si “*Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës*”, pagesat e kryera për ekspertët kontabël të autorizuar etj. pasi për periudhën objekt auditimi këto tre sha në likuidim e sipër kanë funksionuar si institucione të pastra buxhetore, ku janë financuar në masën 100 % të tyre dhe ndonëse qëllimi i likuidimit është shitja e asetëve dhe likuidimi i kreditorëve, aktiviteti i shitjes së aktiveve ka qenë i pezulluar, duke përbërë një barrë të paargumentuar për buxhetin e shtetit, për aq kohë që, këto shoqëri nuk kanë asnjë aktivitet prodhimi, ato kryejnë vetëm monitorimin e minierave dhe asetëve, dhe paguajnë vetëm një nomenklaturë të reduktuar shpenzimesh. **Shpenzimet sa trajtuar më sipër përbejnë shpenzime pa ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit.** Gjithashtu, në ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar neni 198, është përcaktuar se likuiduesi duhet të përgatitë bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave dhe vetëm kur procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 130-149 të Raportit të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi:

- MIE dhe “A.” sha të marrin masat për rivlerësimin e aktiveve afatgjata pasuri sipërfaqësore që administrohen nga “A.” sha në likuidim e sipër, të cilat janë kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasin periudhës 1970 e në vijim, për përputhjen e gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me dokumentacionin financiar me qëllim pasqyrimin e vërtetë të vlerave të këtyre pasurive.

- Nga MIE të përshpejtohet procesi ligjor i likuidimit të këtyre shoqërive, deri në shkrirjen dhe çregjistrimin përfundimtar të këtyre shoqërive duke evituar shpenzimet e konsiderueshme që i ngarkohen buxhetit të shtetit për kostot e stafit administrativ të minierave, shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe shpenzimet për kontraktimin e ekspertëve kontabël me status “*Sha në likuidim e sipër*” pasi këto shoqëri nuk kryejnë asnjë aktivitet prodhues por vetëm monitorimin e minierave dhe asetëve. Gjithashtu nga MIE, të studiohet dhe gjykohet mundësia e bashkimit me anë të përthithjes së të këtyre tre sha-ve që operojnë në sektorin e industrisë minerare, në një shoqëri më vete, e cila duhet të realizojë procedurat e likuidimit të shoqërisë dhe të përjashtohet nga skema e financimit buxhetor.

- Nga MIE të merren masat për koordinimin dhe bashkërendimin me shoqëritë në likuidim e sipër, për rastet kur këto pasuri, galeri dhe zona minerare, jepen për shfrytëzim sipas lejeve të shfrytëzimit, për zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit, që janë pjesë e këtyre shoqërive në likuidim e sipër.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, geramat (b, c, ç) e nenin 58 “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës*”, i ndryshuar, i rekomandohet Titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë disiplinore për drejtuesit e institucioneve të audituara, si dhe këto të fundit për punonjësit e varësisë sipas përgjegjësisë individuale dhe funksioneve zyrtare që mbajnë, si dhe të nisin procedurat për dhënien e masave disiplinore, në përputhje me kuadrin ligjor të rregullimit të marrëdhënieve përkatëse të punës.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.